

Kriza globale

Debate rreth 11 Shtatorit



Ahmet Davutogllu

Ahmet Davutogllu | KRIZA GLOBALE

LOGOS-A



KRIZA GLOBALE
/DEBATE RRETH 11 SHATORIT/

Ahmet Davutogllu

© LOGOS - A
2 0 0 9



S H K U P
PRISHTINË
T I R A N Ë

Ahmet Davutogllu

KRIZA GLOBALE
/Debate rreth 11 shtatorit/

Boton: Logos-A

Biblioteka: Lexo

Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Redaktor biblioteke: Ali Pajaziti

Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi

Redaktor teknik: Afrim Gashi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

Shtypi: Focus - Shkup

Copyright©Logos-A, 2009

Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet në

Bibliotekën Kombëtare Universitare

ISBN 9989-58-288-2

www.logos-a.com.mk

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

*Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe
jofitimprurës.*

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit

apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.

Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi

pa lejen paraprake të Logos-A.

KRIZA GLOBALE

/DEBATE RRETH 11 SHATORIT/

Ahmed Davutogllu

E PËRKTHEU NGA TURQISHTJA:

Ali Pajaziti

TITULLI I ORIGJINALIT:

Ahmed Davutoğlu

Küresel Bunalım

11 Eylül Konuşmaları

Küre Yayınları, İstanbul, 2002



Përmbajtja:

Dy fjalë për botimin në gjuhën shqipe 7

Parathënie 13

Dimensionet filozofike dhe strategjike të krizës globale 25

Dimensioni filozofik 30

Vetëbesimi i tronditur 37

Dimensioni strategjik 43

Tri prirjet 49

11 Shtatori dhe qorrsokaket filozofike të kërkimeve të rendit të ri 65

Qorrsokaku i Amerikës 74

Globalizmi dhe perceptimi i vlerës 82

Kriza globale, Perëndimi dhe ShBA 91

Fundamentalizmi i krishterë 100

Orientime të reja strategjike 109

Amerika në provim 119

Kriza globale dhe bota islame 128

Kriza e Perëndimit 136

Hapësira e sigurisë ontologjike në Islam 146

Provimi i botës islame 157

Kriza globale dhe Turqia 180

Marrëdhëniet NATO-Turqi 191
Prapaskena e mendësisë strategjike 199
Kërkimi i lirisë dhe globalizimi 216
11 Shtatori dhe thellësia strategjike e Turqisë 227
Perceptimi i kohës dhe hapësirës strategjike 234
Turqia u kap e papërgatitur 238
Misioni i Turqisë 247
Takimi i qytetërimeve dhe roli i Turqisë 254
Shekulli i fundit i Perëndimit 302
Dinamizmi i botës islame 314
Përplasja e interesave: një shpjegim për (pa)rendin e botës 321
Teoritë pas Luftës së Ftohtë 321
Gjeopolitika dhe ekologjia e sistemit politik global 326
Fundi i stabilitetit strategjik 333
Zbrazëtia gjeopolitike dhe gjeoekonomike e pushtetit 335
Bota myslimane: kërcënim antisistemor apo viktimë e përplasjes gjeopolitike? 341
Aventurizmi strategjik ose thjesht rendi global 352
Treguesi i emrave dhe nocioneve 361
Ahmet Davutogllu 367

Dy fjalë për botimin në gjuhën shqipe

Ballkani, duke pasur rëndësi gjeopolitike - meqë formon brezin themelor, i cili prej stepave të Euroazisë zbrit në Detin Mesdhe - dhe gjeokulturore, si zonë që e ndan Lindjen nga Perëndimi, përgjatë shekullit XX ka qenë njëri prej rajoneve më të përshkuara nëpër shndërrime dhe kriza të ndryshme, të cilat kanë ndikuar thellë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Krizat, luftërat dhe transformimet globale të shekullit XX, pasqyrimet dhe ndikimet e veta të drejtpërdrejta i kanë shfaqur pikërisht në Ballkan, hapësirë kjo që me një fjalë ka luajtur rolin e gjilpërës së busullës.

Tri luftërat e shekullit XX me pasoja të përmasave globale (Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore dhe Lufta e Ftohtë) për nga shkaqet dhe pasojat janë ndikuar nga trojet ballkanike, por edhe kanë ndikuar në to. Në fillim të shekullit në fjalë, në nënqiellin ballkanas, me goditjen e një plumbi filloi një luftë botërore e përmasave të papara deri në atë kohë; aty nga mesi i shekullit, shpërtheu Lufta e Dytë Botërore që ndikimin e vet më shkatërrimtar e shfaqti në Evropën Lindore dhe në Ballkan, e më në fund Lufta e Ftohtë, - që e shënoi gjysmën e dytë të shekullit të kaluar dhe që shkaktoi ndasi globale mes Bllokut Lindor e atij Perëndimor - refleksionet e veta ndarëse rajonale i pati gjithashtu në Ballkan.

Shikuar nga këndi i tensioneve dhe shndërrimeve të periudhës pas Luftës së Ftohtë, mund të thuhet se me rëndësi të madhe është simbolika e rrënimit të tri strukturave, që përbëjnë shenja me peshë të tranzicionit psikologjik dhe strategjik të epokës pas rënies së “perdes së hekurt”: Muri i Berlinit, Ura e Mostarit dhe Kullat Binjake.

Rrënimi i Murit të Berlinit është perceptuar si fund i poleve dhe i kufijve të prerë në sistemin ndërkombëtar, si fillim i jetësimit të lirisë dhe sigurisë së përmasave globale. Në kuadër të kësaj atmosfere optimiste u përftuan konceptet për “Rendin e Ri Botëror” dhe “Fundin e historisë”.

Në Ballkan atmosfera shpresëmirë e pas Luftës së Ftohtë me zhvillimet që ndodhën atje, u tret tërësisht. Në këtë kontekst, ndodhitë e periudhës mes shembjes së Murit të Berlinit deri te shembja e Urës së Mostarit e lëkundën nga themeli optimizmin psikologjik dhe strategjik. Ndërsa rënia e Murit të Berlinit simbolizonte çlirimin dhe bashkekzistencën, anasjelltas, shkatërrimi i Urës së Mostarit në të njëjtën masë simbolizonte pasigurinë, barbarizmin dhe largimin prej njëri-tjetrit. Rrënimi i kësaj ure nuk ishte vetëm ndarje e dy anëve të qytetit, por përbënte një sulm barbar që i hapte rrugët shkëputjes mes kulturave dhe qytetërimeve.

Njerëzimi, i cili e festoi shembjen e Murit të Berlinit i bashkuar, duhej të reagoonte ndaj rrënimit të Urës së Mostarit. Por ç’do që një gjë e tillë s’ndodhi dhe ky mosreagim i hapi rrugën njërit prej gjenocideve më të tmerrshme që ka parë ndonjëherë njerëzimi, gjenocidit

të Srebrenicës, i cili ndodhi para syve të forcave të Kombeve të Bashkuara. Mosndëshkimi i fajtorëve dhe pranimi i tyre si palë legjitime në Marrëveshjen e Dejttonit, solli me vete përpjekjet për bartjen e eliminimit gjakatar etnik në Kosovë.

Ballkani, me strukturën e vet shumëkulturore në aspektin filzofik dhe me cilësinë e të qenit hapësirë kalmitare në aspektin strategjik, e ka dhënë provimin përgjatë historisë për ndërtimin e një mikrosistemi të qëndrueshëm. Ata që s'kanë arritur të jenë të sukseshëm në këtë mikrosistem, s'kanë arritur të kalojnë në struktura më të mëdha. Shikuar nga kjo perspektivë, mund të themi se përjetimi i provimeve të rënda të periudhës pas Luftës së Ftohtë nuk është rastësi.

Zhvillimet që ndodhën në Ballkan pas përfundimit të Luftës së Ftohtë kanë treguar qartë se fuqitë qendrore të sistemit ndërkombëtar s'arritën të gjenin një sfond të përbashkët filzofik dhe strategjik as për ndërtimin e një rendi të përmasave evropiane, le më të atyre globale. Sistemi ndërkombëtar s'e kaloi provimin e Ballkanit si zonë thyerëse e shumë perandorive dhe sistemeve politike.

Rrënimi i Urës së Mostarit në shikim të parë simbolizonte një krizë të përmasave rajonale, por mostekalimi i kësaj krize dhe tensionet që i solli ajo me vete, paraprinë rrënimin e Kullave Binjake, që përbën një pasqyrim simbolik të një krize globale. Rrëzimi e Murit të Berlinit shpresat për liri dhe siguri rajonale i shndërroi në shpresa globale. Shkatërrimi i Urës së Mostarit në harkun e një krize rajonale shaktoi shpresëthyerjen globale. Shembja e Kullave Binja-

ke, tensionet e mbledhura nga hapësirat e krizave rajonale i shndërroi në një problem të sigurisë globale.

Sikur vlerat e përftuara me rrëzimin e Murit të Berlinit të ishin jetësuar në Ballkan përmes mjeteve filozofike dhe strategjike, Ura e Mostarit ndoshta nuk do të rrënohej dhe shpresat në drejtim të rendit global do të mbeteshin gjallë. Sikur të ishin nxjerrë mësim nga rrënimi i Urës së Mostarit, krizat rajonale nuk do të ishin vënë nën gjendje të ngrirë dhe tensionet që çonin në shkatërrimin e kullave binjake do të mënjanoheshin. Njerëzit e pafajshëm të vrarë dhe vlerat njerëzore të shkatërruara nëpër zonat e krizës, duke filluar nga Ballkani e gjithandej në periudhën pas Luftës së Ftohtë, dhe njerëzit e pafajshëm të vrarë në sulmin e 11 shtatorit përbëjnë pamje të ndryshme të së njëjtës krizës të shfaqur në hapësira gjeografike të ndryshme.

Për këtë arsye sot njerëzimi, për ta kapërcyer këtë krizë, duhet të bëjë përlogari të brendshme shumë më përfshirëse. Për t'i tejkaluar krizat rajonale dhe për të krijuar fusha të sigurisë e të lirisë të përmasave globale duhet që intelektualët e çdo pellgu kulturor, fetar dhe qytetërimor të orientohen drejt horizonteve të reja. Në këtë drejtim, duhet të bëhet riinterpretimi i marrëdhënieve Lindje-Perëndim, Islam-Krishterim-Hebraizëm dhe të rishqyrtohen shkaqet filozofike e strategjike të krizës globale që po përjetojmë. Diskutimi i këtyre çështjeve në Ballkan në mënyrë të shëndoshë është me shumë rëndësi si për paqen rajonale, ashtu edhe për atë globale.

Vepra që e keni në duar përbëhet nga intervistat e mia të dhëna menjëherë pas 11 shtatorit. Në këtë vepër flitet për globalizimin në kornizat e 11 Shtatorit, për marrëdhëniet ndërqytetërimore, për përmasat filozofike dhe strategjike të krizës globale, në të bëhet vlerësimi i kësaj krize nga këndi i Perëndimit, nga ai i ShBA, i botës islame, nga këndvështrimi i Turqisë etj. Botimi i këtyre shkrimeve në gjuhën shqipe për mua është me shumë rëndësi, para së gjithash për shkak të mundësisë për vendosjen e kontakteve me botën kulturore të Ballkanit në përgjithësi dhe me atë shqiptare në veçanti. Ne që me shekuj të tërë jemi fëmijë të të njëjtit pellg kulturor, qoftë edhe kaq me vonesë, është e udhës që përsëri të njihemi në nivelin intelektual dhe të jemi në lidhje. Kjo nuk është vetëm një mundësi, por edhe një gjë të cilën domosdo duhet ta bëjmë.

Shpresojmë që përkthimi i kësaj vepre të ndihmojë në krijimin e raporteve të reja dhe të shëndosha mes qarqeve kulturore të Shkupit dhe atyre të Stambollit. E ndiej si borxh që të falënderoj zotëri Adnan Ismailin për përpjekjet e tij të jashtëzakonshme për realizimin e përkthimit të kësaj vepre në gjuhën shqipe, përkthyesin Ali Pajaziti dhe të gjithë punonjësit në Shtëpinë botuese, të cilët kanë dhënë ndihmesën e tyre që ky libër ta shohë dritën.

Ahmet DAVUTOGLLU
Stamboll, 20 gusht 2005

Parathënie

Thesari mendor i njeriut bazohet mbi tri shtylla: mendimi, debati dhe shkrimi. Ndërmjet këtyre shtyllave ka lidhshmëri përplotësuese si nga këndi i thesarit të subjektit, ashtu edhe nga i komunikimit të këtij subjekti me palën tjetër. Por këto veprime mendore kanë veçori dalluese si për nga cilësitë, ashtu edhe për nga spektri i fushave të përgjegjësisë shoqërore.

Mendimi përbën një aventurë ideore të subjektit brenda botës së vet të brendshme, që mund të kufizohet vetëm me kushtet e veta subjektive. Për këtë arsye themi se prej të tria veprimeve ideore të zëna ngoje, më i liri (në kuptim të lirisë e jo të vlerës - A.P.) dhe më i pakufishmi është mendimi. Nëpër kokë mund të na qarkullojnë ide të shumta, të cilat në botën tonë të brendshme vazhdimisht lëvizin në gjendje dialektike. Horizonti i lirisë së mendimit fiton gjerësi në saje të thesarit intelektual, kurse kufijtë e tij mund të përcaktohen përmes moralitetit të thellë, i cili pasqyron mundësinë që subjekti të bëjë dialog me vetveten.

Duke e pasur parasysh faktin se subjekti s'mund të nxirret prej botës së vet të brendshme pa vullnetin e vet, themi se është e pamundur që ta kufizosh apo ta vësh në përgjegjësi atë. Mendimi që s'është reflektuar te bota e jashtme dhe te marrësit, mund të ndërtohet, të përthellohet dhe të ekzaminohet vetëm nga vetë subjekti. Mendimi mund ta arrijë thellësinë në

saje të shëndetit të vet të brendshëm. Subjekti që s'e ka përjetuar procesin e dialektikës së brendshme është një botë e propozicioneve statike e jo horizont mendimor, që kërkon të thellohet e të rindërtohet përmes provave.

Të folurit përbën përcjelljen e aventurës mendore personale dhe të lirë të subjektit deri te marrësi, duke shfrytëzuar mjetet e gjuhës. Në këtë përcjellje imazhet shndërrohen në fjalë, kurse idetë fluide fitojnë formë shprehjeje brenda kallëpeve të gjuhës. Fuqia, përfshirja dhe llojshmëria e mendimit përcillen në botën e marrësit duke u kufizuar brenda këtyre kallëpeve. Si në çdo veprim të shndërrimit dhe të përcjelljes, edhe në kalimin prej mendimit në të folur, përballemi me njëfarë thyerjeje dhe humbjeje të fuqisë.

Të folurit, ndryshe prej mendimit, është një veprim mendor që kërkon dy palë, prej të cilave njëra është pak më aktive (folësi) dhe tjetra më pasive (dëgjuesi). Por dukja e njëres palë si pasive, nuk do të thotë se ajo s'mund të ketë ndonjë ndikim përcaktues. Përkundrazi, marrësi është pasqyrim i subjektit folës. Ai nuk është vetëm dëgjues pasiv, por në të njëjtën kohë është edhe nxitës aktiv i bisedës. Madje edhe dallgët e detit, të cilat Ciceroni i merrte si palë bisedimi, kishin aftësi që të ndikonin te subjekti folës.

Mendimi që s'gjen palë për bisedë e fut subjektin në telashe, të cilat u përngjajnë dhimbjeve të nënës që përvëlohet pse s'ia del ta lindë fëmijën. Nga ana tjetër, subjekti që mundohet ta gjejë palën tjetër të bisedës duke folur vazhdimisht dhe që veten e rregullon sipas marrësit, dalngadalë shkon duke u shndërruar

në objekt dhe më në fund e humb origjinalitetin e mendimit dhe të të qenët vetvetja. Biseda mund të jetë e kuptimtë vetëm nëse përbëhet nga mendimi, nga pala tjetër e bisedës e cila përmes këtij mendimi dëshiron të hyjë në marrëdhënie dialektike, dhe nga koniunktura që e bashkon subjektin me marrësin. Në të kundërtën, mund të flitet për deklaratë të njëanshme, për dialog të të shurdhërve ose për përpjekje intelektuale abstrakte.

Shikuar nga prizmi i marrësit, subjektit dhe gjendjes, biseda përbën përpjekjen për ndërlidhje me një palë në kuadër të koniunkturës ekzistuese, kurse shkrimi është përpjekje për shumëllojzimin e marrësit dhe për përhapjen e tij në të ardhmen, duke e thelluar edhe vetë koniunkturën. Biseda është orvatje për ta çuar mendjen e marrësit të regjistrojë, kurse shkrimi përfaqëson përpjekjen për të regjistruar në histori dhe në mendjen e marrësit të panjohur.

Gjatë bisedës në plan të parë del komunikimi i bazuar në ndikimin e çastit, kurse në shkrim, komunikimi i vazhdueshëm. Shikuar nga ky prizëm, mund të thuhet se mendimi i përngjan një shigjete që në vete bart shërimin dhe që në çdo çast e pret rastin për të fluturuar. Biseda është në pozitë të lëkundjes së shigjetës drejt një qëllimi të caktuar në kuadër të aksh perspektive, kurse shkrimi, drejtimin e saj (shigjetës) drejt qëllimeve të panumërta në kuadër të koniunkturave që në çdo çast mund të ndryshojnë. Përderisa shigjeta e tendosur në hark është nën kontrollin e dorës që e mban, për shigjetën e bisedës që ka një synim dhe atë të shkrimit shumësynimëshe, era, domethënë

koniunktura, qëllimi dhe pozita e marrësit fillojnë të kenë rol përcaktues. Sa më i përgatitur dhe më i pasionuar të jetë subjekti që e tërheq harkun, aq më i madh është edhe ndikimi i shigjetës mbi koniunkturën dhe mbi cakun. Kjo forcë e ndikimit, në të njëjtën kohë paraqet edhe fushën e përgjegjësisë sociale të subjektit. Një element i mendimit që në mendjen tuaj është i padëmshëm, madje tepër i dobishëm dhe i nevojshëm, për marrësin e bisedës ose të shkrimit mund të shndërrohet në ilaç helmues.

Pra, mund të thuhet se shkrimi, si nga prizmi i lirisë dhe i përgjegjësisë, ashtu edhe nga ai i metodës dhe mjeteve, dallohet prej mendimit e bisedës. Ndërsa mendimi nuk njih kurrfarë kufizimi lirie, biseda sjell kufizim koniunktural lidhur me marrësin, kurse shkrimi ngërthen kufizim metodik. Shikuar nga perspektiva e lirisë, madje edhe fjalimi më i mirë është më i kufizuar se mendimi, kurse shkrimi më i mirë është më i kufizuar se fjalimi. Mendimet që kalojnë lirisht nëpër mendjen e njeriut ngushtohen me kufijtë gjuhësorë të bisedës, kurse brenga metodike e shkrimit i fut elementet e mendimit në një tunel të ngushtë. Metoda e të menduarit ka rëndësi për qëndrueshmërinë e brendshme të subjektit, metoda e debatit është e rëndësishme nga këndi i përcjelljes deri te pala tjetër, kurse në shkrim është me peshë nga aspekti i vazhdimësisë. Metoda shkrimit e bën të vazhdueshëm, por në të njëjtën kohë ia kufizon fushën e lirisë mendimit fluid.

Mendimi është fryt i subjektit që s'ka kurrfarë ndërmjetësuesi. Te biseda kemi shfrytëzim të mjeteve

njerëzore, kurse te shkrimi shënohet përpjekja për të komunikuar mbi sendet. Ndërsa televizioni dhe shtypi i japin bisedës një dimension të ri në saje të mjeteve, kompjuteri e përforcon qëndrueshmërinë e shkrimit.

Tejza akiliane e revolucionit modern nga sfera e komunikimit që subjektin - i cili duhet të jetë burim dhe kontrollues i mendimit - e ka shndërruar në mjet të komunikimit, është shkatërrimi i ekuilibrit mes subjektit, marrësit dhe gjendjes, hapja e një fushe të pakontrolluar të ndikimit dhe lëkundja e fortë e marrëdhënieve mendimi-morali. Komunikimi modern ia ka humbur vlerën dijes dhe e ka shndërruar në mjet të arritjes së fuqisë. Kështu, subjektet e privuara nga thellësia morale duke e shfrytëzuar dijen si armë, janë nxitur që përmes arritjes deri te numri sa më i madh i marrësve ta zgjerojnë fushën horizontale të ndikimit të vet, kurse marrësit duke i deponuar këto dituri pa i lëshuar nëpër filtrin e brengës metodike dhe etike, kanë filluar t'i përdorin shkel e shko.

Në këtë rast përballemi me tëhuajësim të ndërsjelltë mes subjektit, i cili është burim i mendimit, dhe marrësit, i cili duke e shfrytëzuar mendimin duhet të fitojë thellësi. Përpjekja e subjektit për "prodhimin" e diturisë së vlefshme për çdo koniunkturë dhe për çdo marrës, hap rrugët e qarkullimit në mënyrë të pakontrolluar të diturive të papjekura, që s'kanë fituar thellësi mendimore. Nga ana tjetër, vrapimi i marrësit pas dijes mjetësore, pa vendosur komunikim mendor dhe etik me subjektin që është burim i mendimit, shkakton gjendjen e dispepsisë si ajo e grykësit, i cili çdo lloj të ushqimit e quan të nevojshëm. Tëhuajësimi

i subjektit dhe i marrësit ndaj njëri-tjetrit, ndikon edhe në tëhuajësimin e të dyve, e në veçanti të subjektit ndaj vetvetes. Ky tëhuajësim dykahësh e pengon si thellësinë vertikale të mendimit, ashtu edhe formimin e hapësirës së gjerë të ndikimit të tij. Nga ana tjetër, hapësirat e formuara të ndikimit s'kanë thellësinë etike, që do ta gjeneronte vetëdijen për përgjegjësi sociale.



Në ditët e sotme, kur ndikimi psikologjik tronditës i 11 shtatorit dhe i operacionit të Afganistanit relativisht është dobësuar, ndihet nevoja për analiza gjakftohta dhe për projeksione për të ardhmen, që i kapërcejnë interpretimet për ligjësimin e reagimeve të ndër-sjella. Në këtë kontekst, në veçanti në ShBA bien në sy dy qasje të ndryshme: E para, duke i shfrytëzuar kanalet e ligjësimit të formuara nga ndikimi psikologjik, e favorizon vazhdimin e zgjerimit të operacioneve strategjike dhe strukturimin e marrëdhënieve ndërkombëtare sipas një hegjemonie forcë-boshtore. Shembullin më tipik të kësaj qasjeje e përbëjnë përpjekjet e skifterëve të ShBA për zgjerimin e operacionit të Afganistanit edhe në zonat e tjera, mënyrë kjo që me një real-politikë do ta rindërtonte *Pax Americana*-n. Përkundër kësaj, qasja e dytë zhvillimet e 11 shtatorit dhe pas tij i percepton si tregues të deformimit në funksionimin e rendit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe hap debate për kushtet e domosdoshme të paqes ndërkombëtare pas dobësimit të ndikimit psikologjik. Mbrojtësit e kësaj pikëpamjeje që i nxjerrin në plan të parë vlerat universale dhe dimensionin ndërkombëtar

të së drejtës, ndërkohë i aktualizojnë edhe çështjet më të thella, të cilat ngërthejnë në vete rreziqet që mund t'i shkaktojë procesi i globalizimit i shkëputur prej vlerave njerëzore.

Në fakt, të dyja pikëpamjet tërthorazi e pranojnë të vërtetën se pas Luftës së Ftohtë ende nuk janë vendosur parametrat themelorë të funksionimit të rendit botëror. Shikuar nga kjo perspektivë, mund të përfundohet se fuqitë qendrore të rendit botëror janë përballur me dy probleme globale dhe lokale të akumuluar nga lëkundjet e përjetuara ndërmjet shkatërrimit të Murit të Berlinit dhe të Kullave Binjake. Pas shembjes së Murit të Berlinit më 1989, në vend që të ndërtohej infrastruktura e një rendi të qëndrueshëm dhe të drejtë botëror, vazhdimisht janë nxitur konkurrencat e fushave të tensionimeve rajonale. Kjo pati për pasojë lindjen e hapësirave të reja të problemeve, që do të zhvilloheshin nga pluhuri i kullave të rrënuara dymbëdhjetë vjet më vonë. Çështja e rendit botëror, që s'u ndërtua mbi cilësinë pozitive dhe optimiste të shembjes së parë, u hap për debat nën ndikimet negative dhe pesimiste të shembjes së dytë. Me fjalë të tjera, flijimi i atmosferës optimiste të formuar nga shembja e parë për hir të konkurrencës strategjike forcëboshtore, duket se e ka përgatitur atmosferën pesimiste të shembjes së dytë. Pas reagimeve plot pezëm të shprehura fshehur ose hapur ndaj ShBA nga qarqet mallkuese të terrorit ndërkombëtar, shënohet një befasi shpresëthyesë e pesimizëm, që herë shndërrohet në reflekse psikologjike e herë diplomatike.

Shtyrja për më vonë e përcaktimit të parimeve dhe të normave të rendit të ri, në krizat rajonale sjell

me vete armëpushime të përkohshme e jo marrëveshje të qëndrueshme paqësore. Pas Luftës së Gjirit statusi i Irakut ende është i papërcaktuar, kurse në fuqi janë kushtet e armëpushimit. Lirisht mund të thuhet se Procesi Paqësor i Lindjes së Mesme s'përbën marrëveshje paqësore të qëndrueshme; vazhdon të jetë kontratë e armëpushimit që vazhdimisht shtyhet për më vonë, një kontratë e përshkuar nga kriza kronike. Gjendja aktuale në Karabag, në Kosovë dhe në Bosnjën pasdejtiane përbëjnë fusha të ngrira armëpushimesh. Më në fund, shpallja se qeveria e formuar në Afganistan është e përkohshme, flet për një koniunkturë ku mbizotërojnë ShBA, në të cilën mund të ndikojnë edhe valëzimet në marrëdhëniet midis aktorëve si Rusia, Kina, India, Pakistani dhe Uzbekistani.

Mosarritja deri te një marrëveshje e paqes, i ka nxitur aktorët globalë dhe lokalë, të cilët nuk i respektojnë kufijtë e pozitës së vet dhe rregullat e lojës, që t'i zgjerojnë fushat manovruese për të hyrë me më tepër avantazh në procesin e përcaktimit të rendit përfundimtar. Ky proces ka shkaktuar që në veçanti aktorët e mëdhenj, periudhën mes dy shembjeve (Muri i Berlinit dhe Kullat Binjake) ta kalojnë nëpër istikamet që përputhen me parapëlqimet dhe mjetet e tyre strategjike. Paqartësitë në rajonet e marrëveshjeve të armëpushimit kanë sjellë me vete përforcimin e këtyre istikameve. Sulmi i 11 shtatorit dhe zhvillimet e mëpasme tregojnë se kemi arritur në një periudhë të armëpushimit të istikameve, e cila mbështetet në ngrirjen e krizave dhe në paqartësinë e statuseve.



Vepra që e keni në duar i ngërthen në vete dallimet e përmendura mes mendimit, bisedës e shkrimit dhe gjurmë të çdonjërit prej tyre. Në procesin përgatitor të këtij libri janë marrë parasysh të gjitha brengat e zëna ngojë më parë. Në kuadër të zhvillimeve të shpejta pas 11 shtatorit, shfaqet një kërkesë e madhe për botimin e debateve të zhvilluara në mediat e shkrimit dhe në ato audio-vizuale. Kjo kërkesë ne, që për më tepër e kemi bërë shprehi shkrimin e teksteve akademike, na vuri para një dileme të rëndësishme. Nga njëra anë, droja se debatet që i kemi zhvilluar më tepër kanë qenë fryt i metodës debative e jo i një analize teorike akademike, e nga ana tjetër, mundësia që këto biseda të arrijnë deri te masat më të gjera të njerëzve. Me kalimin e kohës vendosëm që përparësi t'i japim kësaj së dytës. Botimi i pakontrolluar dhe i paautorizuar i disa bisedave tona e bëri të domosdoshëm kontaktin e drejtpërdrejtë me lexuesin.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto elemente dhe duke u premtuar lexuesve se pikëpamjet tona rreth temave si globalizimi dhe qytetërimet do t'i publikojmë në një sfond më teorik dhe në përputhje me kërkesat e metodologjisë së shkrimit, vendosëm që bisedat tona t'i botojmë në këtë formë. Mendojmë se kjo vepër do të na mundësojë që të vëmë një komunikim mendimor me lexuesit tanë para se të dalë në shesh hulumtimi ynë në lidhje me çështjet në fjalë. Pra le të theksojmë edhe një herë, se botimi i këtyre debateve i bart në vete të gjitha mangësitë e kalimit prej bisedës në shkrim.

Ishim të detyruar të bënim një përzgjedhje të bisedave tona të zhvilluara pas Luftës së Ftohtë lidhur me krizat globale dhe qytetërimet. Meqenëse u konstatua se numri më i madh i bisedave ishin zhvilluar në periudhën pas 11 shtatorit, që të ruhej vazhdimësia në mendime, e pamë të arsyeshme që në kuadër të librit t'i përfshinim edhe tre debate nga vite të ndryshme para 11 shtatorit 2001 (nga viti 1993, 1999 dhe 2000). Këto biseda, me qëllim që të mos i linim në hije interpretimet e bëra gjatë periudhës së 11 shtatorit, i kemi lënë për në fund të librit.

Pas mënjanimit të disa debateve të zhvilluara pas 11 shtatorit, të cilat përputheshin mes tyre, duke e marrë parasysh rrjedhën e temës dhe metodën, u bë edhe radhitja e pjesës tjetër. Çdo bisedë ka datën e vet, por në kuadër të librit nuk i jemi përmbajtur ndonjë radhitjeje kronologjike. Për shembull, intervista e dhënë pas operacionit në Afganistan në libër është dhënë para debateve televizive në STV dhe TV-8, të mbajtura para ndërhyrjes ushtarake në fjalë. Në radhitjen e bisedave më tepër është marrë parasysh rrjedha sesa kronologjia. Në këtë kontekst, intervistën tonë të botuar në *NPQ*¹ që ka vazhdimësi dhe cilësi të hyrjes, e kemi radhitur si të parën. Pas saj vjen intervista e dhënë për revistën *Tezkire*, e cila jep prapaskenën filozofike të temave, që ka karakter të rezymesë me prerje por mjaft interesante.

Pas këtyre tri intervistave me karakter hyrës, zënë vend tre debatet e njëpasnjëshme të realizuara në STV

¹ *New Perspectives Quarterly*.

në kuadër të emisionit *Boshti i mendimit*, ku është diskutuar në detaje çështja e periudhës pas 11 shtatorit nga këndvështrimi i Perëndimit, ShBA, botës islame dhe Turqisë. Më tutje radhitet intervista e dhënë për TV-8, ku çështja e 11 shtatorit është trajtuar nga prizmi i rendit ndërkombëtar dhe i problemeve të ndryshimit. Më pas vijojnë intervista dhënë revistës 2023, në të cilën është diskutuar rëndësia e thellësisë strategjike të Turqisë, dhe debati nga CNN-Türk, në të cilin është diskutuar forumi i shkurtit i organizuar nga Organizata e Konferencës Islamike dhe Bashkësia Europiane.

Në pjesën e veprës ku janë vendosur intervistat e botuara para 11 shtatorit, këtë herë sipas radhës kronologjike gjejmë vend tri intervista të botuara në revistën *Altınoluk* (1993 dhe 2000) dhe në *Revizyon* (1999). Kështu, jemi munduar që t'i shpalosim vijat kryesore të qasjes sonë dhe pikat e vazhdimësisë së këtyre vijave. Në fund të librit është vendosur artikulli "Përplasja e interesave: një shpjegim për (pa)rendin e botës" i botuar në revistën për çështje ndërkombëtare *Perceptions*, që botuesi e pa të arsyeshme t'ia shtojë versionit shqip të kësaj vepre.

Një gjë që para së gjithash duhet ditur lidhur me këtë punim, është e vërteta se bëhet fjalë për një vepër ku nuk kanë qenë në epiqendër brengat teorike dhe metodike dhe për një vepër që s'është tërësisht fryt i autorit. Për këtë punim që është rezultat i procesit, në të cilin kanë qenë aktivë sa subjekti folës aq edhe pala tjetër që i ka prirë debatit, ndiejmë nevojë të thellë t'u shprehim falënderim bashkëpjesëmarrësve në këto debate, që e kanë mundësuar kalimin prej mendimit

në fjalë, si Halit Refig, Etjen Mahçupjan, Ali Bullaç, Gyl Selçuk, Gyrkan Zengin, Ahmet Demirhan, si dhe mediave në të cilat janë botuar këto biseda, si STV, TV-8, CNN-Türk, NPQ, *Tezkire*, 2023, *Altinoluk* dhe *Revizyon*. Sikur të mos ishin këmbëngulja, puna e përpiktë dhe koncepti mediatik parimor i tyre, s'do të kishte mundësi që subjekti, marrësi dhe situata të takoheshin me konceptin e thellësisë së mendimit dhe me atë të përgjegjësisë etike. Më në fund, duam të falënderojmë Faruk Deniz, i cili e mori mbi vete këtë projekt me plot përgjegjësi, gjithmonë duke qenë i vetëdijshtëm për raportet e ndjeshme mes mendimit, të folurit dhe shkrimit, dhe i ka mënjanuar përsëritjet e panevojshme e është përpjekur që gabimet t'i zbresë në minimum. Po ashtu falënderojmë edhe Zehra Dilekun, e cila i deshifroi me përkujdesje të veçantë shiritat e debateve në TV.

Gjithmonë mbetemi me shpresën se ky punim, në saje të dëlirësisë së mendimeve, të natyrshmërisë së bisedës dhe të qëndrueshmërisë së shkrimit, do të shndërrohet në mjet komunikimi me lexuesit!

Ahmet Davutogllu

*Dimensionet filozofike dhe strategjike të krizës globale**

Halit Refig: Le t'ia fillojmë me një paragraf lidhur me Afganistanin të profesor Davutogllut nga vepra *Thellësia strategjike: Pozita ndërkombëtare e Turqisë*:

“Kjo zonë si skenë strategjike e Lojës së Madhe, të ndër-tuar nga konkurrenca kolonialiste e shekullit XIX, që nga ajo kohë e deri më sot vazhdon ta ruajë pozitën si vijë ndarëse që i përcakton fushat e ndikimit, si zonë tampon mes Fuqisë detare të bazuar në tregti dhe Fuqisë tokësore të Eurazisë. Një nga elementet themelore të vazhdimësisë në konkurrencën anglo-ruse të shekullit XIX dhe amerikano-sovjetike të periudhës së Luftës së Ftohtë është roli i krahut jugor lidhës të Azisë së Mesme. Goditjet që e përfunduan Luftën e Ftohtë janë dhënë në Afganistan, në këtë rajon që i përmban krahinat kalimtare dhe pikat kyçe të sferave të ndikimit”.

Këto radhë janë shkruar para 11 shtatorit 2001. Për këtë arsye çështja e Afganistanit nuk është vetëm ashtu siç tregohet, çështje e terrorit që goditi Nju-Yorkun dhe Uashingtonin. Prej hulumtimeve, nën të dalin shumë gjëra të tjera.

Në kohën kur ngjau 11 shtatori, zhvilluam një bisedë treshe me Ali Sajdamin dhe Ylky Karaosmanogllunë. Tani do t'i përsëris mendimet që i kam shprehur në atë mbledhje. 11 shtatori është një pikë kthese

* Halit Refig, revista NPQ, dhjetor 2001

në historinë e botës. Nuk bëhet fjalë vetëm për një veprim terrorist ose për një ngjarje të rëndomtë trishuese. Këtë datë e konsideroj si një pikë kthese në historinë njerëzore, e cila simbolizon "fundin e një epoke". Çështja jonë e vërtetë fillon pas 11 shtatorit. Por për ta vlerësuar siç duhet periudhën pas 11 shtatorit, duhet të njohim në pikat kryesore periudhën pararendëse, ata para të kësaj date. Ju në veprën tuaj atë periudhë e keni trajtuar në mënyrë të përkryer.

Nëse e shikojmë botën e para 11 shtatorit, në sy na bie ngjarja e shembjes së Murit të Berlinit që ndodhi në vitin 1989. Thuajse të gjitha pikëpamjet e reja që lindën pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, si kriter marrin shembjen e Murit të Berlinit. Kurse një gjë mjaft interesante, që ka të bëjë me aktualitetin tonë, është fakti se ekziston një ngjarje shumë e rëndësishme, e cila ia hapi rrugën shembjes së Murit të Berlinit: disfata e Bashkimit Sovjetik në Afganistan. Mund që të jetë fshirë prej kujtesës, por madje edhe sot kur po e diskutojmë periudhën pas 11 shtatorit, harrohet të shtrohet pyetja e pranisë së Amerikës në Afganistan. Tash kur jemi duke diskutuar, s'dimë për asnjë emër të njerëzve që kanë vdekur në Pentagon. Kurse fort mirë e dimë se jetojmë në epokën e dijes...

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, doli fjala për "Rendin e Ri Botëror" dhe bashkë me këtë rend të ri botëror u shtrua teza se kemi hyrë në epokën e dijes. Toffleri që flet për "dallgën e tretë", ka shtuar se periudha e qytetërimit bujqësor dhe industrial ka mbaruar dhe se kemi hyrë në periudhën e qytetërimit të dijes. Ai flet për njerëzimin që është duke e përjetuar

“dallgën e tretë”. Ndërkohë janë paraqitur edhe të atillë, që e përkufizojnë dhe e interpretojnë periudhën pas Luftës së Ftohtë. Fukujama, të cilin edhe ju e përmendni shpesh në librin tuaj, pohon se ka ardhur fundi i historisë. Ai thotë se përplasjet ideologjike kanë marrë fund dhe demokracia është shndërruar në model të vetëm për tërë njerëzimin. Kjo tezë e tij që të kujton konceptin e Hegelit për “lirinë e pafundme”, pretendon se “e tërë bota ka vetëm një model, atë të demokracisë liberale”. Nga ana tjetër, Samuel Huntingtoni thotë se lufta mes ideologjive ka përfunduar dhe se tash vijon lufta mes kulturave, se demokracitë përballen me pengesa të shumta. Sipas tij, njëra prej këtyre pengesave është Kina, kurse tjetra Islami.

Ndërkohë më 1992 në Rio de Zhaneiro është mbajtur një mbledhje e nivelit të lartë - që përbën njërin prej tubimeve më të gjera dhe me pjesëmarrje të autoriteteve më të larta botërore - në të cilin thuhet se janë ndezur dritat e kuqe alarmuese dhe se duhet ndalur. Në këtë forum mes të tjerash janë shënuar edhe këto fjalë: “Burimet natyrore të botës sonë ditaditës shkojnë duke u harxhuar. Le të kuvendojmë lidhur me atë se dhe sa kohë do të mund ta ushqejnë njerëzimin burimet ekzistuese, sa miliarda njerëz mund të mbijetojnë me to, sa i zhduk burimet rritja e prodhimit-konsumit industrial, në çfarë katastrofash mund të na shpien hedhurinat e energjisë dhe ndotja e natyrës dhe e atmosferës? Pra le t’i marrim masat e duhura në përputhje me përgjigjet e këtyre pyetjeve!” Përmes këtyre pyetjeve u synua që interesimi i njerëzve të tërhiqej në një anë tjetër.

Nëse ndaleni pak të gjykoni, do të vëreni se fjala “globi ynë” për herë të parë është përdorur në lidhje me natyrën në vitin 1995 me themelimin e Organizatës Botërore e Tregtisë, kur edhe për herë të parë ka lindur ideja e përhapjes së globalizimit si veprimtari ekonomike. Në këtë kontekst, në vend të ndarjes Lindja-Perëndimi, lindi ndarja Veriu-Jugu, pra vendet e pasura-vendet e varfra. Tanimë diskutohet për çështjen e industrisë së madhe, për shoqërinë konsumatore dhe për ndotjen e ambientit, shkatërrimin e natyrës si pasoja të saj, dhe për brengën e skajshme të shprehur në kopertinën e numrit të pestë të revistës *NPQ*, ku përmes titullit “Historia pas njeriut!” aludohet në frikën prej një të ardhmeje, kur do të shkatërrohej njerëzimi.

Tema jonë është periudha pas 11 shtatorit, por pa marrë parasysh se për çfarë do të flasim këtu, jemi të detyruar ta shqyrtojmë edhe lidhjen e saj me Turqinë. Nëse e trajtojmë në pikat kryesore periudhën para 11 shtatorit dhe Turqinë, në hijen e marrëdhënieve të këtij vendi me Bashkimin Europian, mund të flasim për “katër data”.

Në takimin e nivelit të lartë të Luksemburgut të vitit 1997 Turqisë i është përcjellë porosia se s’mund të jetë as kandidatë dhe për pasojë është thyer shpresa e këtij vendi për të qenë anëtar i BE-së. Një vit më vonë, më 1998, Turqia shënon rezultate në çështjen e PKK-së, në të cilën këmbëngulte vetë Bashkimi, duke e nxjerrë liderin e kësaj organizate terroriste Oxhalan nga Siria, Rusia e Italia dhe duke e prurë në vend. Në kohën kur po zhvillohej ky operacion, kur Turqia kishte raporte të largësisë me BE-në, ekonomia e këtij vendi po jetonte

një periudhë të shkëlqyer, të pashënuar në historinë moderne të saj. Për herë të parë në historinë e Republikës, të ardhurat vjetore për frymë i kaluan 3200\$, madje nëse do të llogaritej edhe ekonomia e peregjistruar, kjo shifër ngrihej diku në 6000\$. Pra jemi duke folur për vitin 1999, kur Turqinë e goditi një tërmet i tmerrshëm. Pas kësaj ndodhie, shënohet një afrim emocional me botën perëndimore. Atë vit kryeministri dhe ministri i punëve të jashtme u çuan në Samitin e Helsinkit, thuajse duke u tërhequr këmbadoras. Atje Turqia e fitoi statusin e kandidates dhe tash duhej që t'i plotësonte kushtet e kandidaturës... Ja, në dorë i keni Kriteret e Kopenhagës, Dokumentet e Asociimit dhe Partneritetit; u tha se për t'u bërë anëtar i plotë i Bashkimit duhej t'i plotësonim kushtet gjegjëse.

Vijmë te viti 2000. Ekonomia turke po përjeton një ngushticë, vërejmë se një sasi e madhe e devizave janë përcjellë jashtë. Si përfundim, në shkurt të vitit 2001 shfaqet ndodhia e famshme: Kryetari i shtetit në Çankaja, ia hedh fytyrës kryeministrit Kushtetutën dhe dy ditë më pas shënohet një zhvlerësim i lartë, një shkatërrim i vërtetë ekonomik. Në kohën kur po përjashtoheshim nga anëtarësia në BE, po përjetonim periudhën më të shkëlqyer të historisë sonë të afërt, kurse tash, sipas disave, edhe pse unë nuk jam me këtë mendim, po jetojmë në fazën më të errët të historisë së Republikës. Si ndodh kjo?

Një prej termave "të mprehur" para 11 shtatorit është ai i shumëpërfoluri në fillim të shekullit XX dhe i harruari qëmoti: Eurazia. Në veçanti, duke filluar me vitet '90 kur u zhbë Bashkimi Sovjetik, u shënuan

marrëdhënie të afrimit mes Ruisë dhe Kinës. Po si është pozita e republikave turke në Azi? Si është gjendja e Pesëshes së Shangait?

Më në fund mund të flasim për ndikimet e burimeve të energjisë si çështje mjaft të rëndësishme të shoqërive të mirëqenies, mbi ekonominë e bazuara në energji, mbi Turqinë! Në ç'gjendje ishte Turqia para 11 shtatorit në strategjitë e energjisë?

Në përgjithësi, duke i shprehur mendimet e mia, bëra një radhitje të çështjeve rreth të cilave sugjeroj të diskutojmë dhe pas vlerësimeve të bëra lidhur me këto çështje, mund të kalojmë në periudhën e pas 11 shtatorit!

Dimensioni filozofik

Ahmet Davutoglu: Është një e vërtetë e pakontestueshme, se 11 shtatori shumë më tepër është trajtuar nga këndi i dimensioneve strategjike, e shumë pak nga ai filozofik. Shikuar nga kjo perspektivë, zhvillimet e fundit mund t'i trajtojmë nga tri përmasa: 1. Domethënia e tyre afatgjatë në aspektin e historisë së qytetërimit dhe të filozofisë. 2. Domethënia në rrafshin strategjik, në atë të rendit ndërkombëtar dhe të aktorëve kryesorë të tij, dhe 3. Çka mund të thuhet në drejtim të pasqyrimeve të kësaj strategjie në rajonet e ndryshme, duke filluar nga Azia deri në Afganistan?

Elementet më të qarta të dimensionit të parë mund t'i gjejmë te teza e Fukujamës për *fundin e histo-*

risë. Kur Fukujama e shpalli fundin e historisë, këmbëngulte në një propozicion të rëndësishëm. Pretendimin kaq me peshë të një dijetari që ka marrë arsim perëndimor mund ta kuptojmë, sepse Perëndimi historinë e shikon prej vendit ku gjendet vetë dhe s'e vëren dot gjallërinë e pellgjeve jashtëperëndimore. Kur përmendim fjalën "pellg", nënkuptojmë rajonet që kanë homogjenitet strategjik të brendshëm, të formuar nga vijat e ndryshme gjeopolitike, gjeokulturore dhe gjeoekonomike. Fukujama nga vendi që gjendej nuk e ka vlerësuar siç duhet gjallërinë e këtyre pellgjeve.

Ky qëndrim vlen për elitat e atij qytetërimi, i cili ka pozitë mbizotëruese në historinë e qytetërimeve. Ndonëse fiset teutone i shihnin si primitive dhe barbare, dijetarët romakë nuk i vlerësuan si duhet dhe për këtë arsye s'arritën t'i ndalnin që të mos e pushtonin Romën. Roma u shty jashtë historisë - gjë që mund të kuptohet si shprehje e ndryshme e fundit të historisë - nga elementet e anashkaluara në periudhën kur kishte pozitë qendrore dhe kur mbizotëronte shprehja "Të gjitha rrugët shpien në Romë", në periudhën kur ishte më e fortë. Një shembull tipik të kësaj kemi edhe në siglën "Shteti i përherëshëm" (*Deolet-i Ebed Müddet*) që përdorej për shtetin osman. Ky përkufizim, i ngjashëm me tezën për fundin e historisë, e bart në vete pohimin se është themeluar një shtet i përsosur, që do të zgjasë deri në përjetësi, deri në Fundin e Historisë, se janë shpenzuar faktorët që kanë mundësi ta lëvizin historinë. Shteti osman u shkatërrua nga qytetërimi konkurrent perëndimor, të cilin e shihte me përçmim në periudhën kur ishte më i fortë,

u shkatërrua si pasojë e mosvërejtjes me kohë të lëvizjeve që i jepnin dinamizëm historisë.

Nëse hedhim një shikim në historinë e qytetërimit, do të vëmë re se transformimet ideore pas disa shekujve kanë shkaktuar shndërrime serioze politike, lindjen e një rendi politik ndërkombëtar. Në këtë kontekst, qytetërimi perëndimor ballafaqohet me një shndërrim të ri. Për shembull, zgjerimet ideore dhe mendore që u shfaqën në Greqinë Antike, duke filluar prej shekullit VII deri në shekullin V p.e.r., dy shekuj më vonë pas Aleksandrit të Madh u shndërruan në sistemin politik helen. Në këtë periudhë, qytetet e pagëzuara me emrin e Aleksandrit të Madh, të themeluara në vijat kalimtare të Afro-Eurazisë, luanin rolin e qendrave të rendit politik dhe të stacioneve përcjellëse të qytetërimit. Ky sistem, duke u shndërruar në vetvete, më vonë vazhdoi me Romën. Shndërrimet politike të gjeneruara nga spektri ideor kanë ndikuar edhe në vetë qytetërimet. Transformimi ideor i përjetuar në pellgun e qytetërimit indian mes shekujve VII-V p.e.r., i simbolizuar me emrat e Budës dhe Xhainit, ka përfutur një njeri të ri, një Indi të re. Ndërkohë është shënuar edhe sfidimi i sistemit kastian hindu. Ky transformim ideor rreth dy-tre shekuj më vonë përgatiti bazat e Perandorisë Asoka. Në të njëjtën periudhë, hopet ideore në Kinë me burim nga Taoja dhe Konfuci ndikuan në lindjen e Perandorisë së Madhe Hune, e cila ndërtoi Murin Kinez. Shembull i afërt me këtë është transformimi ideor i realizuar nga besimi islam, që zanafillën e pati në Mekë e në Medinë dhe që në tërësi e rindërtoi pikëpamjen ontologjike të pell-

gjeve të qytetërimeve antike. Ky transformim, duke i marrë nën mbizotërimin e vet politik të gjitha këto pellge, i hapi rrugën lindjes së qytetërimit islam. Shembulli i fundit i fortë i reformësimit të pellgjeve të qytetërimeve antike me pikëpamjen islame dhe i shndërrimit të tyre në rend politik u realizua me sistemin politik të shtetit osman.

Edhe qytetërimi perëndimor, mes shekujve XV-XVIII përjetoi një shndërrim të rëndësishëm ideor, që kulmin e arriti në filozofinë iluministe. Ky dinamizëm, të cilin e solli shndërrimi në fjalë, në shekullin XIX e vuri Europën në qendrën e rendit ndërkombëtar politik dhe ekonomik. Imperializmi dhe kolonializmi ndërtuan një rend, i cili u shfaq si pasojë e zgjerimit të kësaj qendre drejt periferisë. Kalimi prej kolonializmit europian drejt *Pax Americana-s* që si qendër e merr Atlantikun, u realizua përmes së drejtës së re ndërkombëtare dhe ndërtimit të organizatave ndërkombëtare. Njëra prej fazave më të rëndësishme të këtyre transformimeve ka filluar të përjetohej me shembjen e Murit të Berlinit në vitin 1989. Fukujama, i cili thënë me shprehje metodologjike - jeton në gypin e vet testues, duke e anashkaluar këtë rrjedhë të gjatë, u ngut dhe shpalli fundin e historisë.

Kur Fukujama e shpalli tezën e vet, në fund të vitit 1990 shkrova një kumtesë, të cilën më 1991 e paraqita në kongresin e ISA-s, që më vonë u botua si libër nën titullin *Civilizational Transformation*, ku duke i shqyrtuar pesë elementet e krizës, jam përpjekur të tregoj se Perëndimi është duke përjetuar një proces të shndërrimit, se historia nuk ka përfunduar. 1. Kriza e

sigurisë dhe e lirisë ontologjike dhe tëhuajësimi ontologjik. 2. Kriza epistemologjike. Sepse tanimë ekuacioni "arsyeja, shkenca, përparimi" s'mund të lëvizë si epistemologji dhe këto propozicione të filozofisë së iluminizmit janë duke përjetuar lëkundje serioze. 3. Kriza aksiologjike, që e shfaq veten në çekuilibrin e mekanizmit dhe të moralit. Nëse pohoni se pa u vënë lidhje mes mekanizmit dhe moralit, mekanizmi "prodhon" moralin e vet, s'ka dyshim se ky mekanizëm krijon tirani. Nëse nuk i ndërlidhni vlerat normative të njeriut me mekanizmat socialë, vetë mekanizmi s'mund ta zgjidhë problemin. 4. Baraspesha ekologjike është prishur, dhe 5. Problemi i shumësisë së kulturave. Por, kur e fokusojmë historinë e qytetërimeve, vërejmë se forcë motorike e saj janë dy kërkesa bazë të njeriut: siguria dhe liria ontologjike. Përderisa njeriu të vazhdojë të ballafaqohet me këto dy fusha problematike, historia gjithmonë do ta ketë dinamizmin e vet.

Përjetimet e 11 shtatorit treguan sesa mashtruese janë fotografimet statike për fundin e historisë, të bëra duke qenë ulur në Nju-Jork ose në Uashington. Njerëzit kur të ndalen pas dy ose tre shekujsh e ta vatërzojnë në këtë periudhë, do të shohin se propozicionet bazë të filozofisë iluministe, të cilat nga shekulli XVIII i hapën rrugët hopit mendor të qytetërimit perëndimor, në fillimet e shekullit XXI po përjetojnë lëkundje serioze. Kjo tronditje nuk është si ajo pikore që ka filluar me vitet 1980, por është rezultat i procesit të përjetuar pas Luftës së Dytë Botërore me tronditje të veçantë.

Moderniteti pretendonte se ishte në gjendje t'u përgjigjej të gjitha kërkesave të njeriut, se në saje të hapave

viganë të teknologjisë dhe të mekanizmave politikë (shteti) dhe ekonomikë (tregu) ishte në gjendje të krijojte një fushë absolute të sigurisë dhe të lirisë. Këta mekanizma do t'u përgjigjeshin të gjitha kërkesave të njeriut dhe do ta rrisnin sigurinë e lirinë e tij. Teza e Fukujamës ka kuptimin e pohimit se e gjithë kjo është realizuar.

ShBA, për shkak të forcës së vet ekonomike dhe politike, s'e vunë re gjendjen reale, s'arritën ta perceptonin procesin që filloi të dukej me Luftën e Dytë Botërore dhe që doli në shesh tërësisht në vitin 1989. Mosperceptimi i këtij procesi shkaktoi dobësitë e analizës së bërë pa iu referuar gjendjeve të njëjta në të kaluarën. Sepse Kriza Ekonomike e vitit 1929 në Amerikë tregoi se mekanizmi ekonomik që funksionon kokë më vete në një vend të caktuar mund të ndalet. Për këtë arsye ekonomia kejnësiane u mundua që ta kapërcente këtë krizë me mjete të ndërhyrjes në treg.

Bombat e hedhura në Hiroshima dhe në Nagasaki u prodhuan nga një mendje e arsyeshme. Urdhri për bombardimin e këtyre qyteteve u dha nga një qeveri e ardhur në pushtetit përmes procedurave demokratike. Bombardimi në fjalë në mendjen e njerëzve shkaktoi revolucion: në periudhat kur njeriu ka qenë më pak i zhvilluar ekonomikisht, shkatërrimi ka qenë i kufizuar me kacafytjet në mejdanin e luftës, kurse shkatërrimet e kohës sonë për herë të parë lënë gjurmë ndikuese edhe te brezat e ardhshëm. Pra, mekanizmat racionalë teknologjikë dhe politikë mund ta shkatërrojnë edhe fushën e sigurisë e të lirisë së brezave të ardhshëm, që s'kanë kurrfarë përgjegjësie për shpërthimin e luftës.

Sipas hipotezave të shekullit XIX, në saje të tre-këndëshit arsyeja-shkenca-përparimi, të infrastruktu-rës teknologjike të bazuar në revolucionin teknologjik dhe të mekanizmave politikë, njeriu do ta maksimi-zonte sigurinë dhe lirinë e vet. Kjo për arsye se maki-nat e Revolucionit Industrial e emociononin njeriun, që do të shprehej kështu: "Kam zbuluar mjete që do të bëjnë shumë punë në emër timin, do të jem gjithnjë e më i lirë!" Por me kalimin e kohës, teknologjia arriti të prodhonte bombën bërthamore, që i kanoset sigurisë njerëzore dhe që e robëron vetë njeriun.

Qytetërimi eurocentrist, që supozonte se do ta shpi-nte njeriun në gjendjen ideale, po lëkundet fort. Sot gjen-den ballë për ballë me krizën e një qytetërimi shumë të madh. Edhe më parë ka pasur kriza të këtilla, por të gji-tha janë tejkaluar me injeksione të tjera. Për shembull, kriza e Kinës u tejkalua në saje të budizmit të ardhur nga India. Sot mbizotëron qytetërimi perëndimor, që sy-non burgosjen e qytetërimeve të tjera, i cili nisët nga teza se të gjitha qytetërimet e vjetra do të zhduken. Sipas Toj-nbit, në botë ekzistojnë 26 qytetërime: 16 prej tyre kanë vdekur, kurse 10 ende janë gjallë. Por nëntë prej këtyre të fundit jetojnë nën kanosjen e qytetërimit perëndimor, domethënë janë duke përjetuar çastet e fundit. Në ko-hën kur është përpiluar kjo vepër, mbizotëronte ky qën-drim: Në saje të këtij mekanizmi do të formohet një bo-të, në të cilën qytetërimet e tjera dalngadalë do të tërhi-qen nga skena e historisë dhe në një kuptim do të arri-het parajsja shekullare dhe fundi i botës. Por zhvillimet nuk e vërtetuan një gjë të tillë; përkundër këtyre propo-zicioneve, hapësira e lirisë dhe e sigurisë u ngushtua.

Vetëbesimi i tronditur

Një gjë që ra në sy bashkë me 11 shtatorin është fakti se para kësaj date, në përgjithësi perëndimorët, e në veçanti amerikanët i nënçmonin problemet e lirisë dhe të sigurisë nga pjesa tjetër e botës. Kjo për arsye se mendonin që u mjaftonte të ishin të lirë dhe të sigurt në vendin e vet. Vetë Amerika ishte hapësirë e lirisë dhe mendohej se ky vend asnjëherë nuk do të përballlej me problemin e lirisë e të sigurisë. Kjo i përngjan shembullit në vijim: Njeriu që jeton në Marmara, mendonte se më parë kishte pasur tërmete në Erzinxhan, në Adana e në Van dhe çështjen e tërmetit e shihte si një problem, me të cilin nuk mund të ndeshej asnjëherë. Tërmeti i Marmarasë krijoi një tronditje të atillë, që ngjarjen e ndjekur në televizion e futi në përditshmërinë e njerëzve. Kur thoshte se “kërkimi i njeriut ka përfunduar”, Fukujama kishte para sysh perëndimorin e pikërisht aty e bëri gabimin. Në dymbëdhjetë vitet e fundit në Ruanda u vranë një milion, kurse në Bosnjë 250 mijë njerëz. Ishte bërë një pikturë statike, në kohën kur bota po përballlej me problemin e pasigurisë së shkaktuar nga tensioni mes Veriut dhe Jugut, me problemet e tjera politike, me fjalë të shkurtra, në kohën kur bota ishte në telashe të mëdha nga sfera e sigurisë dhe e lirisë. Ngjarja e 11 shtatorit tregoi se kriza e qytetërimit frymon edhe në zemër të Amerikës. Sot amerikani e përjeton problemin e lirisë dhe të sigurisë siç e përjeton marmarasi tërmetin. Tani ai s’hyn kollaj në supermarket, s’e hap dot letrën

që i ka ardhur. Si u arrit kjo gjendje? U arrit në saje të shfrytëzimit racional të teknologjisë e të mjeteve të komunikimit dhe në saje të mjeteve të prodhuara po nga ai qytetërim. Kështu u lëkund besimi i fortë në mekanizmat e qytetërimit në fjalë. Aktorët e 11 shtatorit kanë shfrytëzuar të njëjtat mjete teknologjike, racionalitetin dhe mekanizmat e njëjtë sistemikë, të shfrytëzuar edhe nga ndërtuesit e Qendrës Tregtare Botërore e të Pentagonit. S'ka dyshim se vetë mjete s'është i rëndësishëm, nëse nuk e vini pas tij normën morale.

Pas 11 shtatorit ata që i patën mbyllur veshët ndaj vërejtjeve, që ndiheshin të sigurt dhe të lirë në kopshet e veta, filluan ta ndienin gjendjen reale të botës. Në këtë kontekst mund të thuhet se historia s'ka përfunduar dhe s'do të përfundojë përderisa nuk zgjidhet çështja e lirisë dhe e sigurisë.

Perëndimi është kah e përjeton problemin e diskutimit në vetvete të kësaj tematike. Zakonisht, kur qytetërimi bie në krizë, e ka të rëndë ta shohë këtë prej brendësisë së vet dhe gjithherë shpreh reagime "neotradicionale". Sipas meje, reagimi i Hantingtonit është "neotradicional". Madje edhe formimi i Bashkësisë Europiane është reagim i asaj natyre, thelbi i të cilit është interpretimi i krizës me mjete nga brendësia e vetë Perëndimit. Njësoj si shteti osman, i cili nuk i merrte në konsideratë shumë gjëra nga Perëndimi dhe nuk i pa reagimet "neotradicionale" dhe kështu s'arriti ta zgjidhte problemin.

Çështja në fjalë, me rendin ndërkombëtar ndërli-
dhet në këtë drejtim: Qytetërimi perëndimor, men-
don(te) se të gjitha konceptet filozofike dhe synimet e

gjeneruara prej tyre do të realizoheshin në Europë dhe në Amerikën Veriore. Zhvillimet në sferën e ekonomisë dhe të politikës që nga Revolucioni Industrial jepnin të dhëna, që e përforconin këtë përshtypje. Mbizotëronte mendimi se Europa dhe Amerika Veriore janë subjekt, kurse çdo vend tjetër i botës është objekt. Çdo gjë do të zbulohet në Perëndim, e pastaj do t'u përcillet vendeve të tjera, atje do të krijohet siguria që do t'i përshtatet gjithë botës, atje do të formohet sistemi politik që do t'u përcillet të gjitha vendeve të botës. Kurse historia na thotë diçka tjetër. Deri në shekullin XV s'ka ekzistuar qytet në kuptimin e plotë të fjalës. Tërë thesari i njerëzimit deri në shekullin XV do të formohej diku tjetër, por ky thesar do të përjashtohej dhe do të objektivizohej nga një subjekt i caktuar. Edhe Tojnbi ra në kurthin e këtij mashtrimi, edhe pse në vitet '30, në shkrimet e tij të botuara më vonë u mundua të shpëtonte prej tij. Por ngjau një gjë e paparashikueshme për perëndimorët dhe e parashikueshme për ne. Shekulli XIX kaloi në shenjën e kolonializmit. Deri nga mesi i shekullit XX, kur përmendej sintagma "rendi ndërkombëtar", për shkak të sistemeve kolonialiste angleze dhe franceze, nënkuptohej sistemi imperialist-kolonialist. *Pax Americana*, me një kontradiktë brenda paradigmës së vet, e shkatërroi sistemin anglo-francez kolonialist dhe arriti të ndërtonte një sistem të bazuar në të drejtën ndërkombëtare.

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë doli një tablo e re. E gjithë e drejta ndërkombëtare, në rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, aktorët joperëndimorë i pranonte kur ishte ngushtë ose s'i pranonte fare, i

konsideronte sikur s'ekzistonin. Ndaluni pakëz te sistemi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara: Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara është një strukturë oligarkike. Pesë shtete kanë status të veçantë, kurse pjesa tjetër status krejtësisht tjetër. Mendoni pakëz edhe për strukturën ekonomike dhe politike të botës. G-8 është një kategori e veçantë, G-20 përbën periferinë, kurse të tjerët nëpërkëmben tërësisht. Në një strukturë të tillë oligarkike përballemi me problemin e përfaqësimit. Në kuadër të Këshillit të Sigurimit gjendet edhe Kina. Nga ana tjetër Islami dhe India, pra një pjesë e rëndësishme e popullatës botërore është lënë krejtësisht jashtë. Në kuadër të G-8 nuk është as Kina. Thuajse ¼ e popullatës së botës është përjashtuar.

Por kur i hedhim një sy baraspeshës ekonomike dhe politike të botës, shohim se ekonomia botërore zhvillon prodhim në tri fusha. Me prodhim prej dhjetë miliardë e gjysmë \$ kryesojnë Azia e Paqësorit me Azinë Lindore. NAFTA ka një prodhim prej nëntë e gjysmë ose dhjetë miliardë \$, kurse Bashkësia Europiane prej shtatë miliardë e gjysmë ose tetë miliardë \$. Para një shekulli ekonomia e tërë botës kontrollohej prej Europës, prej fuqive kolonialiste. Në vitet '50 ekonomia e botës ishte e ndarë në dy kampe, në atë socialist dhe në atë kapitalist, nën kontrollin e Amerikës ose të armikut brendaparadigmatik, Bashkimit Sovjetik, që prapëseprapë konsiderohej si perëndimor. Por tani vërehet shumë qartë se qytetërimet jashtëperëndimore po shënojnë gjallërim ekonomik, kulturor dhe ideor. Ky gjallërim u pa pas eliminimit të polarizimeve të periudhës së Luftës së Ftohtë, pas

heqjes së vellos të kësaj divergjence. Sot po vërehet një gjallërim dhe dinamizëm i rëndësishëm kulturor, ekonomik dhe politik në pellgjet e Islamit, të Kinës dhe të Indisë. Për shembull, dhjetë vitet e fundit numri i artikujve shkencorë të shkruar nga kinezët shënon rritje të madhe.

Historia e qytetërimit na mëson se një sistem lind në një vend të caktuar - sikurse qytetërimi perëndimor ka lindur në boshtin anglo-sakson, protestant e teuton - dhe ushqehet prej burimeve gjegjëse. Por kur e përjeton periudhën e ngritjes dhe të çlirimit, doemos kozmopolitizohet në qendrën e vet. Shembull për këtë kemi në historinë tonë, në shtetin osman, i cili gjenezën e ka në fisin Kajë, që ka origjinë turke, turane, por pas Sulltan Mehmed Fatihut (Çliruesit) bëhet shumë më përfshirës. Shteti osman ka jetuar përderisa e mbante gjallë këtë aftësi përfshirëse, e cila përbënte sfidë për të. Me të hyrë të elementeve të tjera, si p.sh. të sadrazemëve të kthyer në myslimanë, me të arritur që forca politike dhe ekonomike të ndahej me elementin njerëzor të cilit i prinin dhe e sundonin osmanët, me të arritur që serbët, bullgarët të barteshin brenda sistemit, u provua se shteti në fjalë po jetonte. Edhe Roma e pati përjetuar të njëjtin problem. Amerika dhe Anglia që tridhjetë vite janë duke e përjetuar një ndryshim të tillë. Përtej ndryshimit, po përjetojnë revolucionin demografik. Shtetet e shfrytëzuara më parë nga perëndimorët, tani në vendet e përmendura po bëjnë trysni demografike. Unë thua jse çdo vit shkoj në Angli. Për të parën herë kam qenë në vitin 1978. Në konferencën e titulluar "Islami në Europë" të

mbajtur vitin e kaluar në Londër, dhashë po këtë shembull: Në vitin 1978 Londra ende ka qenë qytet tipik anglez. Çdo vit që e vizitoj Londrën, ndalem në metro dhe i shikoj njerëzit që qarkullojnë. Vërej se çdo vit e më tepër Anglia po nxihet, gjithnjë e më tepër po merr ngjyrë më të zeshkët. Para 50 vitesh në Angli s'ka pasur mesxhid, tash në çdo qytet anglez ka nga një faltore myslimanësh. Në Amerikë gjendja është edhe më interesante, sepse europianët marrin masa për ta mbrojtur vetveten. Vitin e kaluar isha në Hjuston, në një konferencë ndërkombëtare, në Kongresin Ndërkombëtar të Globalizimit dhe të Sociologjisë së Fesë. Ndërkohë shpreha dëshirën të vizitoja një kamp refugjatësh. Në Hjuston ekziston Qyteza Kineze (China Town) që shtrihet në gjatësi prej 12 kilometrash. Paramendoni një vend që shtrihet prej Sirkexhisë në Jeshilkoj ku jetojnë vetëm kinezë. Tash shtrohet pyetja: si mund ta përjashtoni Kinën? Amerika para njëqind ose pesëdhjetë vitesh mund ta mbante Kinën jashtë sistemit, kurse sot jo. Kina është në vetë zemrën e Amerikës. Pikë për pikë si në periudhën e Mark Aurelit të Perandorisë Romake, kur atje u shfaq besimi iranian i quajtur mitraizëm, i cili në kohën e Cezarit s'kishte fare peshë në atë perandori. Si mund ta përjashtoni Islamin? Në çdo qytet amerikan ka nga një qendër islame, nga një faltore budiste ose kurs të jogës. Qytetet osmane gjallëronin përderisa i ngërthenin në vete të gjitha kulturat. Kur kjo paradigmë u eliminua nga një tjetër, ky shtet u bë copë-copë. Sot Amerika po ballafaqohet me një sprovë të këtillë. Ky shtet në vend që të përfitojë prej virtyteve kineze, prej perceptimit

islam e prej filozofisë hinduse dhe të ndërtojë një koncept gjithëpërfshirës, po krijon një polarizim të rrezikshëm të trajtës West/Rest (Perëndimi/Të tjerët).

11 shtatori jep porosinë se Amerika nëse nuk e vëren këtë proces, nëse mbetet në kornizat e fotografive statike të Fukujamës dhe të Hantingtonit, nëse mundohet t'i kontrollojë dhe t'i përjashtojë pellget e gjallëruara në aspektin ekonomik dhe politik, i afrohet fundit të vet. Në një tubim të mbajtur në Turqi, Thomas Fridmanin, njërin prej emrave të rëndësishëm të globalizimit, lidhur me procesin e globalizimit dhe raportet e FMN-së me Turqinë, e kritikova duke i thënë se "Aktorët qendrorë të globalizimit me FMN-në në krye, përmes organizatave ndërkombëtare duan që t'i kontrollojnë elementet pasive të ekonomisë-politikës botërore, e në mesin e tyre edhe Turqinë, e nga ana tjetër e pengojnë pjesëmarrjen e tyre. Sistemet që kontrollojnë pa e lënë të kontrolluarin që edhe ai të marrë pjesë, s'mund të jenë jetëgjatë. Këta aktorë thonë: "Le t'i kontrollojmë qytetërimet tjera, por ato le të mos marrin pjesë në sistem. Ne si Veri duhet t'i kontrollojmë të gjitha lëvizjet e punës dhe të kapitalit që ndodhin në Jug, e ato të mos ndikojnë fare mbi ne".

Dimensioni strategjik

Duke i vënë në lëvizje ata, me siguri do të keni trysni prej tyre. Në kohën e sotme s'mund të tërhiqni një vijë si ajo ndërmjet Romës dhe teutonëve. Ashtu si

këta të fundit e shkatërroan Romën, edhe të tjerët mund t'u shkatërrojnë ju, nëse nuk i poziciononi në një vend brenda sistemit tuaj, në një bazë legjitime. Kjo pyetje na bart në dimensionin e dytë, që ka karakter strategjik. Ne ballafaqohemi me një problem të këtillë strategjik: Sikur të mos ishte ngjarja e 11 shtatorit, amerikanët ndoshta do të rezistonin në prirjen e tyre për të mos e parë realitetin.

Tani le të vijmë te dimensionin strategjik. Në vitin 1989 ndodhi shembja e Murit të Berlinit, kurse në vitin 2001 u shkatërroan Kullat Binjake. Ç'ndodhi ndërmjet dy rrënimeve? Çdo luftë e madhe përfundon me dy gjëra: Së pari ndodh armëpushimi, pastaj njerëzve u thuhet: "U morëm vesh për armëpushim, ejani t'i përcaktojmë themelet e rendit pas luftës", dhe më pas në sajë të një marrëveshjeje të qëndrueshme vihen rregullat e sistemit të pasluftës. Zakonisht marrëveshja shkon në favor të palës fitimtare. Si shembull nga periudha moderne i kemi Luftërat Tridhjetëvjeçare që e dërrmuan Europën, që e shkatërroan Perandorinë Gjermane dhe nxorën në skenën e historisë sistemin e shtetit kombëtar. Më vonë u ulën të gjitha ato principata, papati e të tjerë dhe formuan sistemin e quajtur të Vestfalisë. Sikur palët të mos arrinin marrëveshje për këtë rend, lufta mund të vazhdonte. Iluminizmi, më pas Revolucioni Francez, luftërat e Napoleonit... Në luftërat e Napoleonit ngadhënjimtarët u ulën dhe në Kongresin e Vjenës i përcaktuan rregullat e lojës. Paqen që në Europë do të zgjaste deri në vitet 1870, e siguroi sistemi i quajtur "ekuilibri i fuqive".

Sipas meje, shkaku kryesor i lindjes së Luftës së Dytë Botërore ishte paqëndrueshmëria e rendit të arritur në Luftën e Parë Botërore, paqëndrueshmëria e rendit ekonomik dhe atij politik. Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore forca kaloi në anën e Amerikës, kurse rendi politik ende vazhdonte në trajtën e kolonializmit anglez dhe francez. Amerika i vuri barrierë këtij kolonializmi përmes parimeve të Uilsonit. "E drejta për ta përcaktuar fatin personal" do të thoshte fundi i sistemit kolonialist anglez dhe francez. Kjo barrierë ndikoi që pas Luftës së Parë Botërore të mos ndërtohej një sistem i mirëfilltë. Kjo shkaktoi fillimin e sërishëm të një lufte të madhe, fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Pas Luftës së Dytë Botërore, Teherani, Jalta, Postdami i përcaktuan parametrat e rendit të ri, në të cilin ShBA do të luanin rolin kryesor. Kështu, u themeluan Organizata e Kombeve të Bashkuara, kolonializmi u zëvendësua me një platformë të bazuar në të drejtën ndërkombëtare, u formua FMN-ja, Banka Botërore dhe GATT-i, mbizotërimi i frangut dhe i sterlinës u zëvendësua me dominimin e dollarit, u ndryshua boshti i tregtisë... Më tutje, lindi tregtia liberale që i rrënoi muret e tregtisë koloniale, u formua Banka Botërore si kontrollues i lëvizjes në këtë sferë. Ky është një sistem me rregullat e veta. Në këtë drejtim, palët hyjnë në fushën e njëri-tjetrit; kështu ka lindur edhe konkurrenca mes Europës dhe Amerikës. De Goli në vitet '60 ngriti krye kundër Amerikës, por kjo nuk i prishi marrëdhëniet mes këtyre dy vendeve.

Në vitin 1989 u shemb Muri i Berlinit dhe u mendua se kjo ngjarje e madhe kishte kuptimin e fillimit

të një rendi të ri. Rendi i ri nuk filloi të funksiononte, sepse deri në vitin 2001 ende nuk ishte arritur ndonjë marrëveshje. Amerika nuk bëri marrëveshje me plot vetëdije, për arsye se bota në këtë periudhë dukej një-polëshe dhe mendonte në këtë formë: "S'kam nevojë për një gjë të tillë, bëj atë që dua!" S'arriti ta vinte lidhjen e nevojshme mes së drejtës ndërkombëtare dhe politikës. Në këtë mënyrë e tronditii ligjshmërinë e sistemit të themeluar nga vetë ky shtet. Më pas, kur filluan të dilnin në shesh dhe të ngjiteshin fuqi të tjera, në eter u hodh teza për përplasjen e qytetërimeve. Nëse ndalemi pak te Fukujama dhe te Hantingtoni, do të shohim se këta e plotësojnë njëri-tjetrin. Për më tepër, mes tyre ka afërsi të mësuesit dhe të nxënësit. Fukujama shpalli epërsinë absolute të Perëndimit, tha se kemi arritur fundin e historisë. Si përfundim, u bë përlligjja e Luftës së Gjirit. Të gjitha vlerat e nxjerra në plan të parë në Luftën e Gjirit, u nëpërkëmbën në luftën e Bosnjës dhe u prit që këto probleme t'i zgjidhte fuqia që e solli fundin e historisë. Duhej të kishte përgjegjës për krizën dhe ata në fakt u gjetën. Në tërë këto dymbëdhjetë vite, më shumë njerëz kanë humbur myslimanët. Ata më së tepërmi janë shkatërruar, janë përbuzur, u janë bombarduar kryeqytetet. Mezar-i Sherifi është qytet yni. Pa marrë parasysh kush sundon në të, ai është pjesë e qytetërimit tonë, pjesë jona. Sarajeva. Për ne nuk ka dallim ndërmjet Sarajevës dhe Bursës. Në aspektin e trashëgimisë kulturore të dy janë qytete tonat. Në Luftën e Dytë Botërore, pilotëve amerikanë u ishte dhënë urdhri që të mos e bombardonin qytetin gjerman të Heidelbergut, sepse ky qytet

përfaqësonte qendrën e përbashkët kulturore të Perëndimit. Edhe ju bombardojnë e ju nëpërkëmbin, edhe ju shpallin fajtor!

Qe dymbëdhjetë vite po bëhen përpjekje që Kina të mbahet jashtë sistemit. Sot në mesin e pesë fuqive më të mëdha të ekonomisë botërore tri janë joperëndimore. Këto pesë fuqi janë ShBA, Kina, Gjermania, Japonia dhe India. Hierarkia ekonomike do të jetë e kështillë, brezin më strategjik të botës do ta përbëjnë vendet islame, por këto shoqëri nuk do të kenë kurrfarë të drejte për fjalë në të gjitha vendimet që merren për brezin strategjik të zënë ngoje: Kontrollim pa lejuar pjesëmarrje. Për shkak të mosarritjes së kurrfarë marrëveshjeje për dymbëdhjetë vite, çdo vend i krizës u ngri. Iraku e pushtoi Kuvajtin dhe u ndëshkua. Se ç' status ka Iraku, s' është e qartë. Vetëm dihet se është nënshkruar armëpushimi. Armenia e pushtoi 1/5-tën e Azerbajxhanit, në fuqi është armëpushimi. Marrëveshja e arritur në Bosnjë në fakt s' është marrëveshje, por armëpushim. Shtetit në të cilin kryetari i shtetit s' mund të shkojë në një zonë të caktuar, vallë a mund t' i themi shtet? Procesi i Paqes i Lindjes së Mesme midis Palestinës dhe Izraelit është po ashtu armëpushim. Arafati s' ka shtet. Në fjalimin e mbajtur në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka thënë: "Le të krijohet një shtet!" Edhe në Afganistan kërkohet armëpushimi. Në këtë periudhë të gjithë aktorët e mëdhenj janë ngujuar nëpër istikame. Sipas të gjitha gjasave, qëndrimi në istikame u bë me qëllim të zënies së pozicionit më të mirë në tryezën e larjes së hesapeve. Çdokush bëri llogore të ndryshme. Ku e gër-

muan llogoren e vet gjermanët? Duke e thelluar më tepër Bashkësinë Europiane, nxorën euron dhe thuajse e fshinë prej Europe dollarin. E ku e bënë llogoren e vet francezët? Duke qëndruar si e vetmja forcë bërthamore në Europë, duke mos hequr dorë prej prova-ve bërthamore. E ku e hapi llogoren e vet Anglia? Duke forcuar pozitën diplomatike mes Bashkësisë Europiane dhe ShBA. E ç'bëri Rusia? Ky vend u përpoq ta rehabilitonte veten përsëri në kuadër të parametra-ve të Eurazisë dhe të Europës. Kina, në saje të përparimit ekonomik forcoi pozitën e vet sa më tepër dhe në larjen përfundimtare të hesapeve hyri me gjakftoh-tësi. Ata që s'patën gjasa për të bërë llogore, si Iraku, shumë shpejt u mashtruan. Iraku deshi të bënte një ndërmarrje, duke menduar se me të pushtuar Kuvajtin do të shndërrohej në fuqi të madhe. Edhe të tjerët me traditë shtetërore bënë llogoret e veta. Në mesin e tyre edhe Turqia e Irani. Çdokush u pozicionua dhe kështu u shfaq një hidhërim i akumuluar.

Nëse lejoni që hendeku i të ardhurave ekonomike të zgjerohet deri në këtë nivel, nëse mbroni një globalizëm të egër, s'mund të pritni që varfanjakët e vende-ve të jugut, që s'gjejnë dot kafshatë buke, të qajnë për Qendrën Tregtare Botërore, ku kanë peshë njerëzit më të pasur të botës!

Bota ka nevojë për një shteg të ri. Paralel me këtë ekziston edhe problemi i rendit ndërkombëtar. Ju shtruat një pyetje shumë interesante: "Pse Afganistani?" Përplasja mes Bashkimit Sovjetik dhe Afganistanit duhet shikuar nga dy prizma. Unë, ndërhyrjen e Bashkimit Sovjetik në Afganistan, e më pas edhe atë

të ShBA e cilësoj si *sulm mbrojtës*. Njëlloj sikur bëmë ne rrethimin e dytë të Vjenës. Rrethimi i parë i këtij qyteti ishte sulmues. Kjo do thotë pohim i një shteti të sigurt në vetvete që s'njeh konkurrent në formën: "Këtu sundoj unë!" Shteti osman pas kthimit prej rrethimit të dytë të Vjenës filloi të deformathej. E themi këtë, sepse fuqia e këtij shteti ishte dobësuar relativisht. Ai që është i fortë, s'ka nevojë ta tregojë forcën. Bashkimi Sovjetik, duke ndërhyrë në Afganistan mendohej të tregonte se perandoria në shkatërrim e sipër ende ishte e fortë ushtarakisht.

Këtu na dilte një luftë e dy botëve: Nga njëra anë Ushtria e Kuqe, e cila mendohej se i kishte maksimalizuar të gjitha mjetet teknologjike të parapara me racionalizmin e filozofisë iluministe, dhe nga ana tjetër, shoqëria afgane e organizuar sipas lidhjeve fisnore. Ushtria sovjetike e cila në mënyrë masive shfrytëzonte teknologjinë, dhe ushtria afgane e privuar prej teknologjisë. Por afganët ngadhënjyen ndaj sovjetikëve.

Tri prirjet

Edhe në sulmin e Amerikës ndaj Afganistanit shënohet i njëjti kontrast. Madje edhe nëse ShBA korrin sukses në operacionin e Afganistanit, pa i shmanhur mangësitë e rendit ndërkombëtar, do ta kenë vështirë të realizojnë efektivitet të vërtetë dhe në fund ndoshta, do të jenë të detyruara të ndërmarrin operacion edhe kundër Aleancës së Veriut. Pa u shqyrtuar

edhe një herë në tërësi komponentet themelore të rendit ndërkombëtar, përderisa armëpushimet e përkohshme mes dy rrënimeve (1989-2001) - që shteteve u mundësojnë një nga një të bëjnë hesape të veta dhe që i nxisin prirjet aventuriere - nuk zëvendësohen me një infrastrukturë të sistemit ndërkombëtar ekonomik dhe politik, ShBA gjithmonë do të përballen me kanosje të ndryshme. Askush s'e konsideron përgjegjëse Amerikën për krizën botërore të vitit 1870, madje as për atë të vitit 1930. Por ju edhe pohoni se e keni sjellë fundin e historisë, se çdo gjë duhet ta kontrolloni ju, kurse nga ana tjetër edhe shkishëroni botën jashtë jush.

Unë në shekullin XXI shoh tri prirje. 1. Amerika duke e marrë si qendër vetë kontinentin amerikan, duke e mbrojtur statusin, do të përpiqet të jetësojë një transformim qytetërimor që për bosht ka Atlantikun. Për ta bërë një gjë të tillë duhet që ta ripërkufizojë vetveten brenda vetes. Sepse San Franciskoja, pjesa e ShBA e Paqësorit është më tepër aziatike. Bostoni ka më tepër ngjyrime europiane. Nëse vazhdon edhe një kohë kjo prirje demografike, Amerika mund të përballlet me problemin e identitetit. Përveç kësaj, ky fakt që përbën një sfidë për Amerikën, mund ta shpjerë atë në shpërbërje. Duke e vënë veten në qendër, ShBA përpiqen t'i ekuilibrojnë fuqitë e tjera, kështu që kundër Gjermanisë mbështet Rusinë, kundër Ruisë Kinën, kurse kundër kësaj të fundit mundohet ta mbajë sa më vitale Japoninë.

Prirja e dytë përbëhet prej ndikimit në përhapje e sipër të Bashkësisë Europiane, reagimi "neotradicional" i saj. Kësaj pike është vështirë t'i jepet sqarim filozofik,

sepse Europa nuk pranon kurrfarë elementi jashtë vetes. Amerika si një shoqëri emigrantësh i pranon më lehtë të huajt. Sado që shënohet një grindje mes brezit të parë të të shpërngulurve me brezin e dytë, përfundimisht të dy brezat janë emigrantë. Një gjerman i Berlinit e ka rëndë ta pranojë që me turkun e Gjermanisë të kenë ideale të përbashkëta. Për këtë arsye, mund të thuhet se Bashkësia Europiane do të përparojë ekonomikisht edhe një kohë, por e ka vështirë të përjetojë një qendërzim të transformimit të ri dhe përfshirës të mendësisë. Problemi kryesor i saj në aspektin ekonomik është plakja e popullsisë. Historia rrëfen se asnjë shoqëri që plaket s'ka arritur ta vazhdojë zhvillimin e vet ekonomik. Popullata po plaket, produktiviteti ekonomik po bie. Nga jashtë sillen njerëz me gjenezë të huaj, si p.sh. turq, e si pasojë e kësaj krijohet disharmoni. Europa po ballafaqohet me një rezistencë të këtillë.

Në Oqeanin Paqësor shënohen grupime të ndryshme, konkurrenca dhe përplasje. Raporti i Japonisë me Paqësorin është i njëjtë me atë mes Gjermanisë dhe Europës Lindore. Hungarezi dhe rumuni ndiejnë mahnitje ndaj gjermanit, por ndërkohë edhe e urrejnë atë. Edhe në zonën nga Indonezia deri në Kore vërehet një shkallëzim emocionesh të këtilla. Për shembull, koreanët jugorë kanë përparuar sipas modelit japonez, janë ndihmuar prej japonezëve, por prapëseprapë ushqejnë ndjenja antijaponeze. Paqësori është hapësirë gjeografike ku shpesh ballafaqohen kulturat më dinamike në aspektin demografik. Për këtë arsye, thuhet se përbën një zonë ku do të ketë përshpejtim të gjallërisë ekonomike dhe kulturore.

Sipas meje, të njëjtën tablo e hasim edhe në shekullin XIII-XIV, në periudhën pak para lindjes së shtetit osman. Ekzistonin Kina e India dhe një aliazh i të dyjave, Indokina. Mesopotamia, nëpër të cilën kalonte rruga tregtare që nisej nga India, rajoni i Mesdheut Jugor, pellgu i stepave që shtrihej prej Kinës në Anadoll. Të gjitha këto hapësira përbënin një tërësi të brendshme tregtare dhe të gjallërisë kulturore. Gjeografi tjetër e rëndësishme e asaj kohe ishte Europa Perëndimore, që mbetej më në skaj. Jeta e gjatë e shtetit osman bazohej në njeriun me cilësi të të gjitha këtyre zonave dhe në ndërtimin e një strukture që i përmblihte apo që ishte fqinjë i të gjitha këtyre pellgjeve. Europa i ndau këto pellgje dhe ia bashkoi vetes. Tash, ato pjesë po ndahen prej asaj bashkësie dhe po formojnë fushat e veta. Ja, pikërisht këtu është me rëndësi Eurazia. Kur flasim për Eurazinë, nuk nënkuptojmë vetëm një kontinent. Me përjashtim të Europës perëndimore, të gjitha qytetërimet e mëdha antike këtu kanë lindur. Këtu është pikëtakimi i të gjitha rrugëve ekonomike dhe i kalimeve strategjike.

Refig: Shumë bukur, shumë gjerë dhe qartë, në mënyrë të shkëlqyer e shpjeguat botën e sotme. Këtu ka një gjë që e shqetëson kohën tonë: Duhet që të kthjelltësohet edhe pak më tepër pozita në të cilën do ta vëmë Afganistanin në këtë tablo. Fuqitë antiperëndimore dhe antiamerikane, marrëveshjet mes tyre, problemet, Atlantiku, Paqësori, të gjitha këto janë shtruar shumë qartë. Sot në skenë është çështja e Afganistanit, lufta mes ShBA dhe Afganistanit. Ku qëndron problemi i mosmarrëveshjes mes këtyre dy shte-

teve? Në kohërat e mëparshme kemi pasur luftërat europiane për të dominuar, luftëra mes Anglisë dhe Francës për të mbisunduar, mes Gjermanisë dhe Francës etj. Le të pranoj se s'e kuptoj dot ballafaqimin mes Amerikës dhe Afganistanit! Njëri është shteti më i pasur në botë, kurse tjetri jeton në varfëri të skajshme, në mjerim të vërtetë. S'po më hyn në kokë lufta mes ShBA dhe Afganistanit. Një gjë interesante në këtë kontekst është fakti se ShBA nuk është vend as i Azisë e as i Eurazisë. Është shtet tejoqeanik. Kurse Afganistani është në qendër të kontinentit të Azisë, nuk është vend bregdetar, nuk është vend i limaneve e i tregtisë. Një vend në mes të Azisë. Por mjaft interesant. Fqinjët e tij janë Irani, Pakistani, India, Kina, Rusia. Tani Amerika e sulmon nga qielli një vend të rrethuar nga shtetet e përmendura. Çdonjëri prej këtyre vendeve është trim, që "mund të bëjë çdo gjë". Rusia, përkundra të gjithave pretendon të jetë fuqi botërore, Kina është vlerë në ngritje e sipër, India sot ka rreth një miliardë banorë, Irani pohon se është duke e ngritur flamurin islam. Këto vende sot janë shikues të një filmi tmerresh, ku një kapadai tejoqeanik po sulmon njërin që s'ka të hajë e të pijë. Këtë s'ia dal ta kuptoj!

Davutogllu: A mundet një strateg amerikan të japë koment për gjeografinë, në të cilën gjendet pa e shikur 360 gradë rrethin në të cilin gjendet? Është i detyruar të vërë para vetes hartën e botës. Për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikut, është i detyruar ta marrë parasysh gjeografinë. Konstatimi juaj është i qëlluar. "Pse"-së suaj nga këndi i strategjisë amerikane mund t'i përgjigjemi përmes dy dimensioneve që

kanë vazhdimësi. 1. Amerika konvencionalisht nuk është vend që mund të pushtohet. Asnjë shtet europian s'mund ta pushtojë Amerikën, sepse është vend kontinental. 2. Kjo është një përparësi e ShBA. Disavantazhi i këtij shteti vigan është ky: Nëse dëshironi të sundoni botën, por jeni shumë larg Afro-Eurazisë, duhet të gjeni mjete, në saje të të cilave vazhdimisht do të dominoni atje. Këtë nevojë më së miri e ka përkufizuar njëri prej emrave më të rëndësishëm të strategjisë moderne amerikane, admirali Mahani në vitin 1904 në propozimin e dhënë Rusveltit të Parë, ku propozoi pesë parime bazë për ShBA: Së pari, të hapni kanalin e Panamasë - tha. Pas disa vitesh u hap. Panamaja është në një pozitë të atillë të rëndësishme, që i "mban" brigjet e Amerikës në Atlantik dhe në Paqësor. Së dyti, do t'i vini nën kontroll ishujt e Karaibeve. ShBA prej asaj kohe kontrollit të këtyre ishujve u kushtojnë rëndësi të veçantë, madje për to ishin në gjendje ta fillonin Luftën e Tretë Botërore me Kubën. I treti, propozoi që të pushtohej ishulli Havai, e edhe kjo ndodhi. Kështu ShBA u shtrinë në Oqeanin Paqësor. Këto parime u realizuan, por dy të fundit janë shumë të rëndësishëm. I katërti, luftën gjithmonë do ta mbani jashtë kontinentit amerikan. Ky është një parim me peshë. Nuk do të lejoni që lufta t'i afrohet Amerikës. Që prej asaj kohe, ShBA luftën për herë të parë e përjetuan brenda hapësirës së vet më 11 shtator 2001. Që nga lufta qytetare, më 11 shtator ShBA në gjeografinë e vet kanë përjetuar humbjen më të madhe në njerëz. Dhe i pesti, për ta mbajtur luftën në Europë dhe në Eurazi, duhet të keni përgatitje të fortë

ushtarake për të sunduar oqeanet. Sot këto dy parime po gjejnë zbatim. Amerika dëshiron të sundojë dhe për këtë arsye është e detyruar të merret me tërë botën. Një prej komponenteve që Afganistanin e bëjnë të rëndësishëm është të qenët e tij fqinjë i qytetërimeve në gjallërim e sipër. Le të hapim një parantezë. Që nga ngjarja e fundit sistemi përballet me kanosje dykahëshe, me dy probleme që sjellin telashe: Pentagoni si këmbë ushtarake e hegjemonisë amerikane dhe Qendra Tregtare Botërore si simbol i fuqisë ekonomike dhe politike. Nëse flasim duke i lënë anash spekulimet e shumta, forca e panjohur deshi t'i tregonte Amerikës se me një hov mund t'ia këpuste të dyja këmbët e rëndësishme. Ky ishte mesazhi i 11 shtatorit. Amerikanët, gjermanët dhe rusët e zgjuar më 12 shtator më tepër u morën me pyetjen "Çfarë domethënieje ka kjo koniunkturë e re?", sesa me pyetjen "Kush e bëri këtë?" Destinimi i këtij kërkimi ishte jashtë Perëndimit, te tri forcat bërthamore: India, Pakistani dhe Kina. Afganistani është fqinjë i këtyre tri shteteve. Është fqinjë edhe me Rusinë, por ky vend kohë pas kohe mund të futet brenda sistemit, sepse me të po debatohet çështja e forcës bërthamore. Ta kontrollosh vazhdimisht prej lart Afganistanin do të thotë të mund të luash me lëvizjet e atij nënqielli, ndërhyrja në këtë vend është avantazh për një fuqi, e cila nuk dëshiron që drejtpërdrejt të ndërhyjë në Kinë, në Indi ose Pakistan.

Refig: Sado që sulmi duket se është bërë vetëm kundër Afganistanit, në fakt tërthorazi e ka kuptimin e nënshtrimit, sfidimit, kanosjes në formën "Shihni se ç'mund t'i bëj atij që më kundërshton!" Kjo a s'është

politikë e frikësimit dhe pse s'ndërmerren masa kundër saj?

Davutogllu: Pyetje me vend. Para se të përgjigjem në pyetjen e radhës, më lejoni ta zbërthej sa duhet çështjen e shtruar më parë "Pse Afganistani?" Këtu duhet të përkujtojmë strategjitë e energjisë, të cilat i përmendët në fjalën tuaj më parë. Afganistani, për Amerikën përbën rrugën më të shkurtër, më të lirë dhe më të sigurt të transferimit të burimeve natyrore të Azisë së Mesme dhe të Kaspikut. Kjo rrugë që shtrihet nëpër Afganistan, që kalon nëpër Pakistan dhe shpie në Oqeanin Indian, është mjaft e rëndësishme. Oqeani Indian është një zonë e mirënjohur për flotën ushtarako-detare amerikane. Rruga e dytë e lirë është ajo që kalon nëpër Iran e nëpër Basra dhe kjo po ashtu është nën kontrollin e Amerikës. Dihet se "Dajë Sami" s'ka marrëdhënie të mira me Iranin, kurse në Afganistan ka "një regjim problematik" për të. Linja Baku-Xhejhan është një rrugë e parapëlqyer për amerikanët, e cila zbret në Mesdhe dhe që me hyrjen e Qipros në BE depërton edhe në pellgun e Bashkësisë Europiane. Kjo është një hapësirë e afërt ndaj kontrollit europian. Rruga e katërt kalon nëpër Rusi, kurse e pesta nëpër Kinë... Nëse në Afganistan vjen në pushtet një regjim sipas tekave të Amerikës dhe nëse në jug mbahet edhe më tutje nën kontroll Pakistani, kjo vijë e përcjelljes do të ishte rruga më e shkurtër, më e sigurt dhe më e lirë për të manipuluar me burimet e Azisë së Mesme dhe të Kaspikut. Nuk duhet harruar se Afganistani është edhe Azi e Vogël. Muhammed Ikbali në një varg të tij shprehet: "Azia është lëkurë, Afganistani

shpirt...” Afganistani duket shumë primitiv, por në aspektin kulturor është shumë i gjallë. Të gjitha racat dhe sektet e Azisë mund t’i gjeni në Afganistan: kirgizin, taxhikun, uzbekun, shiitin, sunitin... Së fundi, duhet të merren parasysh edhe fushat e prodhimit të hashashit.

Tani të vijmë te pyetja tjetër e rëndësishme që e shtruat: Si është qëndrimi i aktorëve të tjerë rreth kësaj pozite? Në Gji i dënuari ishte Iraku, por porosia ishte për Gjermaninë dhe Japoninë. Mesazhi ishte shumë i qartë: “Forca juaj po rritet, por unë e kontrolloj naftën që është burim i forcës suaj”. Tani përmes Afganistanit u jepet mesazh të tjerëve. Pyetjen tuaj le ta lexojmë kështu: Pse të tjerët e miratojnë këtë mesazh? Në mëngjesin e 12 shtatorit çdokush bëri këtë vlerësim: Mes aktorëve të mëdhenj u bënë grupime. Një grup mendoi në këtë formë: A thua mund të përfitoj nga kjo koniunkturë? Në mesin e këtij grupi shoh Rusinë dhe Izraelin, të cilat i shtruan vetes këtë pyetje: A mund t’i zgjidh çështjet e mia? Për Rusinë Çeçenia, kurse për Izraelin Palestina. A thua mund t’i zgjidhim këto probleme nën fushatën dhe llafologjinë e “terrorit islam”? Rusia u mundua që gështenjat e Azisë së Mesme dhe të Kaukazit t’i mblidhte nga saçi i Amerikës pa i djegur duart. Në këtë drejtim arriti diçka. Një grup tjetër... Kina e cila nga njëra anë e kundërshtonte ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara, por nga ana tjetër mundohej të mbetej brenda sistemit, arriti të bëhej anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë. Palët e shqetësuara nga dukuria islame e Lindjes së Mesme më parë u takuan në Pesëshen e Shangait. Çdokush e pret fazën strategjike. Mundohen t’i përca-

ktojnë sjelljet e veta duke i vëzhguar veprimet e Amerikës. India është e mbërthyer me problemin e Kashmirit, që mbahet në shkrehës. Irani po ndjek një politikë të qartë. Kur të përfundojë regjimi taleban, Irani, duke synuar ndikimin në Afganistan, mund t'i rishqyrtojë marrëdhëniet e veta me Amerikën. Shikuar në përgjithësi, çdokush mundohet t'i mbajë letrat në duar në mënyrë që të jetë i gatshëm për çfarëdo koalicioni. Përderisa ndërhyrja në Afganistan është kalimtare, të gjithë aktorët vetëm shikojnë. Por nëse Amerika themelon një bazë të qëndrueshme në Afganistan, nëse fillon të përzihet në punët e Azisë, mund të paraqiten kombinime të ndryshme.

Refig: Lidhur me këtë që po diskutojmë, ka një qëndrim të rëndësishëm. Në këtë numër të revistës sonë do të botohet intervista me Nathan Gardelsin dhe Samuel Hantingtonin. Ky i fundit shprehet si vijon: *"Globalizmi po merr hov në rajone të ndryshme të botës, me shpejtësi të ndryshme. S'ka dyshim se procesi i globalizimit e ka nxitur Osama bin Ladenin që të dalë prej shpellave të Afganistanit të varfër në qendër të Manhatanit, ia ka lehtësuar punën atij"*. Më pas shton: *"Rusia, Kina dhe India, që kanë mbetur jashtë bërthamës së proceseve të integrimit, për shkak të telasheve që i kanë me islamistët dhe me terrorin, po i bashkangjiten koalicionit nën udhëheqjen e Perëndimit"*. Kjo ngjarje e bashkoi Perëndimin - thotë Hantingtoni. Rreziku sovjetik i periudhës së Luftës së Ftohtë s'arriti ta unifikonte tërësisht Perëndimin, kurse një njeri nga shpellat e maleve të Afganistanit ia doli ta bashkonte. Sot këtij bashkimi i ngjiten edhe Amerika Latine e Japonia. Sipas Hantington-

nit, çdo shtet që i bashkangjitet këtij koalicioni ka problem me Islamin. Lexuesit e *NPQ*-së do të kenë mundësinë që ta lexojnë këtë reportazh të çmuar. Skenari i bashkimit të gjithë botës kundër Islamit, mua si një qytetar i një vendi islam, më trishton. Le të shtojmë edhe këtë: Dalja në skenë pas 11 shtatorit e përplasjes së qytetërimit dhe nxjerrja në eter e kësaj sintagme nga një mendimtar në asnjë mënyrë s'mund të jetë rastësi.

Hantingtoni është zëdhënës. Ai e ka përmbledhur porosinë dhe e ka përgatitur për t'u nxjerrë para opinionit publik. Hantingtoni shprehet se konceptin e tij të qytetërimit e ka huazuar prej Tojnbit, i cili - siç e përmendëm edhe më parë - thotë se historia botërore njih 26 qytetërime. Sot vetëm dhjetë syresh janë të gjalla. Në mesin e tyre, natyrisht qytetërimit perëndimor, si pjesëtar i tij, i jep një vend të veçantë. Duke e përkufizuar atë, peshë të madhe i jep fesë. Thekson se qytetërimi perëndimor është vazhdimësi e Romës perëndimore, e krishterimit perëndimor që dallon prej ortodoksisë. Duke e vlerësuar lëvizjen e disa vendeve për t'u perëndimorizuar, thotë se "s'mund të bëhesh perëndimor pa qenë i krishterë!" Tojnbi sipas meje prek një çështje mjaft të rëndësishme. Koncepti i këtij shkencëtari tregon paralelizëm të çuditshëm me atë të Ibën Haldunit. Tojnbi, njësoj si Ibën Halduni thotë se qytetërimet janë si organizma të gjallë që lindin, zhvillohen, rriten dhe në fund vdesin e zhduken. Sipas tij, është për këtë arsye që nga skena e historisë botërore janë fshirë mbi njëzet qytetërime. Është për t'u habitur që vetë Tojnbi pohon se qytetërimi perëndimor është duke përjetuar rënien!

Këtu shënojmë një qëndrim që Tojnbin e dallon prej Hantingtonit. Sipas Tojnbit, “ka mundësi që qytetërimi perëndimor të (mbi)jetojë, të ringjallet. Injektimi vetes i aspekteve më të mira të Islamit dhe të feve të Lindjes së Largët, sinteza e re në këtë drejtim, është shpresë si për Perëndimin ashtu edhe për botën përgjithësisht”. “Përndryshe Perëndimi, sikurse disa qytetërime të tjera të historisë njerëzore, po përjeton procesin e shkatërrimit”.

Hantingtoni, i cili nisët nga koncepti i Tojnbit për qytetërimet, është larguar shumë nga dijetari në fjalë. Ai thotë se pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, detyrë e NATO-s është mbrojtja e qytetërimet perëndimor. Ky qytetërim po ballafaqohet me dy rreziqe të mëdha: Islami dhe konfucianizmi. Hantingtoni në vazhdim shton: Le të mos e prekim Kinën. Nëse është e mundur, për ta nxjerrë prej taktit Islamin, për ta penguar aleancën e ardhshme mes Islamit dhe Kinës, së pari duhet të mposhtim Islamin, e më pas do të shohim. Këtu vërejmë se përkundër ngjashmërive mes qasjes së Hantingtonit dhe asaj të Tojnbit, hasim në dallime thelbësore. Tojnbi qytetërimet i veçon me cilësitë shpirtërore. Kurse Hantingtoni, duke i prekur rezultatet politike të qytetërimeve, në plan të parë nxjerr pasuritë e rruzullit tokësor. Tash jemi ballë për ballë dihotomisë universale tematike: A thua vlerat materiale janë përcaktuese për shpëtimin e njerëzimit? Unë besoj se shpëtimi i njerëzimit varet prej daljes zot vlerave shpirtërore. U jap të drejt atyre që thonë se sistemi i ndërtuar mbi vlerat materiale është duke e çuar botën e gjallë kah fundi. Samiti i Mjedisit i mbajtur në

vitin 1992 në Rio de Zhaneiro paraqet pikë kthese në shpalljen e kësaj të vërtete botës mbarë. Mendoj se mbisundimi i vlerave shpirtërore përbën derën e shpëtimit të qenies njerëzore. Jam kureshtar të di se cilat janë qytetërimet, që në plan të parë i kanë vlerat shpirtërore dhe të njëjtat vallë a munden ta ngrenë zërin e vet?

Davutogllu: Fukujama i bazuar te Hegeli, dhe Hantingtoni i mbështetur te Tojnbi, ka ofruar mendime apokrife dhe ia bën fli pragmatizmit politik. Në thelb, për Hantingtonin s'mund të themi se është historian i qytetërimeve. S'ka ndonjë referencë për t'i lexuar qytetërimet në vetveten e tyre. A thua kishte të drejtë kur i akuzonte qytetërimet e tjera? Le t'u hedhim një sy të dhënave që i kemi në dorë: të gjitha luftërat më të mëdha kanë ndodhur mes viteve 1492 dhe 1992, etapë kjo të cilën e konsiderojmë si periudhë moderne. Në këtë drejtim mund të numërojmë luftëra të gjera, në të cilat kanë vdekur mbi 250 mijë njerëz: Luftërat Tridhjetëvjeçare², Luftërat e Trashëgimisë, Luftërat e Napoleonit, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore... Asnjëra prej këtyre luftërave s'e ka pasur epitetin luftë mes qytetërimeve. Këto luftëra janë zhvilluar në kuadër të qytetërimit perëndimor, ku synim kryesor ka qenë përfitimi. Në asnjërën prej tyre palë nuk ka qenë ndonjë qytetërim tjetër. Në Luftën e Parë Botërore shteti osman është bërë palë pa dashur, madje duke u hequr zvarrë. Thuhet: "Sot

² Luftërat mes viteve 1618-1648 që e mbushën Europën në gjak, ishin pasojë e përplasjeve fetare që ndodhën në Gjermani. (*Genel Kültür Ansiklopedisi*, vëll. 3, 1645. - A.P.)

kemi një luftë mes qytetërimeve. Bota islame është përplot kriza!" Le ta diskutojmë këtë tezë. Në botën islame nuk mund të vërejmë ndonjë forcë ushtarake, teknologjike dhe ekonomike që do të mund ta rrezikonte Perëndimin. Në rregull, po pse atëherë në të gjitha krizat përmendet emri i botës islame? A thua do t'i kishim të njëjtat rezultatet sikur bota islame të ishte e pozicionuar në Amerikën Latine ose diku në Afrikën e Mesme?

Pse bota islame? Sipas meje ka disa arsye për këtë. S'do mend se damarët kryesorë të ekonomisë botërore janë rrugët tregtare detare. Sot në botë ka 18 rrugëkalime, që sigurojnë rrjedhën e tregtisë. Ndër nëntë prej tyre me vlerë jetike, tetë gjenden në botën islame. Burimet më të rëndësishme të naftës, të pasurive natyrore të tjera gjenden në hapësirën gjeografike të botës islame. Rrugët strategjike kalimtare të botës gjenden në këtë hapësirë gjeografike. Cilat janë qytetet që pasqyrojnë qytetërime të ndryshme? Nëse kërkoni qytet ku me plot kuptimin e fjalës bashkëjetojnë tradita të ndryshme fetare, s'do ta gjeni atë në Nju-Jork ose në Londër, por në Stamboll, Damask, Bagdad, Kudus (Jerusalem), Samarkandë, Kajro etj. Të gjitha këto janë qytete islame. Si është e mundur që një qytetërim, i cili përgjatë historisë e ka ruajtur shumëkulturësinë e vet, sot përnjëherë të shndërrohet në qytetërim që bie ndesh me të gjitha qytetërimet?

Refig: Unë ndiej nevojë që të ndërhyj pak. Sipas Tojnbit, faktori thelbësor që ka ndikuar në përhapjen e Islamit me shpejtësi të madhe në Azi dhe në Afrikë është "proletariati i jashtëm", pra ajo që ky autor e quan "nënklasat e jashtme". Nëse i marrim parasysh

të dhënat se hendeku mes vendeve të pasura dhe atyre të varfra vazhdimisht po zgjerohet, se vendet e pasura prej gjashtë miliardë banorësh të tokës përbëjnë vetëm një miliard, se numri i njerëzve në kufirim e varfërisë e kalon dymiliardëshin, atëherë shtrohet pyetja nëse proletariati i jashtëm përsëri po e tregon forcën e vet. Më tutje vijon pyetja nëse sot, në kohën e komunikimit të sofistikuar, nuk mund t'i dilet para kësaj shkëputjeje të një pjese të botës prej tjetrës?

Davutogllu: Para 11 shtatorit bëhej një ndërlidhje mes globalizimit dhe demokratizimit. Kjo është një lidhshmëri e rrezikshme për Perëndimin. Demokratizimi i vërtetë, demokratizimi global duhet të shpjerë në zhdukjen e kufijve dhe në rritjen e nivelit të pjesëmarrjes. Nga kjo pikë dhe nga ky kurs i debatit mund të kalojmë në një rrjedhë tjetër.

Refig: Demokracia që nga periudha antike greke e deri në kohën e qytetërimit perëndimor është perceptuar si “liri e zotëruesve të pasurisë”, kurse “demokratizimi” si verifikim i sundimit të parasë. Koncepti i fundit me të cilin po tregtohet, pra globalizimi, nënkupton lirinë e hyrje-daljes së kapitalit në çdo vend, por ç’ë do që qarkullimit të lirë të mundit s’ia njeh të drejtën e njëjtë. Raporti i njeriut me natyrën tanimë po synohet që të mos rregullohet në kuadër të nderimit të Zotit, por duke iu nënshtruar parasë, e cila po mbisundon botën. Mendoj se ndaj këtij rendi të mbisundimit të parasë, që bie ndesh me thelbin e krijimit, do të ngrerë krye si njeriu, ashtu edhe natyra. Sipas meje, 11 shtatori ishte pamje e parë e kësaj. Përdërisa njerëzit e pasionuar pas hegjemonisë globale -

që i kanë lënë mënjanë vlerat universale thelbësore të spiritualitetit - nuk i mbledhin mendtë, është e pashmangshme që të ballafaqohemi me gjendje më rrëqethëse sesa 11 shtatori. Le të mos e harrojmë fjalën popullore turke: “Njëri ha plot gojën, tjetri shikon me sy, kështu vjen e ndodh kijameti i zi!”

*11 Shtatori dhe qorrsokakët filozofike të kërkimeve të rendit të ri**

Ahmet Demirhan: Në një emision të STV-së patët pohuar se për të njohur më mirë ngjarjen që ndodhi në ShBA, duhet kuptuar prapaskaena filozofike e saj. Kjo m'ua duk e çuditshme nga ky aspekt: Si është e mundshme që kjo ngjarje të ndërlidhet me filozofinë? Si mund ta ndërlidhim atë me filozofinë, në një kohë kur pohohet se fuqia e filozofisë është harxhuar, se kemi ardhur në fund të filozofisë?

Ahmet Davutogllu: Në fakt edhe teza për fundin e filozofisë është e hapur për diskutim, por në lidhje me ngjarjen e madhe në fjalë mund të themi këtë: Fukujama, duke u nisur prej Hegelit, shtroi një pretendim të madh, duke thënë se historia ka përfunduar. Lidhja midis filozofisë dhe politikës në fund të Luftës së Ftohtë në përgjithësi doli në këtë formë dhe Fukujama pohoi, se kërkimi i njeriut ka përfunduar me nivelin e racionalitetit të arritur në sferën e institucionalizimit politik. Fundi i historisë do të thotë edhe fundi i modernitetit. Theksohej se në pikën ku përfundon historia, përfundon edhe moderniteti, sepse i ka arritur synimet e veta. Kësisoj, ata që në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare krijojnë lidhje mes politikës dhe filozofisë, ngulmonin se historia kishte përfundu-

* Revista *Tezkire*, nëntor-dhjetor 2001

ar dhe këtë e ndërlidhnin me suksesin e mekanizma-ve racionalë. Në atë kohë unë e kundërshtova me këmbëngulje këtë mendim dhe në vitin 1991 në një konferencë ndërkombëtare paraqita një kumtesë me titullin "The End of the End of the History" (Fundi i fundit të historisë). Mendimi im binte ndesh me atë të Fukujamës. Sipas meje, endizmat ose tezat për fundizmin përbëjnë mashtrim serioz. Shikuar bashkë me pararendëset, kjo ishte hallka e tretë. Më parë moderniteti e kishte shpallur fundin e fesë, pas viteve '50 shpalli fundin e ideologjisë dhe tani, fundin e historisë. Feja, ideologjia dhe historia... Moderniteti shpalli fundin e tri kornizave të rëndësishme që i japin kuptim dhe që e formojnë hapësirën ekzistenciale të njeriut. Këtë e bëri në një mënyrë tepër mekanike dhe formale. Gjëja e parë së cilës iu shpall fundi ishte feja dhe ç'është më interesante, në periudhën kur po shpallej fundi i historisë, po shënohej një periudhë e ringritjes së feve. Po përjetohej një gjallërim jo vetëm në botën islame, në format e reja të krishterimit, por edhe në hinduizëm, madje edhe në fetë e Lindjes së Largët. Si mund të përfundojë historia, kur njëri prej faktorëve më të rëndësishëm të qeniesimit të njeriut, feja, së cilës para një shekulli iu shpall fundi, po shënon gjallërim kaq të hovshëm?³

Demirhan: Këtu dua të shtroj një nënpyetje. Derrida, duke e kritikuar tezën e Fukujamës për fundin e historisë, e cilëson të njëjtën gjë si një "lajm të mirë" dhe thotë se autori i tezës në fjalë po ofron një krishte-

³ Më gjerësisht rreth kësaj teme shih: Ali Pajaziti, *Rinia universitare dhe religjioni*, Logos-A, Shkup, 2003, f. 57-71 (shënim i botuesit në gjuhën shqipe).

rim të ri. Fjala “lajm i mirë” na çon te Ungjilli, është pra term fetar. Pra, teza për fundin e historisë, përveç shumë aspekteve të tjera, a thua e ka edhe atë të një teze fetare?

Davutogllu: Po, pa fije dyshimi. Në artikullin tim të botuar në numrin e nëntë të revistës *Divan*, jam shprehur se qasja e tezës fukujamiane është evangjeliste. Domethënë, endizmi ngërthen në vete pretendim mesianik. Ç’është ajo që mund ta sjellë fundin e historisë?. Një element fetar, një Mesi(h). Në këtë kontekst, mund të thuhet se teza e përfolur bazohet në një *background* evangjelist. Jam i mendimit se për këtë ka kontribuar edhe pasmodernia. Njeriun në skenën e historisë e ka nxjerrë siguria ontologjike dhe kërkimi i lirisë. Ai që kur lind, që nga zëri i vajit të parë ka nevojë për siguri dhe kjo nevojë e përcjell atë deri në vdekje. Që kur lind është i varur ndaj nënës, por prapëseprapë ai dëshiron të tregojë forcën dhe vullnetin e vet. Për t’u arritur fundi i historisë duhet që të jenë zgjidhur problemet e sigurisë dhe të lirisë. Në kumtesën e përmendur të vitit 1991 jam munduar që në pesë pika të tregoja se çështja e lirisë dhe sigurisë nuk është zgjidhur. Këtu le të mos i përmend të gjitha, por le t’i prekim më të rëndësishmet prej tyre. Para së gjithash, tjetërsimi ontologjik ndaj vetvetes dhe ndaj mjedisit. Kjo është një çështje që ndërliidhet me sigurinë dhe të njëjtën gjë mund ta vështrojmë nga këndi i teknologjisë ushtarake. Kjo teknologji është racionale. Sipas Fukujamës, ajo është formuar në bazë të racionales. Teknologjinë ushtarake dhe sigurinë ontologjike mund t’i trajtojmë në tre rrafshe:

1. Nga ai i luftërave frontale, metodë kjo që ndërli-dhet vetëm me sigurinë e ushtarëve që janë në vijën e luftës.

2. Me hyrjen në punë të avionëve luftarakë të përdorur për herë të parë në Luftën Qytetare të Amerikës dhe me përhapjen e tyre në luftërat botërore, proble-min e sigurisë filluan ta ndiejnë edhe civilët.

3. Periudha e luftërave bërthamore, të cilat siç u pa në rastin e vitit 1945 në Japoni, nuk ndikojnë vetëm te njerëzit e një brezi, por edhe te ata që do të pasojnë.

Pra, me shfrytëzimin e mekanizmave racionalë, fusha e sigurisë nuk u zgjerua, por u ngushtua. Pilotët amerikanë i hodhën bombat në Hiroshimë dhe në Na-gasaki, me një vendim të kaluar nëpër mekanizmat demokratikë, me një mendim sistemik të zbatuar në mënyrë racionale. Nëse pohohet se racionaliteti dhe demokracia njerëzve u sjellin demokraci, si të shpj-goget ky rast? Me një dilemë të ngjashme përballemi edhe lidhur me lirinë. Njeriu ka krijuar lidhje mes skllëvërve dhe makinave; ajo që në kohën antike ka qenë skllavi, në kohën moderne është makina. Si e shikonte skllavin Greqia antike? Si qenie që njeriut do t'i ofronte kohë të lirë dhe që do ta ndihmonte në arritjen e sigurisë. Në këtë mënyrë e shikon makinën moderniteti. Makina do të punojë për mua dhe unë do të jem i lirë. Kurse në të vërtetë po ndodh e kun-dërta, makinat filluan ta robërojnë njeriun dhe njeriu u përball me problemin e lirisë.

Demirhan: E gjithë kjo si ndërlidhet me 11 shtatorin?

Davutogllu: Këtu duhet theksuar një gjë tjetër. Kri-za e parë përbëhet prej tjetërsimit ontologjik dhe sigur-

isë, kurse e dyta ndërlihet me problemin epistemologjik, domethënë me kërkimin e së vërtetës, gjë rreth së cilës s'mund të flasim në detaje. Kontradikta mes modernitetit dhe krishterimit shkaktoi daljen në shesh të pikave, për të cilat moderniteti e kishte sulmuar më parë krishterimin: arsyeja, shkenca dhe përparimi.

Demirhan: Të cilat janë ngushtë të lidhura me mësimet e krishtere.

Davutogllu: Natyrisht. Në varësi të kësaj është edhe ideja se arsyeja sjell shkencën, kurse shkenca përparimin. Por u vërtetua se kalimi i shkencës në pozitë të pakontrollueshme, mund të sjellë probleme shumë serioze. Në kontekst të problematikës së lirisë dhe të sigurisë, paraqitet edhe e treta: raporti midis vlerës dhe mekanizmit. Vlerat e gjeneruara nga mekanizmat racionalë kanë shkaktuar lindjen e një rendi ndërkombëtar. Sipas meje, këtu ka lindur dilema mes kulturave antike dhe modernitetit. Te të gjitha kulturat antike, përfaqësuese e fundit dhe më e suksesshme e të cilave është ajo islame, së pari zgjidhet problemi i qeniesimit; në varësi të kësaj zgjidhet problematika e epistemologjisë. S'duhet harruar se aksiologjia varet prej epistemologjisë. E drejta varet prej aksiologjisë, politika prej së drejtës, e ekonomia prej politikës. Ekonomia është disiplinë apo fushë e domosdoshme për njeriun, por e njëjta gjë s'mund të jetë përcaktuese. Moderniteti këtë e ktheu nga e prapta. Ekonomia filloi ta determinonte politikën, liberalizmi politikën; kjo politikë formoi të drejtën e vet, e drejta një kod etik të caktuar, një sistem vlerash, e këto vlera formuan një koncept për dijen dhe ekzistencën. Këtu

njeriu është i vlefshëm si konsumues. Ngjarja e fundit na i tregoi disa gjëra. Para së gjithash, e nxori në skenë problemin e sigurisë ontologjike. Njerëzit s'e ndienin veten të sigurt as në qendrën më të rëndësishme "që e solli fundin e historisë", në vendet më të mbrojtura: në Pentagon dhe në Kullat Binjake. Autorët e sulmit të 11 shtatorit, pa marrë parasysh kush janë ata, te shoqëria amerikane shkaktuan një shok të sigurisë, të cilin amerikanët s'e kishin përjetuar më parë. Amerikanët të gjitha luftërat i shikonin nga televizioni ose si film pas përfundimit të tyre. Që nga Lufta Civile e këndeje, amerikanët asnjëherë s'e kanë ndier pasigurinë që e sjell lufta. Tani për herë të parë po përjetojnë një gjë të tillë. Në çastin kur ndieni se s'mund ta zgjidhni problemin e sigurisë, në pishinë bie një gur që e ka ndikimin e vet.

Demirhan: Në fakt, kur themi se ngjarja e 11 shtatorit duhet të interpretohet në mënyrë filozofike, gjëja e parë që ma tërheq vëmendjen është lënia e strategjisë në plan të dytë. Pas 11 shtatorit, çdokush filloi t'i bënte llogaritë se ç'mund të bënte Amerika në rrafshin strategjik. Kurse shpjegimi i çështjes në aspektin filozofik, nuk ndërlihet me atë sesi Amerika do të reagojë jashtë, por drejtpërsëdrejti me të menduarit rreth brendësisë së këtij vendi. Ndërlihet me të shikuarit të Amerikës prej brenda.

Davutogllu: Gjithsesi.

Demirhan: Nëse mendojmë kështu, na del para një tablo e këtillë: Për shembull, Karl Shmiti inicon konceptin e *nomosit*, i cili na e shpalon brendësinë e periudhës së globalizmit. 11 shtatori tregon se Amerika ose periudha pas vitit 1945 nuk ka nomos të këtillë?

Davutogllu: Çdo qytetërim në skenën historike del me tërë pastërtinë e vet. Qytetërimi romak, që kishte lindur në qytetin e Romës, ishte tërësisht romak. U përhap në Itali, por prapë e ruajti karakterin romak. Kur arriti në Greqi, u përball me filozofinë. Me të përvetësuar trashëgiminë filozofike greke, e rindërtoi vetveten. Pas një kohe të caktuar, filozofinë stoike greke e ripërpunoi bukur mirë dhe udhëheqjen e qindra bashkësive etnike ose fetare të cilat i ngërthente në vetvete, filloi ta shihte si problematikë filozofike. Kjo vlen për të gjitha qytetërimet. Në fazën e lindjes së Islamit, të shpërngulurit në Medinë ishin pjesëtarë të fisit Kurejsh. U themelua qyteti i Medinës, që vazhdoi ta ruante cilësinë e të qenët qytet kurejshit. Por, kur në kohën e Omerit (r.a.) shteti islam filloi të zgjerohej në Siri, u inkuadruan elementet e huaja dhe kur myslimanët filluan të ballafaqoheshin me to, u shënua një periudhë e gjallërimit në lëmin e filozofisë. Kulmi politik i kësaj periudhe të gjallërimit u përjetua në kohën e shtetit osman. Por te osmanllinjë, p.sh. duke e lexuar Kënallëzaden, më tepër pashë kërkim filozofik sesa politik. Kënallëzade dhe Makiaveli kanë jetuar në të njëjtën kohë. Makiaveli në veprën e vet flet për pavarësimin e politikës prej moralit. Kënallëzade në librin e tij fillon me dashurinë, mundohet të ndërtojë një politikë të bazuar në dashuri. Në *Princi*-n e Makiavelit thuajse nuk ka asnjë referim jashtë Romës dhe krishterimit. Sepse çështja dhe synimi i ngushtë i Makiavelit ishte bashkimi i Italisë. Te Kënallëzade vërehet tradita e vjetër iraniane; pothuajse në çdo kapitull shihni Platonin e Aristotelin

dhe çdo ngjyrë të mendimit islam. Ajo që e ka shtyrë Kënallëzaden të ketë një pikëpamje të tillë është përpjekja për të qenë përmbledhës ose ngërthyes. Sepse sulltani i veprës së Kënallëzades, që mundohet t'i bashkojë tre kontinente dhe shumë bashkësi, nuk është si *Princi* i Makiavelit.

Nëse u hedhim një sy filleve të modernitetit, do të shohim se Hobsi është anglez, kurse Rusoi francez. Kur europiani filloi të kontaktonte me faktorë të tjerë, gjeti një fushë krejtësisht të re. Ideja për ndërtimin e një sistemi botëror, ia hapi shtigjet filozofisë. Idetë e Hobsit nga koha e luftës civile në Angli, nga koha e krizës, janë ide të një anglezi të rëndomtë që po kërkonte sigurinë. Idetë e shpalosura nga Rusoi pikërisht para Revolucionit Francez kanë të bëjnë me problemet e francezëve të asaj kohe. Shikoni konceptin e Hegelit për historinë; mundohet të përfshijë gjithçka në boshtin e Gjermanisë. Po ashtu si Kënallëzade përpjeket të sigurojë unitetin e shtetit osman. Sipas Hegelit, njerëzimi foshnjërinë e vet e ka kaluar në Azinë lindore, fëmijërinë në ndonjë vend tjetër, kurse pjekurinë me gjermanët. Nëse i marrim parasysh problemet e asokohshme të Gjermanisë, do të shohim se sqarimi i Hegelit është përpjekje për ta interpretuar historinë nga këndvështrimi i subjektit. Nëse ndalemi te ShBA, do të vërejmë se trashëgimia filozofike dhe fetare e këtij shteti është ndërtuar mbi kulturën e përcjellë prej Europe. Bashkë me bindjen e shprehur përmes shkurtësës WASP, white (i bardhë), anglo-sakson, protestant. (Natyrisht se edhe shteti osman është ngritur mbi trashëgiminë pararendëse.) Për këtë arsye ameri-

kanët nuk nxorën një Kant ose një Ruso të ri, por nxorën neokantistë dhe neohegelianë. Pikërisht si osmanllinjë, që nga periudha Abaside gjeneruan neogazalistë dhe neorushdistë. Amerika s'ndjeu nevojë të tillë. Ajo u përpoq që gjënë e përcjellë ta përbrendësonte në sistemin e vet.

Demirhan: Dhe në këtë kontekst burimi kryesor i ShBA ishte mendimi gjerman i para Luftës së Dytë Botërore...

Davutogllu: Po, pikërisht ashtu. Madje, të gjitha universitetet e rëndësishme në Amerikë i kanë themeluar gjermanët, kurse gjatë Luftës së Dytë Botërore pilotëve amerikanë u ishte dhënë urdhri që të mos e bombardonin Heidelbergun. Për pasojë në Heidelberg nuk është hedhur asnjë bombë, kurse Manheimi i afërt, që është një zonë industriale, u bë rrafsh me tokën. Amerikanët ndiejnë një borxh të kësaj natyre. Amerikani bën një ndarje të shfrytëzuar në gjeopolitikë, të formës *frontier* dhe *border*. Por kjo ndarje mund të shfrytëzohet edhe në aspektin ideor. Amerika është themeluar në bazë të pasionit të paprerë të një bashkësie njerëzore për të pushtuar toka të hapura deri në "pafundësi". Në mendimin gjerman ka një kufi (*border*), një gjë që kufizon (*boundary*). Fjala *frontier* e ka kuptimin e çarjes përpara. Gjermanët, duke u përpjekur që vazhdimisht t'i kapërcenin kufijtë e vet, u futën në filozofi, kurse amerikanët hapëruan drejt Përrëndimit, drejt kontinentit të paskajshëm të Amerikës Veriore dhe më pas duke e "çliruar" botën, menduan se rruga është e pafundme. Për shkak të përvojës së vet s'e perceptuan dot problematikën, transfertin u

përpoqën ta realizonin në saje të filozofisë. Duke e përforcuar hegjemoninë e vet, filluan të mendonin në këtë mënyrë: “Ne s’kemi nevojë për mendim të ri!” Këtë e pasqyron si teza për fundin e historisë, ashtu edhe mendimi për fundin e filozofisë. Kurse e vërteta është se ndërsa ata e përjetonin fundin e historisë, bota islame po jetonte dhe ende po jeton historinë në thellësitë më të mëdha dhe si asnjëherë më parë po ndien nevojë për filozofinë. Sepse është një gjeografi e përshkuar me një sërë krizash ontologjike. Pikërisht si në kohën kur osmanllinjët shkruanin komente (*sherh ve hashije*) dhe kur Hobsi përpiloi *Leviathan*-in. Osmanllinjët s’kishin nevojë për *Leviathan*-in, sepse kishin një rend të mirë, të cilin e kishin pagëzuar si rendi botëror (*nizâm-i alem*). Pra, sipas osmanllinjve historia kishte marrë fund. Për pasojë, tregonte refleksive për ta mbrojtur kulturën e transferuar. Por Hobsi, i cili e kish përjetuar luftën qytetare, në rrethana të tilla kishte ndier nevojën për një koncept të ri të sigurisë dhe të lirisë.

Qorrsokaku i Amerikës

Demirhan: E gjithë kjo, bashkë me ngjarjen e fundit, çfarë tabloje na nxjerr përpara?

Davutogllu: Tash ne ballafaqohemi me një problem serioz: Amerikanët pretendojnë se historia ka përfunduar. Por ngjarja e fundit e shtyu si amerikanin e rëndomtë, ashtu edhe atë të shtresës së elitës që t’i

binte në të së vërtetës, se *Leviathan*-i i krijuar nga vetë amerikanët po i kanoset hapësirës së lirisë dhe sigurisë së tyre. Pas kësaj ngjarjeje filluan të zhvillohen debatet më të mëdha rreth racionalitetit dhe teknologjisë.

Demirhan: Kur flasim për racionalitetin, shtrohet pyetja sesa ky koncept u përshtatet ShBA?

Davutogllu: Unë nuk them se Amerika është racionale. Kjo mund të nënkuptohet nga fakti se teknika është prodhuar në Amerikë. Por Fukujama racionalitetin e ka përpunuar brenda teknikës, kështu që mekanizmi i dalë prej saj e ka prurë fundin e historisë. Për këtë arsye Islamin e sheh si rrezik dhe si fe, në thelbin e së cilës nuk ka arsyeshmëri. Kurse dihet se një vend që e zhvillon racionalitetin dhe që e formon sistemin e vet, pa marrë parasysh e shohim këtë si pozitive ose negative, mund të shkatërrohet nga një forcë që shfrytëzon të njëjtën teknologji. Është i njëjtë racionaliteti që i ka ndërtuar Kullat Binjake dhe racionaliteti që i ka shkatërruar ato. Edhe rrënuesit e kullave i kanë shfrytëzuar të njëjtat gjëra. Sulmin e kanë bërë duke pasur njohuri për atë se ç'mund të ndodhte, nëse avioni u binte atyre me shpejtësinë e caktuar. Atëherë arsyet mund t'i shtrohet kjo pyetje: A mundet që mekanizmat ta kontrollojnë vetveten? Një problem tjetër filozofik është ky: A mund të jetojë mekanizmi që s'ka kontroll etik? Kultura antike ka qenë e ndryshme prej kësaj; asnjëherë s'ka besuar se mund të jetojë mekanizmi pa parimet morale. Libri i el-Hazinit *Kitabu mizani'l-hakk* më pushtoi rrëmujshtëm me leximin e parë. Më herët kisha parë se përmendej në kontekst të historisë së shkencës. Duke

e studiuar filozofinë politike të Islamit, u mahnita kur e pashë traktatin në fjalë që fliste për peshoren.

Demirhan: Për peshoren e drejtësisë...

Davutogllu: Jo, në veprën në fjalë është vizatuar peshorja e mirënjohur e shitësit të pemëve e të perimeve; flitet për mënyrën sesi ndreqet, si përdoret ajo. Në pjesën e hyrjes ka një paragraf të njëjtë me atë të *Mukaddime-s* së Ibën Haldunit. Në të flitet për emrat e bukur të Zotit. Në mes tjerash flitet edhe për drejtësinë hyjnore dhe atë e ndërlidh me rendin kozmik. El-Hazini thotë se rregulli kozmik mund të qëndrojë vetëm në saje të drejtësisë. Në këtë mënyrë ndërtohet një filozofi e drejtësisë. I kërkohet përgjigjja pyetjes "Pse është e nevojshme drejtësia?" Pas trajtimit të të gjitha këtyre pikave, el-Hazini e shpjegon peshoren. Ai që e lexon këtë traktat, nëse nuk i di propozicionet e kësaj tematike, mund të arrijë te përfundimi se kjo peshore si mekanizëm s'kryen kurrfarë pune, sepse s'mund ta kontrollojë as vetveten. Ajo që e mban këtë peshore është koncepti i drejtësisë së dorës. Nëse çështjes i qasemi nga prizmi i Amerikës, do të vërejmë se amerikanët gjithmonë kanë besuar se mund të ndërtojnë një mekanizëm të fortë dhe të përsosur, që mund të funksionojë vetevetiu dhe që mund t'u hapë atyre hapësirë të lirisë. Kësisoj e kanë harruar problemin me vetveten; vetja (*self*) s'ishte më problem. Gjithmonë janë përpjekur që t'i përsosin mjetet, të cilat do t'i përdorë personi. Në vend të një personi që do të thellohet drejt vetvetes, ndërtoan një person që e rrit ndikimin e vet drejt së jashtmes dhe kur del në skenë ky person, filozofia përfundon. Filozofia, misticizmi

dhe mendimi janë rezultat i kërkimit përbrenda. Kur personi i sheh mekanizmat e përsosur të formuar jashtë, fillon të mendojë se edhe vetë është përkryer.

Demirhan: Kur flasim për drejtësinë, le të përkujtojmë se aksionin e ndërmarrë pas 11 shtatorit e pagëzuan "Infinite Justice" (drejtësia e pafundme), dhe menjëherë hoqën dorë prej kësaj sintagme, duke e ndryshuar atë me formën "Enduring Freedom" (liria e vazhdueshme). Si mund të shpjegohet kjo nga këndi i debatit tonë?

Davutogllu: Ky me të vërtetë është një tregues interesant. Drejtësia është gjë që arrihet vazhdimisht. Nëse flisni për drejtësinë e pafundme, drejtësia vazhdimisht do t'u hetojë. Në këtë mënyrë: Çdo herë që e përdorni këtë shprehje, i shtyni njerëzit të mendojnë sesa është i drejtë bombardimi që bën Amerika. Në të vërtetë, njerëzit me të drejtë kanë shumë dyshime lidhur me sulmet amerikane. Aksioni u ndërmor pa u shtruar argumentet as para aleatëve më të afërt. Ka dyshime se aksioni është ndërmarrë për të treguar forcë e jo për të arritur diçka. Dhe nëse ndërhyrjen e quani drejtësi, atëherë ua hapni rrugën polemikave nëse ajo me të vërtetë është e drejtë. Nga ana tjetër, "Liria e Vazhdueshme" nuk gjeneron gjëra të këntilla. Nuk është gjë që i shtyn të tjerët të të gjykojnë. Jam i mendimit se amerikanët nuk zgjedhin asnjë emër rastësisht. Më duket se më tepër peshon dimensionin simbolik i këtyre emrave. Gjithherë diskutojnë nga këndi i shekullarizimit, por gjithmonë ka një dimension të fshehtë të krishterë. Për shembull, emri i bombave bërthamore të hedhura në dy qytetet japoneze

ishte "Trinity" (trinia). Të njëjtën gjë e vëreni edhe te emrat e zgjedhur në Luftën e Gjirit.

Demirhan: Neve emrat e zgjedhur na duken sikur janë të pavarur...

Davutogllu: Për shembull, si të tillë duken emrat "liria dhe drejtësia". Të gjitha këto flasin për faktin se problemet janë shuar. Si për amerikanin e rëndomtë, ashtu edhe për atë që i takon kategorisë së intelektualit, historia, më tepër se çdo herë, fillon përsëri. Ne kësaj i ramë në të në Bosnjë. Artikullin "The End of the End of the History" e pata shkruar në kohën kur po zhvillohej lufta në Bosnjë, e cila i harxhoi të gjitha ato argumente. Por amerikanët s'ishin të vetëdijshëm për të. Amerikanët tash po vetëdijësohen dhe në saje të këtij vetëdijësimi në "vendin e ëndrrave" do të hapen shtigje të reja filozofike. Kjo është e pashmangshme. Jeta s'mund të rrjedhë sipas tezave të Hantingtonit, të cilat në të vërtetë janë kurth për Amerikën. Një artikull lidhur me tezën hantingtoniane e kam përfunduar kështu: Realizimi i tezës së Hantingtonit do të thotë fundi i Amerikës. Sepse Amerika sot nuk është entitet i përbërë vetëm prej WASP-it. Qytetërimi perëndimor ka një kohë të shkurtër që po e përjeton këtë përvojë. Ai po fillon të zbehet e të lëkundet një-lloj si qytetërimi romak, që në vitin 117 p.e.r. arriti maksimumin e vet në zgjerimin e kufijve, por pas kësaj meqë nuk arriti të ballafaqohej dhe t'i zgjidhte siç duhet problemet e ndryshme, u shkatërrua. Ky qytetërim çështjet e shumësisë kulturore, të përfshishmërisë dhe të përbrendësimit filloi t'i njihet në vitet 1960. Deri në atë kohë, njësoj si Perandoria Romake, e cila

në vitin 117 arriti që t'i zgjeronte shumë kufijtë e vet, përjetoj zhvillim të jashtëzakonshëm. Në vitet 1950 dhe 1960 Parisi e humbi identitetin e të qenit qytet francez. Po ashtu edhe Berlin s'ishte më vetëm gjerman. Londra për herë të parë të huajt i njohu në vitet '60. Deri në atë kohë s'kishte arritur t'i përbrendëson-te as zezakët e lë më botën. Problemi që na del para këtu është veprim përjashtues i atij që s'mund të përbrendësojë. Ndërtimi i rendit botëror nuk është i barabartë vetëm me forcën, pa marrë parasysh përmasat e dominimit tuaj.

Demirhan: Ç'thoni për përpjekjen pas 11 shtatorit për përbrendësim?

Davutogllu: Përkundrazi, reagimet e para kanë qenë përjashtuese. Bushi foli për luftërat e kryqëzatave.

Demirhan: ... Por hoqi dorë prej mendimit të shprehur.

Davutogllu: Edhe vetë amerikanët filluan t'i shohin pasojat e një botëkuptimi të tillë. Nëse bashkësinë e dytë për nga madhësia në shoqërinë tuaj e përbëjnë myslimanët, nëse ¼ e botës janë myslimanë, kurse ¼ tjetër kinezë, teoria e përjashtimit të këtyre faktorëve si kjo e Hantingtonit nuk e përforcon WASP-in, por përkundrazi e ngushton atë, duke e futur në një kënd të Europës. Me rëndësi janë shprehjet e përdorura: barbarët. Sot perëndimorët ndihen si romakët në periudhën e sulmeve gjermane. Sulmet që vijnë si rezultat i pabarazisë ekonomike mes Jugut dhe Veriut, shpërnguljet e njerëzve prej vendeve të kolonizuara drejt qendrave kolonizuese dhe vazhdimësia e tyre. U munduan që këtë ta rregullonin me mjete paqësore,

por s'arritën sukses. Kur tjetrin e etiketoni si barbar, atëherë keni filluar ta përjashtoni vetveten. Në Amerikë ka individë që duke i ndier ndikimet e këtij realiteti, po ndërtojnë teza të rëndësishme. Ka të atillë që të drejtave të njeriut u kanë formuar një kornizë të re. Për shembull, Richard Falk në punimin e vet të botuar këtë vit, të titulluar *Religion and Global Human Government*. Në këtë vepër është zhvilluar një koncept i ri, ai për të drejtat qytetërimore (*civilizational rights*) dhe pohohet se s'mund të mbijetojnë fuqitë që i përjashtojnë fetë dhe qytetërimet e ndryshme.

Demirhan: A thua s'ka ndonjë aspekt të këtyre analizave që mund të kritikohet? Për shembull, në këtë drejtim ma ka tërhequr vëmendjen vepra tjetër e Falkut *Globalizmi shkatërrimtar*. Sikur po harrohet kapitali, sikur po harrohet mënyra e funksionimit të logjikës së kapitalit. Kjo ndikon që të fitohet përshtypja se ai s'ndikon në rrjedhën e çështjeve si e drejta ndërkombëtare. Këtë jam munduar ta theksoj, duke thënë se globalizmi në të vërtetë ka përfunduar në vitin 1945. Në fakt, periudha e Luftës së Ftohtë u kalua duke e hequr kohën mënjane. Në vitet '90 të shekullit të kaluar kjo gjendje mori fund dhe kështu përsëri u paraqitën rreziqet. Tash, pas 11 shtatorit prapë po bëhen përpjekje për pushimin e kohës. Në këto pushime të kohës a nuk ka gjëra që burojnë prej logjikës së kapitalit?

Davutogllu: S'ka dyshim se ekziston një lidhshmëri e pakontestueshme mes kapitalit e filozofisë dhe mes ekonomisë e mendimit. Sikur të mos ishte merkantilizmi, mendimet e Hobsit s'do të shndërroheshin në themel të shtetit. Por do theksuar se Hobsi nuk do

të mund të ngjitej në skenë vetëm në saje të merkantilizmit. Ndërlidhje të tilla mes ekonomisë dhe mendimit vërehen edhe në zhvillimet e mëvonshme. Ndryshimi i kapitalit ndikon edhe në fushën e mendimit. Krizat që lindin si pasojë e kapitalit, e vënë në lëvizje edhe jetën ideore. Sikur kapitali të mos ishte determinues, marksizmi asnjëherë s'do të arrinte fuqinë e vet. Doli Adam Smithi dhe tha gjëra që e vunë në lëvizje kapitalin. Por prej tij lindën idetë e Marksit. Pas Luftës së Ftohtë, me përhapjen e globalizimit, në veçanti të atij ekonomik, kapitali u ndërkombëtarizua. Nëse një gjë mund ta disenjoni në Francë, ta prodhoni në Singapor, në Tajlandë apo në Tajvan, nëse paranë e fituar prej saj nga Japonia e përcillni në ShBA, sistemi të cilin do ta ndërtoni duhet ta ngërthejë në vete logjikën e japonezitetit, të kinezitetit, të francezitetit, të amerikanitetit. Kapitali përparoi duke e përjashtuar tjetrin, por s'mund të mbijetojë duke përjashtuar. Nëse nuk arrin të ndikojë në logjikën japoneze, menjëherë njëra prej hallkave shpëputet. Kjo sjell me vete daljen përsëri në skenë të të gjithë faktorëve. Ashtu si kapitalizmi fitoi në peshë dhe arriti të mbisundonte në histori, kur punëtori nga fshati filloi të punonte në fabrikë. Atë s'mund ta ndalni, do të dominojë. Do të arrijë sukses ose jo, kjo është një gjë tjetër, por kështu shpërtheu revolucionin e vitit 1848. Qytetërimi perëndimor deshi t'i përskajonte dhe t'i nxirrte jashtë historisë qytetërimet tjera. I konsideroi sikur s'ekzistonin fare, si në sferën e arsimit, ashtu edhe në atë të mendimit e të ekonomisë. Parapëlqeu paradigmen sipas së cilës gjithë historia rrjedh dhe formohet në Perëndim. Shikuar edhe

nga këndi i kapitalit, s'mund të arrijë sukses nëse nuk i inkuadron në proces të gjithë njerëzit. Nëse ShBA mbeten vetëm brenda kufijve të vet, s'mund të konkurrojnë me veturat japoneze. Nëse kinezi një herë hyn brenda historisë, s'largohet dot prej saj. Nevoja për kapital i fut brenda historisë të gjithë përbërësit e botës. Kinezi në histori inkuadrohet si kinez. Myslimani sado i degjeneruar të jetë në aspektin ideor ose praktik, prapëseprapë në histori inkuadrohet me identitetin e vet prej myslimani.

Demirhan: U bë gjatë që po e diskutojmë gjendjen aktuale dhe mundohemi ta kuptojmë duke e krahasuar me Romën, me qytetërimin kinez, si dhe me qytetërimet e tjera antike. Por, p.sh. osmanlliu nuk është nisur drejt ndonjë vendi për ta pushtuar atë, nuk është nisur drejt Europës për ta kolonizuar atë, lëvizja e tij nuk ka qenë lëvizje kolonizuese. Më duket se gjendja rreth së cilës po diskutojmë dhe dinamikat e kapitalit s'na ofrojnë sfond për të bërë krahasime.

Globalizmi dhe perceptimi i vlerës

Davutogllu: Për këtë arsye, raportin midis globalizimit dhe modernitetit e vlerësoj kështu: Moderniteti i përngjan periudhës greke, kurse globalizimi periudhës së Aleksandrit të Madh. Prej një strukture organike në një strukturë mekanike; kalim prej masës (në kuptim të sasisë) së vogël drejt asaj të madhes. Moderniteti është dukuri europiane që më pas u përcoll

në Amerikë dhe mori formën e vet, por vazhdoi ta ruante karakterin e vet perëndimor. Ashtu si Aleksandri i përcoll vlerat greke deri në Indi e Afganistan ku ndërtoi shumë qytete, edhe globalizimi ndërton Nju-Jorke të vegjël në Singapor, Hong-Kong dhe i bart në to vlerat e veta. Gjatë kësaj përcjelljeje lind një problem. Individit që ka kuptim kur gjendet në vendin e vet, e humb atë, e humb identitetin e vet dhe ndien nevojën për t'i kthyer vlerat e veta. Fenomeni sociologjik që përjetohet me shpërnguljen e një personi prej fshati në qytet, gjithmonë është përjetuar edhe te qytetërimet e përmasave të mëdha.

Sot është prishur struktura statike e globalizimit dhe e modernitetit. Ngjashëm me faktin e ndryshimit të vlerave në Iran dhe në Indi në saje të atyre greke të përcjella nga Aleksandri i Madh. Shtatoret e Budës filluan të gdhendeshin si ato të Zeusit. Ja, sot po përjetohet një ndryshim kësaj natyre. Ndaj ndryshimit të asaj kohe ka pasur tre reagime: Reagimi i parë ishte ai stoik me qëndrimin: "Nëse përmasa është shtuar, atëherë duhet që ta kuptimësojmë atë". Kalimi prej politeizmit grek në monoteizëm dhe në monosistem. Sistemi fisnor s'vlen për bashkësinë e përmasave të mëdha. Duhet të bëhet një hapje e re ose do të vijë në shprehje despotizmi. Edhe Amerikën e pret e njëjta gjë: Ose do të bëjë një hapje të re, ose do të despotizohet, alternativë tjetër s'ka. Ky reagim stoik u gjallërua në Kohën e Aleksandrit dhe i dha jetë Romës. Kjo është përpjekje për të formuar kozmos të ri. Diskurset rreth Rendit të Ri Botëror të shfaqura pas Luftës së Ftohtë janë reagime stoike. Ekziston vetëm një dallim:

Ndonëse janë shekullare, s'e arrijnë dot thellësinë e reagimit stoik. Rendi shekullar s'mund të jetë rend i ri.

Demirhan: Domethënë s'ekziston kozmosi, por kaosi.

Davutogllu: S'mund të jetë stoik reagimi që mendon në varësi të mekanizmave njerëzorë. Flet për "rend të ri botëror", por gjësë së quajtur "botë" s'i jep një domethënie të re. Dhe, përveç kësaj kërkon prej gjithë botës që ta pranojë këtë rend mekanik që nuk ka kurrfarë përkapjeje botërore. Edhe përkundër kësaj, ky reagim stoik mund të hapë shtigje pozitive. Reagimi i dytë është ai cinik, që nisët nga parimi në vijim: "Përmasa u rrit, por e njëjta gjë mua s'më solli kurrfarë kuptimi; unë s'dua që kjo përmasë të rritet; unë do të gjej diçka të kuptimtë në botën time, në të vërtetën time". Si reagimi i Aleksandrit ndaj Diogjenit: "Mos më zër diellin, të mirë tjetër s'kërkoj prej teje!" "Rritja e përmasës për mua s'ka kurrfarë domethënieje, unë, këtu brenda fuçisë sime, në të vërtetën time jam shumë i lumtur!" Reagimi stoik mundohet të ndërtojë një sistem mbi të gjitha teoritë tjera, kurse reagimi cinik i kthehet filozofisë së vet dhe mbyllet në vetvete. Pasmmodernizmi i sotëm përbën një reagim cinik. Në vend të idesë së të vërtetës universale të paraparë prej modernitetit, një ide e së vërtetës lokale, të personit dhe relative. Reagimi cinik gjeneron pluralizëm e jo rend. Reagimi stoik gjeneron sistem despotik, e shkatërron pluralizmin. Reagimi i tretë është ai epikurean, që nisët nga premisa e mëposhtme: "Përmasa pa marrë parasysh rritet ose jo, unë e kam jetën e shkurtër; duhet të kënaqem me jetën, unë do të nga-

rend pas saj!" Kjo nënkupton kërkimin e lumturisë rreth qenies fizike. Reagimi epikurean i globalizmit është përhapja e kulturës së konsumit. Domethënë përhapja e koka-kolës, e Mak Donaldit. Nëse njeriu duke ndjenjur në shtëpinë e vet mund t'i kalojë 280 kanale televizive, nëse mund të pijë koka-kola, nëse mund të lundrojë në internet dhe nëse prej gjithë kësaj ndien lumturi, këtu lind një mjedis që e shkatërron kërkimin e njeriut, që e zbret atë në konsumator të rëndomtë. Këto tri reagime edhe sot janë gjallë dhe do ta ruajnë ndikimin e tyre edhe më tutje.

Demirhan: Sot a është e mundur që të vizatohen kufijtë e këtyre tre reagimeve? Risia e sodit sikur s'lejon një ndarje të tillë. A ka mundësi që personi, i cili reagon në mënyrë epikureane, në një aspekt tjetër të jetë stoik?

Davutogllu: Unë këta i pikturoj si tipa idealë. Por si një ide e sistemit, e sistemit botëror.

Demirhan: Por, për shembull, një njeri që ulet në Mak Donald dhe konsumon hamburger...

Davutogllu: S'mund të mendojë. Nëse hamburgerin dhe koka-kolën që konsumon, i konsideron si ushqim dhe pije të rëndomta, s'prish punë. Por njeriu që hamburgerin e trajton si një gjë që duhet të përjetohet në mjedisin e Mak Donaldit, kurse koka-kolën si "shija e vërtetë e jetës", s'mund të mendojë. E njëjta gjë është edhe me personin që mendon se jetën të kuptimtë e bën "bërthama e qepës". Shpirti i individit që shkuarjen dhe ngrënien në Mak Donaldi e konsideron si *pivot*, si shtyllë kryesore të jetës njësoj si namazi, s'mund të bëjë filozofi. Kur flasim për globaliz-

min, duhet ta dimë edhe një kuptim të tij: globalizimi i simboleve. Nuk globalizohet një ide ose një poezi. Ky është një reagim epikurean, por të gjitha reagimet nuk janë të tilla. Kur flas për reagimin stoik, e nënkuptoj të qenit e *Mesnevisë* së Rumiut bestseller në Amerikë. I njëjtë është rasti edhe nëse Shekspiri është bestseller në Turqi. Një mik imi perëndimor, historian i feve, që merret me hulumtimin e fraksioneve krishtere, më rrëfeu një ngjarje të bukur. Më tha se domethënien e globalizimit e ka kuptuar me të përjetuar të asaj ngjarjeje. Ka vajtur në Indi për të bërë hulumtime rreth një sekti të ri. "Hyra në tempullin prej ku kishte lindur sekti në fjalë. Duke pritur një hindus, para më doli një person me sy të kaltër, një bjond"-tregon historiani. Ky person i ishte drejtuar hulumtuesit me këto fjalë: "Unë jam pasardhës i gurusë" që ju po e kërkoni. Ai s'është këtu. Ka shkuar në Vjenë për t'u mbajtur ligjërata ithtarëve". Përfytyrojeni, gurua në Vjenë, kurse bjondi në Indi. Ky rast, pa marrë parasysh se çka qëndron pas tij, kapitali ose diçka tjetër, i përngjan gurit të hedhur në pishinë. Njëri ndërton një sistem këtu, tjetri atje dhe bota përsëri do të njihet me mendimin dhe me meditimin. Në këtë drejtim, elementi më dinamik do të shpërthejë prej jogrekeve. Mendimi islam pa marrë parasysh shtypjet politike është në procesin e pasurimit dhe të lëvizjes së madhe. Sepse myslimanët nuk kanë qëndruar statikë si kinezët, ata përgjatë gjithë historisë kanë qenë dinamikë. Turqit, arabët dhe iranianët kanë qenë të lëviz-

* mësues feje, këshilltar shpirtëror

shëm dhe këtë cilësi të tyre e ruajnë edhe sot. Në periudhën e kolonializmit, çdokush e mbronte vendin në të cilin gjendej, Shejh Shamili Kaukazin, Mehdiu Sudanin, kurse myslimanët e Indisë, Indinë, dhe bënin lutje për ata që ishin larg. Si rasti i myslimanëve të Indisë që luteshin për besimtarët e Tripolit. Sot myslimanët janë në lëvizje dhe ky dinamizëm me siguri se do të sjellë pasuri të mendimit. Edhe Perëndimi po përjeton një ndryshim pikërisht si paradigmat e Kuhnit. Kjo paradigmë, në momentin kur përjashtohet, shkakton lindjen e një paradigme tjetër. Kjo është e pashmangshme. Ndodhia e 11 shtatorit i dha porosi një grupi të njerëzve që mendonin se Amerika është mbisunduese, se mund ta kontrollojë botën dhe se mund ta ruajë rendin.

Demirhan: Në rregull, po a u kuptua kjo porosi? A mund të thuhet se u kuptua nëse e marrim parasysh reagimin e ShBA? Amerika ka dy rrugë: ose të kthehet në vetvete, ose të bëjë ndërhyrje jashtë.

Davutogllu: Së pari tregimi i forcës, e pastaj mendimi. Amerika e ka bërë zakon promovimin e forcës. Fuqinë ia tregon më të dobët. Nëse merrni një hap të këtillë për ta treguar forcën ndaj më të dobët, kjo do të thotë se doni ta tregoni grushtin tuaj. Sot, sipas meje Amerika do ta provojë rrugën e dytë. Pikërisht si Neroni, ose rasti i Mark Aureliusit. Do të mundohet të kontrollojë. Çka do të kontrollojë? Për shembull, do të mundohet ta kontrollojë rrjedhën demografike. Do të formojë një kanal të kontrollit demografik mes Perëndimit dhe Lindjes. E dyta, duke i kontrolluar fuqitë e terrorit dhe ato bërthamore që përbëjnë rrezik për

të, do të formojë rrjete të kontrollimit të rajoneve të hapura. Nëpër vende të caktuara do të mundohet të ndërtojë kështjella. Do ta kontrollojë rrjedhën e tregtisë. Por do të vijë dita dhe do të kuptohet një gjë: Do të fillojë të kuptohet se rendi nuk mund të mbrohet me një kontrollim të tillë. Në mënyrë të pashmangshme, ShBA në vend që të ndërtojnë rend, do bëjnë përpjekje për ndërtimin e rendit të pjesëmarrjes.

Demirhan: A mund të ketë edhe alternativa të tjera? Për shembull, në librin e botuar rishtazi *Perandoria* jepet një ndërtim shumë althuserian. Perandoria është gjë e formuar nga ShBA, por e pavarur prej tyre. A mund të parashikohet një ndërtim i tillë?

Davutogllu: Faktorët që për nga kapitali e tejkalojnë shtetin, në veçanti ShBA, natyrisht se me vete sjellin një gjë të tillë: ndërkombëtarizimi, dalja në pah e kompanive shumëkombëshe.

Demirhan: Jo bash në këtë domethënie. Për shembull, kalimi i disa institucioneve ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara në varësi...

Davutogllu: Saktë. Zaten ShBA në skenën historike kanë dalë në saje të organizatave ndërkombëtare. Janë detyruar të mbështetet në organizata të tilla. Por, tash vendin e OKB-së e merr G-8. Ky është një hap i gabuar. OKB-ja është organizatë në të cilën merr pjesë çdokush, çdo shtet, i mirë ose i keq, oligarkik ose jo. Kurse G-8 përfaqëson 8 fuqi. Nuk bazohet në pjesëmarrje, por në ndarjen e kulaçit mes të fortëve. Nëse ShBA anojnë nga një gjë e tillë, kjo do t'i përngjajë qëndresës së Romës ndaj krishterimit. Një zhvillimi i këtillë do t'ia hapë rrugët një dinamike tjetër. Por, si-

doqoftë ShBA do të kalojnë nëpër një ekzaminim. S'mund të jenë të sigurta në vetvete. Kur mundoheni ta ruani status quo-në dhe s'jeni të sigurt në vetveten tuaj, atëherë filloni ta humbni refleksin e mbrojtjes së vetvetes. Ose duke i kontrolluar strukturat statike u jepni atyre ngurtësi kocke, ose dalëngadalë filloni t'i diskutoni bëmat. Amerika momentalisht po jep sinjale të ngurtësimit. Nëse e vazhdon këtë proces të shkishërimit, nëse vazhdon t'i përjashtojë myslimanët dhe Kinën, pika e fundit ku do të arrijë është përjashtimi i Kolin Pauellit.

Demirhan: Por te ShBA po vërehet një prirje e përbrendësimit duke përjashtuar. Pra, kur erdhën për herë të parë, u takuan me vendasit, me lëkurëkuqtë. I përjashtuan ata, por pas eliminimit të shumicës së tyre, i pranuan brenda vetes. Në të njëjtën mënyrë u takuan edhe me sklevërit afrikanë, të cilët së pari i përjashtuan e pastaj i përbrendësuan. Si duket edhe botën e shohin me të njëjtin sy. Përjashtojnë e pastaj pranojnë brenda.

Davutogllu: Duhet pasur parasyh një gjë. Amerikën shikoni si një nga çifligjet e mëdha të shekullit XIX, Kolin Pauelli është një qehaja. Ai momentalisht është qehaja i ShBA. Përbrendësimi i vërtetë njerëzor do të fillojë kur zezaku do të bëhet kryetar i ShBA.

Demirhan: Por ç't'i thuash faktit se madje as katolikët s'kanë arritur të hyjnë në kategorinë e njeriut të bardhë?

Davutogllu: Problemi qëndron pikërisht aty. Edhe forca edhe problemi i ShBA qëndrojnë aty. ShBA, në krahasim me Anglinë dolën në skenën botërore në për-

pjesëtim me nivelin e përbrendësimit. Para dy vitesh, isha i ftuar në një tavolinë të rrumbullakët ku u diskutua imazhi i myslimanëve në Perëndim, si dhe imazhi i Perëndimit të myslimanët, çështja sesi mund ta përmirojnë perceptimin e tjetrit të myslimanët dhe të perëndimorët. Titulli i debatit ishte "Muslim Perception of the West - Western perception of the Muslims". Shkrova një përgjigje dhe thashë se vetë titulli ishte i gabuar. Problemi nuk qëndron në atë sesi myslimanët e perceptojnë Perëndimin e as në atë sesi perëndimorët i perceptojnë myslimanët. Problemi qëndron në atë sesi Perëndimi e percepton Perëndimin. Domethënë, nëse perëndimori nuk bën revizion në perceptimin e vetvetes, s'është me rëndësi sesi i percepton të tjerët. Kjo vlen edhe për myslimanët. Njeriu e percepton tjetrin sipas asaj sesi e percepton vetveten. Sot, vetëperceptimi i Perëndimit është njëkahësh, ende është eurocentrist, ende është kundër universalizimit, kurse pro globalizimit. Globalizimi është një gjë sipërfaqësore. Vetë globi është sipërfaqe. Globalizimi është përhapje sipërfaqësore e një kulture. Kurse gjithësia është më përfshirëse dhe e përgjithshme. Nëse ShBA e realizojnë universalizimin, mund të mbijetojnë, nëse s'e realizojnë do të transformohen nën kanosjen e një thelbi tjetër universal. E njëjta gjë si Roma që u transformua nën ndikimin e krishterimit, i cili ishte më universal.

*Kriza globale, Perëndimi dhe ShBA**

Etjen Mahçupjan: Sonte do ta diskutojmë terrorin. Do të mundohemi t'i hapim për debat gjërat që po ndodhin aktualisht në botë. Mendojmë që një pjesë ta ndajmë për ta kuptuar ngjarjen e 11 shtatorit. Ç'kuptim ka terrori, pra duke dalë jashtë gazetarisë ditore, do ta diskutojmë çështjen sesi ai mund të ndikojë në rrjedhat e ritrajtësuar, në "rendin e ri botëror". Prej këtu do të kalojmë te "përplasja e qytetërimeve", si tension më i madh dhe më i përgjithshëm, do ta diskutojmë çështjen sesi është i kuptimtë tensioni i paramenduar, sa ka mundësi që ne t'i japim kuptim atij.

Por unë dua t'ia filloj me gazetari. Javën e kaluar ishit në Bullgari. Morët pjesë në një tubim, në një simpozium ku u diskutua për pakicat në Europën Lindore. Natyrisht që nuk dihet se ku do ta kapin njeriun ngjarjet e terrorit, dhe ju rastisët atje. Cilat janë përshlytjet tuaja nga Bullgaria? Apo, çfarë shoku u përjetua atje në ato momente? Në atë simpozium patën ardhur myslimanë prej vendeve të ndryshme, akademikë dhe natyrisht pas daljes jashtë grupit të punës ose jashtë simpoziumit, ishin populli bullgar, akademikët. Kjo ngjarje si u perceptua atje?

Davutogllu: Në mënyrë shumë interesante. Në Bullgari qëndruam shumë pak kohë. Ngjarja e 11

* Düşünce Ekseni (Boshti i mendimit), STV, 19 shtator 2001

shtatorit ndodhi duke qenë ne atje, dy ditë pasi kisim arritur dhe në vigjilje të simpoziumit. Para kësaj ngjarjeje, gjërat që po i shihja në Bullgari më habitën. Në Bullgari, e cila dikur ishte pjesë e Bllokut Lindor, po vërehej një ndryshim shumë i përshpejtuar. S'vërehej struktura ushtarake, rrugëve s'pamë ndonjë ushtar ose polic. S'e ndienim fare praninë e forcave të sigurisë. Për shembull, ditën e parë kur hymë në hotel s'ishte ndërmarrë kurfarrë mase sigurie. Pas 11 shtatorit, u ndërmorën masa të rrepta sigurie, në çdo kat të hotelit u vendosën policë civilë. Masat po ndërmerreshin për arsye se në atë hotel ishin të pranishëm përfaqësues të bashkësive të ndryshme të myslimanëve të Europës, myftij, akademikë. Ky ndryshim radikal që ndodhi brenda ditës tregon se ngjarja e 11 shtatorit e ndryshoi pamjen e përgjithshme aty ku po qëndronim ato ditë. Përveç këtij ndikimi të përgjithshëm, mund të përcjell edhe vështrime të mia simbolike që i pasqyrojnë reagimet ndaj 11 shtatorit. Ditën kur ndodhi 11 shtatori në mbrëmje po shëtisnim rrugëve të Sofjes. Atje çdokush shet gazeta, plakuri, i riu. Një grua plakë në qendër të Sofjes po shiste gazeta duke bërë titur me plot emocione. E pyeta mikun që po na udhëhiqte se ç'thoshte plaka. Fjalët e saj ishin këto: "Një ditë e madhe për Ballkanin. Më në fund edhe Amerika hëngri një grusht!" Asnjë njeri me mend në kokë s'reagon në këtë mënyrë ndaj një ngjarjeje, në të cilën kanë humbur jetën shumë njerëz. Amerikanët duhet që të mendojnë thellë rreth shkaqeve të një reagimi kaq të bujshëm. Plaka bullgare ishte deri në fyt me mllef ndaj ShBA. Ky është vëzhgimi ynë i parë.

Mahçupjan: Kjo s'mund të shpjegohet si pasojë e larjes së trurit?

Davutogllu: Është interesante se ky rast e ka prapaskenën e vet psikologjike. Reagimi refleksiv ditën e 11 shtatorit i një njeriu të rëndomtë të në një zone që s'ka peshë gjithaq të madhe, na ofron shumë detaje për ta kuptuar procesin që shpie te ngjarja dhe zhvillimet që janë pasojë e saj. Ditën e tretë të qëndrimit tonë në Bullgari, e luta udhëheqësin dhe përkthyesin tonë që të ma përkthente shkrimin e një një autori nacionalist të vendit, të botuar në njërin prej gazetave më me prestigj bullgare. Titulli i artikullit ishte ky: "Jezui kundër All-llahut!" Në shkrimin në fjalë theksohej se kemi të bëjmë me një përplasje të të krishterëve me myslimanët dhe se shkak kryesor i kësaj përplasjeje është fillimi i myslimanëve - që po shtohen me shpejtësi - që ta pushtojnë botën.

Bullaç: Nga titulli përfundojmë se All-llahu i përfaqëson myslimanët, kurse Jezui të krishterët.

Davutogllu: Po. Sipas mendimitarit bullgar All-llahu i përfaqëson myslimanët, kurse Jezui të krishterët. Sipas tij, myslimanët aq shpejt po shtohen dhe po ndikojnë me një shpejtësi aq të madhe, sa që pas një kohe do ta pushtojnë botën mbarë. Myslimanëve u përshkruan një rol të ngjashëm me atë të barbarëve pushtues. Më thanë se bëhet fjalë për një intelektual me të kaluar socialiste, që sot është shndërruar në nacionalist. Ky reagim s'mund të përgjithësohet dhe të thuhet se e përfaqëson tërë shoqërinë bullgare, por s'ka dyshim se e pasqyron nënvetëdijen që mund të gjenerojë rezultate të rrezikshme, të cilat t'i përkujtojnë ato të politikës së bullgarizimit me forcë nga

vitet '80. Shkrimi i gazetarit në fjalë, për nga pasojat, është trishtues. Ndërsa pas Luftës së Ftohtë të gjitha vendet ballkanike janë trazuar e shkundur, Bullgaria, si pjesë e kësaj hapësirë shumë të ndijshme, përbën vendin e vetëm stabël, vendin që më së paku e ka përjetuar tensionimin etnik, vendin ku s'janë shënuar grindje ndërfitare. Dalja në shesh e një reagimi të tillë në një vend që periudhën e tranzicionit e ka kapërcyer pa konflikte, tregon sesa rezultate të rrezikshme mund të sjellë një reagim i tillë. Është me të vërtetë rrëqethëse mundësia që pas një shenje të këtillë të vogël nacionaliste ose raciste, të lindin reagime që mund ta ndezin zjarrin.

Bullaç: Ngjarja e 11 shtatorit për nga reperkusionet është një eveniment madhor. Unë dua t'ia shtroj ca pyetje profesorit të nderuar. Në shkrimet e mia shpesh futem në dyshime sesi ta përkufizoj këtë ngjarje. Aksion, sulm ose luftë? Përdoren tre ose katër terma. Qarqet zyrtare amerikane thonë se bëhet fjalë për luftë. Media, marrë në përgjithësi, ngjarjen e ndër lidh me terrorin. Pretendohet se terrori buron prej Islamit, prej botës islame, prej Lindjes së Mesme, prej njerëzve me prejardhje arabe, në veçanti prej Osama bin Ladenit. Por metoda, teknika dhe mënyra e realizimit, bart në vete ngjyra dhe vija të ndryshme prej atyre të terrorit që ne e njohim. Pas terrorit, që ne e njohim, qëndron ose ndonjë organizatë, ose një kryetar shteti, ose persona që veprojnë në mënyrë të pavarur. Aktin terrorist mund ta kryejë dikush që merr ndihmë prej një shteti oponent me atë që është në shënjestër, mund ta kryejë ndonjë organizatë kriminele ose mafia. Por mjetet dhe metodat e përdorura në për-

gjithësi janë të njëjta. Shpërthimi ose sulmi me armë. Siç kemi parë edhe në vendin tonë pas 12 shtatorit, mund të bëhet ndonjë sulm i armatosur. Por në rastin e 11 shtatorit 2001 ka diçka të veçantë. Kemi të bëjmë me një sulm mediatik, që ka edhe aspektin e vet vizual, me të cilin njerëzit s'ngopen dot duke e shikuar, që e nxit dhe e ushqen te ata shpirtin agresiv dhe shkatërrues. Është shumë interesante që mediat e shfrytëzojnë në këtë rast, por s'i tregojnë fare njerëzit e vdekur e as Pentagonin. Kurse ne e dimë se bëhet fjalë për një shkatërrim të madh. Avionët në mënyrë estetike iu futën Kullave Binjake dhe njerëzit me qindra herë këtë e shikojnë dhe çdo herë kaplohen prej emocioneve. Le t'i diskutojmë pasojat politike, ekonomike, si dhe ato nga sfera e marrdhënieve ndërkombëtare të kësaj ngjarjeje. A thua aktorët e këtij akti kanë pasur një sfond intelektual, filozofik-ideor? A thua kanë ndonjë kuptim të veçantë simbolet e zgjedhura si Qendra Tregtare Botërore, Pentagoni, Ministria e Punëve të Jashtme dhe - sikur të arrinin sukses - aeroplani në të cilin gjendej kryetari? A thua këta terroristë, sulmues apo aksionkryerës kanë pasë parasysh diçka ideore? Mos vallë deshën që t'u jepnin një porosi simboleve të kapitalizmit dhe të qytetërimit? Kjo është një ndër temat për të cilën jam më kureshtar të di diçka!

Davutogllu: Gjithë kjo kureshtje është për shkak se nuk i dimë aktorët...

Bullaç: A thua është një ngjarje që jep asociime apo e rastësishme?

Davutogllu: Meqenëse nuk dihen aktorët, s'mund t'i përgjigjemi as pyetjes lidhur me nivelin

ideor të tyre e as me përmasat e tyre intelektuale. Por nga shenjat mund të arrijmë në disa përfundime. Janë thënë shumë gjëra spekulative. Se ata që e kanë bërë janë të vegjël, si Osama bin Ladeni...

Bullaç: Nëse Bin Ladeni ka lidhje të drejtpërdrejtë me këtë punë, shtrohet pyetja: a thua ka ai një formacion të këtillë?

Davutogllu: Natyrisht. Kjo është një temë tjetër për t'u diskutuar. Para së gjithash ndoshta duhet të ndalemi në çështjen e përkufizimit, rreth së cilës ekzistojnë dallime të mëdha në mesin e aleatëve perëndimorë. ShBA parapëlqejnë përdorimin e shprehjes luftë, që është me rëndësi për t'i vënë në lëvizje mekanizmat e NATO-s rreth parimit të mbrojtjes së përbashkët. Një grup tjetër, me Francën në krye, i ikin këtij përkufizimi. Ky dallim u duk më qartë në sqarimet e fundit të Zhak Shirakut. Ky dallim, sipas meje, me kalimin e periudhës së ndikimit psikologjik, do të rritet. Franca, zaten ka një traditë diplomatike të vazhdueshme të marrjes së qëndrimeve të ndryshme. Këtë e tregoi edhe para Luftës së Gjirit. Ky dallim edhe më tepër rritet me kristalizimin e dallimeve të interesave strategjikë. Francezët, për ta penguar periudhën e tensionit strategjik nën monopolin e ShBA që do ta përmbledhë tërë botën, në vend të terminologjisë së luftës zgjodhën konceptualizimin e terrorit, që mund të ketë pasoja më të kufizuara.

Shikuar në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare në kuptimin teknik, me të vërtetë ky është një aksion i mbuluar (*covert action*). Por s'është gjithaq e qëlluar që të quhet terror klasik. Sepse terrori nën-

kupton aksionin e një grupi ndaj një qëllimi të caktuar. Kurse në këtë rast kemi të bëjmë me një aksion të sinkronizuar ndaj qendrave ekonomike-politike dhe strategjike të palës tjetër. Nga ana tjetër, një aksioni të përmasave të këtilla është gabim që t'i themi luftë. Sepse në luftë së paku duhet të dihen palët që përplasen. Në rastin e 11 shtatorit kemi të bëjmë me një aksion të sinkronizuar përmes të cilit janë goditur disa pika, që jep përshtypje lufte, një aksion në kuadër të të cilit janë sulmuar pikat kryesore të palës tjetër. Por, nga ana tjetër mungojnë elementet me të cilat cilësohet lufta. Ky rast krijon nevojën për një (për)kufizim të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Deri më sot në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke u shtruar koncepti i rendit botëror, gjithherë është vënë theksi mbi mekanizmat racionalë, gjë kjo që vërehet edhe te teza e Fukujamës. Por rendi për të cilin mendohet se bazohet në mekanizmin racional mund të prishet nga një mekanizëm po ashtu racional. Domethënë, racionaliteti nuk është i mjaftueshëm si tharm i një sistemi. Për ta ndërtuar një rend ose sistem nuk mjafton vetëm mekanizmi racional. Del dikush tjetër dhe duke shfrytëzuar të njëjtin racionalitet dhe në saje të mjeteve teknologjike mund të kryejë një aksion fatal ndaj elementeve themelore të forcës së tij. Ky rast nxjerr në pah nevojën për një kufizim të ri mes etikës e racionalitetit dhe mes vlerës e mekanizmit. Madje edhe lufta e ka etikën e vet. Është e pamundshme të formohet etika e këtyre aksioneve apo të caktohen kufijtë e saj. Porositë e aksioneve të këtilla...

Bullaç: S'mund të futen as brenda kornizave juridike. Vrasin civilë, njerëz të pafajshëm.

Davutogllu: Po. Jemi ballë për ballë me një rast që është e vështirë të përkufizohet. Zaten, pas përkufizimit të tij duhet të realizohet ajo që është kërkesë e këtij përkufizimi. Ky aksion rrënoi shumë gjëra që fshiheshin në mendjet tona. I lëkundim seriozisht tezën, si ajo për fundin e historisë, që thoshin se ca probleme kanë përfunduar. Ndoshta kjo duhet theksuar. Intelektuali, personi që ka kapacitet mendor dhe thellësi intelektuale, vështirë se mund të ndër marrë një aksion të tillë. Por duket që në këtë aksion ka një racionalitet sipërfaqësor. Shikuar nga perspektiva e pikave të zgjedhura si shënjestër duket qartë se s'është zgjedhur ndonjë pikë e thjeshtë e as që është përdorur ndonjë mjet i rëndomtë. Këtë ngjarje s'mund ta shpjegojmë as me faktorët psikologjikë si një aksion të kamikaxeve të thjeshtë ose si vetëvrasje. Bëhet fjalë për një ngjarje të zgjedhur mirë nga një qendër e caktuar, me pikat e zgjedhura me racionalitet dhe konsistencë të caktuar. Është e vështirë që të jepen gjykime të pre-
ra lidhur me atë se kush e ka planifikuar dhe realizuar këtë aksion, si dhe cilat kanë qenë motivet që i kanë shtyrë kryerësit e tij; ndoshta është më lehtë të thuhet se cilat nuk kanë qenë motivet e kryerësve të këtij akti. Kjo s'është punë e tre ose pesë vetave, s'është punë e një organizate të kufizuar. Po ashtu është e vështirë që një aksion të këtillë të sinkronizuar ta kryejnë njerëz që s'kanë haber për funksionimin e sistemit amerikan, e as ndonjë organizatë që pultin e ka shumë larg ShBA. S'ka mundësi të jetë as aksion i pla-

nifikuar dhe i kryer nga një shtet i vetëm, sepse bëhet fjalë për një aksion aq përfshirës, pasojat e të cilit s'mund të kontrollohen; shtetit që do ta kishte kryer do t'i kanoseshin rreziqe të mëdha. Pra, është e vështirë që një shtet i vetëm të qëndrojë pas këtij akti.

Mahçupjan: Duket se s'mund të bëhet fjalë vetëm për një shtet. S'është rationale t'i futet një rreziku kaq të madh.

Davutogllu: Natyrisht. Në kohën kur qëndroja jashtë atdheut, s'kisha mundësi t'i ndiqja interpretimet që po jepeshin në Turqi. Por ndërkohë po i dëgjoja spekulimet që po bëheshin nëpër mediat e ndryshme ndërkombëtare. Thuhej se pas kësaj ngjarjeje mund të qëndronte Kina, Rusia, Afganistani. Është shumë e rrezikshme që një shtet i vetëm ta bartë këtë barrë, pa marrë parasyh sesa i fortë është ai. Sepse nëse kryeni ndonjë aksion që e ndryshon paradigmen në tërësi, është e vështirë t'i parashikoni pasojat e mundshme. Po ashtu po qarkullojnë edhe spekulime, se pas 11 shtatorit mund të qëndrojë Izraeli ose disa forca brenda vetë ShBA. Të gjitha këto janë spekulime.

Për këtë arsye është më mirë të merremi me pasojat sesa me interpretimet spekulative; duke i konstatuar burimet duhet ikur prej zgjidhjeve monocentrike, duhet të merren parasysh shumë faktorë. Por elementi më kryesor që duhet të jetë brenda këtyre raporteve është mbështetja logjistike brenda sistemit. Një grup që s'e njeh shumë mirë sistemin dhe mendësinë amerikane, s'mund të bëjë një gjë të këtillë.

Bullaç: A s'mund të mendojmë kështu: Përkufizimi amerikan i kanosjes ndërlihet me ndërhyrjen nga

jashtë, një sulm me teknologji të nivelit të lartë ndaj qendrave strategjike të ShBA, si: ndaj Pentagonit, institucioneve ushtarake dhe ekonomike. A thua s'është menduar fare rreth rrezikut të terrorit? Aktorët e këtij terrorizmi mund të kenë marrë mbështetjen e një ose më tepër shteteve. Pikërisht kjo më duket si një gjë plotësisht e mundshme. Por, është evidente se asnjë shtet nuk futet në një aventurë të tillë me plot vetëdije. Një interpretim tjetër mund të jetë ky: Sfidë përbindëshe ndaj një përbindëshi. Përgjigje me dhunë ndaj botës së dhunës. Përgjigje joetike në një botë joetike. Në rregull, atëherë le të paramendojmë një grup që mund ta ketë kryer këtë akt. Një grup pas të cilit nuk qëndron asnjë shtet, asnjë organizatë. Një grup njerëzish që janë besatuar, që kanë bërë analiza, që kanë menduar thellë thellë, që e kanë kryer atë që kanë dashur dhe janë vetëvrarë. Kjo a s'mund të jetë një prej mundësive? Sepse pas të gjitha mundësive të tjera ka rreziqe tepër të mëdha.

Fundamentalizmi i krishterë

Davutogllu: Po, ka mundësi. Në fakt, ne s'mund ta ndjekim prej së afërmi shoqërinë amerikane. Vitin e kaluar në sesionin përmbyllës të Kongresit të Sociologjisë së Fesë në Hjuston paraqita një kumtesë. Në përgjithësi kur flitet për fundamentalizmin, menjëherë përmendet bota islame. Kurse sot në botën perëndimore, rreth boshtit të krishterë shfaqen rryma dhe

sekte të reja, të cilat japin turlifare deklarata, për porositë e reja të Jezuit, madje ofrojnë edhe argumente të ndryshme se bota i është afruar fundit të vet. Këto grupe që e njohin shumë mirë sistemin amerikan, veten e shohin si përfaqësuese të fesë kundrejt padrejtësisë dhe veprojnë në bazë të motiveve fetare. Le të përkujtojmë se sulmuesit në Oklahoma patën shfrytëzuar argumente të kësaj natyre. Pas ngjarjes së Oklahomës, m'u dha rasti ta ndiqja në detaje seancën e komisionit hetues pranë Senatit amerikan. Kushtetuta amerikane, qytetarëve të këtij vendi ua jep mundësinë që të reagojnë në mënyrë aktive madje edhe me armë kundër pushtetit tiran. Argumenti themelor i liderëve të këtyre grupeve në mbrojtjen para gjykatës lidhur me aktet që i kanë kryer, ka qenë ky: "Shteti amerikan sa shkon e bëhet më tiran, prej këtij fakti lind e drejta jonë për t'u mbrojtur". Ka mundësi që një bashkësi e këtillë e ngushtë, që e njeh mirë sistemin amerikan, të ketë ngritur krye kundër një padrejtësie të këtillë, duke u nisur nga motive fetare ose shekullare. Edhe kjo mund të jetë e mundshme.

Amerika sot po përjeton një rën ndërr tronditjet më serioze në historinë e vet. Në aksionet e përmendura ka efekte që ndikojnë jo vetëm në strategjinë amerikane, por edhe në mendësinë e këtij vendi. Kontinenti amerikan që nga Lufta Civile e këndej për herë të parë po përjeton një konflikt. Sulmi i Pearl Harbour-it, meqë ndodhi shumë larg kontinentit amerikan, s'ka ndikuar gjithaq te popullata amerikane. Për këtë arsye, në mendësinë klasike amerikane ekziston përshtypja dhe bindja, se kontinenti amerikan është i sigurt. Nje-

riu që shkon në Amerikë së pari njihet me dy gjëra, me sigurinë dhe me ëndrrën; mendon të bëhet pjesë e ëndrrës amerikane.

Bullaç: Kjo shkakton traumë.

Davutogllu: Po, shkakton një traumë që ndikon edhe në strategjinë amerikane, edhe në transformimin e mendësisë amerikane. Në aspektin afatgjatë shfaqet dimensionin kulturor; për të do të flasim më vonë. Por, reagimi i parë është ky: Koncepti i hapësirës së siguri-së i nxjerrë në pah nga Lufta e Ftohtë, do të ndryshojë.

Mahçupjan: Le të ndalemi edhe një çikë te kjo ngjarje, para se të kalojmë andej. Unë këtu ndahem prej Bullaçit dhe them se sikur të bëhej fjalë për një grup të mbyllur në vetvete, do të donte të njihej. Do të pohonte: Ne e kemi bërë, arsyeja ka qenë kjo! Do të donte të linte pas një emër.

Bullaç: Sikur të kishin besim fetar.

Mahçupjan: Ma ha mendja se këtë mund ta kenë kryer pjesëtarë të ndonjë besimi fetar të Lindjes. S'mund ta paramendoj ndonjë grup perëndimor që bën vetëvrasje, duke mos dashur të identifikohet. Ata zakonisht lënë pas vetes ndonjë emër ose gjurmë.

Davutogllu: Kam një mik të afërt që është futur në hulumtime mbi një grup krishterësh nga Uganda, i cili ka bërë vetëvrasje kolektive. Bëhet fjalë për njërin nga autoritetet më të forta në fushën e rrymave fetare të botës. Vajti dhe qëndroi tre-katër muaj në vendin ku jetonte ky grup. Dhe arriti deri te ky përfundim: Në kuadër të krishterimit ka një specifikë, që dallon shumë prej Islamit: Në çdo çast mund të komunikoni me Zotin e me Jezuin dhe kur arrini bindjen se zbule-

sa ka përfunduar, kjo lidhje ju kahëzon drejt disa gjërave. Dhe ju mund të pretendoni se merrni porosi prej Zotit. Kjo te rrymat e ndryshme fetare, në veçanti te ato protestante, shkakton ngjarje që arrijnë deri në skajshmëri. Katolicizmi, në këtë kontekst në saje të Papatit nga Vatikani, qëndron më i kontrolluar. Meqë Vatikani është një organizatë racionale, arrin që gjërat t'i mbajë nën kontroll. Nga gjiri i protestantizmit mund të dalë dikush dhe si në rastin e grupit nga Uganda të thotë "Unë kam kontaktuar me Jezuin", "nëse e ndërmerri këtë aksion, do t'i hapni rrugën Apokalipsit". Siç tregon edhe kjo shprehje, vetë aksioni mund të ketë cilësi fetare, edhe pse nuk kemi të dhëna të mjaftueshme..

Bullaç: Por deri te të dhënat mund të arrijmë.

Mahçupjan: Nëse të gjitha këto emra që po i jep FBI-ja janë të pakuptimta dhe bëhet fjalë për një manipulim, kujtoj se është e dobishme të flitet për ngjarje të tilla.

Davutogllu: Keni të drejtë. Nuk flas vetëm për çastin ose vetëm në bazë të kësaj ngjarjeje. Është e vështirë që përnjëherë të pohosh se këtë ngjarje e ka bërë një grup i këtillë ose i atillë. Nga ana tjetër, është e vërtetë se shoqëria amerikane ka një potencial të këtillë.

Mahçupjan: Ngjarja e Bullgarisë tregon se me 11 shtatorin më tepër janë të lidhur njerëzit prej jashtë ShBA, edhe pse janë shfrytëzuar dhe njerëz që e kanë zotëruar mirë teknologjinë amerikane. Kemi të bëjmë me një të arsyeshëm, që e kundërshton të arsyeshmin nga Amerika. Në këtë rast, arsyeshmëria që s'ka arritur të bëhet shtet, sillet arsyeshëm sa shteti.

Davutogllu: Pa kurrfarë dyshimi.

Mahçupjan: Në këtë rast gjithçka është në tre dimensione. Kryerësit e ngjarjes së 11 shtatorit atë që bënë mund ta bënin në çfarëdo dite, dhe e kanë zgjedhur pikërisht këtë datë në bazë të analizave të bëra deri në detaje. Në këtë rast nuk flas për datën njëmbëdhjetë të muajit të nëntë. Por shumë njerëz dhanë mendime të kësaj natyre: "Kjo ngjarje që ndodhi në kohën e Bushit, s'mund të ndodhte në kohën e Klintonit!" Me këtë donin të thonin se Bushi është kryetar më i dobët sesa pararendësi i tij. Por duke u nisur nga gruaja bullgare, le të vijmë në tokat e tjera. Kryerësit ndoshta e kanë menduar si një rast, të cilin do ta kish miratuar bota më me lehtësi. Ndoshta kanë paramenduar se bota "vlon" prej njerëzve që lidhur me terrorin do të kishin thënë: "Në fakt s'ndodhi diçka e keqe". Mendoj se ngjarja ka një prapaskenë të tillë. Të kuptuarit e kësaj ngjarjeje na shpie te prapaskena. ShBA në mënyrë shumë sipërfaqësore thonë se këtë e ka bërë Afganistani, Bin Ladeni, por ndoshta edhe në kokën e përfaqësuesve të këtij shteti ekzistojnë pyetje të tilla. Ata e paraqesin mendimin e tyre në mënyrë sipërfaqësore. Por, në shumë vende të botës njerëzit nuk kanë ndier shumë dhembje. Së paku këtë mund ta themi. Për fat të keq, ky është realiteti.

Davutogllu: Si analizë psikologjike kjo që po thoni është e saktë.

Mahçupjan: Në tërë botën u organizuan homazhe në shenjë nderi për viktimat. Në Turqi, Ministria e Punëve të Jashtme edhe përkundër nënshkrimit e pohimit se "ne e bëjmë", nuk dha leje. Mendoj se ky

insitucion ka vepruar drejt. Sikur të jepej leja, disa njerëz mund të silleshin në mënyrë jokorrekte dhe si pasojë e kësaj mund ndodhte diçka e padëshirueshme. Këtë e vërejmë nëpër protestat gjatë ndeshjeve sportive. Para na del një gjendje, e cila duhet shpjeguar. Si është e mundur që në tërë botën të krijohet një atmosferë antiamerikane? Prej ku ushqehet gjithë kjo urrejtje? Burimi i saj s'mund të jetë Bin Ladeni, pas disa ditësh mund të jetë dikush tjetër.

Davutogllu: Në fakt, në tërë botën po edhe brenda vetë Amerikës po ngrihen zëra të intelektualëve pjesëtarë të feve, kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme që ndiejnë përgjegjësi. Shumë emra të shquar, si Richard Falk, po hapin debate rreth kësaj teme. Me to duhet që dikush të merret në mënyrë serioze. Terroristët mund të gjenden, por nëse ata kanë një sfond të caktuar, prapë mund të dalin në skenë. Mendoj se çështjen mund ta ndërlihim me këtë që vijon: Lufta e Ftohtë përfundoi e bashkë me të edhe parametrat e saj. Pas përfundimit të prapaskenës filozofike dhe ideore të saj, pas Luftës së Ftohtë janë shtruar dy teza: Teza për *fundin e historisë* e Fukujamës dhe ajo e *përplasjes së qytetërimeve*, autor i së cilës është Samuel Hantingtoni. Të dyja këto janë drejtpërsëdrejti të lidhura me strategjinë amerikane. Teza për fundin e historisë njerëzimit donte të tregonte se qytetërimi përrëndimor ka arritur kulmin e zhvillimit dhe se është arritur fundi i historisë, që ka përparuar në mënyrë lineare. Postulati i fshehtë i këtij përfundimii është se njerëzimi e ka arritur rendin politik më të përkryer racional. Prej tij pason ky përfundim: Themeluesit dhe

mbrojtësit e këtij sistemi politik racional janë të mirë, kurse kundërshtarët e tij janë të këqij. Bushi këtë e shprehu në formën: të mirët dhe të këqijtë. Fukujama pohon se ata që e kanë prurë fundin e historisë duke ndërtuar rendin racional, e kanë arritur të mirën absolute, kurse kundërshtarët: budistët, myslimanët, kinezët, arabët, antiglobalistët etj., me një fjalë reagimet e të gjithë atyre që rezistojnë ndaj këtij rendi, janë reagime irracionale të cilat do të shtypen dhe do të shkrihen në kuadër të historisë. Sipas meje, elementët themelorë të kërkimit dhe të ecjes së njeriut në kuadër të historisë janë siguria dhe liria. Njeriu e pasqyron vullnetin e vet, që e dallon atë nga të gjitha qeniet tjera, në skenën historike me lirinë dhe sigurinë. Pra, përderisa njeriu të mos e ndiejë veten absolutisht të lirë dhe të sigurt, s'mund të vijë fundi i historisë. Çdo çështje e lirisë dhe e sigurisë sjell me vete dimensione të reja historike. Përfundimi i Luftës së Ftohtë, formimi i organizatave racionale si OKB-ja, G-8, Organizata Botërore e Trgtisë, s'mund t'i eliminojnë reagimet irracionale e as që kanë kuptimin se të njëjtat gjëra çdo herë do të mund ta realizojnë racionalitetin absolut.

Mahçupjan: Nëse Fukujamën e shikojmë nga një kënd tradicionalist, ai na del si irracional.

Davutogllu: Po. Irracional. Në kumtesën time të vitit 1991 jam përpjekur të tregoj se problemet e sigurisë dhe të lirisë në krahasim me periudhat e mëparshme të historisë po shënojnë prirje shtimi. Ky aksion e përforcon këtë qëndrim timin. Sot shumë më tepër se më parë problemi i sigurisë dhe ai i lirisë po e preokupojnë përditshmërinë e njeriut. Kjo vlen si në as-

pektin individual, ashtu edhe në atë masiv e shoqëror. Çdo zhvillim që mendohet se e lehtëson jetën e njeriut, shkakton pasoja të pakontrollueshme. Me zhvillimin e teknologjisë kompjuterike u formua një individ, që në çdo çast mund të kontrollohet, që ndien se në çdo çast është nën mbikëqyrje, një individ i të-huajësuar ndaj vetvetes. Sot Amerika dhe shtetet perëndimore në përgjithësi po përjetojnë një ndryshim dinamik: Nisen prej cilësisë së siglës WASP (White-Anglosaxon-Protestant), por gjërat vazhdimisht ndryshojnë dhe thuajse në çdo qytet formohet nga një Qytezë Kineze, në çdo qytezë nga një qendër islamike, nga një tempull budist, po formohet një strukturë e përbërë prej grupeve që u përkasin qytetërimeve të ndryshme, një strukturë e ndarë por dinamike.

Në këtë aspekt historia e qytetërimit na mëson se qytetërimet fillojnë t'i përjetojnë krizat pikërisht në periudhat kur sundimin e vet politik e shtrijnë në një fushë më të gjerë. Nëse arrijnë që ta kapërcejnë krizën e përbrendësimit të bashkësive të ndryshme, të cilat i marrin nën ombrellën e sundimit të vet, mund ta zgjasin edhe jetën e vet. Perandoria Romake që nga gjysma e dytë e shekullit I para erës sonë, kur i zgjeroi më së tepërmi kufijtë e vet, hyri në procesin e krizës dhe të llogarisë. Atëherë filloi të shfaqej kriza. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shtetin osman. Shtetet e mëdha, nëse nuk arrijnë të përshtaten me një koncept dhe fushë të re të sigurisë e të lirisë, shoqëritë e udhëhequra prej tyre fillojnë të përjetojnë krizë të përbrendësimit dhe të legjitimitetit.

Qytetërimi Perëndimor, që ka hyrë në periudhën më të gjerë dhe më përfshirëse të dominimit politik, gjendet përballë sfidave serioze. Zhvillimet e fundit e nxjerrin në pah përmasën dhe thellësinë e kësaj sfide. Problemi i kërkimit prej njeriut të sigurisë dhe lirisë s'mund të zgjidhet me racionalitet absolut dhe prapë aktualizohet në saje të një shndërrimi të përshpejtuar. Sot s'mund të çojë në zgjidhje asnjë koncept i rendit ndërkombëtar, që s'ka prapaskenë filozofike. Kështu, mund të thuhet se ka nevojë për një ripërtritje shumë më serioze.

Mahçupjan: Kjo është një periudhë në të cilën vetë ndryshimi paraqet vlerë të rëndësishme. Periudhë e dallimit të vetvetes dhe e shprehjes së dallimit. Periudhë në të cilën nëse nuk dëgjoheni kur flisni, kjo do të thotë se ka mundësi të ngushtoheni. Gjëja që ju vë në pozitë të ngushtimit mund që të mos shkaktojë konflikte dhe ngjarje të mëdha, por mund të shkaktojë një sërë përplasjesh të vogla.

Davutogllu: Moderniteti e ka dobësuar aftësinë e legjitimitetit të njerëzve. Në sistemin e kastave të hindusëve, njerëzit që janë rritur me vetëdijen e pabarazisë dhe të robërisë në kastën që janë, mund që të mos rezistojnë ndaj një gjendjeje të tillë. Por, një hindus që ka formuar idenë se është i barabartë me të gjithë njerëzit, meqë pabarazinë dhe cungimin e lirisë i sheh si jolegjitime, e fiton shprehinë e reagimit.

Mahçupjan: Ka një bindje se mosreagimi përbën dobësi.

Davutogllu: Gjithsesi. Jetojmë në periudhën e tensionit Veri-Jug. Në njërin anë po jetohet në zdër-

hallje e luks, e në tjetrën, në kontinentin e Afrikës, po bëhet luftë me varfërinë e skajshme dhe kjo shumë njerëz – pavarësisht prej përkatësisë kombëtare – mund t'i çojë të shpërthejnë në reagime. Nëse ngjarjen e mendojmë tej dimensioneve të terrorit, nëse do të kërkonim rend e paqe në plotkuptimin e fjalës, njerëzit, pa marrë parasysh kulturat e tyre duhet të zhvillojnë një paradigmë të përbashkët, që do të ishte zgjidhje për dy kërkesat kryesore: sigurinë dhe lirinë.

Orientime të reja strategjike

Bullaç: Dua të kthehem në krye të temës. Sistemi botëror edhe përkundër retorikës demokratike, përkundër strukturës liberaliste dhe të bazuar në të drejtat civile, në fakt përbën një strukturë autoritare, hierarkike dhe të padrejtë. Ky sistem ushqen një botë të ngarkuar me dhunë. Kjo më së miri vërehet në protestat antiglobaliste. Duhet shikuar edhe udhëtarët e tjerë në aeroplan, jo vetëm ata me gjenezë nga Lindja e Mesme, arabe ose myslimane. I gjithë interesimi është përqendruar tek ata. Dhe sot, në Kajro, babai i egjiptasit 26-vjeçar Muhammed Atta thotë: “Tetë orë pas rënies së kullave djali im bisedoi dy herë me mua. Biri im s’ka qenë në aeroplan, pra s’ka mundësi që djali im të ketë marrë pjesë në këtë aksion të përgjakshëm. Kjo duhet të vërtetohet edhe nga regjistrimet!” Sipas meje, duhen hulumtuar edhe bindjet fetare e filozofike të të gjithë udhëtarëve në avion. A kanë qenë

të gjithë udhëtarët besimtarë, përkatës të cilave besime kanë qenë, ç'mendime kanë pasur, si kanë jetuar. Këto pyetje mund të na shpjen deri te të dhëna dhe përfundime të rëndësishme. Natyrisht, FB-ja dhe CIA nuk merren me gjëra të tilla, por me një gjë të tillë duhet të merren shkencëtarët.

Mahçupjan: Një gjë të tillë janë duke e bërë njerëzit e dijes.

Bullaç: Kryerësit e këtij akti, pa marrë parasysh kush janë ata, mund të shkaktojnë pasoja që bien ndesh me qëllimet e tyre. Por një gjë që nënkuptohet është se kjo punë e ka edhe fazën e dytë, për të cilën po diskutohet më së shumti. Amerika e ka vënë në shënjestër Afganistanin. Sipas të gjitha gjasave – inshallah në një gjë të tillë s'ndodh - do të ndërhyjë në Afganistan. S'kemi njohuri për përmasat e kësaj ndërhyrjeje. Flitet se do të pasojë një pastrim si fshesa që pastron qilimin. Kjo do të thotë se gjeografia afgane do të bombardohet pikë për pikë, ndoshta do të shfrytëzohen armë të reja. Kam dy pyetje, të cilat do t'i shtroj përnjëherë. A thua problemi qëndron vetëm në kapjen e Osama bin Ladenit, apo në ndryshimin e regjimit taleban ose në ndërtimin e një gjeostrategjie të re mbi boshtin e Afganistanit? ShBA u vendosën në Ballkan si rezultat i luftës në Bosnjë dhe në Kosovë. Shprehur në mënyrë figurative, "e vunë një rën këmbë" në Ballkan. Nëse e sulmojnë Afganistanin, a ka mundësi që tjetrën këmbë të lëshojnë atje dhe cilat janë pasojat politike, ushtarake dhe ekonomike në skenën ndërkombëtare?

Davutogllu: Në fakt analiza duhet të fillojë prej kësaj pike. Sepse marrë në përgjithësi, mendohet se bëhet fjalë për një rast të së drejtës. Sipas meje, njëri prej dallimeve më të rëndësishme qëndron mes kapjes-ndëshkimit të një fajtori dhe një rasti të sferës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Në veçanti në pikëpamjen realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare, pa marrë parasysh se kush e ka kryer dhe me çfarë arsyeshe e ka kryer këtë akt, tash po vërehet një koniunkturë e caktuar. Strategjisti realist i marrëdhënieve ndërkombëtare, pa marrë parasysh është ai amerikan, rus ose gjerman, menjëherë pas 11 shtatorit, kur ka gdhirë më 12 shtator, ditën e ka filluar me këtë pyetje: "Para kam një botë të re. Çka mund të përfitoj në aspektin strategjik nga kjo botë dhe nga kjo koniunkturë e re?" Dhe natyrisht, çështja në prizmin e etikës shkon përtej kapjes dhe ndëshkimit të një fajtori. Në të vërtetë nuk bëhet fjalë për një veprim etik por realist dhe çdokush mundohet që t'i gjejë përgjigje pyetjes në vijim: "Cila është pozita ime në këtë koniunkturë të re?" Jam i mendimit se ShBA, përtej ndëshkimit të një fajtori, janë në kërkim e sipër të pozicionit në kuadër të koniunkturës së re. Amerikanët edhe para 11 shtatorit ishin në kërkim e sipër. Le të shprehemi në mënyrën e stërpërdorur: Pas çdo lufte bëhen marrëveshje, përcaktohen kushtet dhe rregullat e reja të lojës. Një gjë e tillë ndodhi edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Pas luftërave të Napoleonit, në Kongresin e Vjenës u bë një marrëveshje e tillë. Por që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë kanë kaluar dhjetë vjet; ekziston një armëpushim faktik, por s'janë bërë marrëveshje që i përcak-

tojnë kushtet dhe rrethanat e reja. Për shembull, krizat në Bosnjë, në Çeçeni, në Karabag dhe Palestinë janë ngrirë, por nuk është gjetur ndonjë zgjidhje përfundimtare. Nuk është realizuar një sendërtim juridik, që do t'i përcaktonte rregullat e lojës sikundër u përcaktuan pas Luftës së Dytë Botërore, kur në Kongresin e Vjenës lindi rendi i Kombeve të Bashkuara. Tani jemi duke përjetuar gjendjen aktuale, kur ShBA nuk duan të ndëshkojnë vetëm fajtorin, por dëshirojnë që t'i përcaktojnë edhe komponentet kryesore të këtij strukturimi. Cilat janë këto komponente? E para, duhet që ta plotësojnë nevojën e ShBA për siguri, gjë që përbën një veçori e cila buron nga gjeografia e Amerikës. Amerika asnjëherë s'është frikësuar nga rreziqet konvencionale. Ky shtet s'mund të sulmohet me mjete konvencionale, pra, duke i ngarkuar tanket në anije dhe duke i zbarkuar ato në tokat amerikane ose në saje të avionëve konvencionalë. Kjo mund të vërehet vetëm në skenarët filmikë. Amerikës nuk i kanoset rrezik konvencional as nga Meksika e as nga Kanadaja. Prej Meksikës mund të rrezikohet vetëm në aspektin demografik. Prej atje mund të vërshojnë njerëz për në ShBA, por kjo nuk përbën kushediçfarë rreziku. Pra perceptimi amerikan i sigurisë bazohet në dy elemente: në rrezikun bërthamor dhe në terror. ShBA mund të rrezikohen me armë bërthamore ose me asosh të distancave të largëta, ku bëjnë pjesë edhe ato biokimike. Rreziku i dytë është terrori. Pika më e përthyeshme e shoqërisë amerikane është se për shkak të perceptimit se jeton në siguri absolute, përnjëherë kalon në krizë, kaplohet nga paniku dhe përjeton kao-

sin. Trupi ynë si shoqëri që u jemi përshtatur krizave, madje dhe nëse rritet doza e krizës, përpiqet që t'i përshtatet asaj. Por, shoqëria amerikane, në veçanti në periudhat kur ekonomia dhe politika e saj nuk janë stabile, përjeton kriza të rënda. E këtillë ishte kriza ekonomike e vitit 1929, që përbënte lëkundjen më serioze pas Luftës Qytetare. Madje as Lufta e Dytë Botërore nuk u ka shkaktuar ShBA ndonjë problem destabilizues. Ky shtet humbi njerëz dhe përjetoi dhembje në rajonet tjera të botës, por sistemi i brendshëm nuk u trondit. Kriza ekonomike e vitit 1929 lindi si pasojë e shkatërrimit të bursës. Nëse terrori, si tash, i lëkund tri-katër shtylla, shoqëria amerikane mund të tregojë reagim psikologjik si ai i filmave. Mu për këtë arsye ShBA në periudhën e re po mundohen që ta marrin nën kontroll të plotë armatimin bërthamor dhe terrorin, duke i vënë ato në kuadër të normave ndërkombëtare dhe juridike.

Bullaç: Këtu na del para mundësia e tretë. Sulmin e 11 shtatorit s'e kanë kryer vetë as talebanët e as Osama bin Ladeni.

Davutogllu: Vetë jo. Nëse e pyesim vetveten se çka mund të ndodhë në të ardhmen, unë vërej tri faza. E para është faza psikologjike. Qëllimi i parë i saj është t'ia plotësojë shoqërisë amerikane dëshirën për hakmarrje e ndëshkim dhe t'ia lehtësojnë pezmin. Qëllimi i dytë është forcimi i pozitës në marrëdhëniet ndërkombëtare duke dhënë porosinë se "unë ende jam i fortë, e gjej dhe e ndëshkoj çdo fajtor!" Kjo mund të gjejë mbështetje edhe në fazën psikologjike. Tash për tash këtë e ka mbështetur çdokush. Është

shumë e vështirë të dihet sesa do të zgjasë kjo fazë. P.sh. nëse fillon operacioni i Afganistanit, mund të zgjasë një ose më tepër muaj...

Mahçupjan: E terrori...

Davutogllu: Do vijmë atje. Sipas meje, ShBA mendojnë diçka tjetër. Kur të fillojë faza e dytë, pra ajo strategjike, koalicioni do të plasë. Si amerikanët që në agun e 12 shtatorit 2001 bënë vlerësim, të njëjtën gjë e bëjnë edhe gjermanët, francezët, kinezët, çdokush i bën hesapet e veta. Mendoj se edhe Turqia pjesërisht i ka bërë llogaritë e veta. Reagimet e deritashme të Turqisë janë relative. Koalicioni do të përçahet në fazën strategjike. Nëse ju kujtohet, kështu ndodhi edhe në Luftën e Gjirit. Koalicioni i formuar në Luftën e Gjirit në fazën psikologjike, u prish më vonë në fazën strategjike, kur Bashkësia Europiane i vazhdoi marrëdhëniet me Irakun dhe nuk iu përgjigj kërkesave të ShBA lidhur me Lindjen e Mesme. I vazhdoi edhe marrëdhëniet me Kinën. Gjatë asaj përçarjeje, në fazën strategjike, ShBA do të mundohen t'i vendosin rregullat e reja të rendit të ri. Kurse të tjerët do të mundohen që t'i gdhendin aspektet që s'u shkojnë për shtati. Këtu duhet theksuar reagimi racional dhe i drejtë i Kinës, e cila thotë se meqë bëhet fjalë për një çështje botërore, atëherë e njëjta duhet të zgjidhet përmes OKB-së, institucioni i vetëm legjitim ndërkombëtar për të. Kina nuk është anëtare e G-8 e as e NATO-s. Instanca e vetme ku Kina mund ta tregojë forcën e vet politike dhe ku mund t'i gdhendë vendimet që bien ndesh me qëndrimet e saj, është Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Nga ana tjetër, Japonia dhe Gjermania i japin përparë-

si platformës së G-8 e jo asaj të Kombeve të Bashkuara. Edhe aty përçarja është e pashmangshme. Faza e tretë ka të bëjë me kulturat dhe qytetërimet jetëgjata. Ajo duhet diskutuar më thellë.

Kur vijmë te kjo fazë, mendoj se është kuptimplotë përgjigjja e pyetjes se pse ShBA kanë zgjedhur Afganistanin. Nëse ndalemi një çikë të mendojmë rreth karakteristikave të Afganistanit, do të përfundojmë se ky vend kufizohet me tri fuqi të mëdha bërthamore joperëndimore. Te shtetet Perëndimore që nga kohët e vjetra ekziston një praktikë e marrëveshjeve si xhentëlmënë, të cilën s'e kanë Pakistani, India dhe Kina. Afganistani është fqinjë i të tria këtyre vendeve, në pozitë gjeografike prej ku mund të ndërhyhet ndaj tyre. Nëse hyjmë në detaje, në atë gjeografi gjenden tre qytetërime (ai islam, hindu dhe kinez) që krahas Perëndimit e kanë ruajtur gjallërinë e vet, që kanë potencial të ndikimit demografik ndaj tij. Afganistani është komshi i të tre këtyre qytetërimeve. Është vend i rëndësishëm si në aspektin demografik, ashtu edhe në atë kulturor. Kjo është specifikë që Afganistanin e bën një vend me peshë. Në aspektin strategjik, mund të thuhet se çdo ngjarje historike ose gjeopolitike përfshirëse e ka hapur çelësi afgan. Alekandri i Madh e kaloi grykën e Hajberit dhe ndali në Kafiristan. Mahmud Gazneliu prej atje zbriti në Indi. Kufijtë e atjeshëm u formuan pas përplasjes indo-anglo-ruse. Grykën e Hajberit e kam parë me sytë e mi. Aty formohet kufiri rus. Këta kufij janë natyrorë. Janë kufijtë e fundit deri ku kanë mundur të arrijnë kinezët. Stacioni i fundit deri ku kanë arritur rusët. Raportet brenda

Azisë dhe Eurazisë s'mund të rregullohen pa çelësin e Afganistanit. Ky vend i ngërthen në vete pikat strategjike, si gryka e Hajberit, gryka e Kozhakut dhe ca të tjera, autostrada e Karakurumit, rruga që bashkon Pakistanin me Kinën e që është shkak i reagimeve të ashpra, Kashmiri, të gjitha grykat që kalojnë nëpër Azinë e Mesme. Dhe në këtë kontekst mund të thuhet se trekëndëshi Afganistan, Kashmir, Taxhikistan i përngjan trekëndëshit djallëzor. Simetria e Ballkanit kalon prej këtu. Ashtu si Ballkani përbën shkallën nëpërmjet së cilës Eurazia zbret në det përmes Europës, ashtu edhe Afganistani Eurazisë i jep mundësinë për të zbritur në det përmes Azisë. Le të përmendim edhe një specifikë të rëndësishme të Afganistanit. I përngjan Irakut, por edhe Bosnjës. Hapësira afgane i mbërthen në vete të gjitha racat dhe grupet etnike të asaj zone. Uzbekët, taxhikët, kirgizët, pashtutë, shiitët, sunitët. Me këtë cilësi të përkujton Irakun, në tokën e të cilit jetojnë të gjitha racat dhe grupet etnike të Lindjes së Mesme. Nga ana tjetër, në Afganistan jetojnë të gjitha grupet e Azisë Jugore dhe të asaj të Mesme. Çdo gur i lëvizur atje mund të shkaktojë lëkundje të ndryshme. Për këtë arsye Afganistani në histori ka luajtur rol kyç. Këtë do ta vërejmë edhe në rast se Amerika ndërmerri një operacion të gjerë kundër këtij vendi. Çdokush, pa qenë fare ekspert ushtarak dhe pa pasur pikëpamje prej strategjisti, do të vërejë se nga njëra anë qëndron një bashkësi që s'ka çka të humbë, dhe nga ana tjetër një ushtri me të gjitha të mirat teknologjike. Pa marrë parasysh teknologjinë që zotëroni, atje s'mund të gjeni fabrikë ose institut të cilin do ta shkatërroni.

Bullaç: Ushtria afgane më tepër i përngjan një forme të formacioneve guerile.

Davutogllu: Struktura fisnore e Afganistanit përbën pengesë të rëndësishme për mosthemelimin e shtetit kombëtar dhe për mostejkalimin e Luftës Civile. Por kjo ndërkohë përbën një avantazh në qëndruesën ndaj forcave të jashtme.

Bullaç: Çfarë qëndrimi mund të ketë Irani?

Davutogllu: Mendoj se është e dobishme të ndalemi edhe pak mbi qëndrimin e ShBA mbi këtë ngjarje. Ç'synohet? Nëse mendojmë në mënyrë racionale, na del para qëndrimi se mbi çështjen e terrorit mund zhvillohet një koncept i luftës së vazhdueshme. Kur harxhohet armiku nga ana tjetër, përfundon edhe operacioni juaj. Nëse e rrëzoni prej pushteti Millosheviqin, përfundon edhe ndërhyrja ndaj Jugosllavisë. Kur u dëbua Sadam Hyseini prej Kuvajti përfundoi edhe operacioni i ndërmarrë kundër tij. Kurse terrori është gjendje, kur ju nuk e njihni palën tjetër. Avantazhi i tij qëndron në atë se ngaqë nuk e njihni armikun, gjithmonë qëndroni të gatshëm për të zhvilluar luftë. Ngaqë në çdo çast jam në luftë dhe i fortë, atëherë edhe rregullat i vendos vetë. Sepse gjendja e luftës është gjendje e jashtëzakonshme në kushte normale. Domethënë se vlerat si demokracia, të drejtat e njeriut, liberalizmi, të cilat Amerika e periudhës së Clintonit dhe Fukujama i nxorën në plan të parë, si në përmasa botërore ashtu edhe në ato amerikane, mund të shtyhen në skaje. Mospërfillja e këtyre vlerave ka këtë kuptim: Mbajtja në vendin që janë e shoqërive dinamike, të cilat kanë filluar që në aspektin demogra-

fik ta kapërcejnë Perëndimin, dhe riformimi i sistemit brenda atyre kushteve. Kur themi luftë e vazhdueshme, gjë kjo që sipas meje përbën njërin prej shkaqeve kryesore të mosrënies së Sadamit, nënkuptojmë edhe mundësinë për ta kontrolluar vazhdimisht Irakun nga veriu e nga jugu dhe përmes Irakut kontrollim i rajonit në tërësi.

Mahçupjan: Por kjo në të njëjtën kohë e ka edhe domethënien e paqes së vazhdueshme. Shikuar nga kjo perspektivë, nga këndi i analizës amerikane, duke pararenduar se Amerika në këtë rast do të sillet në mënyrë irracionale, edhe në veprimet në mënyrë të njëjtë.

Davutogllu: Me të vërtetë terrorin mund ta mbani nën kontroll në mënyrë racionale. Ajo që kam për qëllim unë është kontrollimi i vazhdueshëm i Afganistanit përmes fluturimeve; do të thotë kontrollim i Irakut, i Indisë, i Pakistanit, i Kinës dhe i të gjitha rrugëve kaluese pa ndër nevojë për të hedhur ndonjë bombë.

Mahçupjan: Le të mendojmë kështu: Sikur të mos ishte rasti i fundit i terrorit, ShBA nuk do të bënin atë që po bëjnë, por pas ngjarjes së vitit 2001 për amerikanët do të thotë një rast, të cilin pa hamendje do ta shfrytëzojnë në favor të vet. Do ta shfrytëzojnë për kopshtet e imagjinuara me trandafila pa therra. Sepse sipas Fukujamës, Afganistani i sotëm është vendi që ta nxin fytyrën dhe në botën e tij racionale s'ka vend për një sistem të tillë.

Davutogllu: Po.

Amerika në provim

Mahçupjan: Dhe nga një vend i tillë që s'u përngajnë ShBA mund të lindin rreziqe të ndryshme. Për pasojë, Afganistani është armik i ShBA. Mosngjasimi krijon armikun. Natyrisht se do të dëshirojnë që armikun ta zhdukin, por këtu ka një gjë tjetër. Aksionet që ShBA do t'i ndër marrin për hir të sigurisë së vet nuk do të jenë të lehta. "Perandoria bashkëkohore" duke luftuar vazhdimisht, do të mundohet të krijojë paqë të përhershme, por këtë mund ta bëjë vetëm duke e marrë me vete edhe Europën. Mund që të marrë me vete vende si Turqia, madje edhe Iranin. Sepse kohëve të fundit po vërehet një afrim i dukshëm me Iranin. Këtë mund ta bëjë edhe me Rusinë. Nëse Amerika arrin t'i shpëtojë lëkurës si shtet-kombëtar egoist dhe arrin ta luajë si duhet rolin e vet, me të vërtetë ka gjasa që t'i hedhë do hapa të rëndësishëm për botën në përgjithësi.

Davutogllu: Prej atje mund të dilet në diçka tjetër. Këtu qëndron vlera e përplasjes së qytetërimeve për ShBA. Më duket se ShBA për herë të parë në historinë e vet po kalojnë nëpër testin apo mundësinë e të qenët shtet i madh. Pararendësit arrinin sukses shumë kollaj. Hitleri shkaktoi luftë në Europë dhe në saje të forcës së të tjerëve që hynë në koalicion, pësoi disfatë. Kjo nuk është shumë e vështirë. U përngjan fitoreve të mëdha të Romës në kohët më të mira të Cezarit.

Mahçupjan: Këtu duhet bindur gruaja bullgare që e përmendëm më parë.

Davutogllu: Po. Edhe unë dua që të kaloj pikërisht atje. Qëndrimi jashtë një lufte botërore apo mbyllja e vetvetes sipas doktrinës së Monrosë, që ndryshe quhet politikë e izolimit, s'është diçka e rëndë. Është me rëndësi ta udhëheqësh Romën e periudhës së Aureliusit. Famën e *Pax Romana*-s që kishte filluar të rrënohej, mund ta ruante Cezari në saje të sukseseve ushtarake. Por Mark Aureliusi këtë çështje mund ta zgjidhte vetëm si filozof. Në fakt ShBA kanë nevojë për një qëndrim të ri prej filozofi, sepse qëndrimi prej strategjisti nuk mjafton. Amerika e ditëve të sotme nuk ka nevojë për një Cezar të ri, por për një Mark Aurelius. Por, ç'e do që është vështirë të thuhet nëse ka një person të tillë. Ky ka qenë gabimi më i madh i Fukujamës dhe i Hantingtonit. Ne në kritikën që u bëjmë, e trajtojmë edhe këtë pikë. Hantingtoni në fund të artikullit të vet strategjistëve dhe kompetentëve amerikanë u jep këtë porosi: "Do t'i eliminoni mosmarrëveshjet brenda Perëndimit dhe do ta konsolidoni atë. Për t'i penguar koalicionet e mundshme mes qytetërimi-ve të tjera, do t'i provokoni divergjencat e tyre!"

Mahçupjan: Në fakt, kërkon sjellje sipas parametereve të shtetit kombëtar.

Davutogllu: ShBA mendojnë se mund të përfitojnë nga nxitja e konfliktit mes Islamit dhe Kinës. Kurse e vërteta është se sikur të jetë dikush si Mark Aureliusi, që gjërat do t'i shikonte me sy prej filozofi, do të kishte thënë: Nëse unë e udhëheq një rend botëror, duhet të kem legjitimitet te të gjitha shoqëritë të cilave po u prij. Kjo ndërlihet edhe me aspektin e shtetit kombëtar. Sot në Amerikë jetojnë të gjitha grupet etni-

ke të botës. Në artikullin me të cilin i përgjigjem artikullit të Hantingtonit, e vë theksin mbi këtë pikë: Kjo është një tezë që i shkatërron ShBA, që e dobëson pikën e cila i jep forcë këtij shteti vigan. Strategjistët amerikanë duhet ta kenë parasysh këtë. Aty kah fundi i periudhës së Klintonit i panë rezultatet negative të tezave të këtilla. Vetë Klintoni gjatë vizitave që u bëri Indisë, Kinës dhe Turqisë fliste fjalë miradie dhe jepte lavdërime për qytetërimet e tjera. Sepse nëse e përjashtoni botën islame, që përbën $\frac{1}{4}$ e njerëzimit, s'mund të ndërtoni rend botëror. S'duhet harruar se në artikullin e Hantingtonit mund të gjenden edhe ca aspekte të drejta, që nuk bazohen në të dhëna të vërteta historike dhe që gjatë vlerësimit të koniunkturës ekzistuese trajtohen në mënyrë njëdimensionale. Pasi nëse flisni për përplasjen e qytetërimeve, duhet që të jepni edhe shembuj. Unë në artikullin tim e kam dhënë statistikën e luftërave të mëdha ndërmjet viteve 1492-1992. Shprehja "luftë e madhe" s'është e lezetshme dhe me të nënkuptojmë luftërat, në të cilat kanë humbur jetën së paku 250 mijë veta. Nëse nisemi nga ky kriter, do të shohim se të gjitha luftërat, si ato Tridhjetvjeçare, Luftërat e Trashëgimisë, Luftërat e Napoleonit, Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore janë luftëra në të cilat s'ka ndërhyrë asnjë qytetërim tjetër, që kanë lindur si pasojë e konflikteve të interesave brenda kontinentit të Europës dhe të gjitha janë zhvilluar brenda pellgut qytetërimor të Perëndimit. Për këtë arsye themi se argumentet e shtruara vlejné edhe për kohën tonë, nëse jepen referenca nga historia. E dyta, thuhet se qytetërimi islam përplasët me të dyja qyte-

tërimet. A thua kjo është gjendja reale? Nga lindi ky konflikt? A thua përplasen në të vërtetë ose dikush nis nga gjendja reale? Një e dhënë statistikore që do ta japim këtu, është interesante. Në kohën tonë janë 18 rrugëkalime të mëdha, nëpër të cilat zhvillohet tregtia botërore. Nëntë prej tyre janë më me peshë. Nëse i mbyllni këto, s'ka mundësi të përcillni një mall prej një vendi në tjetrin. Tetë prej këtyre rrugëkalimeve i përkasin gjeografisë islame (Rrugëkalimet e Stambollit, e Çanakkalasë, Kanali i Suezit, Malaka, Hormuzi, e Undës, e Lombokut, e Babu'l-Mendebit dhe Gjibraltari), e një është jashtë saj (Kanali i Panamasë). Është normale që prej një gjeografie të tillë të lindin konflikte të interesave. Natyrisht, në Afganistan shfaqen konflikte të interesave e në Kili jo. Sepse Kili nuk përbën një vijë që Amerikën Latine e ndërlidh me Europën. Nëse Amerika synon të udhëheqë një rend, atëherë asaj s'i mjafton vetëm strategjia, ajo duhet t'i respektojë edhe disa parime të gjithësisë. Brenda atyre parimeve duhet menduar rreth një strukturimi, që e mundëson pjesëmarrjen e të gjithë njerëzve, të gjitha qytetërimeve dhe kulturave. Meqenëse nuk jetojmë në kohën e kolonializmit të para njëqind viteve, rendi ndërkombëtar që e përjashton botën islame, Kinën dhe Indinë, të cilat janë gjysma e botës, s'mund të ketë jetë të gjatë.

Mahçupjan: Me sa kuptoj, strategjistët janë njerëz shumë të dëmshëm.

Davutogllu: Me këto fjalë po më hidhëroni mua. (Hë, hë!)

Mahçupjan: S'keni pse të hidhërohemi. Strategjistët e ndryshëm gjithherë bëjnë analiza duke nisur nga dobia e një subjekti dhe s'kanë haber për sinergjinë që lind nga uniteti i subjekteve, dhe nëse çdo subjekt vazhdimisht sillet kështu, paprerë gjenerohet pikëpamja e mangët nacionaliste, që gjendet brenda konceptit shteti kombëtar.

Davutogllu: Emrat amerikanë të ndërgjegjshëm lëshojnë zëra kumbues. Por ç'e do që Hantingtoni dëgjohej, e zërat e tyre s'dëgjohej gjithaq. Njëri prej këtyre të ndërgjegjshëmëve është Richard Falk, i cili një kohë ka qenë kryetar i Komisionit Gjurmues të Kombëve të Bashkuara për Palestinën. Atij i kanë ardhur kanosje prej çifutëve për shkak të konstatimeve të tij lidhur me gjendjen reale në vendin e përmendur. Falku në artikullin e botuar në revistën *Divan* që titullohet "Universalizmi fals dhe gjeopolitika e përjashtimit: Shembulli i Islamit", ka theksuar pasojat negative që mund t'i shkaktojë përjashtimi gjeopolitik i Islamit. Përkundër vështrimeve aktuale, ai thotë se nëse nuk arrijmë të ndërtojmë një sistem ndërkombëtar, s'është e mundur që në qendër të këtij sistemi ta mbajmë Amerikën. Ngjarja e terrorit edhe më tepër e ka ngritur tensionin në një periudhë kur duhej të anohej nga kjo qasje, prej së cilës mund të dilte në pah një koniunkturë të cilën çdokush mund ta shikonte nga këndi i real-politikës.

Bullaç: Deri tani folëm për aspektin gjeostrategjik të ngjarjeve, tash le të diskutojmë rreth aspektit gjeokulturor. Cilat mund të jenë pasojat e tij, çka mund të gjenerojë? Një gjë që vërehet është fakti se bota po ri-

formësohet. Kjo ngjarje ishte mjet i këtij rindërtimi, por në këtë drejtim bota islame duhet të luajë rol shumë të rëndësishëm. Çfarë roli do të luajë? Ku do të mbahet? Çfarë aktori do të jetë? Kjo është me rëndësi. Siç duket, moderniteti global të cilit po i prin Amerika dhe ndaj të cilit Europa mundohet të mbrohet, shfaq në dy pika mangësitë e veta: 1. Kjo botë e padrejtë s'po ndryshon dot. Në botën islame ekziston një ambient që e ushqen dhunën dhe terrorin, një padrejtësi e madhe në ndarjen e të ardhurave. Brenda 100 milionë arabëve vetëm 16 milionë jetojnë si njerëz. Pjesa tjetër jeton në skamje dhe në varfëri. Në botën islame ka shtypje politike, ka diktaturë dhe bota myslimane si në aspektin kulturor ashtu edhe në atë social vazhdimisht po përjashtohet. Për fat të keq, pabarazia s'po eliminohet. 2. Jo vetëm që s'vjen deri te zhdukja e padrejtësive, por ndaj njerëzve ushtrohet dhunë. Kur subjekti "tjetër" futet brenda sistemit, sugjerohet që ta mohojë identitetin e vet. Dobësia më e madhe e këtij qytetërimi dhe e këtij modeli global qëndron në mosfrimin e një projekti të mirëfilltë si mënyrë jetese. Tek ne nuk thuhet asgjë lidhur me atë sesi mund të inkuadrohemi në këtë sistem, duke i ruajtur veçoritë e si të barabartë dhe vazhdimisht po zbatohen standarde të dyfishta. Këtu është me rëndësi të përmendet deklarata e djeshme e ministrit të punëve të jashtme të Britanisë, Kuper, i cili tha: "Ndërhyrjen e shteteve të mëdha ndaj atyre jobashkëkohore duhet që ta pranojmë si një të vërtetë të jetës, duhet që t'i përshtatemi idesë për standarde të dyfishta. Kjo ndërhyrje ndoshta s'e zgjidh problemin, por e qetëson ndërgjegjen dhe

kjo s'është më e keqja!" Fjalët e Kuperit janë shumë të rëndësishme. Vendet që kanë mbetur apo janë shtyrë jashtë sistemit, janë vendet e përjashtuara. Tërë botës i jepet ky sugjerim: "Zhvilloje veten e pastaj eja!" Por ti edhe kur e zhvillon veten, s'mund të bëhesh pjesë e të zhvilluarve. Kështu sot u thuhet njerëzve me prejardhje nga Lindja e Mesme dhe me prejardhje arabe që jetojnë në ShBA, në Kanada ose në Australi. Sot pë shënohen sulme të hapura ndaj zezakëve dhe myslimanëve. Agresiviteti i sulmuesve ushqehet nga një prapaskenë kulturore, nga nacionalizmi dhe racizmi. Kjo buron prej mbamendjes historike të këtyre njerëzve që shpërthen përnjëherë. Dhe kur sulmojnë s'bëjnë kurrfarë dallimi. Nuk pyesin nëse je besimtar, a je i lidhur me fenë, nëse je laik ose jo, a konsumon alkool. Të gjitha këto s'i marrin parasysh. Perëndimorët, shoqëritë të cilat i kanë sunduar një kohë të gjatë i perceptojnë si armiq, si tjetri të cilin e tjetërsojnë. Duhet ndaluar pak edhe në këndin gjeostrategjik të çështjes.

Mahçupjan: Kemi një botë islame që me mijëra vite i ka dhënë kuptim vetvetes, që s'e ka pastruar vetveten, kemi nacionalizmin islam. Fjalën e fundit po ia japim profesor Davutogllut.

Davutogllu: Në këtë pikë duhet dalluar një gjë. Duhet nisur prej dallimit midis modernitetit dhe globalizmit. Moderniteti është dukuri eurocentrike, që përcillej prej Europës në pjesën tjetër të botës. Globalizmi është një gjë që të gjitha shoqëritë i bën të kenë ndikim në kuadër të procesit. Pra, sot nën rrjedhën e historisë përsëri po inkuadrohen kinezët, myslimanët, hindusët, afrikanët, po e tregojnë më tepër qenien e

vet. Kjo do të thotë se është kapërcyer ndarja gjeokulturore bota islame-bota perëndimore. Bota islame nuk përfundon si në kohën e osmanlinjve në Ballkan. Dy milionë e gjysmë turq jetojnë në Gjermani, një numër i madh pakistanezësh në Angli dhe në Amerikë. Tanimë rendi që doni ta ndërtoni s'mund të bazohet në këto vija. Në vend të logjikës "të ndërtojmë një sistem në këto vija", vlen kjo: "në kuadër të sistemit ndërkombëtar të zhvillojmë parime, të cilat çdo shoqëri do ta ushqejnë me siguri dhe liri maksimale". Nëse kjo nuk bëhet, çdo masë e ndërmarrë mund ta rëndojë edhe më tepër zgjidhjen. Ne këtë e dimë nga përvoja jonë. Për shembull, Tanzimati pati si qëllim forcimin e strukturës centraliste, por e njëjta gjë i shtoi më tepër lëvizjet nacionaliste dhe e përshpejtoi shkatërrimin.

Mahçupjan: Vendet nga maja e hierarkisë së një strukture mund të bëjnë thirrje për pjesëmarrje. Kanë kompetenca dhe pozitë për ta bërë një gjë të tillë. Pse shoqëritë nga pjesa më e ulët e shkallares nuk kanë mundësi për t'u inkuadruar? Por nëse duan të jenë pjesëmarrëse, duhet të fillojnë të mendojnë rreth pjesëmarrjes, duhet që ta lodhin kokën një çikë më tepër për gjërat të cilët i kërkon pjesëmarrja.

Davutogllu: Filluam me një vëzhgim nga Bullgaria. Nëse lejoni, të përfundojmë me të. Duke shëtitur në Plevnë, udhëheqësi turistik na rrëfente për rrethimin e këtij qyteti. Atje kishin bërë një panoramë të bukur, që e tregonte tërë fushëbetejën. Natyrisht që udhëheqësi fliste nga pikëpamja bullgare dhe ruse. Unë shtrova një pyetje: "Gjatë këtij rrethimi, Osman Pasha një kohë të gjatë rezistoi, a thua brenda Plevnës

s'ka pasur asnjë bullgar?" "Po - tha - ka pasur shtatë mijë bullgarë!" "E si kanë jetuar ata? A mos vdiqën prej urisë?" "Jo, s'vdiqën!" "Në rregull, a u vranë?" "Jo, nuk u vranë!" "A thua ngritën krye kundër shtetit osman?" "Po, kohë pas kohe zhvillonin luftë çetash". Pyetja sesi jetuan ata, nxjerr në pah çdo gjë. Ja pra, pranimi si palë dhe dhënia të drejtë madje edhe një grupi që bashkëpunonte me armikun ka qenë damari jetësor i osmanllinjve. Tash në këtë provim janë edhe amerikanët. Nëse kryetari i ShBA flet për luftë kryqtare, s'ka asnjë gjasë për të ndërtuar rend legjitim. Sepse me këtë deklaratë të tij në çdo lagje të vendit të vet shkakton përçarje me zezakët, myslimanët, arabët e hispanikët dhe këtyre njerëzve u përkujton diçka tjetër. Në skenën ndërkombëtare s'mund të arrihet sukses me (dis)kurs të këtillë. Ndoshta tash çdo kush duhet ta bëjë këtë llogari. Racionaliteti dhe mekanizmat racionalë mund të shpien deri te sukcesi, por të njëjtat gjëra s'mund të prodhojnë vlera. Vlerat ekzistojnë vetvetiu. Rendi mund të formohet vetëm nëse mekanizmat racionalë përcaktohen nga vlerat. Nëse mekanizmat racionalë i gjenerojnë vlerat e veta, lindin strategjistë të këqij, si Hantingtoni, të cilët të tjerët i shikojnë prej qendrës.

Mahçupjan: Dhe këtu le të përfundojmë!

*Kriza globale dhe bota islame**

Etjen Mahçupjan: Javën e kaluar me Davutogllun, diskutuam rreth gjendjes së re të botës pas sulmit ndaj Qendrës Tregtare Botërore, pozitën që mund ta marrin ShBA në ditët që vijnë dhe rreth rendit të ri botëror në formim e sipër. Profesor Davutogllu ka të botuar në gjuhën angleze veprën *Alternative Paradigms* (Paradigmat alternative). Ne tash do të fokusohemi në paradigmen tjetër: në botën islame. Si duket bota islame pas ngjarjes së 11 shtatorit dhe ç'qëndrim ka ajo lidhur me këtë ndodhi? Në këtë kontekst do ta trajtojmë Islamin dhe terrorin. Ajo që është më e rëndësishme, do ta trajtojmë raportin e Islamit me terrorin. Dhe në mënyrë të pashmangshme do të përfshihet edhe raporti i myslimanëve me Islamin. Mirë se erdhët. Le të fillojmë nga e përgjithshmja. Flitet për rendin e ri botëror, për globalizmin dhe të gjitha këto koncepte rrëfejnë për një dukuri fetare, së cilës po i prin Perëndimi, për një rimanipulim dhe riformësim të botës. Shumë vende, në veçanti ato të botës islame, janë shikues pasivë dhe s'kanë fare ndikim. Por ka një gjë që s'është diskutuar: edhe ato janë pjesë e kësaj bote dhe bota e re s'mund të formohet pa to. Mendoj se është më e drejtë të fillojmë me atë sesi i shpjegon bota islame këto koncepte, ku e vë veten mes globali-

* *Düşünce Ekseni*, STV, 26 shtator 2001

zimit dhe rendit të ri botëror. Mendoj se prej atje më lehtë mund të vijmë te ngjarjet e fundit.

Davutogllu: S' do mend se pikëpamja e botës islame lidhur me globalizimin është një temë mjaft e rëndësishme. Vetë shprehja "bota islame" është mjaft dinamike. Bota të cilën e quajmë islame, në fillim të shekullit XX ka përjetuar ndryshime të mëdha dinamike. Do të flasim edhe për të, por unë dua të theksoj se mund të përballemi me probleme të rënda, nëse globalizimit i qasemi nga këndi i botës islame, Kinës dhe Indisë, të cilat ky proces i ka lënë paksa në gjendje pasive. Ky nuk është problem që ka të bëjë vetëm me Islamin, Kinën ose Indinë. Procesi i universalizimit të vlerave të globalizimit dhe të qytetërimit perëndimor, për nga elementet e qëndrueshme, përbën një proces shembujt e të cilit janë vërejtur gjatë historisë. Nga një aspekt tjetër, si vazhdimësi e modernitetit është dukuri e re. Nëse vështrojmë në shembujt e historisë, do të shohim se qytetërimet tregojnë vijë zhvillimi në gjeografinë ku kanë lindur dhe me veçantinë e vet kulturore në po atë gjeografi, me kalimin e kohës, pas formimit të një identiteti politik, duke u zgjeruar nëpër vende të tjera hyjnë në procesin e ndërveprimit. Qyteti i Romës themelohet në shekullin VI dhe VII para erës sonë, kurse në qytetërim shndërrohet pas disa shekujsh. Roma arrin pjekurinë dhe forcohet pas sigurimit të unitetit latin dhe pas njohjes me qytetërimin grek. Me t'u përhapur në pellget e tjera të qytetërimit, ballafaqohet me procesin e globalizimit.

Mahçupjan: Qytetërimi në ngritje përpiqet të krijojë një standardizim përreth normave të veta.

Davutogllu: Po. Në gjeografinë e vet bën qendërzimin e forcës. Më vonë, me t'u përhapur, nëse arrin t'i ngërthejë në vete pellgjet e tjera qytetërimore dhe kulturore, përjeton një globalizim të kufizuar. Shembulli i parë në histori i këtij procesi përfshirës është ai i Aleksandrit të Madh. Ai në kohën kur shumë pellge qytetërimore ishin të shkëputura njëra prej tjetrës, duke u nisur nga Maqedonia Antike si një gjeografi harmonike, i përmblodhi e i bashkoi thuajse të gjitha qytetërimet që gravitonin deri në Indi, si atë të Palestinës, të Egjiptit, të Mesopotamisë dhe atë grek. Ky veprim i tij në të vërtetë përfaqësonte njëfarë globalizimi. Shikuar nga ky kënd, mund të thuhet se qytetërimi islam është qytetërimi i dytë që pas Aleksandrit të Madh e ka realizuar globalizimin e dytë për nga madhësia. Procesi i globalizimit është përjetuar edhe në kohën e shtetit osman, që ngërthente në vete shumë pellgje kulturore. Një prej prej problemeve themelore të këtij procesi është përkufizimi i hapësirave ekzistenciale të kulturave të tjera dhe mosnxerrja e tyre jashtë historisë. Ky është problemi më serioz i qytetërimit perëndimor të sotëm dhe i globalizimit. Qytetërimi perëndimor u globalizua, por duke u globalizuar filloi që t'i ngushtojë fushat historike të qytetërimeve të tjera. Për shembull, sot kemi një paradigmë të globalizuar të arsimit, e cila përcjell një formë të vetëdijes historike. Të gjithë kemi kaluar nëpër procesin e arsimit. Sot, si në Turqi, ashtu edhe në Kinë, në Indi, në Perëndim, në Amerikë përpunohet i njëjti zinxhir i historisë. Le ta marrim si shembull historinë e mendimit politik. Fillon me Platonin, me Aristotelin,

vazhdon me Romën antike, me krishterimin dhe përmes modernitetit zgjatet deri në shekullin XX. Vijë të njëjtë e ndjekin edhe historia e mendimit ekonomik, ajo e filozofisë etj. Ne aq jemi përshtatur ndaj kësaj koniunkte, sa që nuk i biem në të se ky koncept i përjashton kulturat e tjera. Unë kësaj për herë të parë i kam rënë në fije kur ligjëroja në Lindjen e Largët. Kur këtë format ua ligjëroni studentëve kinezë, hindusë dhe myslimanë, kjo paradigmë e arsimit në mendjet e këtyre të rinjve gdhend këtë bindje: "Ju s'jeni fare në histori!" Dhe ai që s'ka vend në histori, s'ka gjasa që të jetë as sot, s'ka gjasa që t'i orientojë zhvillimet e së ardhmes. Globalizimi nuk ka përhapur vetëm shprehinë e konsumimit, me vete solli edhe standardizimin kulturor. Nëse çështjes i qasemi nga këndi i Kinës, do të vërejmë se për një fëmijë, student ose intelektual kinez, shteti kinez ka rrënjë shumë më të vjetra sesa shteti grek ose Greqia Antike. Por në paradigmen që mësojmë ne, s'ka vend për Kinën e as për ndonjë mendimtar kinez. Dhe për një intelektual që ka kaluar në zinxhir problemi themelor është problemi i ekzistencës në histori. Me pozicionimin e fortë të paradigmes së historisë dhe të mendimit që nga koha e imperializmit, te çdo pellg qytetërimor dhe te çdo shoqëri joperëndimore lindi kjo pyetje: "A thua ne ekzistojmë në histori?" Ju mund të jeni të qetë nëse modernizimin e shihni si një dukuri të mirë dhe si përparim. Por, me kalimin e kohës kur filloni t'i hapni një fushë vetvetes, menjëherë ndieni se keni filluar t'i humbni referencat historike.

Mahçupjan: Madje mund të jetë edhe kjo: Mund të dëshirosh të jesh modern, por të mos kesh mundësi të bëhesh i tillë.

Davutogllu: Gjithsesi. Nëse nuk keni ndikim, mund të përjetoni përçarje brenda vetvetes. Qytetërimi pjesë e të cilit jeni, u jep vetëbesim. Kjo në veçanti vlen për myslimanët, të cilët kur e shikojnë historinë e vet, fitojnë vetëbesim. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Kinën. Por Kina ka mbetur si qytetërim më lokal, që s'ka ngërthyer në vete qytetërimet e tjera në një hapësirë më të madhe nga Lindja në Perëndim, siç është rasti me qytetërimin islam. Më vonë kur është përballur me paradigmen e rrënjosur mirë, përjeton një gjendje të skizofrenisë dhe përçarje të personalitetit. Reagimet e myslimanëve në kohën tonë në formën "edhe ne jemi pjesë e historisë dhe prapë mund të jemi" e hap përsëri për debat paradigmen e globalizimit. Në këtë drejtim duhet shikuar pikëvështrimi i myslimanëve ndaj globalizimit dhe copëzimi që ka shkaktuar kjo dukuri në mendjet e tyre. Ky copëzim sjell me vete krizë intelektuale dhe ekzistenciale. Por, dinamizmi i elementeve përbërëse të qytetërimit islam bie me vete edhe tensionin, përçarjen reaktive dhe produktive.

Bullaç: Pika të cilën po e thekson zotëri Ahmeti është shumë e rëndësishme. Nëse gjatë historisë nuk jeni subjekt, s'mund të keni ndikim as në botën e sotme apo në botën e rindërtuar. Sipas të gjitha gjasave, problemi qëndron pikërisht këtu.

Maçupjan: Ndoshta duhet shprehur në këtë formë: Jo që s'keni qenë në histori, keni qenë gjithsesi, por historia e sodit mohon se keni qenë subjekt i saj.

Bullaç: Kjo është një mënyrë e leximit apo e komentimit të historisë. Në veçanti antropologjia, shkencat e tjera sociale dhe filozofia e historisë shkojnë mbrapa dhe e përfytyrojnë historinë duke i vënë kufijtë e "legjitimitetit të saj". Në vitin 1991 babai i presidentit të sotëm të ShBA, Xhorxh Bush plaku, u shpreh se "po ndërtojmë rendin e ri botëror që do të jetojë njëqind vjet". Dhe që prej asaj kohe bota dalngadalë po merr formë të re. Ndërsa ky proces i riformimit po vazhdon, ndërkohë po shënohet edhe një degëzim i vetë modernitetit. Tanimë kemi modernitetin e njohur, klasik, që bazohet në parametrat dhe në korvizën e iluminizmit, dhe një modernitet global tejmodern. Ky lloj i modernitetit dallon nga ai tradicional. Me modernitetin tradicional nënkuptojmë një koncept të formuar me postulatet e iluminizmit, një sistem ku shkohet prej lart poshtë, një sistem që e nxjerr në plan të parë individin dhe që i eliminon të gjitha mburojat mes individit dhe shtetit - që e mbrojnë individin - siç janë mekanizmat tampon, shoqatat dhe lëvizjet qytetare. Është ky një sistem në të cilin bëhet qërimi i hesapeve me traditën, ku bëhen përpjekje për zhdukjen e tradicionales. Tek turqit këtë e filloi Mahmudi i Dytë. Me të moderniteti del si zgjedhje e pallatit. Por, rendi të cilit po i prijnë ShBA, që e emërtojmë si "moderniteti global" është diçka i ndryshëm. Përkufizimi i individit dhe qëndrimi ndaj feve ka përjetuar ndryshim. Në të vërtetë, pas ngjarjeve të fundit është përjetuar një traumë dhe një dëmtim i vërtetë. Por, ne s'e dimë sesa do të zgjasë kjo. Duke u nisur prej këtu Hantingtoni nxori në skenë *përplasjen e qyte-*

tërimeve. Por këtu pati një problem në përkufizimin e qytetërimit. Kur përmendet fjala qytetërim, nënkuptojmë pasqyrimin e një kulture, besimin, botëkuptimet ose pikëpamjet filozofike, një paradigmë në nivel të institucioneve, në nivelin lëndor, në atë të vendit dhe të jetës së qytetit. Le t'i marrim si shembull institucionet e sotme politike. Sot, institucionet politike të zhvilluara nga Perëndimi po pranohen madje dhe nga regjimet tirane. Në popull, te intelektualët, te borgjezia dhe te tregtarët e qytetit po përjetohet një kaos i demokracisë. Kur flasim për të drejtën, nënkuptojmë një të drejtë rreth së cilës është arritur marrëveshje në nivel botëror që nga Kushti i Parisit e deri te Kriteret e Kopenhagës. Në këtë kontekst nuk ka ndonjë qytetërim të ndryshëm, ndonjë qytetërim që sfidon. Strukturimi administrativ shtetëror përbëhet prej kryetarit, kryeministrit, sistemit presidencial, atij gjysmëpresidencial, ministrit, dhe zbritet deri te drejtoritë e përgjithshme. Edhe produktiviteti ekonomik thuhet në tërë botën është standardizuar. Unë mendoj se në botën islame s'ka ndonjë kundërshtim rreth ndryshimit të teknikave të prodhimit. Folëm edhe për arsimin. Një shembull mjaft i rëndësishëm: Askush s'dëshiron të kthehet në jetën e medreseve klasike osmane ose ato të periudhës së selxhukëve. Përkundrazi, dëshiron të shkojë në universitet por me mbulesë. Dëshiron të studiojë fizikën, astronominë, kiminë, matematikën etj.

Maçupjan: Është e qartë se pak më tepër dëshiron t'i studiojë shkencat pozitive.

Bullaç: Po. Tash dua ta pyes profesor Davutogllun. Domethënë, askush nuk mendon që të bëjë

ndryshim rrënjësor të teknikave të prodhimit ekonomik, askush nuk synon kthimin në kohën e parmen-dës, refuzimin e përdorimit të telefonit celular, televi-zionit ose të udhëtojë përsëri me gomar dhe deve në vend të makinës. Kësi idesh s'ka as në botën islame, as në vendet e tjera. Por, përkundër kësaj, qytetërimi perëndimor (Ky përkufizim është i gabuar sepse në këtë apo në atë mënyrë e gjithë bota është perëndimi-zuar. Në këtë kuptim Perëndim është edhe Japonia, Kina, Turqia, Arabia Saudite etj.), Europa dhe Ameri-ka që janë qendër e tij, e kanë vështirë ta përbrendë-sojnë dhe ta burgosin Islamin, i cili ka sfiduar shumë kultura. Këtu s'kemi kurrfarë ballafaqimi të qytetëri-meve. Mos vallë ka ndonjë përplasje tjetër?

Mahçupjan: Unë, duke u nisur prej termit skizo-freni, mendoj se në Perëndim ka shumë të tilla. Kjo tregon se atje ekziston një gjendje skizofrenike që e kapërcen strukturën e atij që sundon. Kjo ndoshta është pasojë e mosvënies së vetes në pozitën e tjetrit, e shpalljes së vetes fitimtar, është pasojë e letargjisë. Por sipas meje, kjo është një gjë shumë më interesante dhe më e themeltë: Nëse i fokusojmë lëvizjet e mëparshme të globalizimit, do të shohim se kemi të bëjmë me pje-kurinë e globalizuesit dhe përbrendësimin e kultura-ve të tjera. Perëndimi, pas shkatërrimit të Bashkimit Sovjetik, filloi ta pëlqejë vetveten dhe të vetëshpallet për ngadhënjimtar. Kjo në aspektin ideologjik ndodhi pikërisht në pikën e disfatës. Duke u bazuar në fitoren e modernizmit, filloi të jetohet globalizimi. Perëndimi s'arriti ta bënte atë që ishte e domosdoshme për të, s'arriti ta ripërtërinte vetveten.

Bullaç: Tjetër gjë është që një paradigmë të kryesojë, e tjetër është të shndërrohet në fuqi hegjemonike. Për shembull, osmanllinjtë e shpallën “rendin botëror” (*nizam-i alem*) dhe nëse atë e vështrojmë nga këndi i pikëpamjes klasike të historisë, do të shohim se ajo kohë përbën periudhën e dekadencës së shtetit osman. Ky shtet u ngrit, i arriti kufijtë e vet natyrorë dhe më pas filloi të flitet për rendin botëror e për përsosurinë. U shfaqën pohimet se askush s’mund të shkruajë poezi më të mirë se ajo e Bakiut, se s’mund të ketë arkitekt më të mirë se Sinani, se askush s’mund të bëjë muzikë më të mirë se ajo e Itriut. Në fakt, prej këtyre pretendimeve vërejmë se paradigma në fjalë e ka harxhuar energjinë e vet të brendshme, se ka filluar ta konsumojë vetveten. Shprehur me fjalët e zotëri Etjenit, kur arrihet faza e hegjemonisë, kalohet në identitetin skizofrenik. Perëndimi po konkurrohet me performacat e mëdha ekonomike dhe teknologjike të Indisë, të Kinës dhe të Japonisë, por nuk po sfidohet në aspektin kulturor. Joperëndimi s’gjeneron dot një paradigmë alternative. Mos vallë Islami përbën një fushë problematike pikërisht për arsye se përfaqëson një sfidë kulturore ndaj Perëndimit dhe modernitetit?

Kriza e Perëndimit

Mahçupjan: Nëse nisemi nga fjalët e Bullaçit, do të fitojmë këtë përshtypje: Bota perëndimore s’i përngjan osmanllit. Shteti osman ka qenë një perandori

dhe një botëkuptim shumë më patriarkal. Dihet se gjithësia ka rend universal. Të njëjtën gjë e kanë besuar edhe shoqëritë e udhëhequra prej osmanllinjve. Pra, kemi të bëjmë me një konstelacion të këtillë. Sot kemi botën e shteteve kombëtare dhe flitet për thyerjen e saj. Kjo botë u shndërrua duke ia mbajtur anën Perëndimit, u shndërrua në një botë shumë autoritare dhe konfliktuale. Pala që humb në konflikt fillon të humtojë. Por, çdo kthim në vetvete bart edhe qëndrimin, se s'ia kemi dalë të korrin sukses as me shtetin kombëtar. Po e vërejmë qartë përthyerjen dhe për këtë arsye njerëzit si Fukujama kanë mundësi të pohojnë, se kjo apo ajo gjë ka përfunduar. Në fakt, nëse shikojmë prej pozitës së tyre, e kemi vështirë ta perceptojmë tjetrin.

Davutogllu: Gjendja skizofrenike e njeriut perëndimor duhet të konstatohet mirë. Në vitin 1991, në kohën kur po përjetonim Krizën e Gjirit, mora thirrje për pjesëmarrje në kongresin e titulluar "Ardhmëria e sistemit ndërkombëtar" dhe m'u kërkua që të përpiloja një kumtesë me titull "Kriza e botës islame". Kjo më preku thellë. Po, bota islame ishte në krizë, por ajo s'kishte të bënte me një krizë sistemike të përgjithshme. U përgjigja me një letër ku theksova se doja të merrja pjesë në kongresin e përmendur, por me një kumtesë të titulluar "Kriza e botës perëndimore dhe ndikimet e saj në sistemin ndërkombëtar". Sepse kriza e qytetërimit mbisundues ndikon në tërë sistemin. Nëse sistemi mbisundues nuk ka krizë ose nëse punon në rregull, ai duhet të tregojë aftësi që në bazë të kriterëve të veta t'i zgjidhë edhe problemet e qytetëri-

meve të tjera. Kumtesa më vonë u botua në formë libri nën titullin *Civilizational Transformation and the Muslim World*. Problemi themelor i botës perëndimore në këtë fazë të globalizimit është (mos)marrja e të tjerëve në gjirin e vet dhe (mos)formimi bashkë me ta i një sistemi të caktuar. Për këtë arsye Perëndimi po përjeton problemin serioz të legjitimitetit. Mendoj se kjo paradigmë ka pesë elemente përbërëse. Sepse, sot me të vërtetë s'kemi një perëndimor të sigurt në vete si ai i shekullit XIX ose një tip ideal që botës i ofron rend ideal, si ai i veprës së Rudyard Kiplingut *Përgjegjësia e njeriut të bardhë* (*White Man's Burden*). Në veprat e këtij autori ka tablo mjaft interesante. Pyjet e Afrikës po shënonin çrregullime; vjen një njeri i bardhë dhe çdo gjë bie në hulli, bota shtazore, ajo bimore... Perëndimori, për të cilin besohet se bart në vete idenë e rendit, sot nuk e ka më këtë vetëbesim. Të menduarit rreth mungesës së vetëbesimit e ka kuptimin e të menduarit rreth problemeve të globalizimit. Dhe duhet theksuar se gjendja e skizofrenisë është një gjendje që më tepër përjetohet në Perëndim sesa në qytetërimet tjera. Kjo vërehet qartë edhe në veprën klasike të R. D. Laing-ut *Vetja e ndarë* (*The Divided Self*), si dhe në disa hulumtime të tjera dhe mund të sqarohet me problemet me të cilat ballafaqohet ontologjia perëndimore. Këtyre pesë problemeve Islami u ka gjetur zgjidhje dhe kështu mund ta kuptimësojmë çështjen, nëse kjo fe ka përgjigje pozitive për rendin ndërkombëtar dhe globalizimin.

Sipas meje, çdo krizë është pozitive nëse shpie në krijimtari. Në emisionin e shkuar diskutuam rreth kë-

saj. Është mjaft interesant edhe paralelizmi nga teza e Fukujamës. Në një artikull tjetër kam theksuar paralelizmin mes tezës së Fukujamës për fundin e historisë dhe parimit të osmanllinjve për shtetin e përhershëm (*devlet-i ebed müddet*). Te të dyja gjejmë të njëjtën psikologji. Shprehja “Unë kam krijuar një shtet të atillë që do të zgjasë përgjithmonë” ka domethënien “Unë e solla fundin e historisë” dhe kjo ndjenjë ngjallet te qytetërimi që arrin karakter mbisundues. Prej atij çasti kur ngjallet ajo ndjenjë, nëse qytetërimet e tjera janë në lëvizje e sipër, nëse është dinamik, vetëbesimi bëhet edhe më statik. Fukujama konstaton se historia ka përfunduar, sepse është arritur kulmi i racionalitetit. Ky racionalitet është gjeneruar në saje të mekanizma-ve dhe hapësirat e lirisë e të sigurisë janë fiksuar pre-razi. Këto janë të lidhura me vlerat. Por, në të vërtetë, hapësirat e lirisë dhe sigurisë ontologjike të Perëndimit, për shkak të veprimit të këtij qytetërimi duke mos i përfillur qytetërimet tjera, po ballafaqohen me probleme të rënda. Perëndimi, që nga Greqia antike me shprehjen liri nënkupton kohën e lirë. Qëndrimi se robërit njerëzve do t’u mundësojnë të kenë kohë të lirë, në periudhën e modernitetit, me përhapjen e makinave, ia lëshoi vendin pikëpamjes se hapësira e lirisë vazhdimisht do të zgjerohet. Njeriu do t’i shfrytëzojë robotët, makinat, kompjuterët dhe do të jetë më i lirë.

Bullaç: Të njëjtën gjë e thoshte edhe Lenini.

Davutogllu: Gjatë tërë kohës së Revolucionit Sovjetik përdorimi i aparateve të ndryshme është përkujtuar me rituale të caktuara. Është besuar se siguria

dhe liria do të vijnë në saje të treshit arsyeja-shkenca-përparimi. Njeriu, i cili "vazhdimisht po përparonte" në saje të racionalitetit dhe të shkencës, më në fund do ta arrinte lirinë e plotë. A ndodhi kjo në të vërtetë? Zhvillimet e shekullit të fundit flasin se njeriu ka filluar të kontrollohet prej makinave dhe për pasojë ka lindur një sërë problemesh. Për shembull, sot në ShBA pjesa dërrmuese e sëmundjeve psikologjike janë pasojë e varësisë prej televizionit. Këtu, ontologjia shekullariste ballafaqohet me probleme të shumta. Njeriu i modernitetit, në kërkim të një ontologjie fepërjashtuese, më në fund kthehet në trupin e vet dhe shpreson se realitetin dhe lumturinë absolute do ta gjejë aty. Domethënë bashkë me trupin imagjinon përsosurinë. Por, pas një kohe të caktuar, pasi gjëja e imagjinuar nuk realizohet, tensioni mes forcës ideore dhe asaj trupore shkakton përçarje. Narcizmi shekullar luan rol me peshë në lindjen e ideologjive moderne si fashizmi. Idetë që burojnë nga pëlqimi i tepërt i vetvetes, shkaktojnë e lindin dëshirën për të mbisunduar mbi tjetrin dhe madje për ta zhdukur atë, për të kryer gjenocid. Narcizmi dhe vetvetja e ndarë e ngushtojnë hapësirën e lirisë. Një gjë që duhet theksuar lidhur me sigurinë është kjo: Mendohej se me zhvillimin e ekonomisë do të zgjerohej edhe hapësira e sigurisë. Por ngjarja e fundit e terrorit tregon se çështja e sigurisë ka domethënie jetike. Transformimi i kohëve të fundit në teknologjinë luftarake në mënyrën më domethënëse pasqyron problemin e sigurisë së këtyre përmasave. Mund të thuhet se teknologjia ushtarake ka kaluar nëpër tri faza: Faza e luftërave frontale. Në këtë fazë

palët dëmtoheshin vetëm nëse hynin në luftë. Pra, në luftërat frontale, njerëzit jashtë mejdanit luftarak, ata të qytetit, ishin të sigurtë. Mund të pësonin vetëm në rastet e krimeve dhe likuidimeve barbare, të cilat ishin të kufizuara. Në fazën e dytë, kufijtë e shkatërrimeve luftarake u zgjeruan një çikë dhe filluan që t'i kanosen brezit. Forca shkatërrimtare e luftës doli në pah në Luftën Qytetare amerikane, kur u përdorën baona dhe teknologji të ngjashme. Teknologjia e re luftarake filloi që t'u kanosej qyteteve dhe njerëzve që s'janë përzier fare në luftë. Faza e tretë është ajo kur filluan të përdoren armët bërthamore dhe kimike. Shembull tipik përbën Lufta e Dytë Botërore. Jo që u vranë njerëz të papërzier në luftë, por u kanosën edhe brezat që ende s'kishin lindur. Njerëzimi u përball me këtë dilemë: Me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë nuk u zgjerua hapësira e sigurisë, përkundrazi, ajo u ngushtua dhe nëse kjo dyshe nuk merret nën kontroll, nëse nuk mbështillet me vlera, nëse nuk afirmohen vlerat universale, do të vihet në rrezik ardhmëria e brezave të ardhshëm. Nëse njerëzit janë të mendimit se ende s'e kanë zgjidhur problemin e lirisë dhe të sigurisë, kjo do të thotë se historia nuk ka përfunduar dhe se kërkimet e reja do të vazhdojnë. Filozofia gjithherë është e gjallë dhe rilindet. Një gjë tjetër që ndërlihet me problemin e sigurisë dhe lirisë ontologjike është lëkundja e vetëbesimit në spektrin epistemologjik. Domethënë, bindja të cilën moderniteti e ka gjeneruar duke u bazuar në arsye dhe që si e tillë përbën një realitet inter-teorik, tanimë ka filluar të tronditet. Çdo zbulim nga mikrokozmosi dhe makro-

kozmosi zgjidhi nga një problem, por në rend dite solli probleme të reja. Këtu del në shesh dallimi midis së vërtetës dhe reales. Epistemologjia pasmoderne filloi të debatojë rreth dijes akumulative. Këtu për shkak të kohës nuk do të hyjmë në detaje, por qasjet që vijuan pas konceptit të Thomas Kuhnit për paradigmen, filluan ta lëkundin qëndrimin se moderniteti shpie drejt përparimit dhe se ky përparim është absolutisht racional. Tanimë madje edhe në sektorin e filmit e të kinematografisë kanë filluar të pasqyrohen burime të diturisë, si shpallja hyjnore, frymëzimi dhe të ngjashme, që moderniteti i përjashtoi jashtë hapësirës së dijes. Pritej që termat e përmendur (shpallja hyjnore, frymëzimi...) të nxirreshin jashtë historisë dhe të bëheshin të pavlefshme. Por gjërat po zhvilloheshin në drejtimin e kundërt. Në vitet 1870, u tubua Koncili I i Vatikanit me qëllim gjetjen e zgjidhjes së krizave të shkaktuara nën ndikimin e filozofisë së iluminizmit dhe të Kantit. Por në kohën e Koncilit II të Vatikanit të tubuar në gjysmën e dytë të shekullit XX, krishterimi, si pasojë e krizës së modernitetit filloi ta gjente veten dhe të hapej ndaj botës. Koncili I paraqet reagim ndaj krizës së shkaktuar në krishterizëm nga moderniteti. Koncili II i Vatikanit, si larje hesapësh me problemet që i solli moderniteti, përbën rikthimin e krishterimit në skenën e historisë.

Në këtë shekull njeriu ishte i detyruar të ballafaqohej me tri ide të fundizmit (*endism*): në vitet 1920 u shpall fundi i fesë, në vitet 1960 fundi i ideologjive, kurse tani fundi i historisë. Dhe shpallja e fundit të këtyre tri fushave që i japin kuptim jetës së njeriut, e

ka edhe domethënien e fundit të pretendimit për dhënie kuptim. Edhe rendi ndërkombëtar në aspektin filozofik është i detyruar t'i kthehet gamës së referencave. Pas të gjitha këtyre fundeve, u pa se janë formuar kushtet që një grup i vogël i organizuar të shfrytëzojë teknologji në përmasa që i kanosen një mase shumë të madhe njerëzish.

Mahçupjan: Të gjitha këto sollën fundin e normave.

Davutogllu: Problemi i tretë ndërlihet me këtë. Po vjen deri te shkëputja e mekanizmit prej vlerës. Mendohej se nëse ndërtojmë një mekanizëm racional, ai do të mund që vetë ta prodhojë vlerën e vet. Në planin politik ky është mekanizmi demokratik, në planin teknologjik janë ato shkencore që e krijojnë vlerën dhe sistemin. Ky është dallimi kryesor i qytetërimeve klasike-antike dhe i atij islam prej qytetërimit perëndimor. Në kulturat antike asnjëherë s'ekzistonte bindja se mekanizmi i caktuar mund të gjenerojë vlera; në to, mekanizmi është legjitim nëse është gjeneruar prej vlerave. Duke punuar në veprën time *Alternative Paradigms*, rastisa një traktat që më ka lënë mbresa të thella. Bëhet fjalë për veprën e el-Hazinit, *Kitabu mi-zani'l-hakk*, që është shumë pak e njohur dhe që në përgjithësi shqyrtohet në historinë e shkencës. Tërë libri trajton çështjen e peshores. Ajo është gjithçka. Shpjegohet mekanizmi i peshores. Më tepër më ka lënë përshtypje pjesa hyrëse e traktatit, ku së pari flitet për njërin prej emrave të bukur të Zotit, *el-adil* (i Drejtë) dhe kështu shtrohet koncepti i Krijuesit. Më tutje shpjegohet reflektimi i këtij emri hyjnor në gjithësi, konceptit të së drejtës i bëhet një trajtim filozo-

fik. Pas dhënies së kësaj prapaskene ideore, pason shpjegimi i peshores. Dhe, te lexuesi i rëndomtë lind ky përfundim: Peshorja që po e mban në dorë s'ka kurrfarë kuptimi nëse në kokën tënde nuk ke një koncept rreth ekzistencës, një koncept rreth diturisë që ndërlihet me të parin dhe një filozofi të drejtësisë që është ngushtë e lidhur me të dytin.

Mahçupjan: Madje i pakuptimtë është edhe përdorimi i peshores.

Davutogllu: Po, s'ka kuptim. Mekanizmi për të cilin jemi duke folur këtu në të gjitha qytetërimet klasike dhe antike përbën fundin. Për këtë arsye ekonomia është fundi. Së pari ontologjia, pastaj dija, më tutje vlera, e drejta dhe politika. Ekonomia është një gjë e përcaktuar. Moderniteti bëri ndryshim invers dhe ekonominë e vuri në qendër. Si në ndërlidhshmërinë midis kapitalizmit dhe demokracisë, ekonomia filloi ta përcaktojë politikën; politika të drejtën, e drejta filloi t'i gjenerojë vlerat, të cilat cilat filluan të përbëjnë boshtin e identitetin e konsumatorit dhe vetëdijen individuale të njerëzve në botën e globalizuar.

Bullaç: Në fakt kjo është edhe pyetja ime. Raporti mes lirisë, sigurisë, epistemologjisë, mes vlerave dhe mekanizmit, ekonomisë, politikës, së drejtës dhe vlerave. Në kuadër të këtij konfuzioni ngjarjet e terrorit, luftërat, konfliktet e brendshme, revolucionet. A thua çfarë premtion Islami në këtë ambient të përplasjeve?

Davutogllu: Për ta kuptuar më mirë problemin filozofik që pasqyrohet në sistemin ndërkombëtar, mendoj se duhen dhënë edhe ca shpjegime. Nëse dini që ta shfrytëzoni mirë një mekanizëm të teknologjisë,

atë mund ta përdorni si mjet terrori për t'i zhdukur të gjitha vlerat. Dhe nëse kthehemi mbrapa, do të vërejmë se vendimi për hedhjen e bombës atomike në Japoni është marrë përmes mekanizmave të demokracisë. Edhe zbatimi i këtij vendimi është bërë në saje të mekanizmave racionalë, edhe pse gjithmonë është diskutuar aspekti etik i këtij akti. Sipas meje, pika më e rëndësishme dhe më e dobët e Fukujamës është besimi i thellë të mekanizmi. Mbështetja e skajshme e njeriut të mekanizmi mund ta shpjerë atë deri të shkatërrimi i vlerave kolektive që shtrihen deri në thellësitë e historisë. Ja, sot kjo është ajo që na paraqitet në ngjarjet e terrorit. Kush e shfrytëzon këtë mekanizëm, mund të ketë pasoja negative madje dhe për gjërat e veta që i konsideron të vlefshme. Natyrisht, një aspekt tjetër i kësaj janë edhe problemet ekologjike, që burojnë prej të njëjtave mekanizma. Teknologjia, e cila e prish edhe baraspeshën ekologjike, shkakton lëkundje serioze. Këto lëkundje i shtyjnë njerëzit që t'i diskutojnë parametrat kryesorë të sistemit ndërkombëtar dhe prapaskenën ideore të tij. Sot, problemi themelor në Perëndim është fakti se qytetërimi perëndimor përkundër lëvizjeve globaliste të historisë, po sundon botën duke i zhdukur hapësirat e tjera qytetërimore. Tojnbi thotë se në botë janë themeluar gjithsej njëzet e gjashtë qytetërime, se prej tyre gjashtëmbëdhjetë kanë vdekur. Prej dhjetë qytetërimeve që janë gjallë, ku bën pjesë edhe ai islam, qytetërimi perëndimor është duke i përjetuar çastet e fundit të jetës. Në vitet 1930 kishte mendime të tilla. Sikur të realizoheshin ato, ndoshta do të lindte një rend i mirëfilltë.

Bullaç: Flitet për *qytetërimin e ndalur*.

Davutogllu: Këtu kemi të bëjmë me një keqkuptim. Tojnbi shprehjen 'qytetërim i ndalur' e përdor për shtetin osman dhe i jep asaj kuptim negativ. Lidhur me shtetin osman përdor edhe termin *arrested*, që nënkupton vendin i cili si pasojë e kushteve gjeografike e ka burgosur vetveten. Tojnbi bën padrejtësi të madhe ndaj shtetit osman, duke e krahasuar atë me eskimezët dhe me qytetërimet e Paqësorit.

Mahçupjan: Me sa duket, Tojnbi nuk është person të cilin sot do ta kishim pëlqyer.

Davutogllu: Por mendimi i Tojnbit nuk u realizua, përkundrazi, të gjitha këto qytetërime filluan të gjallërohen.

Mahçupjan: Me të vërtetë është për t'u habitur sesi kohëve të fundit po dalin në skenë historianë që bëjnë gabime të njëjta si ato të Tojnbi-t.

Hapësira e sigurisë ontologjike në Islam

Davutogllu: Edhe vetë Tojnbi në shkrimet e tij mëvonshme i ka pranuar gabimet e bëra, prandaj s'duhet sulmuar shumë. Në vend të Tojnbit, nëse ndalemi te MakNili do të përballemi me një koncept përendimor egocentrik. Vepra e tij që trajton historinë e qytetërimeve, e titulluar *The Rise of The West* (Ngritja e Perëndimit), pasqyron mendësinë se "gjithçka rrjedh në Perëndim". MakNili edhe pse është një historian më objektiv se të tjerët, prapëseprapë s'ia ka dalë ta

shpëtojë veten prej këtij kurthi egocentrik. Marshall Hodgson, si një historian i qytetërimeve, i shpjegon mjaft mirë kokëçarjet që mund t'i shkaktojë tipologjia e trajtës egocentrike. Kjo në fakt duhet trajtuar në kuadër të debatit rreth *përplasjes së qytetërimeve*. Tojnbi konstatimin se “ne, perëndimorët historinë e shikojmë me bindjen se tërë njerëzimi rrjedh drejt nesh”, e koncepton me sintagmën e rëndësishme *iluzioni egocentrik (egocentric illusion)*. Është normale që një perëndimor të ketë pikëpamje të këtillë, madje si një qëndrim i tillë mund të duket mjaft i shëndoshë nga këndi i vetëbesimit të mendësisë perëndimore. Por kur këtë koncept historik ia përcillni një banori të Indisë, të Kinës, ndonjë pjesëtari të Islamit ose të ndonjë pellgu tjetër qytetërimor, shkaktoni përçarje të vetëdijes dhe përkatësisë qytetërimore. Në veçanti, nëse kinezi njih më tepër Dhiatën e Vjetër sesa Konfucin, nëse një turk e njih Hegelin pa lexuar asnjë prej klasikëve osmanë. Prej këtu mund të kalojmë në problemin e mendimit, me të cilin po përballet bota islame. Kemi të bëjmë me një përçarje në nivelin intelektual, e cila duhet shkoqitur mirë.

Bullaç: Në botën moderne, Islamit po i jepet një rol i veçantë. Por kjo më tepër në nivelin e etikës, rol ky që ka të bëjë me rehabilitimin në aspektin shpirtëror. Me sa kuptoj, nuk i jepet roli i kulturës alternative ose i një paradigme qytetërimore. Në Perëndim shpesh tregohet interesim për taoizmin ose hinduizmin si mënyra të rehabilitimit të personaliteteve të shkatërruara. A hasim gjëra të tilla edhe tek ne? Moskonsumimi i alkoolit dhe i mjeteve narkotike është gjë

shumë e rëndësishme. Gjithmonë duhet pasur parasysh ndalimin e këtyre veseve, si dhe degradimi moral. A thua Islami është identitet vetëm i këtyre gjërave? Një herë të marrim përgjigjen e kësaj pyetjeje e pastaj do të shtroj një pyetje tjetër.

Davutogllu: Kjo çështje kërkon një analizë më përfshirëse. Lidhur me Islamin dhe çështjet me të cilat ndeshet qytetërimi islam mund të paraqiten dallime të shumta. Për shembull, prej pyetjeve në vijim, si: “Çfarë qëndrimi ka dhe çfarë qëndrimi ka pasur gjatë historisë Islami lidhur me çështjen e sigurisë dhe lirisë ontologjike? Sot a mund të thotë diçka në lidhje me këtë problematikë?” më në fund mund të arrijmë të rendi. Cilat janë postulatet kryesore që në histori qytetërimin islam e kanë dalluar prej qytetërimeve të tjera dhe që e kanë nxjerrë në skenën e historisë? Sipas meje, postulati i parë dhe më i rëndësishëm që e dallon qytetërimin islam prej atyre të mëparshmëve, është vetëperceptimi i tij. Me shprehjen vetëperceptim nënkuptoj ndikimin që një individ ka në vetëdijen e tij. Në përgjithësi Islamin e shohim si fe të bashkësisë, kurse Perëndimin si individualist, por nëse Islamin e krahasoni me fetë e tjera nga aspekti i perceptimit të ekzistencës, do të vëreni se kjo fe niset prej individit. Çdo individ, pa marrë parasysh ku është, vetë mund ta arrijë perceptimin e ekzistencës pa ndërmjetësimin e ndonjë institucioni. Ky është një propozicion me peshë, prej të cilit vërehet se Islami i beson individit. Për shembull, në krishterizëm, në veçanti në katolicizëm, njeriut të rëndomtë nuk i besohet. Protestantizmi ka lindur si reagim ndaj këtij qëndrimi të krishte-

rizmit. Me të drejtë e ka kundërshtuar ndarjen kategorike bardhë e zi. I bardhi, gjegjësisht "i miri", kur hyn në klasën e pritërfinjve pastrohet prej të gjitha mëkateve dhe shndërrohet në engjell. Madje dhe nëse nuk kalon në atë grup, vazhdon të qëndrojë në një pozitë sublime. Kjo vlen edhe në budizëm e në hinduizëm. Brahmanët e sistemit të kastave janë ata që e kanë arritur lirinë dhe që e kanë shijuar sigurinë absolute. Të gjithë të tjerët qëndrojnë nën ta. Kurse forca bazë e Islamit që prej lindjes së vet është ngritja e Bilall Habeshiut prej vetëdijes së skllavit në atë të njeriut të lirë. Ky përparim është rezultat i shembjes së të gjitha kategorive ontologjike të kohës së atëhershme. Pra, komunikimi i drejtpërdrejtë me Zotin. Shikuar nga këndi i lirisë dhe sigurisë, ky parim i Islamit është i rëndësishëm edhe në kohën tonë. S'mund të ndërtojë rend një qytetërim, që nuk i beson njeriut të rëndomtë. Qytetërimi që nuk beson se njeriu i rëndomtë mund ta gjejë të mirën, është qytetërim që s'mund të ndikojë në vetëdijen e njeriut të rëndomtë. Para disa javësh në Turqi erdhi njëri prej emrave më të dalluar të teologjisë pasmoderne perëndimore dhe gjatë bisedës hymë edhe në çështjen e trinisë së shenjtë. Me sinqeritet më tha: "Edhe unë mendërisht s'e kuptoj dot trinitetin!" Kjo është mjaft e rëndësishme. Vetëm besimi i kuptueshëm mund të ndikojë në vetëdijen e individit. Këtë e vërejmë në periudhën e parë të Islamit, kur ky element ka luajtur rolin e forcës shtytëse në përhapjen e Islamit.

Këtu duhet pasur kujdes në njërin prej problemeve të modernitetit. Në paradigmen e modernitetit,

liria është gjë që shpjegohet me parimin e barazisë. Mund të jeni të lirë vetëm nëse jeni të barabartë me të tjerët. S'ka dyshim se koncepti i bazuar vetëm në barazi është problematik. Në Islam si në burimet klasike të periudhës së parë, ashtu edhe në ato të mëvonshme, liria më tepër është kuptuar si çështje individuale sesa si barazi me tjetrin. Domethënë, problemin e lirisë mund ta përjetojë edhe një njeri i vetëm.

Bullaç: Me rëndësi është përsosuria e brendshme.

Davutogllu: Që nga periudha e modernitetit dhe e Revolucionit Francez çështja e lirisë nuk trajtohet se çështje e individit, sepse sipas postulateve të kësaj kohe, vetëm një individ s'e ka problemin e barazisë me tjetrin. Traktati i Ibën Baxhes që titullohet *Tedbi-ru'l-mutevahhid* është një vepër shumë interesante. Në të diskutohet çështja e lirisë së një individi të vetëm. Islami shtron parimin se madje edhe një njeri i vetëm, duke e ekzaminuar dhe kapërcyer vetveten pa ndihmën e hapësirës, institucionit ose të ndonjë personi, mund ta arrijë ndjenjën e sigurisë dhe lirisë ontologjike. Në Perëndim, mekanizmat që janë të pavarura prej vlerave, në saje të racionalitetit i shtyjnë njerëzit që ta legalizojnë pabarazinë ekzistenciale. Është ky perceptim i ekzistencës ai element, që Islamin e dallon prej disa qytetërimeve të tjera, prej Perëndimit dhe prej ideologjive moderne që janë produkte të tij.

Mahçupjan: Një gjë të tillë nuk e hasim vetëm në Islam, por edhe në budizëm.

Davutogllu: Po. Budizmi në një aspekt është i afërt me Islamin e në një aspekt tjetër me krishterimin. Kam pasur rastin të gjendem në mesin e budistë-

ve. Ekzistojnë dallime të dukshme midis budizmit Teravada dhe atij Mahajana. Ky i dyti deri diku është i afërt me Islamin. Le të japim një shembull të dallimit mes Islamit dhe budizmit. Shikoni adhurimin e haxhit në Islam. Gjatë haxhit, kur besimtari mysliman është në ihram, vlejné të gjitha ndalesat që vlejné edhe për priftërinjtë budistë, kur veshin rrobën e tyre specifike. Prifti budist e mban veten larg sjelljeve apo veprimeve të njerëzve të rëndomtë, të cilët asnjëherë s'mund të bëhen si priftërinjtë. Në Islam, të gjithë haxhilerët e përjetojnë haxhillëkun e pastaj kthehen në jetën reale. Është një gjë tjetër, që neve na intereson nga këndi i psikologjisë së fesë dhe ai i raporteve mes fesë e modernitetit. Islami e formon njeriun që pas ngritjes metafizike t'i kthehet përsëri realitetit historik e jo njeriut që mbetet atje. Ekziston edhe një arsye që Islamin e nxjerr në skenën e historisë si qytetërim, që e veçon atë në aspektin ideor, që e dallon prej feve të tjera. Në të gjitha fetë, periudha e lëkundjeve më të mëdha është ajo e vdekjes së profetit. Sipas meje, ndërtimi i vërtetë i fesë islame, vendosja e saj në skenën historike ka ndodhur pas vdekjes së Muhammedit (a.s.). Në aspekt të fesë dhe të historisë me probleme thuajse me të njëjtat gjëra janë përballur edhe krishterimi dhe budizmi. Në këtë drejtim dallon konfucianizmi. Me vdekjen e Budës dhe me ngritjen e Isait (a.s.), ithtarët e tyre i kanë hyznizuar këta njerëz dhe kanë krijuar meskategorinë ontologjike, që ka rolin e ndërmjetësuesit mes Zotit dhe njeriut, klasën e priftërinjve. Ky motiv e ka penguar rënien e këtyre dy feve. Polemika mes Ebu Bekrit dhe Omerit (r.a.) pas

vdekjes së të Dërguarit dhe shprehja se “ai ka qenë njeri dhe ka vdekur”, Islamin në saje të racionalitetit e ka futur brenda historisë. Për këtë arsye në Islam asnjëherë asgjë s’mund të shpjegohet me një parajsë tokësore. Në këtë kontekst në Islam shfaqet një bazament racional e jo racionalist, një rezultat epistemologjik. Tek ne nuk është përjetuar një problem i historizimit si ai i krishterimit. Në krishterim, kur arriti të mbizotërojë bindja se Jezui nuk ka vdekur, pyetja kyç që lindi ishte kjo: Nëse Jezui është gjallë dhe ka fuqi hyjnore, atëherë kush është ai që mund të kontaktojë me të, kush sjell porosi prej tij? Ky është shkaku pse në krishterim, në kishën katolike shpallja është reduktuar në dogmat kishtarë. Sot të gjitha kishat dhe lëvizjet fetare që lindin në Perëndim pretendojnë për lidhje me Jezuin. Kjo tregon se krishterimi vazhdon të ballafaqohet me problemin e historizimit. Pikëpamjet si ajo, se kisha është mbihistorike dhe tejhistorike, kurse mbreti është brenda historisë, flasin për tensionet që në këtë fe i kanë sjellë dogmat e ndryshme. Për këtë arsye në Perëndim, për të lindur racionalizmi së pari është dashur të bëhej historizimi i krishterimit, madje para kësaj historizimi i Jezuit. Literatura krishtere e shekullit XIX merret plotësisht me këtë çështje. Në Islam një problem i tillë nuk është përjetuar dhe kjo e ka bërë këtë fe që qysh nga fillimi të jetë efektive në kuadër të historisë.

Dimensioni i tretë ka të bëjë me hapësirën ku Islami ka lindur dhe është zhvilluar. Gjeografia ku ka lindur Islami nuk është një hapësirë e veçantë dhe e shkëputur prej qytetërimeve antike të mëparshme.

Nuk është shfaqur në Afrikë ose në Amerikën Latine. Islami ka gufuar në një hapësirë shumë të afërt me Egjiptin, me Mesopotaminë, me Iranin dhe me Indinë, por jo në brendi të tyre. Mosqenia e Islamit në brendinë e këtyre hapësirave qytetërimore, ka ndikur që kjo fe të mos transformohej prej tyre siç ka ndodhur me krishterimin. Ashtu si një fëmijë që për t'u rritur futet për një kohë të qëndrojnë në an me qëllim që të sillet në gjendje t'u përshtatet kushteve të jashtme, edhe për qytetërimi islam, pas lindjes u poqën kushtet e Hixhazit dhe më vonë ndikoi në qytetërimet tjera. Kjo sjell me vete një specifikë, që sot është interesante për ne: Të gjitha qytetërimet antike kanë gjetur hapësirë jetike brenda qytetërimit islam. Ne mendojmë se qytetërimi islam ka filluar me Muhammedin (a.s.), kurse osmanlliu me shprehje *kadim* (antik/e) ka nënkuptuar diçka që arrin deri te Ademi (a.s.), deri në thellësitë e historisë.

Bullaç: Historia e "gjithësisë së njerëzimit".

Davutogllu: Po. Por sot po jepet një fotografi e Islamit që është i huaj për të gjitha kulturat, që përjashtohet prej të gjitha kulturave, që përplasit me të gjitha kulturat. Ky është përshkrimi që Hantingtoni i bën Islamit, duke mos u bazuar në kurrfarë të dhënash dhe të vërtetash historike. Çështja do të sqarohet nëse bëjmë krahasimin e dy emrave të rëndësishëm, që kanë jetuar në të njëjtën periudhë: Makiavelit dhe Kënallëzades. I pari ka shkruar një vepër në periudhën kthesë të qytetërimit perëndimor, kurse Kënallëzadja në kohën e kulmit të zhvillimit të qytetërimit osman. Nëse bëjmë krahasimin e *Princit* të Makiavellit

dhe të *Ahlak-i Alai* të Kënallëzades, do të vërejmë se te mendimtari italian nuk do të gjejmë kurrfarë referen-
 ce jashtë jashtë Romës dhe Kishës. Ai nuk i referohet as Greqisë Antike, nuk e përmend fare Platonin ose Aristotelin. Sepse bota e Makiavelit në atë kohë ka qenë e nivelit që ka mundur t'i perceptojë vetëm Romën dhe Kishën. Nga ana tjetër, në veprën e Kënallëzades, hasim transmetime prej Sokratit, sofistëve, Platonit, Aristotelit, prej traditës iraniane, asaj indiane etj. Sot Kënallëzade nuk ka kurrfarë vendi në kuadër të modernitetit. Mendohet se historia e njerëzimit ka rrjedhur dhe është formuar vetëm në Perëndim, se Islami ka mbetur jashtë kësaj rrjedhe dhe se kjo fe s'mund t'i përshtatet asaj. Jo. Qytetërimi islam e ka vazhduar përfshishmërinë e vet deri në shekullin XVIII dhe XIX. Qytetërimi perëndimor sot për herë të parë gjendet në provimin e globalizimit. Qytetërimet e tjera, (Kina jo gjithaq) në veçanti ai islam, shumë më herët e kanë përjetuar këtë përvojë. Në një vepër të një historiani francez thuhet se në vitin 1596 qyteti më i madh i botës ka qenë Stambolli me 700 mijë banorë. I dyti për nga numri i banorëve ka qenë Kajroja, qytet ky brenda kufijve osmanë, kurse i treti Pekini. Parisi me 100 mijë banorë s'ka arritur të hynte as brenda dhjetë të parëve. Nëse Parisin, Berlinin, Londrën i konsiderojmë si pellgu në të cilin ka lindur dhe është zhvilluar qytetërimi perëndimor, mund të themi se në kuadër të pellgut të zënë ngoje deri në shekullin XVI s'ka pasur asnjë qytet të madh. Mungesa e qyteteve të përmasave të mëdha do të thotë mungesë e një strukture që do t'i mbante të bashkuara elementet e ndry-

shme kulturore. Qytetet si Parisi, Londra dhe Berlina për herë të parë kanë filluar të ngërthejnë në vete elemente të ndryshme kulturore brenda këtyre tridhjetë viteve të fundit. Perëndimi rishtazi është duke e përjetuar një dukuri që ne e kemi përjetuar gjatë periudhës osmane. Krahasimi që këtu po e bëjmë mes Islamit dhe Perëndimit, përbën krahasimin e globalizmit të fundit të kufizuar që është bazuar në kulturën antike, pra krahasimin e shtetit osman dhe të sistemit të miletit me globalizmin modern perëndimor. Perëndimi, duke e shfrytëzuar thesarin dhe sfondin historik të botës islame, në vend që ta jetësojë procesin që do t'i japë kontribut të thellë globalizmit, po e përjashton botën islame në aspektin politik dhe mundohet ta mbajë atë jashtë thesarit të njerëzimit. Kjo nuk shkon në të mirë të rendit botëror.

Mahçupjan: Kjo sipas meje është shumë e rëndësishme. Tjetri mund t'ju përjashtojë, por nëse ju s'mund të bëni gjë vetëm pse dikush ju ka përjashtuar, mendoj se s'është e logjikshme që faji të kërkohet te tjetri. Duhet gjetur një damar tjetër ose duhet rrjedhur drejt tokës në mënyrë tjetër.

Një gjë që mua më tërheq vëmendjen pas ngjarjes së 11 shtatorit, duke u nisur edhe nga fjalët tuaja, është kjo: Perëndimi përfaqësohet edhe prej perëndimorëve të sotëm. Për fat të keq ne flasim për Islamin, por jo për performancat e tyre të kohës sonë. Islami dhe Perëndimi aktual janë dy gjëra të pakrahasueshme. Islami është fe por ndërkohë edhe fenomen sociologjik. Për dallim prej Perëndimit, edhe atje ekziston një thyerje. Një gjë që më bie në sy nga rasti i fundit i terrorit është

ajo, se Bushi brenda dy-tri ditëve tha se “Islami është fe e paqes” dhe njerëzit u gëzuan shumë. Unë nuk jam mysliman, por këto fjalë më prekën. Sepse të gjitha fetë janë paqësore. Shprehja “Islami është fe e paqes”, më duket se ka këtë kuptim: “Në fakt nuk është i tillë, por unë po ua bëj qejfin juve”. Fjalët e Bushit nuk më pezmatuan sa gëzimi i njerëzve. Prej aty lind pyetja, se çfarë fshihet pas kësaj ligështie?

Bullaç: Në historinë islame ka edhe filozofë çifutë, si Ibën Mejmuni (Ben Majmonides), të cilët sikurse Ibën Sina, Farabiu dhe Kindiu merren parasysh prej peripatetikëve. Të gjithë këta kanë përdorur gjuhë të përbashkët. I kanë huazuar prej filozofisë greke termat themelorë, kanë bërë një ndërhyrje semantike dhe i kanë ripërkufizuar ato. Edhe filozofët hebrenj kanë shfrytëzuar të njëjtën nomenklaturë dhe janë marrë me problematikë të njëjtë si ajo e filozofëve myslimanë. Terminologjia dhe argumentet të cilat i kanë shfrytëzuar apologjetët hebrenj janë të njëjta me ato të apologjetëve myslimanë, por ata në jetën ideore kanë marrë pjesë si filozofë dhe apologjetë hebrenj ose si myslimanë. Në Islam kjo llojshmëri s’gjeneron ndonjë problem. Në fillim të shekullit XX, numri i jo-myslimanëve në Stamboll ka qenë më i madh ose i barabartë me atë të myslimanëve. Por nëse e shkoqisim jetën sociale, do të shohim se jeta e qytetit i përngjan stilit arkitekturor të Mimar Sinanit. Një kube e madhe dhe gjysmëkubetë ose çerekkubetë, që mbajnë atë të madhen. Domethënë, të gjitha nënkulturat, sektet, fetë dhe grupet sociale përmbledhen nën atë ombrellë të madhe. Pas viteve 1920 ndodhi shpërngulja e

madhe sociale, tre milionë grekë u këmbyen dhe ndoshta sot për herë të parë Stambolli është qytet me 99,9 % myslimanë. Në aspektin demografik është një qytet mysliman, por nuk është qytet islam, sepse në të s'ka kulturë e as qytetërim islam. S'ka as mënyrë jete-se pluraliste. Do të thotë se mrekullia nuk qëndron te numri i popullsisë. Në të kaluarën në kulturën osmane-islame kanë dhënë kontributin e vet muzikantë, poetë, arkitektë armenë, njerëz të profileve të ndryshme me prejardhje hebreje dhe kështu është ndërtuar një kulturë shumëngjyrëshe. Sot popullata po myslimanizohet, por qytetërimi nuk po lind. Prej jush pres përgjigje lidhur me këtë. Do të pyes edhe një gjë, por para së gjithash mendoj se duhet t'i kushtojmë rëndësi deklaratës së Bushit.

Mahçupjan: Pajtohem me ju.

Provimi i botës islame

Bullaç: Deklarata e zënë ngoje është e rëndësishme, sepse politika amerikane për herë të parë në nivelin zyrtar shprehet se Islami nuk ka të bëjë me terrorin dhe se myslimanët s'mund të cilësohen për terroristë vetëm në bazë të identitetit të tyre mysliman apo të fesë së tyre. Presidenti Bush tha edhe një gjë tjetër të rëndësishme: "Gratë e mbuluara le të ecin të lira rrugeve. Le të mos frikohen. Janë të mbrojtura". Ky përkufizim zyrtar duhet të shkaktojë ndryshime konceptuale në vendet islame, në shumë vende të Lindjes së

Mesme, të cilat myslimanin e përkufizojnë si terrorist ose reaksionar. Lidhur me këtë kam një pyetje. Mendoj se pas përplajses së qytetërimeve duhet të ketë një sfond të fesë ose të kulturës. Por në këtë kontekst të ri vërejmë se asnjë fe nuk e mbështet luftën. Në këtë drejtim janë të rëndësishme deklaratat që Papa ka dhënë në Kazakistan dhe në Armeni. Fliste vetëm rreth paqes. Kurse në jetën reale kishim luftë mes ushtrive kryqtare dhe botës islame të sulmuar. Edhe këtu fetë nuk marrin pjesë në përplasje. Kjo nuk është përplasje midis myslimanëve dhe të krishterëve. Liderët myslimanë pohojnë se nuk bëhet fjalë për luftë fetare. Edhe prijësit e krishterimit, kishat dhe Papa theksojnë se s'kemi të bëjmë me luftë fetare. Në rregull, atëherë çfarë lufte është kjo? Do të ndërhyhet në Afganistan. Zoti na ruajtë, ndoshta do të pasojë edhe sulmi ndaj Irakut. Kjo luftë nuk është luftë fetare e as luftë mes qytetërimeve. Cila është korniza e legjitimitetit të saj dhe si do ta pagëzojmë atë?

Davutogllu: Pyetja juaj e fundit është e rëndësishme nga aspekti i themelimit të rendit ndërkombëtar. Është e dobishme të ndalemi pak dhe të flasim rreth dallimit mes Islamit dhe myslimanëve, rreth të cilit me ngulm po insiston zotëri Etjeni. Dhe është me të vërtetë i saktë konstatimi juaj, se edhe përkundër rritjes së numrit demografik të myslimanëve të Stambollit, Islami gradualisht po zbehet në këtë qytet.

Bullaç: E ka humbur edhe cilësinë e qytetërimit. Nuk është më qytet i civilizimit.

Davutogllu: Po. Çdo herë kur kaloj nëpër urën e Bosforit prej Azisë në Europë, përjetoj një dilemë pre-

këse. Kur shikoj në të majtë e shoh siluetën e pasur dhe të bukur të mbështjellë me elemente të shumëkulturesisë. Kur shikoj në të djathtë, shoh një siluetë krejtësisht tjetër, të përbërë prej rrokaqiejve. E përjetoni tensionin mes thellësisë historike dhe Nju-Jorkut të vogël. Ky tension po përjetohet edhe në botën islame e atë në shumë dimensione. Është me rëndësi të thuhet se qytetërimi islam në të gjitha periudhat e mbi-sundimit është pakicë. Në Medinë, në etapën fillestare në Andaluzi, në Indi madje edhe në shumë troje të shtetit osman. Edhe pse ka qenë pakicë, nuk ka përjetuar ndonjë problem të sigurisë. Gjithherë është i sigurt në vetvete dhe nuk përjeton ndonjë problem të tendosjes.

Bullaç: Bëhet prijës, por asnjëherë nuk shfaq hegjemoni.

Davutogllu: Ashtu si njeriu i harmonizuar me vetveten mund t'u japë mesazhe të tjerëve, edhe kulturat që janë të sigurt në vetvete s'mund të kenë karakter përjashtues. Nëse një kulturë ka filluar të bëjë përkufizim përjashtues, dijeni që prirja i fillon të vërtitet nga e kundërta. Për këtë arsye, lirisht mund të thuhet se ndarja kategorike e Hantingtonit *West-Rest* (Perëndimi dhe të tjerët) është treguese, se Perëndimi po përjeton lëkundje të vetëbesimit.

Qytetërimi islam ka përjetuar tre provime historike. Provimi i parë janë luftërat e kryqëzatave, që përbëjnë sulmin e parë ndaj gjeografisë islame prej jashtë. Deri atëherë Islami vazhdimisht është zgjeruar dhe ka qenë i sigurt në vetvete. Luftërat kryqtare janë goditje si për kryqtarët ashtu edhe për myslimanët, por për

kryqtarët janë goditje më e rëndë. Ata njihen me një qytetërim të një hapësire, të cilën e trajtonin si barbare dhe të prapambetur. Për botën islame këto luftëra nuk paraqesin ndonjë sfidë të madhe. Sfida ushtarake përfundoi me çlirimin e Kudsit (Jerusalemit) nga ana e Salahuddin Ejjubit. Provimi i madh i dytë janë sulmet mongole, që përbëjnë një trysni të madhe demografike të ardhur nga Lindja dhe ndërmarrje shkatërruese. Islami i ka kapërcyer edhe këto sulme. Qytetërimi islam ka përjetuar një krizë që ka zgjatur mes njëqind apo dyqind viteve. Shteti osman është një sintezë që e ka tejkaluar lehtë sfidën mongole.

Provimi i tretë ka filluar me kolonializmin europian. Kriza që buron nga larja e hesapeve me qytetërimin perëndimor, e filluar me kolonializmin, ende vazhdon. Pse? Sepse kolonializmi nuk ishte vetëm sfidë ushtarake. Sikur të ishte i tillë, do të mund të tejkalohet me thesarin e formuar nga lufta antikolonialiste e emrave si Shejh Shamili dhe Omer Muhtari. Kolonializmi para së gjithash ka sjellë me vete shndërrimin mendor, atë ekonomik dhe më në fund atë politik. Kolonializmi ka ndikuar thellë në të gjitha këto sfera, por ndikim më të madh ka pasur në shndërrimin ideor. Myslimanët që dy shekuj po e përjetojnë pjesërisht tendosjen e kësaj dileme. Tendosja që po e përjetojnë hebrenjtë është një problem edhe më i thellë. Për ta kuptuar psikologjinë e hebrenjve, duhet të lexoni Torahun, në të cilin thuhet se hebrenjtë janë racë superiore dhe se ata kanë mision të veçantë. Nëse e shikoni historinë, do vëreni se hebrenjtë vazhdimisht janë shtypur e janë përçmuar dhe si pasojë e kë-

saj, ata e bartin me vete tendosjen psiko-ontologjike. Ky realitet, në periudhat kur hebrenjtë kanë qenë pasivë i ka bërë të mbyllur, kurse në ato kur kanë qenë aktivë, tepër agresivë. Pikërisht si sot. Bota islame s'ka përjetuar diçka në përmasa të këtilla. Historikisht ka qenë më e sigurt në vetvete. Bota islame ka përjetuar një tendosje dykahëshe, tendosje psiko-ontologjike. Shikon historinë dhe shënon suksese të larta; i ngërthen në vete të gjitha kulturat antike. Libri thotë "ju jeni superiorë". Pra, kurrë s'është përshkuar nga kompleksi i vlerës së ulët, por realiteti politik, ekonomik dhe inetelektual është jashtë kësaj. Kjo gjendje e tregon veten me shumë kundërveprime. Me reagimin modernist, që nënkupton shkëputjen prej trashëgimisë historike dhe përshtatjen trashëgimisë tjetër. Reagimi i dytë përbëhet prej strehimit në trashëgiminë historike, është reagim tradicionalist deri diku i skajshëm. Dhe reagimi i tretë, ai abstragues dhe përjashtues i vetvetes. Bota islame të trija këto reagime i ka përjetuar shumë. Nëse i hedhim një sy trashëgimisë dyqindvjeçare, do të vërejmë se në kuadër të botës islame - për Turqinë do të flasim më vonë - njerëzit e qendrës së gjeografisë osmane këtë e kanë përjetuar më thellë. Kur vjen deri te ballafaqimi i copëtimit mendor me tendosjen psiko-ontologjike, lind problemi i intelektualit.

Bullaç: I shpjeguat bukur mirë të tria ballafaqimet. Në dy të parat, s'ka pasur konflikt të thellë midis myslimanëve dhe krishterimit të Lindjes. Bashkë e kundërshtojnë vërshimin mongol dhe luftërat e kryqëzatave.

Mahçupjan: Madje krishterimi ortodoks ka ngrënë një grusht shumë më të rëndë.

Bullaç: Nëse Islami dhe osmanlliu kanë përjetuar traumë të rëndë në sulmin e tretë të madh, a thua të njëjtën s'është duke e përjetuar edhe krishterimi lindor?

Davutogllu: Në kulturën osmane myslimanët kanë qenë kryesues, por kjo kulturë ka qenë produkt i përbashkët edhe i kulturave të tjera. Madje, siç kam cekur edhe në një kumtesë të paraqitur në Kongresin Ballkanik, mund të thuhet se krishterimi lindor, sllavizmi dhe Ballkani si qendër e Bizantit, asnjëherë s'ka qenë më afër qendrës së historisë sesa në periudhën osmane. Shikoni periudhën romake e atë bizantine dhe do të konstatooni se Ballkani në atë kohë përbënte pjesë skajore. Kurse në periudhën osmane, hapësira e Rumelisë është vendi prej ku është udhëhequr bota. Osmanlliu kur e ka bërë këtë, nuk i ka rrënuar muret. Në qytetet osmane të Rumelisë së asaj periudhe elementet krishtere janë mbisunduese.

Mahçupjan: Për qytetërimin perëndimor, Ballkani është skaji, sepse përbën pjesën lindore të tij. Por për osmanlliuin Ballkani është perëndimi i Lindjes. Duket sikur prapë Perëndimit i jepet përparësi.

Davutogllu: Saktë. Diçka jashtë bisedës: Termat Rumeli, Lindja e Afërt dhe Lindja e Mesme pasqyrojnë njëri-tjetrin. Nuk janë terma statikë. Për Perëndimin, Lindja e Afërt është vendi ku ka arritur krishterimi perëndimor. Në tekstet e shkruara në vitet 1890 nëpër gazetën angleze Lindja e Afërt ose Lindja e Mesme fillojnë që nga Bosnja. Kurse sot Bosnja është pjesë e Europës, sepse kufiri i sotëm është Edreneja. Sikur

turqit ta humbnin Luftën e Pavarësisë dhe të tërhiqeshin brenda, ndoshta edhe Edreneja ose Bursa do të konsideroheshin për pjesë të Europës. Kur erdhën selxhukët, Anadolli ishte pjesë e Rumelisë. Mevlana i kohës së osmanëve quhet Xhelaludin Rumi (i Rumelisë). Në fazën e mëvonshme, Ballkani u bë Rumeli. Këto të dhëna flasin për ndërveprimin interesant midis perceptimeve dhe konceptimeve. Nëse i kthehemi thelbit të temës, mund të themi se bota islame sot është ballë për ballë me një sfidë ideore. Cili duhet të jetë qëndrimi i marrë? Duke i marrë parasysh të gjitha reagimet, si ato moderniste, tradicionaliste dhe selfiste, a mund të kalohet në një perceptim të qytetërimit islam që integrohet me historinë botërore dhe që e merr forcën nga ajo? A mund të kalohet në një konceptim të qytetërimit islam, duke u nisur prej vendores drejt globale, që do të mund t'i jepte mesazhe për tërë botën? Sipas meje, për këtë ka burime teorike dhe historike. Disfata psikologjike të cilën kolonializmi e ka mbjellë në mendjet e njerëzve, dhe reagimi mbrojtës i popullit, që është rezultat i tendosjes psiko-ontologjike, mund të na pengojnë nga përdorimi i drejtë i një fuqie të tillë.

Bullaç: Myslimanët nuk janë rehat.

Davutogllu: Ekzistojnë arsye të shëndosha për këtë reaksion mbrojtës. Për ta kuptuar reagimin e pakistanezit kundër perëndimorit duhet shikuar në historinë e kolonializmit. Kur në vitin 1706 u themelua qyteti i Kalkutës, anglezët u vendosën në Bengal. Atëbotë Bengali ka qenë njëra prej qendrave më të rëndësishme aziatike të tregtisë. Në atë kohë bota islame i kon-

trollonte ekonomikisht të gjitha këto pellgje kyçe. Pas Revolucionit Industrial, bëhet një praktikë interesante për shitjen e produkteve industriale në Bengal. A e dini ç'kanë bërë anglezët në këtë provincë, ku kanë ekzistuar punëtori të shumta tekstilësh? Me qëllim të ndërprerjes së prodhimit ia prisnin gishtërinjtë një brezi të tërë.

Bullaç: Brenda një jave ua prisnin gishtërinjtë dyzet mijë mjeshtërve të tezgjahut.

Davutogllu: Anglezët, pas ardhjes në Indi i kthyen nga e prapa të gjitha veshjet dhe titujt simbolikë. Veshmbathjet e sulltanëve baburë turq të Indisë ua veshën shërbëtorëve të kolonialistëve anglezë. I kthyen nga e prapa simbolet. Dhe, natyrisht, ndaj kësaj do të pasonte një reagim serioz. Gjëra të njëjta kanë bërë edhe rusët në Kaukaz dhe francezët në Afrikën Veriore. Qytetërimi islam që është veçuar me përbrendësimin e kulturës bizantine, iraniane dhe hinduse, me vetëbesimin dhe antikolonializmin e vet, meqë qërimin e hesapeve me Perëndimin shkishërues më tepër e përqendroi në fushën ushtarake, s'ia doli të mendonte gjakftohtë. Bota islame, ndoshta për këtë ka pasur arsye. S'arriti të gjykonte me gjakftohtësi, për arsye se s'ia doli të mendonte me gjakftohtësi. Ne tani jemi ballë për ballë me këtë përgjegjësi. Duke e vlerësuar tërë këtë trashëgimi, duhet të bëjmë një sintezë mes universale dhe lokale. Qytetërimi islam s'arriti ta nxirrte prototipin e dijetarit. Për shembull, Ibën Rushdiu sot çmohet prej çdokujt. Ai është model i ndikimit ndaj modernitetit. A kemi sot në botën islame ndonjë prototip të dijetarit, që e pasqyron metodën ose etikën e Ibën Rushdiut? A ka ndonjë intelek-

tual që ka arritur të integrohet me shoqërinë e vet në kohën kur në kontekstin vendor përjetohej një çarje e tillë? Çarja intelektuale me vete solli edhe çarjen e bazuar në tendosjen individuale psiko-ontologjike. Bota islame e ndjeu veten pa të zot. Myslimanët e rëndomtë duke e ndier veten pa të zot, filuan të tregojnë reaksion mbrojtës. E ndien veten të mjerë në fushën ekonomike. Filloi të mbizotërojë ndjenja se burimet ekonomike shfrytëzohen nga të tjerët. Mendoni rreth ndjenjës që ka ngjallur nafta në botën arabe: "Nafta buron në tokat tona, por populli irakian është i uritur. Çfarë dobie kam unë nga burimet? Ç'sistem ndërkombëtar është ky, në kuadër të të cilit gjëja që buron tek unë s'më kthehet mua, por ushqen dikë tjetër?" Këto konstatime ngjallin reagime mbrojtëse. Nëse ndalemi në sferën politike, do të përfundojmë se në tërë botën ka prirje demokratike, por ç'e do që kjo prirje s'kthen dot nga bota islame. Kryengritja e rumunëve gjatë Luftës së Ftohtë është konsideruar si popullore dhe demokratike. Ngjashëm me këtë, lëvizjet e Estonisë për pavarësi janë mbështetur nga Perëndimi. Por kryengritja azere e vitit 1990 kundër pushtimit sovjetik u trajtua fare në mënyrë tjetër.

Bullaç: Ose Algjeria...

Davutogllu: Algjeria ose Tunizia. Bota islame s'ia doli ta përjetonte vijën natyrore dhe për këtë arsye s'arriti të gjente mjete për t'i zgjidhur problemet e veta.

Mahçupjan: Bëhet fjalë për dallimin në fe. Moskuptimi dhe mospranimi i atij që s'i përngjan vetvetes ose perceptimi ndryshe i tij. Perëndimi e ka në palcë refuzimin dhe 'përrjashtimin e tjetrit pa menduar shumë'.

Davutogllu: Ndërkohë po përjetohet edhe dukuria e shtetit-kombëtar. Në filmin *Propaganda* ka një shembull mbresëlënës. Gjendja e krijuar si pasojë e formimit të kufijve është jonormale. Nëse shtrohet pyetja se ç'kuptim ka kufiri për një sirian brenda Irakut, ose për një mysliman irakian, s'mund të gjejmë kurrfarë reference, as historike, as kulturore e as gjuhësore. Por, sidoqoftë ky kufi ekziston dhe te njerëzit ka një ndikim tensionues. Kurse të gjitha këto dhera janë pjesë e njëri-tjetrit. A ka ndonjë periudhë historike në të cilën është përjetuar një ndarje kaq e madhe mes Antepit dhe Halebit? Sot po përjetojmë modernitetin dhe flitet për globalizimin, por një çarje e tillë s'është shënuar as në periudhën bizantine, as në atë abasite e as në atë osmane. Edhe pse duhet që në saje të globalizmit të bëhet një afrim mes tyre, largimi ka gjeneruar përçarje të re. Përçarja shoqërore dhe ajo mendore kanë shkaktuar refleksin e mbrojtjes me atë që kemi në dorë. Ky refleks më vonë ka shkaktuar urrejtjen ndaj atij, i cili i kanoset gjësë që kemi në duar. Pse për Kinën dhe Indinë këto nuk vlejné? Pse myslimanët? Pse bota islame? Nëse e krahasojmë Islam, Indinë dhe Kinën, do të vërejmë se në histori deri më tani me qytetërimin dominant të kohës sonë ka mbisunduar vetëm qytetërimi islam. Pra, qytetërimi islam është qytetërimi i vetëm që drejtpërdrejt është ballafaquar me qytetërimin perëndimor, përmes Andaluzisë me Europën Jugperëndimore, përmes shtetit osman me Europën Lindore e atë të Mesme dhe shekuj me radhë në masë të madhe ka sunduar me këtë qytetërim. Për perëndimorin, Kina është

shumë larg, është një qytetërim ekzotik; India është një vend mistik që në thellësitë e historisë ka prodhuar diçka; kurse Islami është një fuqi që deri para do kohe i ka sunduar perëndimorët. Islami dhe Perëndimi shfrytëzojnë burime të ngjashme. Nga këndi i historisë së feve mund të flitet për tri kategori fesh: *fetë perëndimore*, si Islami, krishterimi dhe hebraizmi. Në mesin e feve lindore ka edhe *fe sociologjike* si ato të Kinës dhe *fe psikologjike* si hinduizmi. Në një tipologji të këtillë, Islami dhe krishterimi në masë të caktuar ndajnë të njëjtën paradigmë, por e pasqyrojnë në një prapaskenë të ndryshme. Një rezultat tjetër i ndarjes politike që është pasqyruar në shtetin osman, është tensioni mes sistemit të Vestfalisë dhe sistemit të milletit. Me përhapjen e sistemit të Vestfalisë, ka pasuar shkrirje të sistemit të milletit. Kjo shkrirje në botën islame e ka shkatërruar tërësisht qendërzimin mendor, atë ekonomik dhe politik. Lidhur me konceptin, për botën islame nuk duhet bërë një portret statik. Bota islame është koncept dinamik. Në të kaluarën ajo emërtohej me shprehjen *daru'l-islam*. Në veçanti në Perëndim, kundërshtarët e Islamit, si Daniel Pipes, me qëllime provokuese vazhdimisht po parashikojnë luftë të vazhdueshme mes *daru'l-islamit* dhe *daru'l-harbit*. Në terminologjinë klasike dihotomia e përmendur nuk është e tillë. Këto dy sintagma nuk janë dy gjëra të diferencuara mes vete si dy shtete nacionale. Edhe brenda botës islame ka shtete dhe forca të ndryshme dhe *daru'l-harbi* nuk është përkufizuar si hapësirë, me të cilën vazhdimisht duhet luftuar. Ky është një përcaktim që ka lindur brenda funksionalitetit juridik.

Nuk është një ndarje e llojit ShBA-Bashkimi Sovjetik ose Blloku Lindor-Blloku Perëndimor.

Bullaç: As në Kur'an e as në hadithe nuk përmen-den sintagmat *daru'l-islam* dhe *daru'l-harb*.

Davutogllu: Kjo është çështje shumë praktike. Në *daru'l-harb* nuk ekziston autoriteti islam dhe s'ka kush e ndëshkon atë që bën shkelje të ligjit dhe që ia cënon të drejtat dikujt tjetër. Ky përkufizim është përgjigje praktike ndaj një pyetjeje praktike. Meqë nuk zbatohet ligji islam, kjo tokë trajtohet si hapësirë tjetër.

Bullaç: Nga *daru'l-islami*, përmes shtetit osman dhe Lindjes së Mesme arrijmë te bota islame.

Davutogllu: S'duhet harruar se shprehja bota islame është koncept modern. Më parë një gjë e tillë s'ka ekzistuar. Nëse ndalemi në kushtet e lindjes së tij dhe në drejtimin e ndryshimit, do të vërejmë se ka ndryshuar nëpër katër faza: krizat dhe zhvillimet në botën islame. Nëse i krahasojmë këto katër faza, do të shohim se zhvillimi i botës islame nuk ka qenë shumë negativ. Le ta ndajmë shekullin XX në katër pjesë. Periudha e parë është ajo prej vitit 1900 deri në vitin 1918. Periudha e dytë zgjatet deri në Luftën e Dytë Botërore. Periudha e tretë shtrihet prej Luftës së Dytë Botërore deri në themelimin e Organizatës së Konferencës Islamike, deri vitet 1970. Dhe periudha e fundit fillon me vitet 1970 dhe zgjat deri në ditët tona. Në periudhën e parë imazhi kryesor lidhur me Islamin është tipologjia osmane; dy kategori të ndryshme: shteti osman dhe vendet kolonialiste. Shteti osman është përpjekur që t'i rezistojë fuqisë imperialiste të Perëndimit. Kolonitë kanë qenë nën ndikimin e Pe-

rëndimit. Por mes tyre ka pasur lidhshmëri të drejtpërdrejtë. Kur osmanlliu ishte më i fortë, kolonitë ndiheshin më të sigurta. Por ka vlerë edhe e kundërta. Në kohën e Abdulhamidit II, shteti osman ka qenë i fortë aq sa kanë qenë të organizuar dhe të fortë myslimanët e kolonive perëndimore të Lindjes. Kjo shihet gjatë Luftës Çlirimtare të Turqisë kur erdhi një ndihmë e madhe prej Indie, shihet në lëvizjet e hilafetit. Në atë kohë afganët e kanë ndihmuar materialisht Luftën Çlirimtare turke. Në politikën islame të kësaj periudhe ka ekzistuar lidhshmëri e ngushtë mes këtyre dy faktorëve. Mendimtarët e asaj kohe nga sfera e politikës gjithmonë janë munduar t'i përgjigjen pyetjes, sesi mund të bëhej reformë politike dhe intelektuale duke i ruajtur konceptet themelore të rendit osman. Është për këtë arsye që të gjitha shkollat e rëndësishme të asaj kohe janë formuar në periudhën e Abdulhamidit II, e cila i ka tiparet e saj të veçanta.

Prej Luftës së Parë deri në Luftën e Dytë Botërore, unë këtë e zgjas deri në formimin e Pakistanit, qytetërimi islam ka përjetuar periudhën më të thellë dhe më problematike të historisë. Sepse me shembjen e shtetit osman, bota islame thuhet tërësisht u kolonizua. S'pati mbetur shtet i pavarur pos Turqisë, Iranit dhe Afganistanit. Këta dy të fundit kanë qenë gjysmëkoloni, kurse Turqia ka qenë në kërkim të identitetit të ri. Në një konstelacion të këtillë, si në debatet e Ali Abdurrazikut ashtu edhe në ato të Reshid Ridasë, më tepër flitet për përshtatjen ndaj gjendjes së re sesa për ringjalljen ose ripërtëritjen. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me botën islame. Është një periudhë kur edhe krishte-

rimi ka përjetuar krizë të thellë. Sepse në rendin ndërkombëtar feve ua kanë zënë vendin ideologjitë. Përveç kësaj, rendi kolonialist, kolonializmi anglez dhe francez, arritën ta kontrollojnë thuajse tërë botën. Ndërsa fetë janë dobësuar kundrejt ideologjive, edhe pellgjet joperëndimore si Kina dhe India kanë rëndë në shkallën më të ulët kundrejt Europës. Eurocentrizmi arriti kulmin e vet. Le të përmend këtu një kujtim interesant nga ajo kohë. Në vitin 1991, para se Hantingtoni ta shkruante artikullin "e famshëm", po vështroja në një librari të vjetër, që datonte nga koha e kolonializmit holandez. Ma tërhoqi vëmendjen një libër i shkruar në vitin 1926 dhe i ribotuar në vitin 1928. Një vepër që përbëhej prej përshtypjeve nga bota islame të një misionari të quajtur Basil Mathews dhe që titullohej *Young Islam on Trek: A Study in the Clash of Civilizations* (Islami i ri në ngritje: Një studim rreth përplasjes së qytetërimeve). Bota islame për të cilën flitet në këtë vepër është tërësisht nostalgjike, një botë e varfër dhe e prapambetur, që është në gjendje ta përqafojë krishterimin, një qytetërim që po jep frymë e fundit të rezistencës. Edhe Tojnbi, disa pjesë të veprës së vet *A Study of History* që kanë të bëjnë me botën islame, i ka shkruar në atë kohë.

Pas vitit 1948 - datë kjo shumë e rëndësishme për ShBA, Amerika në vend të kolonializmit anglez solli sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe kështu përhap idenë e shtetit kombëtar. Çdo shtet duke e formuar identitetin e vet, duhej që t'u kthehej referencave historike. Në periudhën e tretë, njëri prej shndërrimeve më të rëndësishme u përjetua në rastin e Pakistanit.

Për herë të parë u themelua një shtet islam me referenca islame. Shkëputja e Pakistanit prej Indisë dhe hindusëve ndodhi vetëm për shkak të dallimit fetar. Më pas u formuan edhe shumë shtete. Përnjëherë bota islame që numëronte 45 shtete, u shndërrua në një faktor që kontrollonte pikat më strategjike të botës. Nëse i shikoni hartat e asaj kohe të botës islame, do të vëreni një botë islame të ngjyrosur me të gjelbër që Afro-Eurazinë e ndan në dysh. Por, s' duhet harruar se bota islame e përbërë prej shumë shteteve ishte dukuri krejtësisht e re. Në këtë kohë është polemizuar rreth shtetit islam. Kur flitej për botën islame, nënkuptoheshin shtetet kombëtare të ndara mes vete, që konkurronin njëri-tjetrin. Në mesin e tyre mund të gjeje shtete socialiste, kapitaliste dhe shtete që kishin pëlqyer ndonjë formë tjetër të qeverisjes. Një botë islame që e kishte përjetuar ndarjen dyshe.

Në periudhën ose çerekun e katërt vërejmë një fenomen të ri, një gjë që është zhvilluar përmes globalizimit. Çdo shtet kombëtar i botës islame filloi të përjetonte probleme me Perëndimin. Arabët, për shkak të Jerusalemit dhe të Palestinës, kurse turqit për shkak të Qipros për herë të parë pas Luftës së Parë Botërore u ballafaquan me Perëndimin. Më pas Revolucioni Iranian dhe xihadi i filluar në Afganistan kundër Bashkimit Sovjetik. Në botën islame u shfaq një tendosje e re dhe u formua bindja se bota e jashtme po i përjashton myslimanët. Turqit i kaploi ndjenja e të qenët të përjashtuar për shkak të embargos amerikane pas rastit Qipro. Edhe arabët filluan të ndiejnë se janë të përjashtuar nga Perëndimi, të cilin e ushqenin me

naftë, kur ky filloi ta mbështeste Izraelin. Pakistani filloi të ndihej si i përjashtuar për shkak të Kashmirit, kurse Indonezia për shkak të Timorit Lindor. Në botën islame u përhap bindja se sistemi ndërkombëtar është kundër botës islame dhe zbaton standarde të dy llojeve. Lindi një reagim që edhe më tepër e ushqente reagimin e mëparshëm mbrojtës. Pas Luftës së Ftohtë ndryshoi koncepti bota islame. Sot kemi një tjetër botë islame. Që nga çereku i dytë, kur osmanllinjë u tërhoqën prej Ballkanit, bota islame tanimë ishte një botë Afro-Euraziatike e Afro-Aziate dhe vazhdimisht identifikohet me Afrikën dhe me Azinë. Ashtu si në një kohë kur flitej për Islamin nënkuptohej osmanlliu, në vitet 1960 kur përmendej Islami, menjëherë binte ndër mend Organizata për Shpëtimin e Palestinës, fotografitë e gueriljeve dhe përfytyrohej Azia e Afrika. Pas Luftës së Ftohtë përsëri u zgjua fytyra europiane dhe Euraziatike e Islamit. Islami europian në Bosnjë, në Kosovë, në Maqedoni, madje edhe në Azinë e Mesme, në Çeçeni. Alija Izetbegoviqi përbën shembullin tipik të këtij rigjallërimi, i cili me gjuhën europiane vazhdimisht u mundua ta tregonte praktikën e standardeve të dyfishta të Perëndimit. Nëse Izetbegoviqin e krahasojmë me Millosheviqin nga këndi i vlerave si liria, toleranca, barazia, të cilat Perëndimi mundohet t'i globalizojë e Fukujama i quan si pjesë të fundit të historisë, do të vërejmë se Izetbegoviqi i përfaqëson të gjitha këto vlera, kurse Millosheviqi antivlerat dhe gjërat që duhen hedhur jashtë historisë. Kjo kontradiktë filloi të dilte në pah atje dhe kjo prirje do të vazhdojë. Ky është ndryshimi i parë i rëndësishëm.

Ndryshimi i dytë i rëndësishëm do të shfaqet edhe më thukshëm pas kësaj ngjarjeje të terrorit. Islami tanimë nuk është një botë që mund të matet me kufij e as një botë që mund të frenohet. Më parë shteti osman përjetoj dekadencë, u tkurr e u tërhoq deri në Edrene. Bota islame fillonte prej këtij qyteti. Në etapën e shtetit kombëtar bota islame dhe shtetet anëtare të Konferencës Islamike fillonin prej aty e tutje. Por sot bota islame nuk mund të përcaktohet me kufij e as të frenohet. Qytetërimi islam është në zemër të Europës dhe të Amerikës. Ekziston një ndërveprim i vazhdueshëm, këtë duhet ta pranojë edhe bota islame, edhe Perëndimi. Në Sofje duke u folur për pakicat myslimane, u mundova të tregoja se bota islame deri në periudhën moderne nuk ka pasur probleme, as të drejtë të këtillë. Bota islame s'e ka diskutuar aspektin juridik të një bashkësie të madhe myslimane që jeton nën mbisundimin e jomuslimanëve. Ajo gjithherë ka zhvilluar një koncept të së drejtës në bazë të kushteve kur ka mbisunduar. Por sot myslimani amerikan, kur mbetet përballë me akuzën kolektive për shkak të terrorit ose të sulmit të kryer nga dikush tjetër, është i detyruar që ta pajtojë identitetin e vet prej amerikani me atë prej myslimani. Mendoni një çikë rreth psikologjisë së formuar nga ezani i kënduar me rastin e ceremonialit mortor të viktimave të terrorit. Ezani në qiellin amerikan, por i kënduar me një motiv tjetër. Këtu kemi të bëjmë me një koncept të botës islame të përkufizuar me komponentet kulturore e jo me përvijimet demografike. Edhe Perëndimi është i detyruar ta pranojë këtë. Myslimanët për herë të parë janë qenie shoqëro-

re kolektive në tokat ku nuk mbisundojnë myslimanët. Edhe Perëndimi për herë të parë në historinë e vet duhet të ballafaqohet dhe t'i pranojë jo vetëm myslimanët, por edhe kinezët e indianët. Bushi tanimë s'mund të thotë "Nuk ballafaqohem, s'pranoj!" Nëse shprehet ashtu, së pari duhet t'i qërojë hesapet me Kolin Pauellin. Dhe me shumë çështje të tjera që vijojnë.

Nëse krijojmë një lidhje mes globalizimit dhe rendit ndërkombëtar, mund të konstatojmë se Perëndimi po shfaq tri mënyra të reagimit, të cilat bota islame është e detyruar t'i shohë dhe t'i interpretojë. Ky reagim u përngjan reagimeve të kohës pas Aleksandrit të Madh. Në një çast pati dalë prej qytetit-shtet grek dhe pushtoi një hapësirë të madhe; nga struktura organike, drejt një sistemi më të madh, drejt një strukture mekanike. Prej filozofisë drejt rendit juridik. Janë shfaqur tre reaksione më të dalluara: Reagimi stoik. Domethënë, ta vësh rendin e ri në një sfond filozofik që do t'i japë atij kuptim. Reaksioni cinik: Të tërhiqesh në vetvete dhe në vend që të merresh me të vërtetën universale, të preokupohesh me pyetjen "Ç'është e vërteta ime vendore?" Reagimi i tretë është ai epikurean, që mundohet ta maksimizojë kënaqësinë individuale. Në fakt, nëse ideja për rendin e ri botëror shfrytëzohet në kuptimin e saj të vërtetë, paraqet një mënyrë pozitive të reagimit. Rendi i ri botëror është një reagim stoik: Të ndërtojmë një botë me parime të caktuara, të cilat do t'i shfrytëzojë në mënyrë të barabartë i gjithë njerëzimi. Reagimi cinik është i natyrës pasmoderne, i natyrës relativiste dhe e ngërthen në vete mbylljen në vetvete. Është më i afërt me të

vërtetën relative sesa me idenë e së vërtetës. Epikureanizmi nënkupton kulturën dhe shprehinë e konsumit. Globalizmin e shikon kështu: Sa më tepër që të përhapet koka-kola ose Mak Donaldi, aq më tepër degëzohet globalizmi. Ky është një reagim tipik epikurean. Nëse ideja për rendin e ri botëror me të vërtetë do të shndërrohet në një rend botëror, do t'i shijojë të gjitha këto forma të reagimit. Perëndimi duhet t'i shpëtojë egoizmit dhe egocentrizmit, kurse ne jemi të detyruar që historinë ta ndërtojmë përsëri. Dhe këtë histori duhet ta shndërrojmë në pjesë të historisë së njerëzimit. Jemi të detyruar që si myslimanë dhe si botë islame, si pasojë e kësaj "larjeje të hesapeve", të formojmë një sfond teorik, filozofik, ideor që do t'i kushtohet tërë njerëzimit dhe një gjuhë që do t'i shërbejë këtij sfondi. Nuk është me rëndësi që konceptet t'i ndërtojmë të jenë të kuptimta vetëm në botën tonë, duhen zhvilluar aq mirë, sa që të mund të reflektohen në tërë botë e jashtme.

Mahçupjan: Dhe në këtë drejtim nuk duhet pritur islamizimin e botës, por i duhet dhënë kontribut asaj, duhet vepruar në vijën e arritjes së një sinteze.

Davutogllu: Bota islame, madje edhe vetë Muhammedi (a.s.) kur ka hyrë në Medinë, e as myslimanët që kanë shkuar në ndonjë zonë, nuk kanë pritur që të gjithë njerëzit e atij nënqielli të bëhen myslimanë. Turmat e atyre hapësirave kanë kontribuar edhe si të krishterë, dhe si hebrenj.

Mahçupjan: Është shumë më me rëndësi të konstatohet se çka presin myslimanët e kohës sonë.

Davutogllu: Në të gjitha librat klasikë gjendet shprehja, se Zoti nuk i ndihmon një sundimtari mysliman të padrejtë dhe e ndihmon sunduesin jomysliman që vepron me drejtësi. Pse? Sepse drejtësia është parim themelor.

Bullaç: Mosbesimi mund të ketë jetë, kurse tirania jo.

Davutogllu: Mosbesimi ka gjasa që të përmirësohet, kurse dhuna dhe tirania ngjallin reagime më të qëndrueshme. Përvoja e Andaluzisë dhe e shtetit osman, që kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me Perëndimin, flet se myslimanët nuk kanë pritur që të gjithë njerëzit të bëheshin myslimanë. Le të japim një shembull më domethënës. Indonezia tash për tash është shteti me më shumë banorë myslimanë. Për islamizimin e Indonezisë nuk është bërë as një "tëk" i shpatës, s'është bërë asnjë betejë ose luftë. Islamizimi i këtij vendi nuk është bërë as me qëllime të ngjashme si ato të misionarëve perëndimorë. Atje kanë vajtur tregtarët, dijetarët dhe më pas mistikët myslimanë. Në Indonezi është realizuar një islamizim në kuadër të dinamizmit të jetës sociale, askush s'i ka bërë presion askujt.

Mahçupjan: Këto janë të vërteta. Por nëse i shikojmë shpresat dhe reagimet e tashme pas 11 shtatorit, demonstratat e hapura, gëzimin dhe gjuhën e shfrytëzuar në to, do të përfundojmë se të njëjtat gjëra nuk i kontribuojnë botës dhe të njëjta gjëra shtrojnë një qëndrim islam për hakmarrje ndaj një pjese të botës. Mendoj se këtu duhet të bëhet një larje e brendshme e hesapeve. Për shembull, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut tha shumë gjëra lidhur me rastin e

Partisë së Refahut, por më e rëndësishmja ishte ajo, se ndërsa disa njerëz po bënin kundërvajtje dhe thoshin gjëra me të cilat po e shkelnin ligjin, të tjerët nuk po lëviznin fare. Për këtë arsye u fitua përshtypja se ashtu mendonte tërë partia. Ka mundësi që për shkak të një pakice, duke u tejkaluar partia, të vuloset një bashkësi e madhe, një botë e tërë. Nga ana tjetër, ka një përparësi. Mendoj se tash pasmodernizmi është i dëmshëm për botën islame, por po asaj mund t'i sjellë edhe dobi të shumta. Sepse vlerat pasmoderne, si llojshmëria e pluralizmi dhe taktika e të jetuarit në mikrobotëra, në pikën e fundit shkojnë në favor të myslimanëve. Më parë flitej për një botë islame që s'i përshtatet modernizmit. Kjo ndoshta për arsye se bota islame modernizmin e identifikonte me shtetin kombëtar. Edhe unë jam i mendimit se fenomeni i shtetit kombëtar s'mund të bashkërendohet me Islamin. Mendoj se mossauesi i botës së shtetit kombëtar qëndron në nacionalizmin e paraqitur, nën të cilin janë shtypur edhe myslimanët. Nacionalizmi islam në fakt Islamin e shtrydhi si vlerë, si fe ose si një tërësi vlerash. Atë e zvogëloi shumë dhe e shndërroi në mjet. Në kohën e pasmodernizmit bota islame mund të shpëtojë prej nacionalizmit. Dhe atëherë ajo mund të shikohet si një botë tjetër dhe nga një kënd tjetër. Atëherë do të ketë mundësi për ringjalljen e prapaskenës kulturore dhe për shpëtimin nga kompleksi i të qenët i shtypur. S'duhet harruar se flasim për një gjë, që mund të ndodhë në saje të intelektualëve.

Davutogllu: Nëse kalohet në një proces gjakftoh-të, mendoj se jemi në pragun e një periudhe shumë

produktive. Kriza është shumë e madhe dhe sipas meje, sa më e madhe të jetë kriza, aq më të forta janë edhe reagimet ndaj saj. Duke menduar në këtë mënyrë, ndoshta mund të ndërlihdemi edhe me Turqinë, e cila është e detyruar të ballafaqohet me problemet që i ka sjellë zgjerimi i qytetërimit perëndimor dhe të bëjë llogarinë e vet të brendshme. Këto gjëra duhet t'i bëjë edhe qytetërimi islam, duhet t'i diskutojë të gjitha këto probleme. Këtë do ta bëjnë edhe pellgjet e tjera qytetërimore. Janë të detyruara t'i nxjerrin shembujt e gjallë të kësaj problematike. Unë çështjen e shikoj nga një kënd më optimist. Kontributi i mëvonshëm do të dalë nga ndërveprimi mes vlerave universale dhe atyre vendore. Aty e tutje kulturat dhe qytetërimet që janë pjesë e historisë do të japin produkte universale dhe nuk do ta humbin dimensionin e universalitetit.

Në këtë çështje, mendoj se qytetërimi islam ka gjasa shumë të mira dhe mund të gjejë një rrugëdalje fatlume. Në një kongres në të cilin u shtrua pyetja "Përplasja ose dialogu mes qytetërimeve", e thashë këtë dhe një perëndimor m'u drejtua kështu: "Si mund të jeni kaq të sigurt? Edhe ju vini prej një vendi të çarë, shprehur me fjalët e Hantingtonit, prej një *torn country*?" Unë u përgjigja se mendjet më të ndritura lindin në periudhat e krizave më të mëdha. Rusoi dhe Hobsi janë shfaqur në periudhat e luftërave civile në Angli dhe Francë, kurse Hegeli dhe Kanti në kohën e përçarjes së Gjermanisë. Duke u nisur prej kësaj, mund të themi se në vendet ku po përjetohen kriza, do të shfaqen horizonte të reja. Kjo përlllogaritje duhet bërë doemos. Por gjatë këtij procesi është me rëndësi vendi

ku qëndrojmë. Nëse një njeri e përjeton në vetvete problemin e identitetit dhe nëse nuk i ka rënë në të fazës historike në të cilën po jeton, s'mund të kuptojë diçka tjetër dhe s'mund të japë kontribut të mirëfilltë.

Bota islame deri më tani ka qenë një gjeografi, në të cilën kanë menduar njerëzit që s'kanë pasur koncept për pozitën e vet. Një hapësirë në të cilën sot mund të paraqitet një hop dhe zgjidhje e njerëzve që e kërkojnë vendin e vet, që nuk dyshojnë në vetvete, që s'ndihen fajtorë për vetëbesimin që kanë, që s'ndiejnë nevojë të zhvillojnë një ligjëratë apologjetike, që shprehen kështu: "Unë jam ky që jam dhe jam i kënaqur. Jam i kënaqur me veten dhe me botën në të cilën po jetoj. S'kam ndonjë qëllim për përjashtim të dikujt. Por, në rast se dikush dëshiron të më përjashtojë, jam i detyruar ta tregoj vetveten. Ka diçka që dua ta them. E kam formuar edhe sfondin teorik të saj. E kam dhe bazën historike për të thënë një gjë të tillë". Bota islame këtë hop nuk duhet ta bëjë vetëm në aspektin intelektual, por edhe në atë të insitucionalizimit ekonomik e politik. Është me rëndësi të dihet se po hyjmë në një periudhë shumë produktive, shumë të gjallë, e cila nga prizmi i ndryshimeve në Turqi mund të jetë shumë produktive, nëse përjetohej duke i kuptuar gjërat dhe pa përjashtuar dikën.

*Kriza globale dhe Turqia**

Mahçupjan: Në pjesën e parë të bisedës u morëm me Perëndimin, në të dytën me Lindjen, me botën islame, dhe Turqinë e prekëm vetëm sipërfaqësisht duke folur për amullinë dhe ngushtësinë e saj mes dy botëve. Në mënyrë interesante të dy botët i përkufizua si skizofrenike. Tash kemi përpara pyetjen sesa mund të jemi të shëndoshë në mesin e këtyre botëve skizofrenike. Por, gjendjen tonë ne ia paraqesim vetes duke e zbukuruar. Themi se jemi një urë mes Perëndimit dhe botës islame. Por në kokë vazhdimisht më silllet pyetja, sesa është i vërtetë ky pohim. Sepse shikuar nga Lindja, Turqia është shtet perëndimor, por nëse e shikojmë nga Perëndimi, nuk duket si i tillë. Nëse Turqia shikohet nga Perëndimi, fitojmë përshtypjen se është shtet mysliman, por nëse e shikojmë nga Lindja nuk na del si shtet gjithaq mysliman. Pra, mund të themi se bëhet fjalë për një shtet perëndimor dhe mysliman, por ndoshta nuk është as perëndimor e as mysliman. Mendoj se kjo pozitë e Turqisë e vë atë në telashe të perspektivës, krijon ngushtim të perspektivës. Turqia disa gjëra në të njëjtën kohë edhe i do, edhe s'i do. Njëra prej tyre është Bashkësia Europiane. Më duket se si shoqëri nuk jemi duke diskutuar sa duhet rreth asaj, se çka duam dhe çka nuk

* *Düşünce Ekseni*, STV, 3 tetor 2001

duam. Nëse nisemi prej kësaj, përfundojmë se Turqia e ka vështirë të futet brenda disa attributeve. Është shumë vështirë të thuhet se Turqia është një vend i këtillë ose i atillë. Dua që debatin ta fillojmë me këtë pyetje: Me çfarë atributesh mund ta shpjegoni dhe ta përkufizoni këtë vend?

Davutogllu: Keni prekur një çështje mjaft interesante. Kjo ka qenë pika të cilën e kam trajtuar kryq e tërthor në librin tim të fundit. Pas Luftës së Ftohtë Turqia është përkufizuar me dy përcaktime të skajshme: Nga njëra anë, si një vend i përçarë mes dy botëve, si një shtet që s'e ka gjetur pozitën e vet, si një shtet që ka telashe me identitetin e vet. Nga ana tjetër, strategjistët e ndryshëm, në veçanti strategjia amerikane e ka përkufizuar atë si bosht të rëndësishëm, si një *pivot state* (shtet strumbullar). Duke shkruar vepërën *Thellësia strategjike* që flet për pozitën ndërkombëtare të Turqisë, më mundonte pyetja sesi mund të përkufizohet Turqia dhe arrita në përfundimin se pas Luftës së Ftohtë asnjëri prej këtyre përkufizimeve koniunkturale nuk është i mjaftueshëm. Unë mendoj se Turqia një shekull më vonë më së miri mund të përkujtohet dhe të përkufizohet përmes atributit *ile thellë*, i cili tek ne gjithmonë shoqërohet me diçka negative. Por Turqia, edhe në aspektin gjeografik, edhe në atë historik, është një shtet i thellë. Kjo thellësi e sjell me vete edhe copëzimin. Pra, sikur Turqia të mos ishte një vend me thellësi historike dhe gjeografike, sikur të ishte një shtet homogjen, ndoshta nuk do ta përjetonte këtë përçarje. Për shembull, sikur të ishte një Zvicër në kuptimin pozitiv ose një Ugandë në atë negativ,

mund të ishte vend më koheziv. Nëse ekziston përçarja, kjo në fakt ka kuptimin e përçarjes së tërësisë. E dyta, është një shtet i thellë edhe historikisht. Hapësira gjeografike e Turqisë është një zonë, në të cilën janë formuar arteriet kryesore të historisë së njerëzimit. Gjendja jonë i përngjan asaj të mbetjes së Romës periferi pas rënies së Perandorisë Romake dhe vuajtjeve të saj. I përngjan edhe shembullit të Greqisë, e cila një kohë të gjatë mbeti periferi edhe pse në botën helene ishte qendër. Turqia mbetet një vend edhe i ndarë, edhe strumbullar, për shkak të thellësisë së saj historike dhe gjeografike. Pamundësia për të përcaktuar diçka përreth Turqisë pa e marrë në konsideratë këtë vend, e bën atë shtet kyç. S'mund të shkruani për Ballkanin, për Kaukazin, për Lindjen e Mesme, pa e njohur historinë turke ose osmane. Historia serbe s'mund të shkruhet pa historinë osmane, pa marrë parasysh se serbët osmanllin e perceptojnë si armik. S'mund të shkruhet historia e Kaukazit, e Azisë dhe e Eurazisë. Është kjo një histori kaq e thellë. Nga ana tjetër, lidhur me thellësinë e kësaj historie mund të tregojmë edhe gjëra të këtilla interesante: Edreneja dhe Shkupi asnjëherë në histori s'kanë qenë kaq të huaj për njëri-tjetrin. Urfa dhe Halebi asnjëherë s'kanë qenë kaq larg njëri-tjetrit. Me qebapët dhe me të gjitha gjërat janë të njëjta, por njerëzit s'mund të shkojnë prej njërit në tjetrin qytet. S'shënohet ndonjë marrëdhënie kulturore mes Urfës dhe Halebit. Gjatë udhëtimit tim të fundit në lindje të Turqisë shkova deri në Harran, qendër kjo e shkëlqyeshme. Por sot kjo qendër është në skajin e Turqisë dhe është lënë pas dore.

Kurse në kohën osmane ky qytet ishte diçka tjetër. Batumi dhe Trabzoni asnjëherë në histori - viteve të fundit diçka ka ndryshuar - nuk kanë qenë kaq të shkëputur mes vete. Trabzoni dhe Konstanca asnjëherë s'kanë qenë kaq të ndarë. Shikuar nga ky kënd, mund të thuhet se ka një shkëputje dhe në themelin e problemeve tona vërehet një thellësi, që është pasojë e kësaj shkëputjeje. Librin tim e titullova *Thellësia strategjike* për arsye se përmban vetëbesimin. Jam munduar që ta kuptoj thellësinë gjeografike e historike të Turqisë dhe Turqinë e thellë. Shprehja Turqia e thellë nuk ka kuptimin e thellësisë së shtetit kombëtar, por edhe të thellësisë së mbamendjes kulturore, të thellësisë ekonomike e politike. Pak më vonë ndoshta do të flasim për rendin ndërkombëtar, për problemet rajonale. Për shembull, pellgu i Mesopotamisë është thellësi jona, që sot është përçarë. Thellësia e këtyre kulturore e Stambollit shtrihet deri në Bosnjë, por sot hapësira përtej Edrenesë përkapet si një pellg kulturor tjetër. Ne jemi të detyruar që të ballafaqohemi me këto probleme. Me të vërtetë është shumë me rëndësi, që të bëhet përkufizimi dhe të gjenden atributet e vërteta. Sot problem shumë më i mprehtë sesa në çdo periudhë tjetër të historisë është gjetja e atributit që nuk sjell restriksione dhe përkufizimi i drejtë i gjendjes.

Bullaç: Turqia duhet shikuar nga kjo thellësi historike. Le të vijmë pak edhe te aktualiteti dhe le të përpiqemi që këtë koniunkturë aktuale ta shikojmë nga thellësia historike, le të mundohemi që t'i japim asaj një domethënie. Më 11 shtator ndodhi sulmi. ShBA pas disa orëve këtë sulm e përkufizuan si luftë.

Këtu ka një pështjellim. A thua bëhet fjalë për një akt terrorist ose për luftë? Kur veprimi terrorist mund të cilësohet si luftë? Dhe shpallja e luftës a mund të arsyetohet me një akt terrorist? Turqia dhe vendet e NATO-s nuk ndërhyjnë gjithaq. Më pas hyri në fuqi neni i pestë i NATO-s, që është mjaft me rëndësi për Turqinë. Le ta lexojmë: "Aleatët e NATO-s sulmin e ushtarak ndaj një vendi të Europës ose të Amerikës Veriore e konsiderojnë si sulm ndaj të gjitha vendeve anëtare të NATO-s". A thua në këtë rast kemi sulm të armatosur? A thua armiku i jashtëm ka sulmuar një shtet ose një grup ushtarak me pushkë, me top, me tanke ose me armë bërthamore? Pse u vu në funksion neni i pestë? Turqia kundërshtoi ca në këtë drejtim. Ndoshta me qëllim janë zgjedhur aktorë të këtillë. Sepse Turqia njëmbëdhjetë vite më parë pat qenë e sulmuar dhe këtë sulm e pati cilësuar si "luftë e intensitetit të ulët". Dhe brenda njëmbëdhjetë viteve humbën jetën 30 mijë njerëz.. Më vonë dolën në shesh vendet që kishin pasur gisht në këtë luftë: Siria, Libani, Italia, Greqia, në një mënyrë edhe Gjermania, Franca, madje edhe Holanda. Komandanti i njësisit ushtarak të Egjeut, insistonte që të provohej se bëhej fjalë për një sulm armiqësor nga jashtë. Turqia është në një gjendje të këtillë. Nga njëra anë Afganistani dhe nga ana tjetër përvoja e vet nga lufta e intensitetit të ulët. S'duhet harruar se ndërkohë është edhe anëtare e NATO-s. Turqia në aspektin gjeografik është larg, por në aspektin njerëzor, kulturor dhe historik nuk është shumë larg. Gjatë Luftës Çlirimtare, gratë myslimane afgane dhe ato të gadishullit indian i patën dhuruar

bylyzykët dhe vathët e tyre për t'u ndihmuar vëllëzërve myslimanë turq. Nëse çështjen e shikojmë prej kësaj thellësie historike dhe prizmit të koniunkturës aktuale, shtrohet pyetja nëse Turqia gjendet në një konfuzion konjitiv.

Davutogllu: Të qenët në gjendje të konfuzionit konjitiv, të qenët në gjendje pështjellimi nuk është gjendje e re. Duhet që kësaj gjendjeje pjesërisht t'i jemi përshtatur. Ndoshta s'është një gjë shumë e keqe. Shpeshherë ndodh që të mendoni se çdo gjë mund ta shpjegoni fije për fije dhe shkëlqyeshëm e në fakt të mashtroheni. Është gjë e kuptueshme që mendja vazhdimisht të jetë e kthjellët karshi problemeve komplekse si ato të kohës sonë. Ajo që s'mund të kuptohet është hyrja në këtë periudhë si i papërgatitur. Inteligjencia dhe politikanët turq ende nuk i janë përshtatur koniunkturës së re të krijuar pas Luftës së Ftohtë. Për ta diskutuar dhe për ta vlerësuar pozitën e Turqisë në kuadër të koniunkturës ndërkombëtare pas rastit të 11 shtatorit dhe të globalizimit duhet që të nisemi nga një kornizë më e gjerë. Në historinë moderne pas çdo lufte është bërë marrëveshje, por pas Luftës së Ftohtë s'është arritur kurrfarë marrëveshjeje. Në këtë kontekst gjendja e Turqisë është shumë interesante. Turqia është munduar që pas çdo lufte, e cila e prek rendin ndërkombëtar, t'u përshtatet kushteve të reja. Edhe shteti osman është përpjekur që t'u përshtatet ndryshimeve nga arena ndërkombëtare në saje të ndryshimeve të bëra në vetvete. Pas Luftërave Tridhjetëvjeçare u nënshkrua Marrëveshja e Vestfalisë dhe në Europë u vendos një rend i ri. Në atë kohë

shteti osman ka pasur një vetëbesim të fortë. E pasonte Perëndimin por gjithherë nga një distancë e caktuar. Shteti osman, pas Vestfalisë filloi të realizojë një restaurim të madh, restaurimin e Kuprylysë. Nga njëra anë, sistemi osman i milletit dhe nga ana tjetër formësimi sipas procesit të shtetit kombëtar. Osmanlliu mundohej që ta mbante sistemin e vet në saje të reformave të Muratit IV, të Kuprylysë, të Periudhës së Tulipanit dhe reagonte ndaj ndryshimeve që ndodhnin jashtë. Ndoshta kështu ia mundësonte vetes që ta vazhdonte jetën edhe për një shekull. Vlerave që i solli Revolucioni Francez, koniunkturës ndërkombëtare të formuar në Kongresin e Vjenës të mbajtur më 1918 pas Luftërave të Napoleonit dhe sistemit europian, mundohej t'u përshtatej përmes transformimeve përmbledhëse të Tanzimatit. Nënshkroi marrëveshje tregtare me Anglinë. Atëbotë u formuan institucione të reja. Në aspektin politik u shpall Tanzimati. Në krye të vendeve joeuropiane dhe atyre sistemike që iu përshtatën Bashkësisë së Kombeve të formuar pas Luftës së Parë Botërore është Turqia. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas Luftës së Ftohtë prapë e shfaqti reagimin e vet dhe kaloi në demokraci.

Turqia pas Luftës së Ftohtë po përballet shumë më fuqishëm se më parë me problemin e përkufizimit të vetvetes dhe të përshtatjes kushteve të reja, po përjeton një ngatërresë të madhe. Është e diskutueshme madje sesa jemi të gatshëm mendërisht dhe institucionalisht që të përfshihemi në rrethanat e reja. Janë tre parametra të dalë në skenë në kuadër të rrethanave të reja që kërkojnë ballafaqim serioz.

1. Pas Luftës së Ftohtë është përjetuar një përçarje gjeopolitike, kanë lindur fusha të boshllëkut gjeopolitik, është përjetuar përçarje statike, është shkatërruar struktura dyshe. Të gjitha këto ndryshime e kanë përfshirë Ballkanin, Kaukazin, Azinë e Mesme dhe pjesërisht Lindjen e Mesme, zona këto fqinje të Turqisë. Është e dobishme që përsëri të theksohet se edhe Turqia në aspektin gjeopolitik është vend i përçarë. Këtë e them në kuptimin se Mesopotamia asnjëherë gjatë historisë nuk ka qenë kaq e ndarë sa sot. Në asnjë periudhë të historisë s'ka ekzistuar kufiri i sotëm i Irakut. Në raportet mes shtetit osman dhe Iranit, ose Irani forcohej tepër dhe arrinte deri në Diyarbakër, ose osmanlliu në saje të fuqisë që kishte ia dilte të arrinte deri në Basrë. Kjo ka qenë kështu edhe në marrëdhëniet mes Bizantit e sasanitëve dhe në mes sumerëve e akadëve. Mesopotamia përbën një tërësi. Vetë ka përjetuar përçarje dhe si shtojcë e kësaj edhe sot në koniunkturën ndërkombëtare po përjetohet përsëri përçarje. Gjatë udhëtimit tim në Bullgari pashë se në Trakinë Lindore ka një fushë që shtrihet prej Filibes (Plovdivit) e këndeje, tërësi kjo që është copëtuar në mënyrë artificiale. Ngjashëm me këtë, edhe hapësira mes bjeshkëve të Erzurumit dhe Kaukazit verior kërkon një ripërcaktim.

2. Forcat botërore të globalizimit po thyejnë kokën për shkak të ndarjes ekonomike dhe politike. Çështja e shfrytëzimit të minierave të virgjra të Azisë së Mesme, hapësira të reja për shtetet e NAFTA-s, të Bashkësisë Europiane, të shteteve të Azisë Lindore, Bashkësisë së Shteteve të Pavarura. Ashtu si pas Luftës së Dytë Botë-

rore burimet e virgjra të Lindjes së Mesme kanë shkaktuar problemin e ndarjes së tyre mes shteteve arabe, me probleme të njëjta mund të përballen edhe republikat e Azisë së Mesme. Çdo krizë e Azisë së Mesme më tepër pasqyrohet në Turqi sesa te bota arabe. Turqia po përjeton një përçarje ekonomiko-politike. Ajo është seriozisht e shtrënguar për shkak të ujërave të Anadollit Lindor, për shkak të linjës Baku-Xhejhan dhe të problemeve në Detin Egje etj.

Edhe kjo duhet të përkufizohet. Një gjë që do të ketë ndikim më gjatë është ballafaqimi gjeokulturor. Dhe Turqia është në qendër të tij. Në marrëdhëniet mes qytetërimeve po shënohet një llojshmëri gjeokulturore dhe ngritje e qytetërimeve klasike. Turqia është duke e përjetuar një përçarje gjeokulturore. Ka një strukturë që në vete i ngërthen të gjitha elementet njerëzore të rajonit, si bosnjakët, shqiptarët etj.

Bullaç: Gjeografia kulturore dhe humane po përhapet në tërë rajonin. Por gjeografia politike...

Davutogllu: Po. Ajo është e kufizuar me gjeografinë politike. Por gjeografia kulturore dhe ajo ekonomiko-politike janë shumë më të thella. S'ka mundësi të shkëputet prej këtyre fushave problematike. Turqia, si në raportet me ShBA dhe NATO-n, ashtu edhe në rastin e ndërhyrjes në Afganistan, s'po mendon rreth këtij dimensionit dhe s'i vlerëson sa duhet këto thellësi. Turqia ka një kujtesë jashtë arsyeve të NATO-s që tash po ngjallet. Shumë gjëra dalin si pasojë e reflekseve reciproke. Dhe ky përkufizim mbeti ballë për ballë me të gjitha problemet. Problemi kyç këtu është elementi njerëzor, elita e cila do ta vërë në lëvizje fu-

qinë ndërkombëtare të shoqërisë në të tria dimensionet. A thua kemi elitë strategjiste që do ta përkufizojë koniunkturën e re dhe që do ta kuptimësojë përçarjen gjeostrategjike? A kemi elitë afariste që do të interpretojë dhe do ta vërë në lëvizje ekonominë tonë politike, që do ta kuptimësojë pozitën e Turqisë në kuadër të koniunkturës së re? Të gjitha këto janë pyetje jetike për Turqinë. Ndaj të tjerave që janë më pak të rëndësishme mund të bëhen edhe reagime të çastit. Amerika ka një politikë të caktuar ndaj Afganistanit, por kjo nuk i zgjidh problemet e Turqisë.

Bullaç: Nëse ka mundësi, të vazhdoj me pyetjen time. Turqia është shtet anëtar i NATO-s, gjë që është një avantazh, por ç'e do që këtë avantazh s'është duke e shfrytëzuar sa duhet. Të qenët e Turqisë anëtar i NATO-s i mundëson asaj që dëmtimet t'i ketë minimale dhe të jetë trajtuar me më tepër butësi e përdëllim. Edhe unë ndaj mendimin tuaj. Pas luftës, ose thënë më drejt, pas operacionit të madh mund të krijohet një tryezë e re e kontraktimit. Por në të Turqia s'ka vend të qartë. S'ka karrigen e vet. Le ta shikojmë Rusinë, njëri prej vendeve që kanë përfituar më shumë nga kjo ngjarje. Ka dalë si një prej vendeve të çmuara të bashkësisë ndërkombëtare. Madje dëshiron të jetë edhe anëtar i NATO-s. Sikur edhe të mos anëtarësohet në NATO, dëshiron të ketë hise në mekanizmat vendosës sa një shtet antar i NATO-s. Pika e tretë me rëndësi është ajo, se Turqia provoi se ka ndikim të madh mbi republikat turke të ish-BRSS, mbi republikat e Azisë së Mesme. Në këtë drejtim ka dalë me fitim. Le të ndalemi te Irani! Edhe pse ka një pozitë

shumë të ndryshme, dhe ky vend nga ngjarja në fjalë doli fitimtar. Edhe vetë pranon se e ka ndihmuar Aleancën Veriatlantike. Dhe ndoshta do të marrë pjesë në tavolinën e ndarjes së presë. Sot ose nesër, operacioni do të fillojë. Le t'i përkujtojmë vendet të cilat i vizitoi ministri i mbrojtjes i ShBA: Egjipti, Omani, Pakistani dhe Uzbekistani. Në këtë sërë s'është Turqia. Si mund të shpjegohet kjo? A thua do të zvarritet pas ngjarjeve dhe do të kënaqet me vendin që do t'i ndahet asaj, apo do të ndër marrë politike më aktive. A nuk duhej që në bazë të një perspektive më afatgjate të zhvillojë një strategji të veten?

Davutogllu: S'ka dyshim se po, duhej. Ky është tregues se i kemi humbur dy vitet e fundit. Tregon se në periudhën pas Luftës së Ftohtë s'kemi hyrë siç duhet, s'iu kemi përshtatur dinamikës së kërkuar. Nëse i krahasojmë Turqinë, Rusinë dhe Iranin, në veçanti duhet të bëjmë krahasim të shëndoshë me Rusinë. Turqia është pjesë e Bllokut Perëndimor. Në mënyrë të domosdoshme nënkuptohet se ta bindësh Turqinë, e cila është pjesë e NATO-s, gjegjësisht e mekanizmit, nuk është sikur të mundohesh ta bindësh Egjiptin, Omanin ose Pakistanin. Meqenëse Turqia trajtohet si pjesë përbërëse e tavolinës së Aleancës Veriatlantike, ShBA nuk ndiejnë nevojë që ta bindin këtë vend lidhur me bazat e Inxhirlikut.

Mahçupjan: Jemi perëndimorë, por sipas Bullaçit nuk jemi gjithaq perëndimorë.

Marrëdhëniet NATO-Turqi

Davutogllu: Nëse gjendjes aktuale i qasemi pa e përkapur thellë, por vetëm mekanikisht, do të pohojmë se Turqia si vend i NATO-s është pjesë e mekanizmit. Nëse bisedoni me një amerikan lidhur me Turqinë, do t'ju thotë: "Turqia është një nga aleatët tanë dhe ajo po lufton në kuadër të NATO-s. Kemi institucione e baza të përbashkëta dhe s'kemi nevojë për përpjekje të veçantë lidhur me të". Rusia ndonëse është aktor i jashtëm, ka nevojë për pjesëmarrje në këtë proces.

Bullaç: Por formacioni i NATO-s për herë të parë po përdoret kundër një vendi islamik.

Davutogllu: Do të vijmë edhe atje. Shikuar mekanikisht, ashtu është. Por nëse ndalemi te dimensionet psikologjik, social dhe kulturor, do të shohim se marrëdhëniet mes Turqisë dhe Perëndimit ngërthejnë në vete një dilemë interesante. Kjo është çështje që ka të bëjë me përkufizimin e Turqisë. Turqia është shtet që nuk zë vend qendror në sistemin e Perëndimit. Me shprehjen vend qendror në sistemin e Perëndimit nënkuptojmë shtete qendrore, që në shekullin XIX kanë themeluar perandori koloniale ose si ShBA, që e kanë marrë stafetën prej këtyre perandorive. Turqia nuk është njëri prej këtyre vendeve. Madje edhe Rusia, shikuar nga aspekti i diplomacisë së shekullit XIX, bën pjesë në mesin e vendeve qendrore. Turqia jo që s'është vend qendror, por s'është as vend i kolonizuar nga perandoritë koloniale. Është shtet që gjatë histori-

së, qysh nga shteti osman, është ballafaquar me këto vende. Për këtë arsye, Turqia në perceptimet e perëndimorit gjithmonë zë vend në kuadër të këtyre dilemave. Nuk shikohet si Algjeria apo Pakistani si shtete të kolonizuara, por nuk trajtohet as si vend i qendrës së sistemit. Me shekuj të tërë po shënohet sfida dykahëshe në këto marrëdhënie.

Mahçupjan: Domethënë nuk shikohet as si vend mysliman.

Davutogllu: Në atë aspekt, po, nuk shikohet se i tillë. Në aspektin mekanik është brenda sistemit, kurse si perceptim s'ka dyshim se është jashtë sistemit. Pra është shtet të cilit s'i jepet vend në tavolinën e ndarjes së hiseve, në kuadër të BE-së, por në tavolinën strategjike, në NATO.

Bullaç: Dua të jap një shembull pikërisht lidhur me këtë çështje. Në vitin 1987 në kuadër të NATO-s lindi një polemikë. Komandanti i aleatëve europianë të NATO-s shtroi këtë pyetje: "Nëse Bashkimi Sovjetik edhe një herë hyn në Anadollin Lindor, a thua shtetet e NATO-s do të dërgojnë ushtarë për ta mbrojtur Turqinë? Kam dyshime të mëdha në veçanti lidhur me shtetet e veriut". Atëbotë u zhvilluan debate të shumta. Në opinionin europian mbisundoi mendimi se nëse BRSS e sulmonte Turqinë, ushtarët europianë s'do të dërgoheshin në mbrojtje të këtij vendi anëtar i NATO-s. Domethënë një perceptim i tillë nuk mbizotëron vetëm në Turqi, por edhe në Perëndim.

Davutogllu: Po. Unë, kur për herë të parë në tekstet dhe në hartat e NATO-s hasa në një shprehje, u zemërova shumë. Në të vërtetë, shumë turq e kanë

ndier të njëjtën gjë. Në hartat e NATO-s Turqia përmendet si "Turkish Barrier". Barrierë ndaj kujt? Ne jemi trajtuar si hapësirë barrierë ndaj zgjerimit sovjetik. Për shumë europianë kontributi më i madh i Turqisë në atë kohë për Europën është tërheqja e shtypjes ruse prej Europës në Anadollin lindor e në Kaukaz dhe pakësimi i kësaj shtypjeje. Këtu kemi të bëjmë me një qasje mekanike. Por e njëjta Europë, e cila i ka dhënë rëndësi kaq të madhe Turqisë duke e cilësuar atë si barrierë, vazhdimisht e ka konsideruar Turqinë si palë kundërshtare si në çështjen e Qipros, ashtu edhe në shumë çështje të tjera. Por duhet pasur parasysh se edhe te turqit është zhvilluar ndjenja për "palën kundërshtare". Madje dhe te intelektualët turq që perëndimorizimin e kanë pasur si qëllim ideologjik më të lartë, ka jetuar një osmanli i fshehtë. Shpesh po e përmend shembullin në vijim. Kryetitulli i një gazete një ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Doganës në vitin 1995 ishte ky: "U realizua ëndrra shekullore. Turqia tanimë është pjesë e Europës!" Në faqen e fundit të së njëjtës gazete, lidhur me fitoren e Gallatasarajit ndaj një ekipi europian, hasa në titullin "Europë, Europë dëgjoje zërin e shputave tona!" Sikur të bëhej fjalë për ngadhënjimin ndaj një ekipi aziatik s'do të thuhej fare "Azi, Azi dëgjoje zërin e shputave tona!"

Bullaç: Tek ne mbisundon psikologjia se Azinë mund ta fitojmë.

Davutogllu: Turku e sheh Europën si palë ndaj së cilës duhet korrur fitore. Kjo psikologji ekziston edhe te pala tjetër, pra është reciproke dhe krijon tendosje.

Në Europë më tepër shkakton paqëndrueshmëri sesa tendosje, kurse tek ne tendosje. Një vend që dikur ka qenë qendër, një shoqëri që ka pasur peshë gjatë historisë, s'mund të pranojë të jetë periferi. Madje edhe nëse pëson disfatë. Ju s'mund ta bindni japonezin të jetë periferi. Madje edhe në kohën kur u përjetua katastrofa e Hiroshimës dhe e Nagasakit, japonezët s'ndiheshin të shokuar. Shok përjetuan kur dëgjuan zërin e perandorit, sepse dëgjimi i zërit të tij është një zhvillim interesant po aq sa bomba atomike. Kjo për arsye se japonezi veten e percepton si të kuptimtë në histori. Thellësinë tonë historike s'e përkufizoj si nacionalizëm etnik. Ne kemi një të kaluar që jeton në të gjitha hapësirat gjeografike, ku rrjedh historia antike, një të kaluar në të cilën në të njëjtat hapësira është bërë sinteza e fundit e madhe. Në kuadër të kësaj sinteze gjendet edhe tradita sirianite, tradita mesopotamase, ajo ortodokse etj. Në këtë vijë hasim edhe traditën selxhuke, atë greke, por edhe atë osmane që i ka bashkuar të gjitha të lartpërmendurat. Krahasimi mes shtetit osman dhe Perëndimit nuk i përngjan krahasimit të dy shteteve kombëtare.

Bullaç: Madje edhe Europa Lindore përcaktohet si pellg kulturor osman.

Davutogllu: Gjithsesi. Në Kongresin e Ballkanit bëra një përkufizim të këtillë. Ballkani gjithmonë gjatë historisë ka qenë periferi. Periferi e Romës ose e Bizantit. Ballkani ka qenë qendër vetëm në periudhën osmane, kur botën e kanë udhëhequr njerëzit me prejardhje shqiptare, bosnjake, serbe... Këtu s'kam për qëllim që t'ia rris namin shtetit osman. Në fakt s'duhet ha-

rruar se ekziston një kujtesë e këtillë historike. Në emisionin e kaluar, duke shpjeguar tendosjen psikologjike të botës islame, theksuam se Kur'ani dhe historia flasin se jemi superiorë, por realiteti është ndryshe. Ne këtë e ndiejmë thellë në vetvete. Le t'u kthehemi pyetjeve të zotëri Etjenit: Në cilin grup të shteteve bën pjesë Turqia? Me kë mund ta krahasojmë atë? Politikanët tanë "të mëdhenj", për të treguar se Turqia ka përparuar shumë, e krahasojnë me shumë shtete dhe thuhet "jemi në gjendje shumë të mirë".

Bullaç: Turqia më së shumti është krahasuar me Ugandën dhe është pohuar se jemi në pozitë më të mirë se ky vend afrikan.

Davutogllu: Po. Krahasohet me këto shtete dhe na del para një tablo, se jemi relativisht mirë. Në bazë të problemeve që ka, mendoj se Turqia mund të krahasohet me tetë vende. Ato janë shtetet që nga shekulli XIX në shekullin XX kanë hyrë me përmasa të mëdha: Anglia, Franca, Perandoria Austro-Hungareze, Perandoria Gjermane, Perandoria Ruse, Kina, Japonia dhe ShBA. Ne po i përjetojmë me Lindjen e Mesme problemet të cilat gjermanët i kanë me Europën Lindore dhe japonezët me Azinë Lindore. Ashtu si anglezët shfaqin interesim për Pakistanin dhe Indinë, për pellgun indian, ne mund të ndiejmë ndaj Polonisë. Pse? Sepse i kemi kaluar kufijtë tanë, lagjja e Lalëlisë në Stamboll është përplot reklama sllave ose arabe. Sepse Stambolli çdo herë ka qenë qytet qendror i Europës Lindore dhe i Ballkanit. Dhe kur Turqia hapet ndaj botës së jashtme, aktualizohet me këto veçori të vetat. Problemet e Turqisë dhe të vendeve të për-

mendura janë të krahasueshme. Të gjitha këto vende, me përjashtim të Austro-Hungarisë, janë aktorë të rëndësishëm të sistemit dhe mund të krijojnë lidhje mes gjendjes së tyre reale dhe asaj historike. Kam bërë një studim lidhur me transformimin strategjik të mendësisë gjermane. Shembull mjaft interesant, sot në çdo vend ku kanë hyrë tankset e Hitlerit shfrytëzohet marka gjermane. Gjermani mund të krijojë lidhje mes gjendjes reale dhe kujtesës historike për arsye se ka arritur të forcohet ekonomikisht. Ose japonezët... Në Luftën e Dytë Botërore, në çdo liman në të cilin kanë zbarkuar anijet japoneze sot mbizotëron modeli ekonomik japonez dhe japonezët kanë lidhje të mira me ato vende. Problemi i Turqisë është ky: Nga njëra anë, është e detyruar të mbetet brenda përkufizimit të shtetit kombëtar, e nga ana tjetër, globalizmi dhe domosdoshmëritë gjeopolitike dhe ekonomike e nxjerrin atë jashtë kufijve të saj, s'e lënë të rrijë në vend. Ndërsa kur del jashtë, fuqia reale që zotëron nuk e lejon që thellësinë historike ta shndërrojë në strategji optimale. Kontradikta serioze përjeton edhe në vetvete. Sipas meje, pas Luftës së Ftohtë janë të rëndësishme tre dimensione, që e tejkalojnë edhe përçarjen tonë: 1. Vetëbesimi. Tash për shkak të krizës ekonomike dhe politike po ballafaqohemi me probleme serioze. Kjo brenda dymbëdhjetë viteve ka shkaktuar që populli turk, pak edhe për shkak të orientimit të elitës politike e të papërgjegjësisë së mediave, të qarkullojë mes shpresëthyerjes dhe iluzionizmit të skajshëm. Thamë "Bota turke prej detit Adriatik deri në Murin Kinez". Një botë e madhe e imagjinatës, por ditëve të njëjta në

Turqi po përjetohej Sevri, paranoja e pyetjes “Vallë, a do të copëtohem?” Paramendoni një njeri që kur zgjohet është shumë i shëndoshë, sa mund të ballafaqohet me çdokënd. Pas një ore thuhet se vuan nga kanceri dhe se do t’i pritët një pjesë e trupit. Një orë më pas thuhet se prapë është shumë i shëndoshë. Ky njeri vazhdimisht fillon të polemizojë me vetveten: A thua jam me të vërtetë i shëndoshë?

Mahçupjan: Edhe s’e diskuton.

Davutogllu: Edhe s’e diskuton. Vazhdimisht sillet mes të dyjave. Një herë e përjeton këtë gjendje e një herë tjetrën. Populli ynë po e jeton lodhjen që ia ka shkaktuar kjo gjendje.

Mahçupjan: Pamundësia për të menduar.

Davutogllu: Duhet theksuar se mangësia nuk është te populli. Për këtë arsye, pak më parë shtrova pyetjen “A kemi intelektualë që do ta interpretojnë këtë?” Në këtë rast na del para problemi i të zgjedhurve, problemi i elitës. E dyta, një gjë tjetër që ndërli-dhet me këtë është mungesa e racionalitetit në dymbëdhjetë vitet e shkuara. Kjo çështje mund të ndërli-dhet edhe me të qenët tonë mesdhetarë ose me ndonjë element tjetër.

Bullaç: Mungesa e veprimit sipas një racioje politike.

Davutogllu: Racioja politike disa herë funksionon si refleks edhe pa dëshirën tonë. Mungesa e racionalitetit vërehet edhe në atë, se ne mendojmë me simbole. Nuk mendojmë përmes proceseve njohëse. Polemikët tona të brendshme ngrihen mbi simbolet dhe armiqtë.

Bullaç: Që më tepër u përshtaten përplasjeve dhe kufizimeve.

Davutogllu: Po. Menjëherë polarizohemi, hidhërohem. Pas një kohe, vërejmë se ky pezëm, ky polarizim dhe ky përjashtim është gjë e gabuar. Por ç'e do që tanimë kthim prapa s'ka. Për shkak të mungesës së racionalitetit në vitet e kaluara, përsëri e fusim në punë racionalizimin. Domethënë, pasi nuk mund të mendojmë në mënyrë racionale, fillojmë që gjendjen tonë ta racionalizojmë. Racionalizmi fillon pasi vëren që nuk je racionale. Themi: "E bëmë këtë, por e dimë se kjo është e gabuar. E bëmë për qëllime më të larta, për këtë ose për atë arsye". Kurse e vërteta është se viteve të fundit, në Turqi shumë ndodhi nuk mund të shpjegohen në mënyrë racionale, por prapëseprapë shpjegohen. Në vend që ta diskutojmë këtë çështje, menjëherë e shpjegojmë nga prapaskena. Një faktor tjetër kyç që i ushqen këta dy është zhvillimi i retorikës së bazuar në përjashtim, në vend të qëndrimit përbrendësues. Sikur osmanlliu të kishte filluar të përjashtonte në Sogyt, asnjëherë s'do të mund të dilte jashtë fshatit. Po ashtu sikur të fillonte të përjashtonte në kohën e Tanzimatit ose në periudhat e mëparshme, s'do të mund të jetonte edhe një shekull. Sepse kur të filloni të përjashtoni, do të gjeni shumë gjëra për të përjashtuar. Në këtë mënyrë e patëm kritikuar Amerikën. Probleme të ngjashme përjetojmë edhe ne dhe rrethi ynë.

Bullaç: Pra, përkufizojmë dhe përjashtojmë.

Davutogllu: Po. Besoj se pas një kohe të caktuar do të bëhet një analizë e shëndoshë. Turqia me të vërtetë është laborator. Jo vetëm në rrafshin e rendit ndërkombëtar, por edhe në atë sociologjik. Në vitin 1992 kur filloi lufta në Bosnjë dhe më vonë, populli

turk ishte shumë dinamik. Nga Refik Erdurani deri te Deniz Bajkalli, edhe islamistët dhe çdo shtresë tjetër e shoqërisë, e shprehën reagimin vet ndaj krimeve të bëra nga serbët dhe mundoheshin t'i ndihmonin popullit bosnjak. Në vitin 1999 në Kosovë ndodhën ngjarje të njëjta, thuajse nuk pati kurrfarë reagimi. Në vitin 1993 populli turk u tregua shumë vigjilent ndaj ngjarjeve në Çeçeni. Por në vitin 1999, kur Rusia ndërhyri në Çeçeni, s'u dëgjua zë në shoqërinë turke. Arsyeja qëndron në atë se populli u lodh brenda kësaj periudhe pesë-gjashtë vjeçare. Vërejtja se shumë probleme të cilat dukeshin jashtë, në fakt gjallonin edhe brenda. Në Turqi u përjetuan përjashtime e tendosje si ato të jashtmet dhe për pasojë, populli u lodh tepër. Populli duhet shpëtuar prej kësaj gjendjeje. Janë elitat e ndërgjegjshme ato që do ta shpëtojnë nga gjendja e lodhshmërisë, që do të bëjnë përkufizime me vetëbesim racional, që me plot vetëdije do të futen në thellësitë gjeografike dhe historike të kësaj shoqërie.

Prapaskena e mendësisë strategjike

Mahçupjan: Dua ta përmbledhim temën duke u kthyer në fillim. Flasim për thellësinë. Për një thellësi si potencial material dhe shpirtëror. Është një thellësi të cilën për momentin s'mund ta shfrytëzojmë. Ndoshta në imagjinatën tonë, në kujtesën tonë, në botën tonë të brendshme ose në ragimet tonë të brendshme kohë pas kohe ka simptoma të kësaj thellësie.

Por këto shfaqen në mënyrë aq joracionale dhe sipërfaqësore, sa që ne këtë thellësi nuk e perceptojmë si të tillë. Nga ana tjetër, duhet theksuar se Turqia s'mund ta plotësojë nevojën e politikës aktive pa e perceptuar këtë thellësi, të cilën na e përkujton edhe bota e jashtme. Ne ende s'e kemi zbuluar atë. Tash për tash na duket si një gjë që ka të bëjë me ndjenjat. Përkufizimet si vend i copëtuar (*torn country*) dhe vend strumbullar (*pivot country*) vijnë prej jashtë. Nuk janë përkufizime tonat. Vendi i copëtuar tregon një gjendje. Ende s'ka kurrfarë aksioni. Të tillë në të vërtetë jemi. Shprehja vend strumbullat tregon se strategjistët amerikanë Turqinë e konsiderojnë vend që mund të shfrytëzohet. Ne na paraqesin si shtet mjet. A themi se duam të jemi vend strumbullar ose a ia shtrojmë vetes pyetjen se çfarë shteti duam të jemi? Këtu kemi të bëjmë me traumën psikologjike ose me infrastrukturën e kalimit prej qendrës drejt periferisë, të kalimit pas periudhës osmane prej një shteti qendror në shtet periferik. Më duket se rreth disa çështjeve ne s'mendojmë fare. Ne s'po i diskutojmë çështjet e vetvetes dhe të botës në kuadër të një baraspeshe racionale e shoqërore. Po i kërkojmë vend vetvetes nën dritën e përkufizimeve të bëra prej jashtë. Për pasojë, s'ka mundësi të ndërtohet një politikë aktive. Por faji s'është vetëm te bota e jashtme. Kur ndalem e mendoj, konstatoj se një vend që më parë ka qenë qendër s'mund ta pranojë psikologjikisht që të jetë periferi. Të qenët qendër nuk është e drejtë historike dhe për fat të keq s'po shoh sinjale se Turqia do të shndërrohet përsëri në qendër. Kjo mund të realizohet nëse punojmë dhe atë e meritoj-

më, nëse bëjmë punë të cilave do t'u referohet bota e kohës sonë. Përkundrazi, s'mund të bëjmë gjë nëse shohim ëndrra duke e përkujtuar të kaluarën. Për të bërë një gjë të tillë duhet të kemi një strategji që e përfshin këtë thellësi. Kur po e shoh strukturën tonë të shtetit kombëtar, vërej dy zbrazëti. Problemin me kohën dhe me ndryshimin. Ndoshta është për këtë arsye që s'po e perceptojmë dot periudhën pas Luftës së Ftohtë, e cila ishte shumë statike dhe e përshtatshme. Po e vëzhgoj politikën e jashtme të Turqisë së sotme dhe përfundoj se kjo politikë synon që asgjë të mos ndryshojë, të mbetet ajo që është. Përfaqësuesit e kësaj politike s'po ia shtrojnë vetes pyetjen "Ç'dua në fakt unë?" Ekziston një shkëputje shpirtërore midis shtetit që në të kaluarën ka qenë qendër dhe midis shtetit që sot është periferi. Nga aspekti i kuptimit politik, shteti ka një vazhdimësi, por në aspekt të kuptimësisimit dhe përkufizimit të vetvetes, nga ai i lidhjeve kulturore, është përjetuar një këputje e madhe. Dhe rezultati i saj është shoqëria pa bazë. Kurse, për ta përjetuar thellësinë çdokush duhet ta plotësojë themelin e vet. Por ky themel zhduket përnjëherë me dorën tonë, me t'u shndërruar në shtet kombëtar. Atëherë thellësia shndërrohet vetëm në lidhshmëri emocionale. Dhe në këtë rast s'ka mundësi të jemi racionalë. Për fat të keq, sot s'kemi njohuri të mjaftueshme lidhur me këtë gjendje, s'po shtrojmë ide dhe s'po e diskutojmë fare. Kurse realiteti kërkon që të merremi me pyetjen sesi mund të ndërtohet përsëri, sepse rithemelimi është gjë e ngutshme. Në periudhën e Luftës së Ftohtë s'kishite problem edhe nëse nuk e (ri)ndërtonit shoqërinë tuaj.

Meqë jetonim në një kohë statike, mund ta shtynit këtë çështje për pesë ose për dhjetë vjet. Por sot, nëse Turqia nuk e bën rindërtimin, periudha vijuese e ndryshimit Turqinë do ta dërrmojë shpirtërisht edhe më tepër dhe ndoshta do ta çojë në copëtim fizik. Ky mund të mos jetë copëtim gjeografik, por përçarje shpirtërore mes njerëzve, një pandjeshmëri mes lindjes dhe perëndimit të Turqisë. Atëherë shtrohet pyetja, se ç' duhet bërë në aspektin strategjik?

Bullaç: Dua që edhe unë të shtroj një pyetje. Mund që të dy pyetjeve t' u përgjigjeni përnjëherë. Është fat që e kemi librin e profesorit të nderuar *The-llësia strategjike*, të cilin ia sugjeroj për lexim çdokujt. I nderuar, atje pohoni se për të pasur gjeostrategji duhet të keni më tepër mendje dhe aktorë: ministria e punëve të jashtme, Shtatmadhuria Ushtarake, Këshilli Kombëtar i Sigurimit, universitetet, intelektualët, shoqatat qytetare, burokracia etj. Kur të gjitha këto komponente ose përroska rjedhin në një lumë, formohet një arsye e përgjithshme. Këtë pyetje e shtroj të ndërli- dhur me atë të zotëri Etjenit. Shoqëria jonë a s'po mendon si tërësi me të gjitha institucionet, intelektua- lët, universitetet? A ka një qendër të vetme? A ka një arsye ose mendje të vetme? Kjo a thua është pasojë e mosformimit të një mjedisi demokratik të duhur ose e mosmarrjes në konsideratë të popullit? Në një shoqëri të këtillë del në pah njëdimensionaliteti dhe e njëjta s' mund t' u përgjigjet zhvillimeve të reja. A thua kjo ka të bëjë me politikën dhe projektin modernizues, që Turqia po e ndjek nga çereku i parë i shekullit XX e këndej?

Davutogllu: Analizat dhe pyetjet janë shumë të qëlluara dhe përfshirëse. Por, duke synuar që të mos e zgjas shumë dhe të mos bëhem monoton, do të përpiqem që të përgjigjem duke i ndarë pyetjet, duke u nisur nga pyetja e zotëri Aliut dhe duke kaluar në komentet e sakta të zotëri Etjenit. Përvoja jonë e modernitetit ka veçoritë e veta *sui generis*. E para, nga prizmi i premisave, mund të thuhet se përvoja jonë e modernitetit është e lidhur ngushtë me burokracinë. Elita osmane ka pasur tre elemente: *ilmijje* (shkencëtarët), *sejfiije* (ushtarët) dhe *kalemijje* (burokracia). Në këtë drejtim përnjëherë janë përjetuar dy lloje të sistemit. Që nga fillimi i shekullit XIX, është shënuar një sistemim qytetërimor përfshirës shumëdimensional, ekonomik, filozofik, ekzistencial, që bashkë me Tanzimatit vazhdimisht është zgjeruar. E dyta, sistemimi politik dhe ushtarak. Në fillim, meqenëse osmanlliu i ka besuar shumë vetvetes, pra nuk ka dyshuar fare në parametrat e vet qytetërimorë, sistemimin e kufizoi vetëm në aspektin ushtarak e politik. Një sistem i tillë, në kushte normale, nëse udhëhiqej prej elitës intelektuale, do të mund të fitonte thellësi shumë më përfshirëse. Kjo për arsye se burokracia çdo herë është pragmatike dhe përpiqet që pozicionin e caktuar ta mbrojë me reagime të çastit. Është konservative, përpiqet ta mbrojë politikën e vet. Tradita intelektuale e Turqisë ka lindur prej burokracisë. E keni përkufizuar shumë drejt, ndonëse çështja buron prej burokracisë, në rend të parë ka dalë sistemimi politik. Dimensionin e sistemit qytetërimor në thellësi s'u vërejt fare. Mu për këtë arsye shumë klasikë perëndimorë tek ne janë përk-

thyer shumë vonë. Kështu ka qenë reflektimi i politikës së jashtme turke, gjë kjo që ngërthen në vete edhe kontinuitetin historik. Ne si trashëgimtarë të një perandorie të zvogëluar, gjithmonë përpiqemi ta mbrojmë atë që ekziston. Në veprën time këtë e përkufizoj si *mbisundim absolut* dhe *braktisje absolute*. Vendet e braktisura në kuptimin absolut braktisen, kurse të tjerat mbrohen. Shembull tipik i këtij pretendimi janë simbolet nga romani *Mali i Ullirit* i Fatih Rifki Atajit.

Bullaç: Në vitet 1945 myslimanët e Ballkanit vijnë te Inonuja dhe i thonë që të merret edhe me çështjet e tyre dhe marrin këtë përgjigje: "S'ka turq jashtë kufijve nacionalë të Turqisë. Unë pra, me kë të merrem?". Braktisje absolute.

Davutogllu: Rasti është i njëjtë si me Ballkanin, ashtu edhe me Lindjen e Mesme. Ky refleks statik i mbrojtjes, në aspektin e traditës diplomatike në disa vende ka dhënë rezultate pozitive, statike. Për shembull, statusi i Qipros për 26 vite nuk ka ndryshuar. Në botë gjithçka ka ndryshuar, por statusi i Qipros jo. Ky është fryt i aftësisë së fortë të diplomacisë turke për të bërë manovra të forta për ta mbrojtur ekzistenten. Ngjashëm me këtë edhe shteti osman në periudhën e vet të fundit me vite të tëra e kishte ngrirë çështjen e Kretës. Ky refleks në të kaluarën mund të ishte i dobishëm në masë të caktuar. Lidhur me filozofinë është thënë një e vërtetë e padyshimtë: në filozofi s'ka mediokritet, mediokriteti në filozofi është i dëmshëm. Ose do t'i hyni në thellësi, ose s'do të merreni fare me të. Globalizimi dhe faktorët e jashtëm Turqinë e kanë prurë në një situatë, kur kjo s'mund të jetojë me mesa-

taren dhe me status quo-në. Turqia s'është Japoni. Turqia s'mund të ndjekë politikën e izolimit si Japonia ose ShBA, s'mund të thotë "Së pari t'i rregulloj çështjet e brendshme, t'i vë në binarë disa gjëra e më pas mund t'i hap dyert". Në Turqi në lidhje me globalizimin ekzistojnë dy prirje. E para e sheh globalizimin si një fat të pashmangshëm dhe sugjeron që ky shtet të lëvizë si gjethi në ujë. Përballë këtij qëndrimi është ai, që globalizimin e sheh si një fenomen të jashtëm, që duke u nisur nga motivi se duhet të mbyllemi në vetvete, i cili e merr trajtën sipas Revolucionit Industrial nga fundi i shekullit XIX, nga konceptet për shtetin kombëtar, nga iluminizmi, nga abstraktimi ndaj elementit të jashtëm, që e avancojnë mbylljen në vetvete. Kurse këto të dy qëndrime e përjashtojnë njëri-tjetrin. Nëse Turqia ka një thellësi të këtillë, është e pamundur që të mbyllet në vetvete, madje një gjë e tillë është tepër e rrezikshme për këtë vend. Thuhet se "Filozofia është det, nëse fillon të lundrosh je i sigurt, e nëse mbetesh në bregdet ke gjasa të përmbytesh". I tillë është edhe rasti me Turqinë, nëse ky shtet fillon të mbyllet ndaj botës, duke i bartur në brendi polemikat, tendosjet dhe përçarjet e ndryshme, mund të përballlet me copëtimin e vet. Por s'duhet harruar se me psikologjinë e thellësisë së këtij vendi nuk përputhet as absolutizimi i globalizimit dhe mosshfaqja e vullnetit të vet. Tradita intelektuale turke këtë çështje serioze, duke e shikuar vetëm nga këndi politik, modernizimin e ka trajtuar si proces të transferimit. Gjithmonë i kemi përcjellë gjërat me të cilat kanë jetuar të tjerët dhe për këtë arsye s'kemi arritur të zhvillojmë

prototipin tonë të intelektualit, të afaristit ose të strategjistit, që do ta realizojë ballafaqimin kulturor. Gjithçka që bëmë ka qenë derivat që s'jep kurrfarë shijeje. Lëreni një kohë të presë çajin ose ushqimin dhe konsumojeni më vonë, do të shihni se s'kanë kurrfarë shijeje. Nëse në procesin e globalizmit do të marrim pjesë jo si objekt por si subjekt, me tërë thellësinë tonë historike, me përvojat e përfituara nga ajo histori, duke e përmbledhur gjithë atë thellësi gjeografike, si një subjekt që shndërrohet në vetvete, nëse e japim kontributin tonë, në kuadër të rrjedhës së këtij procesi, nuk do të jemi lëndë e rëndomtë ose një gjë që ka rënë rastësisht në ujë, por element konstruktiv me peshë. Nxjerrja në pah e cilësive tona specifike nuk do të thotë abstraktim i vetvetes ndaj botës së jashtme. Unë në mënyrë simbolike shpesh e përdor shprehjen *rol i urës* dhe atë *rol gjeostrategjik*, por kjo, nëse mund të thuhet ashtu, është vetëm lajkë. Theme-luesit e qytetërimit si urë, ashtu si ka ndodhur në histori nëpër qytetet e Andaluzisë, në zonën e Harranit, në qytetet helene, nga vendet në të cilat arrijnë si pasojë e zgjerimit, i marrin gjërat e reja, i tretin, u japin atyre cilësi specifike, i rikthejnë dhe i shndërrojnë. Në çastin kur e preferoni statizmin dhe qëndrimin burokratik, të cilat zotëri Etjeni i quan moskuptim i ndryshimit, s'mund ta kapni ritmin dhe dinamizmin e këtij shndërrimi. E kur s'e kapni ritmin, ose u merr uji e u mbyt ose përpiqeni që të rezistoni. Tanimë strategjia nuk është çështje politike, madje as vetëm ushtarake. Strategjia nga prizmi vendor dhe ai global është shumë përfshirëse dhe elementi kulturor gjendet në

qendër të këtij koncepti. E them këtë në kuptimin se në shumë vende bëhet dallim mes makrostrategjisë dhe mikrostrategjisë. Në veçanti në vendet totalitare. Me shprehjen makrostrategji nënkuptoj strategjinë, kulturën e parapëlqyer nga njerëzit që e mbajnë timonin e shtetit, kurse me mikrostrategji, strategjinë të cilën e ndërton individi në botën e vet të brendshme. Nëse nuk krijoni lidhshmëri mes këtyre të dyjave s'keni kurrfarë strategjie nga makrostrategjitë e zhvilluara në letër. Strategjia s'mund të jetojë, nëse nuk e merr në konsideratë botën e njeriut. Regjimet totalitare e hapin trurin e njeriut ose të qytetarit dhe mundohen që ta mbushin atë me gjëra, të cilat i shkojnë për shtat sistemit. Procesi natyror s'i duron regjimet e atilla, të cilat si pasojë e moskënaqjes së elementeve mikrostrategjike shkatërrohen. Si në rastin e Bashkimit Sovjetik, i cili për shkaqe shumë të thjeshta s'arriti që qytetarëve t'u plotësonte nevojat themelore, madje as ato të konsumit të gjerë. Ose mes tyre krijohet një shkëputje, kështu që ata, të cilët përpiqen të krijojnë makrostrategji, gjithherë mundohen që mikrostrategjinë ta mbajnë jashtë. Tash shumë gjëra po ndryshojnë. Bashkë me globalizimin, bota ka marrë trajtën e një tërësie, ku në kuadër të vizionit strategjik gjendet politika e jashtme, e cila s'mund të shpjegojë gjithçka, ku edhe individit i jepet vend i caktuar në politikë, por me të s'mund të interpretohet çdo gjë, ku ekonomia ka një vend të çmuar por prapëseprapë me të s'mund të sqarohet gjithçka. Edhe ju duhet që t'ua jepni hakun të gjitha këtyre komponenteve dhe t'i ndani këto botëra. Në Turqi shpesh po flitet për rrezi-

kun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Në fakt këto rreziqe ekzistojnë dhe qendra politike mund të zhvillojë disa pozita të caktuara. Por strategjitë e qëndrueshme, sikurse është rasti edhe me përvojën e Anglisë, të ShBA dhe të shtetit osman, janë krijuar jo në bazë të rrezikut, por në bazë të vizionit. Vizioni njerëzve u mbjell ndjenjën e aksionit. Mbylljet ndaj botës së jashtme, shkëputjet, përjashtimet, përpjekja që çdokush t'i japë diçka të re botës së vet të brendshme, mund të shpien deri të shembja e strukturës sociale dhe politike. Çështja e hapjes ndaj botës dhe pjesëmarrjes në procesin e globalizimit si subjekt e jo si objekt është më tepër problem i elitës sesa i popullit. Popullin, në çështjen e përjashtimit, e shoh në nivel shumë më të lartë të njohjes dhe të largpamësisë. Populli as që i vëren shumicën e përthyerjeve dhe të përçarjeve brenda elitës së Turqisë. Mbylljet brenda botës së elitës s'i gjeni dot kur zbrisni në botën e masës. Ne kemi nevojë për prototip strategjist, intelektual, ekonomist, me një fjalë për elitë që do ta realizojë hapjen ndaj botës.

Mahçupjan: Nëse në Turqi do të krijohet lëvizje intelektualësh ose e elitës, kjo në të njëjtën kohë me vete do të sjellë edhe gjuhën, literaturën dhe këndvështrimin e vet konsistent. Dhe natyrisht, një terminologji të caktuar. Ne po ballafaqohemi me çështjen e përshtatjes dhe të të kuptuarit të botës së jashtme. Sot Amerika mund të përfitojë prej shumë gjërave të Turqisë. Sepse ata po flasin se janë bërë ekspertë në çështjen e terrorit. Në të vërtetë është turp të kesh pretendime të tilla. Sepse nga ana tjetër thuhet se jemi shtet

që s'e kemi kryer punën tonë. Shteti që është sulmuar nga terrorizmi është shtet që ende s'e ka rregulluar strukturën e vet të brendshme. Pra, ende kemi një qëndrim të shtrembër. Gjënë të cilën duam "t'ia shesim" botës, nuk është diçka e zgjedhur mirë. Ne s'mund të themi se jemi shoqëri ose elitë që ka ndërtuar sisteme, të cilat mund t'i bëjnë njerëzit të kënaqur. Ne në të njëjtën kohë jemi elitë, që mund t'i kapë dhe t'i shtrydhë ata që nxjerrin probleme. Kjo është një provë që tregon sesa jemi larg disa gjërave. Ne po përjetojmë disharmoni të rëndësishme me botën e jashtme. Duhet që t'i shqyrtojmë konceptet kritike, të cilat do ta eliminojnë këtë disharmoni. Për shembull, ndoshta duhet që tash ta mendojmë dhe ta ndërtojmë përsëri konceptin e shtetit kombëtar. Koncepti ynë i deritanishëm i shtetit kombëtar ka qenë shumë tepër përjashtues. Nëse sistemin dhe veten tuaj e bazoni në diferencim, atëherë automatikisht shkoni drejt një logjike mbrojtëse, përjashtuese, mbyllëse në vetvete, në një logjikë që çështjen e vet e percepton si rrezik i brendshëm-rrezik i jashtëm. Përveç kësaj, s'ka mundësi të hiqni dorë prej shtetit kombëtar, sepse globalizimi aktual dhe gjendja e ngushtësisë mes Perëndimit dhe Lindjes nuk ia mundëson Turqisë të bëhet lehtë pjesë e kësaj ose e asaj gjëje. Ne jemi të detyruar të vazhdojmë si shtet kombëtar. Atëherë duhet që këtë ta ripërkufizojmë dhe t'i japim një trajtë të re. Në të njëjtën kohë duhet të bëjmë një ndërmarrje të re edhe në çështjen e nacionalizmit. Sepse s'ka mundësi që të heqim dorë edhe prej këtij koncepti. Por s'ka mundësi gjithashtu të bëjmë diçka edhe duke e përqaftuar nacionalizmin e tashëm.

Këtë në një vend natyror do ta bëjnë elitat, por nuk është gjë që mund të bëhet vetëm në saje të elitave, kërkon një amalgamim fare tjetër.

Davutogllu: Përsëri erdhëm në një pikë mjaft të rëndësishme. Elita s' do të dalë në një boshllëk, do të dalë në kuadër të një grumbullimi e përzierjeje. Shikuar nga përvoja e 200 viteve të fundit, sikur të bënim një vlerësim me gjakfohtësi dhe sikur të vepronim nën dritën e intelektualëve dhe elitave të së kaluarës, mendoj se do të arrinim rezultate shumë më të mira. Duhet ta kemi parasysh se rrjedhim bashkë me lumin dhe brenda atij lumi gjendemi dhe jetojmë. Nuk duhet që të turpërohemi që rdo t'i biem në të kësaj të vërtete. Ne ndoshta jemi një pikë në lumin me nivel të lartë dhe që ka rrjedhë të shpejtë. Në kuadër të përgjegjësisë intelektuale, duhet të kemi njohuri rreth rrjedhës së lumit, duhet ta vëzhgojmë ndryshimin dhe duhet ta orientojmë atë në mënyrë që t'i japë atij identitet të veçantë. Në çështjet që kërkojnë pozicionim duhet që njerëzit me përgjegjësi të dalin pak më përpara. Ne duhet të merremi me çdo vlerë dhe çështje që burojnë nga universalizmi e globalizmi dhe që e preokupojnë njerëzimin. S' kemi nevojë për tipin e njeriut që merret vetëm me botën e vet. Universiteti s' mund t'i përshtatet globalizimit, nëse nuk përgatit persona me aftësi dhe etikë që do t'u mundësojnë atyre të punojnë në institucione së bashku me afrikanin, me kinezin, me indianin ose perëndimorin. Përsëri do të përjetojmë shkëputje, nëse nuk përgatisim kuadro që do të punojnë në kompani shumëkombëshe dhe që do të mund të integrohen me njerëzit e kafenesë së

Urfës, të Erzurumit ose të Edrenesë. Kjo do të thotë shkëputje dykahëshe. Nuk duhet të përgatisim një elitë, që e përjeton përçarjen dhe tëhuajësimin e përshkruar në veprën *Mali i ullirit* të Fatih Rifkisë e as në atë *Yaban* të Jakup Kadriut, por një elitë që u jep përparësi integriteteve, që mund t'i përkapë burimet me të cilat ushqehen këto integritete, një elitë që gatuhet me atë ritëm. Nëse arrijmë të përgatisim një elitë të tillë, populli do të integrohet me të dhe shoqëria nuk do të përjetojë përçarje dhe shkëputje.

Bullaç: Platoni thotë se “Nëse i shikojmë prej jashtë dy ushtri që përpasen mes tyre, do të fitojmë përshtypjen se bëhet fjalë për një ushtri që po bën vetëvrasje”. Sot në Afganistan është në veprim një makinë e madhe luftarake. Atje a thua ka ushtri? Kjo është pyetja e parë. E dyta: A thua Osama bin Ladeni dhe talebanët kundër të cilëve është shpallur luftë, e përfaqësojnë Islamin e tërë botës? A janë prototipi i Islamit? A janë referencë e lëvizjeve islame dhe rrymave islamiste? Apo vallë mos bëhet fjalë për një gjë të ashpër, që është aliazhi i interpretimit vahabist të Islamit, nga zona e Nexhdit, me traditën fisnore afgane? Nëse prej këtu kthehemi përsëri në Turqi, shtrohet pyetja se çfarë rëndësie ka Islami në Turqi gjatë procesit të globalizimit? Si në ShBA ashtu edhe në Angli po shënohet një ftohje ndaj Islamit dhe myslimanëve. Thuhet se myslimanët nuk janë terroristë. Më 27 shtator Toni Bleri mbajti një fjalim shumë të rëndësishëm: “Ky nuk është terror i islamistëve. Islamizmi është një lëvizje serioze, që vazhdon të ekzistojë që nga shekulli i kaluar e këndej”. Pra kjo është korniza e pyetjes sime.

Davutogllu: Nëse këtyre tri pyetjeve u japim një përgjigje të vetme, mund të fillojmë një debat të ri. Duke u nisur prej këndvështrimeve të palëve, s'mund të themi se kemi të bëjmë me dy ushtri. Në qëndrimin e Amerikës vërehet motivi psikologjik i njeriut të bardhë që u nis drejt Perëndimit të egër, përpjekja për ta kapur fajtorin që është pjesëtar i një bashkësie të konsideruar për primitive. Kjo është përshtypje e gabuar dhe po kjo gjë s'mund të sjellë rend. Te afganët mbizotëron vetëbesimi: "Pa marrë parasysh kush vjen, ne do t'ia bëjmë atë që ua kemi bërë më parë anglezëve dhe rusëve. Do të presim pak, do të durojmë, zaten jemi mësuar". Por edhe ky qëndrim është mashtrues. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me luftë mes dy ushtrive, por mes psikologjive. Nëse Afganistanin e sotëm e shikojmë nga nga këndi i gjendjes së përgjithshme të botës islame, është vështirë të thuhet se ky vend ka potencial sociologjik për ta përfaqësuar këtë botë. Afganistani s'ka pasur politikë të jashtme për ta pasqyruar veten jashtë. Bota islame në përgjithësi s'ka një tablo të këtillë.

Bullaç: Gazetat e ndryshme mes të tjerash kanë shkruar se "Talebanët ushqehen prej Sejid Kutubit dhe Mevdudit. Myslimanë të Turqisë dhe të botës mbarë, shprehuni haptazi se jeni kundër tyre, përndryshe edhe ju do të konsideroheni si simpatizues të talebanëve!"

Davutogllu: Kjo është përpjekje për thjeshtësimin e çështjes. Një pikëpamje e tillë është vështirë që të ketë ndikim te komponentet dhe veçoritë themelore të mendimit bashkëkohor islam. Qasja e tillë është ref-

leksion i drejtpërdrejtë i literaturës perëndimore te ne. Tash edhe te ne diskutohet se pas xhihadit afgan dhe Revolucionit të Iranit, në vitet 1980 në Perëndim ka lindur një orientalizëm i ri. Bëhet fjalë për një orientalizëm tepër politik, që i përngjan interpretimit të bërë nga burokracia osmane lidhur me Perëndimin. Të gjitha analizat e bëra rreth botës islame janë thjeshtëzime, kategorizime dhe konceptime të bazuara në to. Ato nuk u përngjajnë përpjekjeve të orientalizmit gjerman të shekullit XIX për ta njohur një kulturë në thellësinë e saj; është përpjekje praktike dhe mjaft sipërfaqësore, përpjekje për të interpretuar një mendësi të caktuar.

Pyetja është kjo: "A thua çfarë të dhënash mund t'u ofrojë politikanëve të botës islame me qëllim kontrollimin e vendeve të tyre?" Kjo është pikëpamje shumë e thjeshtë. Duhet pasur një pikëpamje më e thellë. Ajo që për teutonët është krishterimi, për turqit është Islami. Teutonët, duke hyrë në Europë s'ishin të njohur me krishterimin, me kulturën e fortë që më vonë do ta gjeneronte sintezën mes Romës së shenjtë dhe traditës teutone. Gjermania dhe qytetërimi perëndimor i sotëm janë fryt i dinamizmit të teutonëve, që kanë përvetësuar krishterimin semit dhe kanë ndikuar mbi Romën e dikurshme. Shikoni tipologjinë e qytetërimeve të Hegelit dhe interpretimin e tij të historisë. Analizat e Hegelit përbëjnë shpirtin e mendimit politik bashkëkohor. Njerëzit fitojnë identitetin e vet kur kalojnë në rendin e ngulur. Hiqeni elementin e krishterimit prej identitetit gjerman dhe s'do të keni mundësi ta kuptoni romantizmin gjerman. Nga ana

tjetër, formimi i Turqisë, shikuar nga këndi i thellësisë historike, përbën dinamikën e traditës së Iranit, të Mesopotamisë, të Bizantit dhe të asaj abasite, dinamikën vendore. Një element ky i selxhukëve dhe osmanëve që kanë ardhur prej Azisë së Mesme, dhe një sintezë që lind nga homogjenizimi i këtij elementi me Islamin. Dhe kjo sintezë ka lindur Stambollin, Bursën, Edrenenë, Sarajevën, Shkupin, Konjën, Erzurumin. Nëse Erzurumit i themi "qyteti ynë", atëherë Islamin duhet ta quajmë "thellësi e pellgut kulturor të Turqisë". Hiqeni Rumiun prej Konjës, ç'cilësi mbetet tjetër prej këtij qyteti pos një vendbanimi stepor? Ç'mbetet prej Stambollit nëse e hiqni siluetën historike të tij?

Osmanllinjtë Islamin e kanë kuptuar ndryshe e ne sot ndryshe. Kjo për ta ka qenë një traditë antike, që kishte depërtuar deri në thellësitë e historisë. Për këtë arsye të gjithë profetët janë shndërruar në simbole të lozhave të esnafëve. Koncepti i antikitetit nuk është shikuar si diçka e ndarë prej Islamit dhe në kuadër të këtij koncepti kanë gjetë vend tradita persiane, greke, egjiptiane, arabe etj. Një qytetërim i kulluar në aspektin pozitiv. Ne nëse duam që Perëndimit t'i ofrojmë diçka origjinale, atëherë duhet që t'i hapim thesarin i cili në muzikë ka Itriun, në arkitekturë Sinanin, në poezi Rumiun etj., një thesar shpirtëror, metafizik, në thelbin e të cilit gjendet edhe Islami. Ne duhet që të njihemi me dimensionin universal të globalizimit, i cili i aktualizon shumë qytetërimet dhe nga ana tjetër, ta zbulojmë thellësinë tonë dhe kështu të bëjmë një sintezë të re. Në këtë kontekst mund të them se veten e ndiej shumë të favorizuar. Të jetosh në një vend të

këtyllë të ndarë, në një vend strumbullar, dhe të kesh një gjeografi e histori të këtyllë të thellë është shumë më e kuptimtë sesa të jesh qytetar i një vendi stabil siç është Norvegjia. Sepse si qytetar i Turqisë ke vend të merituar edhe në histori. Nëse kemi qenë dje, do të jemi edhe nesër. Nëse këtë psikologji e shndërrojmë në element bazë të prototipit të elitës, do të bëjmë një hap të rëndësishëm drejt tejkalimit të përçarjes.

Mahçupjan: Norvegjezët i përmendët ratësisht apo jo?

Davutogllu: Po. Po.

*Kërkimi i lirisë dhe globalizimi**

Gyl Selçuk: Nëse i hedhim një sy periudhës para 11 shtatorit, do të shohim se në atë kohë filloi lëvizja e kërkimit të ardhmërisë së botës. 11 shtatori shënon fillimin e një ere të re. Pas kësaj date me të vërtetë filluan të diskutohen tema shumë të rëndësishme. Le të fillojmë duke pyetur se çfarë do të ndryshojë pas këtij sulmi, çfarë trajte do të ketë rendi i ri botëror?

Davutogllu: Në fakt, nëse e marrim parasysh prapaskenën historike, do të shohim se koncepti i *rendit të ri botëror* nuk është i ri dhe në përgjithësi, në periudhën moderne pas çdo lufte të madhe ka pasur përpjekje për të ndërtuar një rend të ri botëror. Pas Luftërave Tridhjetëvjeçare një rend i ri u themelua me Kongresin e Vestfalisë, pas luftërave të Napoleonit me Kongresin e Vjenës, pas Luftës së Parë Botërore me formimin e Lidhjes së Kombeve dhe pas Luftës së Dytë Botërore me themelimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Lufta ka kuptimin e kaosit. Gjithmonë ka ekzistuar prirja për shpëtimin prej kaosit dhe për shkuarjen drejt kozmosit. Por pas Luftës së Ftohtë doli në pah një deklaratë shumë e hershme. Bëhet fjalë për pohimin e Fukujamës për fundin e historisë, që te njerëzit la përshtypjen se është formuar një rend i ri. Por faza dymbëdhjetëvjeçare pas përfundi-

* Bota në kërkim të ardhmërisë, TV 8, 3 tetor 2001

mit të Luftës së Ftohtë tregon se ende po vazhdon të mbisundojë periudha e kaosit. Nga perspektiva e analizave afatgjata mund të shtrohet pyetja, se nga është duke shkuar rendi botëror, kurse nga ajo e analizës strategjike afatgjatë mund të shtrohet pyetja, se cilat janë fushat problematike të rendit botëror. Nëse ndalemi te periudha afatshkurtër, do të vërejmë se në dymbëdhjetë vitet e kaluara janë bërë shumë marrëveshje armëpushimi. Por ç'e do që këto marrëveshje nuk gjeneruan paqen, në të cilën çdokush të ishte pajtuar me të gjitha normat, insitucionet dhe vlerat e veta. Në fushat e krizës në vend të zgjidhjeve përfundimtare janë parapëlqyer normat e ngrirjes së krizës. Për shembull, Iraku pushtoi Kuvajtin. Lindi kriza dhe kaosi. U bë ndërhyrje, por nuk u vu rendi, u formua një *status quo* i përkohshëm. Iraku ende po e përjeton përçarjen, atje ende po mbretëron paqartësia. Në Bosnjë e Hercegovinë u shfaq problemi i sistemit, kaosi që arriti deri në pikën e gjenocidit, por Marrëveshja e Dejtonit nuk e solli rendin. Pushtimi armen i Karabagut po ashtu solli gjendje kaosi. Statusi i këtij rajoni ende nuk është i kthjellët. Thënë më drejt, ekziston dallim i madh mes statusit të së drejtës ndërkombëtare dhe atij faktik. Pas Luftës së Ftohtë të gjitha krizat janë ngrirë. Këtë periudhë mund ta pagëzojmë si periudha e armëpushimeve të përkohshme. Qe dymbëdhjetë vite ende nuk ka dalë në pah një sistem strategjik, rreth të cilit të jenë pajtuar të gjithë aktorët e mëdhenj, ende nuk janë shtruar vlerat që do të përbëjnë sfondin dhe themelin filozofik të sistemit në fjalë. Domethënë, pas Luftës së Dytë Botërore ende nuk është

përjetuar një shndërrim si ai i OKB-së. Shkaqet janë të ndryshme. 11 shtatori më së paku e tregoi këtë të vërtetë. Mendoj se teza e Fukujamës ka lindur shumë herët. Sepse kërkimet kryesore të njeriut janë ai i sigurisë dhe i lirisë. Njeriu nëse nuk e ndien veten të sigurt dhe të lirë, vazhdon të kërkojë. Teza e Fukujamës e bartte në vete pretendimin se kërkimin e njeriut për siguri dhe liri e kanë zgjidhur mekanizmat e qytetërimi perëndimor të demokracisë liberale. Por zhvillimet e fundit treguan se madje edhe ShBA po përjetojnë problemin serioz të sigurisë.

Selçuk: Këtë e përjetuan për herë të parë.

Davutogllu: Për herë të parë në mënyrë të drejt-përdrejtë. Nëse njerëzit nuk e ndiejnë veten të sigurt në qendrën më të rëndësishme të sistemit botëror, kjo pasiguri zgjerohet drejt vendeve të tjera. Ngjarjet e 11 shtatorit treguan se atmosfera e sigurisë s'mund të formohet në saje të mekanizmave dhe të teknojlogjisë. Sepse pala tjetër duke shfytëzuar teknologjinë, ka ardhur në gjendje që ta rrezikojë sigurinë tuaj.

Selçuk: Amerika para 11 shtatorit veten e ndiente të sigurt, kurse vendeve të tjera u shpërndante pasiguri. Tash nëse Amerika ndihet një herë e pasigurt, shtetet e tjera ndihen trefish, pesëfish më të pasigurta.

Davutogllu: Po. Për amerikanët problemet e Ballkanit, të Irakut, të Somalisë, të Afrikës ose të ndonjë rajoni tjetër janë probleme të jashtme. Por ç'do të bëni kur problemi i sigurisë shfaqet në brendësinë e ShBA? A zotëroni vlera dhe mjete që ta zgjidhni këtë problem? ShBA për shkak të pozitës së vet gjeografike asnjëherë nuk janë kanosur nga ndonjë rrezik konven-

cional. Mund të rrezikoheshin vetëm nga terrori dhe nga fuqia bërthamore. Për ta përballuar rrezikun bërthamor, zhvilluan mburojën e raketave. Por terrori është një rrezik që kërkon organizim shumë më të gjerë dhe nuk mund të mënjanohet me një aksion pikësor. Për evitimin e terrorit në vend të mjeteve strategjike ushtarake, kërkohet rishqyrtimi i vlerave themelore të njerëzimit. Në këtë aspekt fundi i historisë ende nuk ka ardhur. Kjo koniunkturë e shtyn njerëzimin në kërkime të reja. Globalizimi e shtoi ndërveprimin mes shoqërive, por s'ua ofroi atyre psikologjinë e sigurisë. Sot, njerëzimi po heq dhimbjet e mosndërtimit të sistemit të vlerave, rreth të cilave është arritur konsensusi. Pas 11 shtatorit përtej ndëshkimit të fajtorëve ose përtej pengimit ushtarak të terrorit, duhet të diskutohet nëse mund të dalë ose jo një sistem ndërkombëtar pjesëmarrës, i ndërtuar mbi vlerat e përbashkëta në të cilat merr pjesë gjithë njerëzimi, në të cilat e kanë fjalën dhe kanë arritur në ujdi të gjitha kulturat.

Selçuk: Me siguri se kjo do të diskutohet. Por, pas sulmit terrorist ndaj ShBA, ndoshta duhet bërë përkufizimi i terrorizmit. Sepse disa mund të shndërrohen në terroristë përnjëherë edhe pse deri para pak kohe kanë pasur statusin e mikut ose të luftëtarit të lirisë. Këtu pra ka një kontradiktë. Shumë u përfol terrorizmi. A thua me shprehjen luftë kryqëzate që doli nga goja e Bushit dhe me gjërat që u shprehën në Gjermani, u zgjua një kuçedër që po flinte? U etiketua Islami. U dha formula se Islami është baras me terrorizmin. Dhe tash në Amerikë ka reagime të ashpra kundër myslimanëve që jetojnë në atë vend. Ç'mund të thoni lidhur me këto gjëra?

Davutogllu: Nëse me përkufizimin e terrorit dhe akuzat e bëra lidhur me të synohet fajësimi i aktorëve të 11 shtatorit dhe kufizimi i këtij akti me një hapësirë të caktuar, kjo mund të quhet veprim racional. Por nëse në skenë nxirrni një fajtor anonim dhe akuzoni në përgjithësi duke thënë se 11 shtatorin, sipas të gjitha gjasave, e kanë bërë "këta", kjo do të thotë se i shkatërroi edhe elementet përbërëse të sistemit ndërkombëtar që doni ta ndërtoni.

Dilema kryesore e ShBA në këtë çast del në pah në tendosjen mes së drejtës ndërkombëtare dhe politikës reale. Faktori kryesor që ShBA i ka nxjerrë në skenë pas Luftës së Dytë Botërore si një fuqi e madhe, është zëvendësimi i kolonializmit anglez dhe francez me të drejtën ndërkombëtare dhe institucionalizimi i kësaj të drejte. Kolonializmi anglez dhe francez, duke e mbajtur çdo vend dhe çdo shoqëri në pozitën që gjendej, synonte që të bënte përcjelljen dhe shfrytëzimin e burimeve të tyre. Nga ana tjetër, ShBA mundohen që të formojnë një hapësirë të mbisundimit dhe të rendit në bazë të normave juridike ndërkombëtare dhe të sistemit të Kombeve të Bashkuara. Tash ShBA po i shkelin normat juridike ndërkombëtare dhe vlerat universale për hir të interesave real-politike në Afganistan, në Azi dhe në Ballkan. Në fakt këto norma dhe vlera janë shkelur edhe më parë. Pushtimi i Kuvajtit nga Iraku i përngjan okupimit të Bosnjës nga Serbia. Vrasja e ndërgjegjes së njerëzve për shkak të mosreagimit ndaj zhdukjes së 250 mijë njerëzve për tre vitet e luftës në Bosnjë dhe gjenocidit ndoshta më të madh në historinë e njerëzimit, e pengon rendin

ndërkombëtar - që ndërtohet me fuqinë ushtarake dhe materiale - t'i arrijë rezultatet e duhura. Në këtë drejtim na del para edhe kjo çështje: Hedhja në eter e konceptit të luftës së kryqëzatave, në botën islame shkaktoi dallgëzime të forta. Ka dy mundësi: Bushi këtë sintagmë e ka përdorur ose me vetëdije ose pa vetëdije. Nga sqarimet e mëvonshme kuptohet se këtë sintagmë e ka përdorur pa qenë i vetëdijshëm për të. Në fakt, një gafë e çastit e pasqyron nënvetëdijen. Rreziqet strategjike të perceptimit të botës islame si armik janë të shumta, por me rëndësi është që koncepti i botës islame është shndërruar. Tanimë asnjë botë, as Kinën, as Indinë, as botën islame, as atë perëndimore s'është e mundur që ta kufizosh me një gjeografi të caktuar. Sot nuk është lehtë si më parë të thuhet se këtu përfundon bota islame e fillon bota perëndimore; këtu përfundon bota islame dhe fillon Kina. Pra, nuk ka mundësi që të thoni "Botën problematike ta mbajmë brenda kufijve të vet". Sot degët e trungut të botës dhe të qytetërimit islam i hasim në çdo qytet të ShBA, të Anglisë, të Francës, të Gjermanisë etj. Bota islame tanimë është më tepër një koncept kulturor/demografik sesa gjeografik. Tanimë qytetërimi nuk nënkupton vetëm Europën dhe Perëndimin, e as që qytetërimet e tjera mund të shndërrohen në objekt të kolonizimit. Këto qytetërimet po ngjallen dhe kjo ngjallje në mënyrë të pashmangshme do ta shfaqë veten në histori. Ky gjallërim sot në Kinë po e pasqyron veten si në aspektin kulturor, ashtu edhe në atë ekonomik e politik. Dy të tretat e prodhimit botëror realizohen në Azinë Lindore. Shikuar prej kësaj, shtrohet pyetja se

pse bota islame perceptohet si rrezik apo siç ceket në artikullin e Hantingtonit, pse kufijtë e botës islame janë vizatuar me gjak? Këto shkaqe duhen shqyrtuar mirë.

Selçuk: Kur akuzohet bota islame si shkak, merret rëndësia ushtarake, politike dhe strategjike e Afganistanit dhe e Azisë, apo jo?

Davutogllu: Gjithsesi. Pikë që duhet pasur parasysh është mu kjo. A thua problemet e botës islame rrjedhin prej burimeve të qytetërimit islam? Sikur të ishte ashtu, një qytet si Stambolli a do të mund ta ruante karakterin e vet shumëkulturor, shumëfetar, karakterin e një qyteti islam për 400-500 vite të plota? Sikur të ishte ashtu Bagdadi, a do të mund të shndërrohej në një vend në të cilin që nga shekulli X do të bashkëjetonin të gjitha kulturat? Sikur problemet e botës islame të rridhnin prej burimeve të qytetërimit islam, a thua në qytetin andaluzian të Granadës do të mund të krijohej një atmosferë e formuar nga myslimanët, krishterët dhe hebrenjtë, nga e cila kanë përfituar mendimtarët e mëdhenj perëndimorë? Me siguri se jo. Pra problemet e botës islame nuk rrjedhin prej vetë qytetërimit islam. Për t'i kuptuar drejt çështjet e qytetërimit islam duhen shqyrtuar mirë cilësitë dhe rëndësia strategjike të botës islame. Në mënyrë më ilustrative mund të themi se gjeografia e quajtur botë islame në vete i ngërthen tetë prej nëntë rrugëkalimeve strategjike, nëpër të cilat rrjedh tregtia botërore. Bota islame gjendet në një vijë të këtillë strategjike. Të gjitha rrugët e mëdha dhe kalimtare të Eurazisë, në drejtimin Veri-Jug, Lindje-Perëndim janë zona në të

cilat jetojnë bashkësi myslimane. Për këtë arsye bëhet nxitja e konkurrencës strategjike me botën islame, nxitet qërimi i hesapeve me bashkësitë myslimane të atjeshme, shfrytëzimi i tyre për shkaqe pragmatike, nxitet lufta mes këtyre bashkësive - gjë kjo të cilën Hantingtoni ua sugjeron autoriteteve amerikane - e kështu me radhë.

Mendoj se këtu duhet të ndalemi në peshën që ka Afganistani. Pse Afganistani? Më 11 shtator ndodhi ngjarja e madhe. Por në mëngjesin e 12 shtatorit, njerëzit nga gjitha bota: amerikanë, rusë, gjermanë, izraelitë, politikanë që e orientojnë strategjinë e shteteve, u morën sa me pyetjen "Kush e bëri këtë?" aq edhe me atë "Çfarë forme do të marrë bota pas kësaj ngjarjeje?" Zgjidhja ndoshta do të ishte më e lehtë, sikur kufiri i aksionit të ndërmarrë sot të ishte kapja e aktorëve të terrorizmit. Por në Afganistan po vërehet një konkurrencë e atillë strategjike që... Afganistani është i rëndësishëm për disa arsye. Është fqinjë i tre shteteve të mëdha: Pakistanit, Indisë dhe Kinës, që jashtë Perëndimit zotërojnë fuqi bërthamore. Është fqinjë i tre pellgjeve qytetërimore (Islami, India dhe Kina), që jetojnë në mënyrë më dinamike dhe numri i popullsisë së të cilave shënon rritje të madhe. Afganistani i ngërthen në vete të gjitha rrugëkalimet lindore të lidhjeve mes Ballkanit, Kaukazit dhe Azisë së Mesme, pikat kalimtare të Hajberit, të Golakut dhe të Karakurumit.

Selçuk: Për të sunduar botën duhet ta sundosh Afganistanin.

Davutogllu: Afganistani meqë i ngërthen në vete të gjithë popujt e Azisë, gjatë historisë ka luajtur rol

kyç. Aleksandri i Madh është ballafaquar me një kyç të këtillë. Zbritja e Timurit dhe e Mahmud Gazneliut deri në Indi, ardhja e Bashkimit Sovjetik dhe e anglezëve deri në Afganistan, këtij vendi i jep një identitet vendosës. Kur i marrim parasysh të gjitha këto llogari strategjike, mund të themi se ShBA ballafaqohen me këtë çështje: Duhet ndërtuar një rend ndërkombëtar me norma universale, të cilat do të jenë të pranueshme për të gjitha vendet dhe qytetërimet, s'duhet përjashtuar asnjë element ose faktor, as bota islame, as Kina e as India...

Selçuk: Kjo duhet bërë, por a vërehen shenja se po bëhen përpjekje për një gjë të tillë?

Davutogllu: Në një periudhë të shkurtër nuk duket ashtu. Reagimet momentale flasin se realiteti s'është ashtu siç pretendohet. Por, sipas meje, në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë ballafaqimi me të vërtetën është domosdoshmëri. Problemi nuk do të përfundojë madje edhe nëse kapen e ndëshkohen aktorët e 11 shtatorit. Nëse në botë do të vazhdojë të mbizotërojë padrejtësia, nëse hendeku mes Veriut dhe Jugut vazhdon të zgjerohet me shpejtësi kaq të madhe...

Selçuk: Po zgjerohet me të madhe edhe hendeku mes veriorëve.

Davutogllu: Shkaku i rritjes së distancës mes veriorëve është diferencimi mes tyre në llogaritë strategjike. Për shembull, viteve të fundit janë shfaqur dallime të dukshme strategjike mes ShBA dhe Europës. Krijimi i ushtrisë së Europës, misioni i ri i NATO-s e kështu me radhë. Dhe pasojat më të rënda të këtyre

divergjencave i përjetuan myslimanët bosnjakë. Në dymbëdhjetë vitet e fundit, bota islame nuk është shkaktare e krizave por viktimë e tyre. Kjo më së miri vërehet në fotografitë nga Bosnja, Karabagu, Çeçenia... Pse rasti i ndërhyrjes turke në Qipro trajtohet me kut të ndryshëm nga rasti i Karabagut azeras të okupuar prej Armenisë?

Selçuk: Dua të vijmë te çështja e Turqisë, e cila ka një pozitë mjaft të rëndësishme strategjike. Cili do të jetë vendi i Turqisë në rendin e ri botëror, që do të formohet ose që mendohet të formohet pas 11 shtatorit? Çka duhet të bëjë Turqia?

Davutogllu: Pas Luftës së Ftohtë janë shfaqur tri fusha problematike të rëndësishme:

1. Fushat e boshllëkut gjeostrategjik.
2. Ndarja e burimeve gjeoekonomike, gazet natyrore, dhe
3. Ballafaqimet gjeokulturore.

Problemet e dymbëdhjetë viteve të fundit janë ngushtë të lidhura mes vete, pra shkojnë bashkë. Turqia duhet të merret drejtpërsëdrejti me to.

Turqinë e prek çfarëdo rrëshqitjeje e fuqisë në boshllëkun e fushës gjeostrategjike të Ballkanit. E prek çdo çështje që lind në Kaukazi. Edhe çdo çështje e Afganistanit, sepse ky vend ka një pozitë me vlerë që prek Azinë e Mesme. Nëse e keni parasysh, problemet e dymbëdhjetë viteve të fundit janë përjetuar në këtë hapësirë. Turqia, nëse dëshiron të jetë aktor aktiv në ndarjen e burimeve të Azisë së Mesme, duhet të interesohet për rrjedhat në Afganistan dhe në Azinë e Mesme, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë

në rrjedhat e këtij vendi. Këtu duhet përmendur edhe ballafaqimi kulturor. Elementi i fundit unifikues i të gjitha këtyre pellgjeve janë turqit. Pra, nëse çështjen e trajtoni nga këndi i Eurazisë, do të shihni se deri në shekullin XVII kur perëndimorët erdhën në këtë nënqiell, osmanllinjët kanë qenë më në perëndim, safevitët në mes, kurse turqit baburë kishin formuar një baraspeshë në Indi. Mund të themi se Turqia gjendet në qendrën e ndërveprimit qytetërimor.

Të gjitha këto mund të duken si dizavantazhe por edhe si avantazhe. Turqia, nëse në veçanti elita e luan rolin e vet depërtues drejt horizonteve, nëse i kapërcen shkishërimet e brendshme, nëse i tejkalon problemet e veta duke i brendësuar ato, nëse ndjek një politikë ndërvepruese në fushën e ekonomisë e të kulturës me pellgjet e afërta, do t'i evitojë të gjitha rreziqet dhe do të korrë suksese të ndryshme strategjike. Ma ha mendja se kjo mund të realizohet.

Selçuk: Prej gjithë kësaj që u tha mund të arrijmë në përfundimin se 11 shtatori është datëlindje e rendit të ri botëror. Profesor, ju falënderojmë shumë dhe ju dëshirojmë suksese në fushën e veprimit tuaj.

11 Shtatori dhe thellësia strategjike e Turqisë*

2023: Dua që bisedën tonë ta fillojmë duke u nisur nga vepra juaj *Thellësia strategjike*, në të cilën nga të gjitha frontet e trajtoni pozitën ndërkombëtare të Turqisë. Në librin tuaj në fjalë, gjatë shqyrtimit të temave shtroni një filozofi të veçantë, të cilën e shpjgoni në mënyrë sistematike. Çfarë rëndësie ka strategjia në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare? A mund të na shpjgoni se në fakt çfarë metode është strategjia?

Davutogllu: Nëse ia fillojmë me shpjegimin e konceptit *thellësi strategjike*, do të vërejmë se strategjia është e përkufizuar brenda këtij koncepti. Në të njëjtën kohë do të kthjelltësohet edhe metoda e strategjisë. Duke e pagëzuar librin tim *Thellësia strategjike* i kam pasur parasysh dy gjëra: E para, si mundet që analiza strategjike të fitojë thellësi? E dyta, thellësia strategjike e Turqisë. Si mund ta analizojmë thellësinë strategjike të Turqisë në kuptim të zbatimit të thellësisë metodike në teori? Duke u nisur nga pika e parë, në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, çdo shtet mund ta vini në kornizë përkufizuese dhe mund të jepni një tablo përshkruese të tij. Tabloja të cilën në librin tim e quaj “përshkrim”, ofron informata të çmuara. Kur e shikoni atë tablo, nëse është e mirë,

* Revista 2023, 15 dhjetor 2001

menjëherë mund ta vëreni fytyrën e dukshme të një ngjarjeje. Natyrisht, shtrohet pyetja nëse ai që e ka bërë këtë tablo, është objektiv si një fotograf ose fotografisë i ka shtuar vijat e veta? Kjo sjell me vete çështjen e objektivitetit. Është e vërtetë se në çdo fotografi ka objektivitet. Nëse fotografia e përgjithshme përfytyrohet si përshkrim sipërfaqësor, është vështirë të nxirren në shesh marrëdhëniet shkak-pasojë. Pra, është vështirë që t'i kthjelltësoni lidhjet shkakësore vetëm në saje të një fotografie. S'ka dyshim se në kuadër të dimensionit kohor të asaj fotografie, dalin disa pamje. Është vështirë t'i shpjegosh marrëdhëniet shkakore pa e kuptuar ndryshimin. Atëherë duhet të kalojmë në diçka më të thellë, në dimensionin e shpjegimit. Aty, për ta sqaruar raportin shkak-pasojë duhet që t'i kemi para fotografitë e ndryshme të bëra një pas një, në kohë të ndryshme. Nëse arrini që në mënyrë të shëndoshë ta tregoni ndryshimin në pozitat e aktorëve, analiza juaj fiton në thellësi. Duke u nisur prej pozitive të tyre ndërkombëtare, do të keni mundësinë t'i shihni pozitat që ndryshojnë të aktorëve, të cilët e zhvillojnë politikën e jashtme në kuptim të strategjisë. Sa më afatgjatë të jetë këndvështrimi juaj, sa më tepër tablo të keni të Ruisë cariste, të Ruisë Sovjetike dhe të asaj putiniane, aq më mirë mund t'i kuptoni komponentet e mendësisë strategjike sovjetiko-ruse. Kjo vlen edhe për Turqinë. Nëse shteti osman i shekullit XIX vlerësohet bashkë me periudhën e Republikës dhe atë të historisë më të afërt, mund të vërehet qartë lidhja shkak-pasojë. Por as kjo nuk mjafton. Nxjerrja në pah e marrëdhënieve shkak-

pasoje në analizat e politikës së jashtme na ndihmon në ndërlidhjen e ngjarjeve mes tyre dhe në të kuptuarit e aktorëve që janë pjesë e pandashme e këtyre ngjarjeve. Por edhe kjo nuk mjafton. Duhet që të zbrehim edhe pak në thellësinë e analizës strategjike. Atëherë kemi arritur në dimensionin e të kuptuarit metodik. Këtë herë prej pozitës së vëzhguesit të jashtëm që i shpjegon gjërat, duhet të mendoni duke e vënë veten në vendin e aktorëve të skenës. Domethënë, një mendësi hebraike dhe ndikimi i saj ndaj Izraelit. Një mendësi strategjike ruse, një mendësi strategjike turke. Kur arrini që t'i shihni formacionet njohëse të ndryshme dhe të dhënat historike që i ndjekin ato, jeni thelluar edhe një hap. Si e shikon amerikani botën? Si do të reagoje rusi nëse 11 shtatori do të ndodhte në Moskë? Si do të reagoje amerikani? Kjo nuk është pyetje që ka të bëjë me kundërshtimin e terrorit ose me veçoritë objektive të terrorit. Kur një ngjarje e tillë ndodh në Amerikë, shndërrohet në paranojë të siguri-së. Sepse Amerika është vend në të cilin njerëzit vazhdimisht ndihen të sigurt dhe të lirë. Qe 150 vjet, pas Luftës Qytetare, në Amerikë është akumuluar një psikologji e njerëzve që s'kanë parë luftë. Pa e kuptuar këtë psikologji, s'mund t'i vlerësoni rezultatet e 11 shtatorit. Kjo sjell me vete dimensionin e të kuptuarit. Nëse doni të bëni vlerësimin e strategjisë amerikane, është me rëndësi që asaj t'i qaseni nga dimensionin e të kuptuarit. Amerikanët mund t'i doni ose jo, kjo është gjë tjetër. Ne kemi një mangësi në këtë drejtim. Ndoshta për shkak të temperamentit mesdhetar, ndoshta prej identitetit tonë prej lindori, shumë

shpesh diçka ose e urrejmë skajshmërisht, ose e konsiderojmë miqësore deri në pafundësi. Kurse në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk ka gjëra të këtilla. Çdo shtet sillet sipas koniunkturës përreth. Pas kësaj, një vëzhgues që e ka ndjekur tërë këtë proces, një ekspert në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare, mund të japë komente të kuptimta rreth kësaj ose asaj çështjeje. Shkencëtari duhet të jetë objektiv. Deri këtu është gjithçka në rregull. Çdonjëri prej nesh duhet të jetë brenda këtij objektiviteti. Por çdo shkencëtar i përket një historie dhe një vendi. Domethënë, shkencëtari i sferave shoqërore s'mundet që fenomenet shoqërore t'i trajtojë siç i trajton fizikani dukuritë fizike në laboratorin e vet. S'ka mundësi që të shkëputet si ai prej mjedisit. Në shkencat shoqërore kësaj i themi "të jesh brenda gypit tënd eksperimentues". Një gjerman, duke e vlerësuar pozitën e Gjermanisë, veten e vlerëson brenda përkatësisë së vet. Kjo nuk e eliminon shkencëtarin. Dihet se të gjithë ekspertët amerikanë të marrëdhënieve ndërkombëtare, siç shihet edhe në rastin e Fukujamës, mundohen ta mbrojnë Amerikën. Ne, në përgjithësi, kur kalojmë në këtë fushë ose shkëputemi skajshëm prej shoqërisë, ose bëjmë vazhdimisht përshkrime dhe s'nxjerrim gjë në mejdan. Ose perspektivën tonë e mbrojmë aq zëshëm saqë nuk shohim gjë veç vendit në të cilin jemi. Nëse mendojmë rreth asaj, sesi mundemi që çështjen ta zgjidhim nga perspektiva jonë, analiza fiton edhe më tepër në thellësi. Vetëm pas kësaj mund të bëni kahëzime. Nëse thoni "Kam një fotografi dhe Turqia duhet të qëndrojë këtu" dhe analizat i bëni sipas kësaj foto-

grafie, s'mund ta arrini thellësinë pozitive. Kjo është ajo që unë metodikisht kuptoj me shprehjen thellësi. Turqia nuk i përngjan çfarëdo shteti kombëtar. Në shekullin XX kanë lindur shumë shtete kombëtare, numri i të cilave arrin deri më 180-200. Një pjesë e këtyre shteteve janë formuar në saje të vullnetit të jashtëm. Për shembull, është vështirë të gjejmë ndonjë dinamikë të brendshme për lindjen e shteteve si Kuvajti, Katari apo Dubai. Pse ekzistojnë Kuvajti dhe Katarri, çfarë dallimi kanë prej Arabisë Saudite? Turqinë s'mund ta krahasoni as me ndonjë shtet që ka lindur për x apo y kushte në Amerikën Latine.

2023: Atëherë shtrohet pyetja, se cilat janë ato tipare që Turqinë e bëjnë të veçantë?

Davutogllu: Jemi të detyruar që ta kuptojmë thellësinë strategjike të Turqisë. Unë në veprën time hulumtoj dimensionin e hapësirës. Pozita gjeografike në të cilën gjendet Turqia nuk ia lejon këtij vendi të mbyllet brenda kufijve të vet. Në këtë hapësirë Turqia, pa marrë parasysh çfarë politikash pacifiste do të ndjekë - e në fakt është vend që shumë pak ka luftuar - prapëseprapë s'mund ta ndryshojë këtë të vërtetë. Domethënë, nëse i lëmë mënjanë përplasjet dhe luftërat nga periudha e fundit osmane, krahasuar me shtetet e tjera nga gjeografia e afërt, në periudhën e Republikës nuk kemi bërë luftëra të mëdha, por kjo hapësirë ka një thellësi që na rëndon. Kufiri i Turqisë me Sirinë dhe me Irakun s'ka ndonjë kuptim të veçantë. Asnjëherë më parë Urfa dhe Halebi nuk kanë qenë kaq larg njëri-tjetrit. Kufiri ekziston dhe duket se këto dhera i largon mes vetes, por është vështirë e ndoshta edhe e

pamundshme që Mesopotaminë veriore dhe atë të jugut ta ndash prej Turqisë. Kjo kështu ka qenë edhe gjatë historisë. Në këtë hapësirë ka një thellësi dhe tërësi gjeografike. Trakia lindore dhe ajo perëndimore shtrihen në një hapësirë që fillon me Filiben dhe vazhdon deri në malet e Ballkanit dhe kjo fushë shumë rrallë ka qenë e ndarë sa është sot. E njëjta gjë vlen edhe për kufirin kaukazian. Mbrojtja e bjeshkëve të Erzurumit varet prej raporteve në Kaukazin Verior. Stabilitetin kufitar dhe dimensionin e qëndrueshmërisë e shohim në kufirin mes Turqisë dhe Iranit, që ka bazë historike. Por në të gjitha këto vija kufitare ka veçori që i japin thellësi mjedisit. Thellësia sjell edhe përparësi, por edhe rreziqe. Madje edhe përtej kësaj, siç kam cekur edhe në analizën që kam bërë, ekziston një thellësi detare. Shikuar edhe nga prizmi i kontinenteve, mund të thuhet se Turqia ka pozitë që s'i lejon asaj të "burgoset", të mbetet e vetmuar. Është e detyruar të zhvillojë politika rajonale. Një dimension tjetër që e mbështet këtë hapësirë janë të dhënat historike. Pra, përtej llafeve të trajtës "Mos vallë këta turqit prapë po synojnë diçka perandorake?", mund të thuhet se historikisht ekzistojnë disa shtete kombëtare që i përngjajnë njëri-tjetrit. Këto shtete kombëtare të formuara nga elementet qendrore të strukturës perandorake kanë probleme, që i veçojnë prej shteteve të tjera kombëtare. Cilat janë këto probleme? Në vigjilje të shekullit XX ekzistonin tetë shtete të mëdha, të cilat në vete ngërthenin shumë fe, shumë fraksione, kultura dhe raca: Perandoritë koloniale angleze dhe frënge, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia, Perandoritë ki-

no-japoneze, Perandoria Osmane dhe ShBA, të cilat dalngadalë po forcoheshin. Prej të gjitha këtyre strukturave lindën shtete kombëtare. ShBA t'i lëmë mënjanë, ato më vonë do ta tregojnë fuqinë e vet në skenën e historisë. Perandoria Gjermane u tkurr në shtetin kombëtar gjerman. Problemet e Gjermanisë lidhur me Europën e Mesme dhe me atë Lindore u përngjajnë problemeve që Turqia i ka me Lindjen e Mesme. Popujt e Europës së Mesme dhe Lindore janë simpatizues të gjermanëve, janë në sferën e ndikimit të gjermanëve, por nga ana tjetër qëndrojnë në distancë dhe frikësohen prej tyre. Këtë e vërejmë edhe në raportet që Japonia i ka vendosur në Paqësor, si dhe në ato të Ruisë në Azinë e Mesme e në Balltik. Perandoria Austro-Hungareze, e cila u shkatërrua, përbën strukturën më me pak pretendime. Të gjitha perandoritë e tjera janë ballafaquar me këtë pyetje: Çfarë raportesh të ndërtoj me zonat që më parë kanë qenë periferi në krahasim me qendrën? Çfarë politike të zhvilloj ndaj tyre në kushtet e reja? Këto pyetje i shtrojnë, sepse sikur të mos zhvillojnë politikë ndaj tyre, humbin në fuqi. Domethënë, nëse Gjermania e humb Europën e Mesme dhe atë Lindore ndahet në dysh. Nëse Rusia e humb Kaukazin, s'mund të ndihet e sigurtë as në Moskë. Këtu kam parasysh Kaukazin Verior dhe stepat. Turqia sado që të ndërtojë mure në raportet me Lindjen e Mesme, prapëseprapë Lindja e Mesme s'shkëputet dot prej saj. Edhe nëse mundohet të shkëputet, prapëseprapë çdo problem që lind atje e prek këtë vend. Kështu është edhe me Ballkanin... Turqia nuk kufizohet me Bosnjën. Sikur të mendonim si shtet

kombëtar, kishte mundësi që edhe të mos merreshim fare me këtë pikë nevralgjike. Por shtrohet pyetja përse bosnjakët kur kanë probleme, arrijnë masivisht në Kapikule e jo në ndonjë vendkalim kufitar të Austriës ose të ndonjë vendi tjetër? Pse problemet e Gjeorgjisë e preokupojnë Turqinë? Kjo e ka kuptimin e forcës, edhe pse në përgjithësi ata që mendojnë në mënyrë statike, thonë se përbën dobësi ose rrezik. Sipas meje, nëse mendohet në mënyrë racionale, kjo shndërron në forcë. Kur? Kur nuk do të mbajmë ligjëratat epike, kur nuk do ta trishtojmë tjetrin dhe kur do të zhvillojmë një makrostrategji afatgjatë. Një gjë e tillë s'mund të bëhet me mikrostrategji dhe me hapa të vegjël. Kjo është thellësia strategjike e Turqisë.

Perceptimi i kohës dhe hapësirës strategjike

2023: Përveç nocionit të hapësirës që e shfrytëzoni në këtë bisedë, në veprën tuaj flisni edhe për kohën e për "ri-interpretimin e kohës dhe të hapësirës". Çka nënkuptoni me kohën dhe me hapësirën që i përdorni në këtë përkufizim?

Davutogllu: Natyrisht, kjo çështje e ka edhe prapaskenën e vet filozofike, pra domethënien filozofike të kohës e të hapësirës, subjekt ky që unë e lë jashtë debatit tonë. Me interpretim të kohës dhe të hapësirës strategjike nënkuptoj parametrat e fuqisë, të dhënat konstante apo reale të historisë e të gjeografisë. Të dhënat konstante janë gjëra të cilat në një periudhë

afatshkurtër dhe afatmesme s'mund të ndryshohen nga një vullnet i caktuar. Pra, një shoqëri jeton në një hapësirë gjeografike të caktuar. S'ka mundësi që popullin turk ta bartni në Azinë e Mesme nën pretekstin se "hapësira gjeografike e Turqisë është problemsjellëse". S'mund ta ndryshoni historinë duke thënë se "Historia jonë po na sjell shumë telashe, na detyron t'i fusim hundët gjithkund", ju jeni ai që jeni madje edhe nëse e refuzoni trashëgiminë tuaj. Te të tjerët, refuzimi i trashëgimisë s'ka kurrfarë kuptimi.

Kur flasim për të dhëna konstante, nuk duhen nënkuptuar të dhëna statike. Të dhënat konstante ka mundësi që përsëri të interpretohen. Dimensioni kohor dhe hapësinor, apo thënë më drejt historia dhe gjeografia në çdo periudhë mund të japin kuptime të ndryshme. Përgjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, gjeografia e Anadollit në dokumentet e NATO-s është emërtuar si "Barriera turke". Barrierë ndaj kujt? Ndaj rrezikut sovjetik. Zona prej bjeshkëve të Erzurumit deri në fushën e Konjës trajtohej si barrierë turke. Për atë kohë kjo mund të shihej si e qëlluar. Sepse Turqia ka qenë pengesë në rrugët e zbritjes së Bashkimit Sovjetik në detet e nxehta. Kurse tash nuk jemi pengesë, jemi hapësirë kalimtare. Pra Anadulli duhet interpretuar si zonë kalimi e jo si pengesë. Ai që, duke menduar me kallëpet e Luftës së Ftohtë, Turqinë e sheh si barrierë, ende s'i ka ri-interpretuar të dhënat.

E ndryshme ishte pikëpamja rreth historisë, e shfaqur në periudhën e formimit të shtetit kombëtar, kur shteti kombëtar u zhvillua në saje të industrializimit dhe të mbrojtjes së brendshme. Por kur shteti

kombëtar, me kalimin prej industrializimit në periudhën e industrisë pozitive e të shoqërisë tejindustriale, u detyrua të dilte jashtë masave mbrojtëse dhe kur u stabilizua, ndryshoi edhe pikëpamja rreth historisë. Në fillim ballafaqimi mund të duket i arsyeshëm dhe i përshtatshëm me koniunkturën ndërkombëtare. Por, të njëjtën politikë s'mund ta ndiqni në periudhat e mëvonshme. Në atë periudhë shteti kombëtar duhej t'i lante hesapet me historinë e vet. Por në etapat e mëvonshme i njëjti shtet kombëtar, duke i marrë parasysh të dhënat historike, detyrohet të zhvillojë politikë të re, detyrohet që ato të dhëna t'i ri-interpretojë. Për shembull, Turqia që nga lufta e Krimesë ka marrëdhënie të afërta me Perëndimin. Duke i interpretuar vazhdimisht këto marrëdhënie, janë zhvilluar koncepte të reja. Sot s'ka mundësi të mbijetoni me diçka statike. S'mund të thoni "Ne e kemi ndalur në një pikë të caktuar historinë dhe ia fillojmë prej këtu". Në të kaluarën e afërt nuk kishte nevojë që shumë e shumë ta shprehnim mendimin tonë lidhur me shtetin osman. Kjo për arsye se bota dypolëshe na kishte rrethuar me mure, të cilat s'na lejonin që të diskutonim përsëri rreth këtij shteti vigan islam. Domethënë, kufiri i Turqisë me Bashkimin Sovjetik nuk ishte kufi mes këtyre dy shteteve, por kufi i NATO-s me Paktin e Varshavës. Edhe sikur të donit s'mund të ndërhynit nëse vriteshin çeçenët, e as ata mund të ndërhynin në Turqi. Kjo vlente edhe për kufirin e Turqisë me Bullgarinë, edhe ai ishte kufi mes NATO-s e Bllokut Lindor. Çështja e turqve të përtej kufirit vlerësohej në kuadër të dy poleve ideologjike. Por tashmë nuk

është si më parë, rrethanat ndryshuan e natyrisht edhe pikëpamjet. Gjeorgjia në raport me Turqinë domosdo veten e sheh si një vend në periferi të shtetit osman. Tanimë Shevarnadzja fqinjët s'mund t'i shikojë me syrin e ministrit të punëve të jashtme të Bashkimit Sovjetik, e as nga perspektiva sovjetike.

Para 20 viteve në Turqi sa njerëz dinin diçka për Bosnjën? Çka ngjallej në kokën e njerëzve kur përme-ndej Sarajeva? Sa kishim njohuri për Shkupin jashtë njohurive letrare të atyre që kishin lexuar Jahja Kema-lin? Por sot Sarajeva dhe Shkupi në çdo çast janë në-për televizionet dhe mediat tona. Nëse atje lëviz një gjethe, menjëherë në Kërklareli hapim kamp ikana-kësh. Ja, pra këto ndryshime na detyrojnë që historinë ta riinterpretojmë. S'mund të thoni "Ne nuk jemi shteti osman, jemi shtet i ri kombëtar dhe s'kemi lidh-je me bosnjakët ose shqiptarët", sepse këto etnose ju detyrojnë të merreni me ta. Kjo është ajo që unë nën-kuptoj me riinterpretimin e historisë. Duhet që koha dhe hapësira të riinterpretohen në përputhje me koni-unkturat që do të ndërtohen pas 20 ose 30 viteve. Ju jeni pjesë e asaj historie dhe ata janë pjesë e juaja. Për këtë arsye jemi të detyruar që në vend të interpreti-meve statike, të zhvillojmë interpretime dinamike dhe vazhdimisht të jemi të hapur e t'i ndjekim zhvillimet e reja. Me siguri që gjendjen e Turqisë së vitit 2023 nuk mund ta sqaroni me parametrat statikë të kohës sonë, por duke i marrë parasysh dinamikat dhe ndry-shimet e njëpasnjëshme në hapësirë dhe kohë, duke bërë riinterpretime.

2023: Folët për procesin e Luftës së Ftohtë. A thua Turqia pas këtij procesi ka ndryshuar diçka në pikëshikimin e politikës ndërkombëtare? Mos vallë kemi mbetur brenda kallëpeve të periudhës së Luftës së Ftohtë?

Turqia u kap e papërgatitur

Davutogllu: Në disa pika kemi mbetur në kallëpet e përmendura, kurse në disa të tjera kemi kaluar në një strukturë dinamike. Diplomacia turke ka një veçori shumë të rëndësishme, që ka pasojat e veta pozitive dhe negative. Tek turqit, që nga Marrëveshja e Karllovcit ka lëshuar rrënjë psikologjia e një shteti, kufijtë e të cilit vazhdimisht ngushtohen dhe të një shteti që vazhdimisht zvogëlohet. I kemi braktisur në mënyrë absolute vendet, të cilat i kemi sunduar dhe sot e kësaj dite me plot telashe po mundohemi ta mbrojmë tokën që e kemi. Ky konstelacion tek ne i ka nxjerrë në plan të parë kërkimet e koniunkturave të stabilitetit dhe ato statike. Mendësia jonë diplomatike është formësuar sipas këtij parametri dhe për këtë arsye diplomacia turke është shumë e suksesshme - si në rastin e Qipros - në ruajtjen e status quo-së. Domethënë, ne bëjmë manovra të suksesshme në ruajtjen e gjendjes ekzistuese. Por, nëse shfaqet një koniunkturë dinamike, na kaplojnë telashtet se a thua prapë do të zvogëlohemi ose do të ballafaqohemi me rreziqe të ndryshme. Kjo ka pasojat e veta psikologjike. Për këtë arsye ne jemi të qetë, nëse ruhet gjendja statike dhe

gjithmonë dëshirojmë që mos të bëhen ndryshime. Dhe mu për këtë arsye në përgjithësi në fazat e mëvonshme kapemi të papërgatitur. Turqia, pas Luftës së Ftohtë u kap e papërgatitur, jo vetëm diplomatët e saj, por edhe universitetet. Për shembull, shtrohet pyetja sesa ekspertë të gjuhës ruse kemi? Sa njerëz kemi që i njohin profesionalisht gjuhët e Ballkanit ose gjuhën arabe? S'kemi fare ose kemi shumë pak. Një shoqëri që dëshiron t'i hapet botës duhet të ketë një tablo krejt tjetër. Gjermanët nuk janë në gjendje të këtillë si jona. Ata qysh në vitin 1968-1969, që nga koha kur Vili Brandti shpalli politikën e vet të lindjes (*Ostpolitik*), mori iniciativë dhe bëri përgatitje të jashtëzakonshme. Turqia s'ka kaluar ndonjë periudhë të këtillë të përgatitjes. Jo që s'kemi bërë përgatitje për Azinë e Mesme, por trishtime shkaktonte dhe biseda rreth marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Në të vërtetë mund të bëheshin përgatitje pa i tensionuar vendet e tjera. Në atë kohë s'kishte kurrfarë pengese që Azinë e Mesme t'ua ndanit insitucioneve, të cilat merren me hulumtime shkencore. Në këtë drejtim u kapëm të papërgatitur. Së pari, qemë të papërgatitur dhe kur pamë hapësirë të madhe për manovra, reaguam në dy mënyra: Reaguam në mënyrë irracionale, me slogane, në mënyrë emocionale, pa parapërgatitje, duke i shqetësuar faktorët që na rrethojnë, dhe nga ana tjetër, na kaploi frika se në koniunkturën e re Turqia do të copëtohej. Të dyja këto reagime ishin ekstreme. Ishin reagime jo të shëndosha të elitës politike dhe burokratike. Kanë kaluar 11 vite që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe te ne ende ka lëkundje e zig-

zage serioze ideore. Madje edhe në rastin e ngjarjeve të vogla, na përshkojnë shpresa të pafundta. Mendoj se është koha që të stabilizohemi. Shumë parametra të periudhës pas Luftës së Ftohtë ende nuk janë përcaktuar. Armëpushimet e Luftës së Ftohtë janë bërë, kurse marrëveshjet jo. Në këtë fazë kohore nuk është arritur të vihen konturet e rendit, gjë kjo që po i shqetëson të gjithë aktorët. Për Turqinë është e dobishme që tanimë ta bëjë llogarinë e vet. Çka ka mundur dhe çka s'ka mundur të bëjë. Mendoj se është me rëndësi që të bëhen vlerësime të këtilla.

2023: Çka mund të thuhet për rendin e ri botëror, për të cilin flitet pas 11 shtatorit?

Davutogllu: Në periudhën moderne, marrëdhëniet ndërkombëtare ripërkufizohen pas çdo lufte të madhe. Pas Luftërave Tridhjetëvjeçare u nënshkrua Marrëveshja e Vestfalisë, me të cilën doli në skenë shteti kombëtar. Luftërat e Napoleonit, Revolucioni Francez me të cilin erdhën idetë nacionaliste, menjëherë pas tij Kongresi i Vjenës, ku u vunë themelet e rendit të ri. Pas Luftës së Parë Botërore u formua Lidhja e Kombeve. Por me këtë sistem nuk u arrit të viheshin themelet e një rendi të ri. U formua Organizata e Kombeve të Bashkuara, periudhë kjo në të cilën do të përjetohet Lufta e Ftohtë. Marrëveshja e Teheranit dhe ajo e Jaltës e përcaktuan rendin politik, kurse institucionet si FMN-së, Banka Botërore - sistemin ekonomik. Kombet e Bashkuara gdhinë si faktor i ri i rendit ndërkombëtar. Në këtë periudhë çdo shtet e mori vendin dhe pozitën e vet. Detyrë e çdo shteti në këtë rend është luajtja mirë e lojës, në përputhje me

rregullat e vëna, e jo futja në llogore. Pas Luftës së Ftohtë u përjetuan shumë luftëra ose thënë më mirë, me shembjen e Murit të Berlinit dhe të Kullave Binjake, të gjithë aktorët filluan të gërmojnë llogore. Pas Luftës së Gjirit Iraku u tërhoq prej Kuvajtit, por gjendja e këtij shteti ende është e mjegullt. Prosesi i paqëtimin në Lindjen e Mesme ka kuptimin e armëpushimit. Shtrohet pyetja nëse tash ekziston shteti i Palestinës dhe nëse ai ekziston, cilët janë kufijtë e tij? Ende s'është arritur marrëveshje. Marrëveshja e Dejtonit në fakt nuk është marrëveshje por armëpushim. Sot është e diskutueshme madje nëse shteti i Bosnjës mund të qëndrojë në këmbët e veta. Gjendja e Kosovës po ashtu nuk është e kthjellët. Gjithkund armëpushime. Pra, lirisht mund të thuhet se pas Luftës së Ftohtë ende nuk ka lindur rendi i ri botëror.

Natyrisht, shkohet drejt një strukturimi shumëpo-lësh, drejt një strukturimi të cilin e quajmë ekuilibër forcash, në të cilin ShBA kanë rolin e balancuesit. 11 shtatori këtë e tregoi në mënyrë më domethënëse. Reagimet pas 11 shtatorit në një mënyrë e pasqyruan shqetësimin e akumuluar nga ky kaos. Dhe si përgjegjës i kësaj gjendjeje kaosi u akuzuan ShBA. Për gjendjen e krijuar në periudhën deri në ndodhinë u kritikuan ShBA nën pretekstin se s'e kanë siguruar rendin dhe çdokush, meqë e dinte se kjo është një periudhë kalimtare, u ngujua në llogoren e vet. Për shembull, Gjermania, duke e zhvilluar thellësinë e Bashkësisë Europiane, duke krijuar euron, bëri një llogore që do t'i ndihmonte kësaj njësie të re monetare kundër dollarit amerikan. Është shumë me rëndësi që Gjermania

një gjë të tillë e realizoi në këtë kohë të lëkundjeve. Ky hap Gjermanisë i ka mundësuar të marrë pozitë mjaft të rëndësishme strategjike.

Sot çdokush po hap llogoren e vet. Nëse i kthehemi Turqisë, do të shohim se në fakt arritjet tona nuk janë të ulëta. Këtë e them lidhur me nivelin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të nismave strategjike. Për shembull, jemi lidhur me NATO-n dhe ShBA. Në saje të bisedave për anëtarësim në BE kemi vendosur marrëdhënie me Europën. Jemi të lidhur edhe me Organizatën e Konferencës Islamike dhe me botën islame. Duke e zgjeruar ECO-n i kemi futur në këtë korvizë Afganistanin dhe gjashtë vende të tjera të Azisë së Mesme. Në saje të marrëveshjes së Bashkëpunimit të Detit të Zi kemi bërë përpjekje që të zhvillojmë marrëdhënie mes shteteve të Detit të Zi. Kemi bërë përpjekje edhe për hope të reja, siç ishte organizata D-8. Janë organizuar edhe samitet turke. Të gjitha këto ishin aspekte të hapjes së Turqisë ndaj botës së jashtme, por ç'e do që nuk kanë qenë funksionale, nuk kemi arritur që asnjërin prej tyre ta shfrytëzojmë siç duhet. Në saje të ECO-s u zgjeruam në Azi, arritëm të futemi në bashkëpunim me Iranin dhe Pakistanin. Në saje të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi u orientuam drejt Rusisë, e cila u shqetësua për shkak të ECO-s. Irani s'ishte i kënaqur me Bashkëpunimin ekonomik të Detit të Zi. Tash ka probleme në Afganistan dhe Turqia s'arrin ta vërë në lëvizje ECO-n. S'dihet se kur do të fillojë të lëvizë kjo organizatë. Tash është koha më e përshtatshme. Të gjitha vendet që ia mbajnë anën Afganistanit janë anëtare të ECO-s. Nëse

Turqia merr një iniciativë dhe i thërret të gjitha këto vende që ta përcaktojnë së bashku ardhmërinë e Afganistanit, përnjëherë formohet një fushë tërheqëse. E pse pra, po pritet? Sipas të gjitha gjasave, po pritet drita e gjelbër prej ShBA. Për fat të keq, s'kemi arritur t'i vëmë në lëvizje organizatat që i kemi themeluar dhe zgjeruar vetë. Në letër duket se kemi bërë një llogore, por duhet një nismë që do t'i vinte në lëvizje ato. Madje edhe nëse e zhvilloni strategjinë më të mirë në botë, gjithmonë duhet ta merrni parasysh edhe mentalitetin. Kjo i përngjan drejtuesit të orkestrës, i cili duhet t'i bashkërendojë zërat e të gjitha veglave muzikore që është duke i dirigjuar. Në Turqi brenda kësaj kohe janë ndërruar shumë drejtues të orkestrës, shumë ministra të punëve të jashtme, shumë kryetarë shteti. Politikën e parapëlqyer nga njëri, tjetri e ka zbatuar në mënyrë krejtësisht tjetër. Hapat nuk janë hedhur njëri pas tjetrit. Në këtë periudhë në Gjermani disa udhëheqës kanë qenë nga Partia Demokristiane e disa nga ajo Social-Demokrate, por të gjithë ata janë pjesë e një vazhdimësie. Kurse te ne zëvendësohet kryetari dhe me të ndryshon gjithçka. Për shembull, Demireli ka qenë shumë ekstern, kurse Sezeri është shumë intern dhe po preferon një politikë që s'del jashtë kornizave të së drejtës. Momentalisht, në kohën kur është më i nevojshëm, në politikën tonë të jashtme nuk kemi dirigjent të politikës së jashtme, me lidhje nga jashtë dhe me cilësi karizmatike. Fotografia na del edhe më e keqe kur kemi parasysh faktin, se në këtë kohë kemi një konstelacion të marrëdhënieve të shkëputura. Këto rrethana e pengojnë dirigjentin të

bëjë planifikim dhe të shprehet "Tash le të bëjë muzikë ky instrument, e pas tij instrumenti tjetër që i përshatet atij".

2023: A thua strategjia jonë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare kaq shumë varet prej liderëve? Ose, a thua duhet që kaq të varet prej tyre?

Davutogllu: Sipas meje, jo. Siç kam theksuar edhe në veprën time, këtu hyn në punë dallimi mes makrostrategjisë dhe mikrostrategjisë. Makrostrategjinë e përcaktojnë liderët, por s' duhet harruar se institucionet që do ta zbatojnë atë në mikrorrafsh duhet të jenë të zhvilluara mirë. Domethënë universitetet, dhomat e tregtisë, atashetë kulturorë, ambasadat etj. Nëse nuk është arritur që në mendjen e një udhëheqësi të një firme të ngjallet përshtypja se nga është duke shkuar Turqia, udhëheqjen e asaj firme s' mund ta bësh pjesë të strategjisë së marrëdhënieve të ekonomisë së jashtme. Lideri i vendon gurët kilometrikë të makrostrategjisë dhe zbatuesit e makrostrategjisë ecin pa dalur jashtë vijës së gurëve në fjalë. Mungesa e liderëve shkakton shkëputje, shkakton mosvënien në vendin e vet të gurëve kilometrikë. Lideri nuk është zgjidhje në vetvete, nuk mjafton as për kapërcimin e një problemi, por ka rëndësi të veçantë në ndërtimin e politikës së jashtme. Çdo institucion duhet të jetë në veprim. Çdokush duhet të veprojë duke e ditur pozitën e vet. Në Turqi, shumë institucione disa herë në mënyrë të paautorizuar e disa herë me autorizim hyjnë e dalin nga procesi i përjetuar dhe mungesa e liderit e tregon veten pikërisht aty. Nevojitet aftësi që këto institucione të detyrohen të punojnë në harmoni. Në këtë drej-

tim duhet të merret vendim nëse lidhur me këtë çështje do të jetë përcaktuese qeveria ose Këshilli Kombëtar i Sigurisë. Kohëve të fundit ka një anim në drejtim të këshillit të zënë ngojë. Kjo mund të shkaktojë probleme në lidhje me marrësit e jashtëm të autoritetit politik. Një gjë që s' duhet harruar është edhe ajo, se edhe populli duhet të motivohet në çështjen e politikave të jashtme. Nëse universiteteve nuk u ndani mjete të mjaftueshme dhe nëse nuk ua jepni mundësinë për ta shprehur mendimin e vet, s' mund të prisni rezultate. Pra çdokush do ta shprehë mendimin e vet dhe ju si politikëbërës do ta keni mundësinë për të zgjedhur mendimin më të përshtatshëm. Por nëse keni vetëm një alternativë, për shembull nëse çdokush është kushtëzuar që marrëdhëniet mes Turqisë dhe Greqisë t' i shohë vetëm nga prizmi negativ, nëse pohon se "Ne këtë shtet e kemi themeluar duke luftuar kundër grekëve", tek ata që synojnë të paraqesin politika alternative në raportet mes këtyre dy vende mbjellin frikën dhe njerëzit natyrisht, fillojnë t' i shtrojnë vetes pyetjen "A thua nëse them diçka lidhur me këtë çështje, mund të keqkuptohem?" dhe kështu humbet alternativa. Po ashtu nuk do të keni gjasa të përgatitni personel dhe të zhvilloni alternativa edhe nëse rusët i shikoni nga dritarja e "Moskës", kurse Lindjen e Mesme në bazë të paragjytimeve. Ka mundësi që të merrni pozitën e "skifterit", por duhet që t' u jepni mundësi edhe pëllumbave t' i hapin krahët, po edhe nëse e parapëlqeni pozitën e "pëllumbave", duhet që t' u jepni mundësi edhe "skifterëve" që t' i shfaqin sqarimet e veta. Kjo ka qenë përparësia e

ShBA ndaj Bashkimit Sovjetik, i cili politikën e jashtme e zhvillonte në mënyrë monolitike, me një formacion ideologjik njëtrajtësh. Për këtë arsye s'arriti që në asnjë vend t'i nxirrte në plan të parë interesat e veta dhe vazhdimisht bëri investime të gabuara. Ka bërë investime nëpër shtete që i rrisnin shpenzimet ushtarake dhe që nuk sillnin kurrfarë leverdie ekonomike. Ka investuar në Siri, në Jemen, në Etiopi, vende këto që s'kanë fare naftë. Nga ana tjetër, ShBA kanë me dhjetëra institucione strategjike që gjenerojnë teza dhe skenare të ndryshme. Madje kanë edhe institucione, të cilat incizojnë filma që ndërliidhen me strategjinë amerikane. Tash pas 11 shtatorit skenaristëve filmikë të Holivudit u jepen porosi për përgatitjen e skenarëve të sulmeve të mundshme në të ardhmen. ShBA i vënë në sprovë horizontet mendimore të njeriut, i thonë vetes "Të shoh se me çka mund të ballafaqohem". Në këtë mënyrë ky shtet ia hap shtigjet lirisë së mendimit, që mund të krijojë alternativa të politikës së jashtme, ia hap rrugën institucionalizimit të mirëfilltë të bazuar në mendimin e lirë. Shtrohet pyetja se sa qendra hulumtimi kemi, që mund të "skuqen" me vajin e vet, që mund të thonë diçka me peshë? Shumë të dobëta na dalin edhe qendrat shtetërore të hulumtimit, kur i krahasojmë me vendet e ngjashme të botës. Universitetet merren me shumë probleme të tjera. Në këtë drejtim luan rol edhe pamjaftueshmëria e stimullit material. Në përgjithësi ka një boshllëk të madh.

Misioni i Turqisë

2023: Turqinë po e cilësoni si qendër të boshteve Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim. A mund të na e shpjego- ni këtë vlerësim tuajin dhe përcaktimin e Turqisë sipas po atij vlerësimi? Në këtë konstelacion Turqia çfarë mi- sioni ka?

Davutogllu: Turqia në shumë raste përkufizohet si “shtet urë”, por unë më tepër parapëlqej shprehjen “shtet qendër”. Të qenët vend qendror në të njëjtën kohë e ngërthen në vete edhe të qenët urë. Turqia, shikuar nga këndi i koncepteve strategjike ndërko- mbëtare, është në qendër të Eurazisë, por mbi rrugët kalimtare Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim. Pra urë, por në një vend qendror. Domethënë, asgjë përreth Turqi- së s’mund të kuptohet pa Turqinë. Për shembull, Irani dhe Iraku janë vende të Lindjes së Mesme, Greqia është vend ballkanik, kurse Turqia është vend i Lin- djes së Mesme, vend ballkanik, i Kaukazit, i Detit të Zi dhe vend mesdhetar. Pra, një shtet me një pozitë strategjike... Shikuar nga prizmi i ekonomisë dhe i po- litikës, Turqia për nga numri i popullatës dhe të tre- guesve të përgjithshëm të ekonomisë së saj është një vend ndërmjet Veriut dhe Jugut. Nuk është vend i ve- riut me popullatë të paktë dhe me të ardhura të larta për frymë banori, por nuk është as vend i Jugut me popullatë jocilësore, numri i popullatës së të cilit shto- het në mënyrë të pakontrolluar. Ka një popullatë di- namike dhe indikatorë që tregojnë standard kalimtar mes Veriut dhe Jugut. Në aspektin kulturor është

vend që mund të ketë ndikim prej qendrës drejt periferisë, por meqë nuk e ka përkufizuar si duhet kulturën e vet, mund të mbetet në pozitë pasive. Turqia është skaji i Lindjes dhe përfaqësuesi i fundit i saj. Perëndimi vazhdimisht do të na shikojë kështu. Turqia është vend lindor që ka arritur deri në Vjenë. Si përfaqësues i fundit i Lindjes, si osmanli... Por nëse e trajtoni periudhën e Republikës dhe të Luftës për Pavarësi, Turqia na del si vend lindor që i bën rezistencë kolonializmit perëndimor. Në një mënyrë është vend lindor, i tillë madje edhe duke u perëndimorizuar. Por nëse e shikojmë nga Lindja, na del para si zëdhënës i Perëndimit në Lindje. Është mjaft me rëndësi që kjo gjendje dyshe të vlerësohet mirë, të formohet ndjenja e vetëbesimit. Por nëse s'ka vetëbesim brenda, shfaqet potenciali që mund të gjenerojë tendosje dhe përplasje të brendshme. Dhe e humbni besimin edhe te të tjerët. Perëndimi s'ju beson se jeni perëndimorë, e as lindori s'ju beson se jeni lindorë. Kurse një formulim tjetër lind, nëse Lindja Turqinë e shikon si "zëdhënës të Lindjes në kuadër të Perëndimit", kurse Perëndimi, si "shtet që në kuadër të Lindjes në përmasat më të mëdha është duke e përjetuar perëndimorizimin". Por në shumë vende s'janë harruar as qëndrimet lidhur me pozicionimin e vetes sonë. Për shembull, flitet se në rastin e Algjerisë i kemi mbajtur anën Francës. Nëse Turqia shikohet si vend që sillet sipas dëshirave të të tjerëve e jo si shtet i pavarur, nëse për shkak të borxheve të jashtme shihet si vend i përulur ndaj Perëndimit, kjo do të thotë se jeni tëhuajësuar si ndaj Lindjes ashtu edhe ndaj Jugut. Nga ana tjetër,

nëse vazhdimisht e përjetojmë tendosjen se “Perëndimi po na copëton, do të na copëtojë”, atëherë edhe Perëndimi na shikon me tendosje. Ne pra, po e përjetojmë këtë dilemë. Këtë situatë unë e shpjegoj me shembullin e shigjetës dhe të harkut. Fati i Turqisë varet prej asaj sesa e ka tërhequr prapa harkun. Nëse harkun e tërheqim në drejtim të thellësisë së Azisë, kemi mundësi që në drejtim të Europës të hedhim një shigjetë shumë larg dhe me ndikim. Nëse Turqia nuk beson se Azia e ka thellësinë e vet, asnjë europian nuk shikon në fytyrën e Turqisë. Do t’ju shikojnë si vend në të cilin afër Efesit mund të kalohen bukur pushimet, por jo edhe si fuqi strategjike. Në Perëndim keni ndikim dhe peshë aq sa e keni ndikimin dhe peshën në Lindjen e Mesme. Këtë duhet ta dimë mirë. Sikur selxhukët të mos e tërhiqnin harkun, osmanllinjët nuk do të merrnin hov drejt Europës. Kjo është ajo që unë nënkuptoj me shprehjen shtet qendror dhe me ekuacionin Veriu-Jugu dhe Lindja-Perëndimi.

2023: Për Turqinë janë dhënë përkufizimet *shtet strumbullar, shtet i ndarë*. Kjo sipas jush e ka kuptimin se “në vete bartim potencial të brendshëm”. Më tutje pohoni se ky potencial mund të vihet në lëvizje...

Davutogllu: Po. Unë shprehjen *torn country*, të cilën Hantingtoni e sheh si mangësi, e shoh si burim të fuqisë. Pra, copat të cilat duket se janë të ndara mes vete, kur të tubohen mund të japin potencial të madh. Shtetet si Kuvajti, Jordania që janë homogjene, që s’ngërthejnë kurrfarë diversiteti, që përbëhen prej njerëzve të llojit të njëjtë, që prodhojnë naftë, që janë të lidhura me një fis konsumues arab, që nuk reflektojnë

gjëra të ndryshme, s'mund të kenë as pretendime të mëdha. Nëse në indin tuaj si shtet mund t'i integroni tërë popujt e Ballkanit, si bosnjakët, shqiptarët, pomakët etj., të gjitha fiset e Kaukazit, të gjitha bashkësitë e Lindjes së Mesme, kurdët, arabët, kjo do të thotë se jeni të fuqishëm, e jo se jeni i copëtuar. Ky diversitet e përbën tërësinë. Uniteti dhe shpërthimet e mëdha të fuqive botërore kanë vijuar pas ndarjes. Për shembull, lufta civile gjermane... Lindja e romantizmit gjerman nga kuadri i përçarjes gjermane. Është Lufta qytetare angleze ajo që e ka lindur konfederatën angleze... Nga Franca e përçarë prej revolucionit lindi kultura frënge. Në këtë kuptim, duke përfituar prej këtyre përvojave mund të vijmë në përfundim edhe për gjendjen dhe pozitën tonë. Në gjuhët e ndryshme botërore ka lidhje të ngushtë ndërmjet termave qëndrojnë dhe kuptoj. Në gjuhën angleze shprehja *stand* e ka domethënien qëndrojnë, kurse ajo *understand*, kuptoj. Në gjuhën gjermane barasvlera e këtyre fjalëve janë shprehjet *stehen* dhe *verstehen*, kurse në gjuhën arabe shprehja *vakafe*. Pse po i përmendim këto gjëra? Sepse në shumë gjuhë qëndrimi nuk e ka domethënien e të qenët statik. Ta marrësh perspektivën e vendit në të cilin po qëndron, ta kuptosh atë. Nëse Anadollin, gjegjësisht gjeografinë në të cilën jetojmë, e njohim mirë dhe nëse në bazë të kësaj diturie e zhvillojmë një identitet të shëndoshë, më mirë do t'i kuptojmë edhe ngjarjet që pasojnë. Por nëse në një vend sillemi si perëndimorë e në një tjetër si lindorë, nëse s'arrijmë ta reflektojmë as këtë e as atë botë, s'ka mundësi t'i kuptojmë çështjet e as të kuptohemi prej të tjerëve.

2023: Si e shihni ardhmërinë e Turqisë pas dhjetë vjetësh?

Davutogllu: Gjithçka varet prej nesh. Turqia është në udhëkryq. Ka tre opsione. E para: Globalizimi është një dallgë dhe një proces i pashmangshëm. Ne jemi një gjethe që kemi rënë mbi lumin e globalizimit. Ku të na çojë ky proces, atje do të shkojmë. E tërë kjo gjendje s'jep mundësinë për ta kuptuar historinë, gjeografinë dhe shumë komponente të tjera të Turqisë. Ky qëndrim ndaj globalizimit është pozitë pasive. Qëndrimi i dytë është ai i mbylljes në vetvete për arsye se "po vijnë dallgët që do të na godasin". Asnjë shtet s'ka gjasa të mbijetojë i mbyllur. ShBA mund të mbylleshin në vetvete në kuadër të doktrinës së Monrosë, sepse janë kontinent dhe shtet i ishullit. Japonezët mund të mbylleshin, sepse edhe Japonia është shtet ishullor. Por Turqia s'mund të mbyllet. Kjo hapësirë s'mund të mbyllet në vetvete. Nëse mbyllet do të fillojë të ndahet e të copëzohet. Duhet ndjekur rruga e tretë, e cila sipas meje është zgjidhja më e mirë. Nëse e bëjmë këtë, horizontet e Turqisë do të jenë shumë të hapura. Rruga në fjalë ka këtë domethënie: T'i kuptosh drejt vlerat vendore të Turqisë, ta kuptosh tërësinë e formuar nga pjesët, t'i perceptosh mirë thellësitë e kohës dhe të hapësirës, të historisë e të gjeografisë dhe ta përcaktosh mirë pozitën, t'i hapësh botës me gjithë potencialin... Një popullatë kaq e madhe nuk duhet t'i frikësohet hapjes. Por nëse nuk e dini ritmin e kësaj hapjeje, nëse nuk keni kuadro të forta që do ta ndjekin këtë ritëm, atëherë mund të bini në qorrsohak. Për këtë punë duhet një grup intelektu-

alësh, një elitë politike dhe ekonomike që do ta mbajë ritmin e kësaj rrjedhe. Tash për tash mungesa jonë është pikërisht në këtë segment. Për këtë arsye duhet t'i bëjmë hapat me kohë. Nëse arrijmë sukses në këtë drejtim, ardhmëria e Turqisë pas dhjetë ose njëzet viteve do të jetë e ndritur; në vitin 2023 do të mund të flasim për Turqi shumë më të fortë dhe më me ndikim. Nëse s'arrijmë sukses në këtë drejtim, edhe në vitin 2023 do t'i përjetojmë të njëjtat paranoja, të njëjtat përçarje, do të jemi edhe më tej në gjendje pasive.

2023: Në të kaluarën mesazh jepte osmanlliu, sot vlen mesazhi i botës perëndimore. Cili duhet të jetë mesazhi që Turqia e re duhet ta bartë me vete në këtë hapje ndaj botës së re?

Davutogllu: Turqia e ka porosinë e vet... Jo në kuptimin e një patriotizmi llafesh. Turqia ka pozitë të atillë në raportet mes Perëndimit dhe Lindjes, që e gjeneron edhe vetë porosinë. Moderniteti është eurocentrik. Kurse globalizimi do t'i futë në rrjedhën e historisë të gjitha elementet e historisë dhe të njerëzimit. Dhe në procesin e globalizimit në plan të parë dhe porosidhënës do të jenë shtetet e shoqëritë, që në vete i ngërthejnë këto elemente historike, që janë fqinjë me to, që munden t'i kuptojnë mirë ato elemente. Dime thënë, tash e tutje të jesh zëdhënës i modernitetit eurocentrik në plot kuptimin e fjalës, do të thotë i një vendi që nuk ia jep detyrën e mesazhdhënies, sepse zëdhënësit e tij tanimë ekzistojnë. Nga ana tjetër, na dalin para ligjërata shumë të vjetruara. Mesazhet e Kinës, të Japonisë, të Lindjes dhe të lindorëve që kanë mbetur në Lindje mund të jenë autentike dhe ekzoti-

ke, por e kanë vështirë të barten në nivelin global. Sepse qytetërimi kinez dhe ai hindus asnjëherë nuk kanë pasur dimension global. Kurse trashëgimia jonë nuk është e tillë, shteti osman ka qenë realizuesi i fundit i globalizimit në kuptimin e ngushtë të fjalës. Kjo është trashëgimia jonë. Sipas meje, jetësuesi i parë i globalizimit është Aleksandri i Madh, për arsye se në shtetin e vet i ka përmbledhur shumë pellgje qytetërimi... Kurse jetësues i fundit i globalizimit është shteti osman antik. Shprehja antik nënkupton thellësinë e trashëgimisë njerëzore. Nëse mund t'i kapim damarët kryesorë të një trashëgimie, nëse ia dalim ta ballafaqojmë këtë trashëgimi me modernitetin, do t'ia hapim shtigjet globalizimit dhe do t'i kontribuojmë një mesazhi të ri.

*Takimi i qytetërimeve dhe roli i Turqisë**

Gyrkan Zengin: Ç'mendim kemi, mos vallë po ekzagjerojmë, ose ky takim ishte me të vërtetë kaq i rëndësishëm?

Davutogllu: Me të vërtetë ishte një takim mjaft i rëndësishëm. Rëndësia e këtij forumi mund të trajtohet në tre rrafshe: 1. Çfarë kuptimi ka ky takim nga prizmi i së kaluarës filozofike dhe historike? 2. Çfarë kuptimi ka nga këndi i kërkimeve të rendit ndërkombëtar? 3. Çfarë kuptimi ka nga spektri i orientimeve rajonale dhe strategjike? Forumi në fjalë kishte karakter diplomatik dhe politik. S'ka pasur tipare intelektuale, fetare dhe filozofike. Sipas meje, aspekti i qëndrueshëm i këtij takimi, ndoshta aspekti më i rëndësishëm bazat e të cilit duhet të mbushen mirë, është ai i pari. Shekulli XIX ka qenë shekull i Europës, kurse ai XX, deri në çerekun e fundit ka qenë shekull i Atlantikut. Por, që nga çereku i fundit i shekullit XX edhe te pellgjet tjera qytetërimore po shënohet gjallërim i dukshëm. Kina, India dhe shumë vende islame që në shekullin XIX ishin koloni të Europës, në shekullin XX e fituan pavarësinë e u futën edhe në krizë, edhe në lëvizje, në zhvillim e transformim serioz ekonomik, politik dhe kulturor.

* Debati lidhur me forumin "Takimi i qytetërimeve", mbajtur në Stamboll nën patronazhin e BE-së dhe organizatës së Konferencës Islamike, emisio-ni Editër, *CNN Türk*, 12 shkurt 2002.

Dhe rezultatet e kësaj ecurie filluan të duken. Sot në mesin e fuqive më të mëdha ekonomike llogariten Kina, Japonia dhe India. Gjallërim shënohet edhe në aspektin kulturor. Ky gjallërim në fund të shekullit XX dhe në fillim të atij XXI nga Hantingtoni u perceptua si kanosje, si rrezik dhe si burim krize. Në fakt, ky zgjim ishte shumë i rëndësishëm nga aspekti i vlerës së përgjithshme të trashëgimisë historike të njerëzimit, e kishte domethënien e rikthimit në skenën historike të trashëgimisë së tërë njerëzimit. Me këtë zgjim kultura perëndimore fitonte diversitet, kurse ajo botërore një begati. Teza e përplasjes së qytetërimeve, një zhvillim të këtille serioz dhe pozitiv e bënte kurban të një pragmatizmi strategjik mjaft të shëmtuar. Ç'është e mira, ndaj kësaj teze pati shumë reagime. Dhe sipas meje, forumi i Stambollit nuk mund të shihet vetëm si hap koniunktural, por si ndërmarrje e rëndësishme dhe e qëndrueshme.

Zengin: Ndoshta është një nga përgjigjet më të rëndësishme dhënë Hantingtonit?

Davutogllu: Po. Por nuk duhet të mbetet me kaq. Është e domosdoshme që të mbushet edhe prapaskena filozofike e historike dhe në këtë perspektivë duhet të bëhet ringjallja dhe "rindërtimi" i vetëdijes historike të Turqisë. Përndryshe e gjithë kjo përpjekje mund të mbetet vetëm në planin diplomatik dhe koniunktural.

Dimensioni i dytë ndër lidhet me rendin ndërkombehtar. Në periudhën dymbëdhjetëvjeçare që nga shembja e Murit të Berlinit e deri te shembja e Kullave Binjake bota, në vend që të shkojë drejt rendit, ka ha-

përuar drejt kaosit dhe mbi ujë kanë dalë shumë probleme të pazgjidhura. Kjo periudhë mund të quhet periudha e armëpushimeve të përkohshme. Pas sulmit ndaj Qendrës Tregtare Botërore disa qarqe përsëri deshën ta ndezin tezen e përplasjes së qytetërimeve. Forumi i Stambollit përbën tubimin më përfshirës pas 11 shtatorit dhe rezultatin më pozitiv pas kësaj date. Dhe për herë të parë, Perëndimi dhe Lindja janë takuar në një emërues të njëjtë. Bota ka nevojë për rend ndërkombëtar që nuk është i bazuar në kontroll dhe në ekuilibër, por në pjesëmarrje. Deri më tash, botës joperëndimore si në mekanizmat e OKB-së ashtu edhe në të tjerat nuk i është dhënë hapësirë për pjesëmarrje. Në të vërtetë, me globalizimin duhet të formohet një rend, në të cilin do të marrin pjesë të gjitha qytetërimet. Europa i ka rënë në të kësaj të vërtete. Nga vetëllogaria që po e bën vërehet se bota islame është në kërkim e sipër të një rendi.

Dimensioni i tretë ka të bëjë me rëndësinë strategjike, rajonale dhe koniunkturale. Sepse ky takim është bërë në kohën kur në Palestinë ka lëkundje serioze, kur Iraku, Irani dhe Koreja veriore janë shpallur si "bosht i djallit". Vazhdimisht në rend të ditës mbahet mundësia për të ndërhyrë në Irak. Ky forum ka formuar një bazament për të dhënë mesazh me peshë lidhur me Palestinën dhe Irakun. Në një mjedis të tillë, takimi në një pikë të Europës dhe botës islame, siç e përcaktuat drejt edhe ju, përbën një mesazh drejtuar tejAtlantikut. Tajmingu i kësaj mbledhjeje e ka kuptimin e zërit të përbashkët të BE-së dhe të botës islame kundër qëndrimit të përbashkët të Izraelit dhe të

Amerikës, kundër vendimeve të marra nga takimi Ariel Sharon-Bush, kundër tablosë që e legjitimon qëndrimin e Izraelit. Pohimi i ministrit të punëve të jashtme të Francës se zgjidhja e drejtë e çështjes izraelito-palestineze mund të bëhet vetëm me krijimin e shtetit palestinez, jep përshtypjen e mbështetjes së përpjekjeve të bëra në këtë drejtim. Kjo mbledhje si në çështjen e Irakut ashtu edhe në atë të Lindjes së Mesme, që gjendet në mesin e Afro-Eurazisë dhe në vijën ndërprerëse të botës islame, tregoi se Europa dhe bota islame mund të kenë qëndrim të përbashkët rreth disa çështjeve.

Zengin: Në atë pjesë pak më vonë do të hyjmë në detaje. Pra ju doni të thoni se sintagma "Fryma e Stambollit", pa marrë parasysh se me çka do të mbushet ajo, nuk është shprehje boshe.

Davutogllu: Nga perspektiva e Turqisë është mjaft me rëndësi. Ky forum është një nga zhvillimet e rëndësishme të realizuara vitet e fundit me iniciativën e Turqisë. Kohëve të fundit Turqia e pat humbur aftësinë për ta shfrytëzuar iniciativën në marrëdhëniet ndërkombëtare. Pas themelimit të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi dhe pas zgjerimit të ECO-s, s'është shënuar ndonjë projekt me peshë i filluar me nismën e Turqisë. Le të shpresojmë se ky nuk do të mbetet në gjysmë të rrugës si projektet e mëparshme, se do të shndërrohet në një projekt me vazhdimësi dhe do të japë ndihmesën e vet si në drejtim të paqes rajonale, ashtu edhe në atë të paqes globale.

Zengin: Në këtë forum mbajtën fjalime ministrat e vendeve të ndryshme, u organizuan panele, u shfa-

qën mendime të ndryshme. Në njërin prej këtyre paneleve mori pjesë edhe ministri i punëve të jashtme i Gjermanisë, Joshka Fisher. Ai dha porosi me gjilpëra për botën islame, të cilat shkaktuan reagime të shumta. E ftoi botën islame që të bëjë autokritikë. Fisheri në një vend ku gjendej edhe Organizata e Konferencës Islamike, e nënvizoi dobësinë e botës islame në çështjen e të drejtave të njeriut, të drejtave të grave dhe në atë të demokracisë. Në këtë drejtim duket se deri diku ka të drejtë, si thoni?

Davutogllu: Lirisht mund të thuhet se bota islame po kalon nëpër një proces të krizës dhe të transformimit të rëndësishëm. Nëse e shikojmë historinë islame, do të vërejmë se qytetërimi islam është ballafaquar me tri sfida serioze: kryqtarët, mongolët dhe kolonializmi ose qytetërimi perëndimor. Dy sfidave të para u bëri ballë më lehtë, sepse ishin të karakterit ushtarak. Kurse e treta me vete solli një nevojë për ballafaqim mendor. Dhe dy shekujt e fundit, bota islame po ballafaqohet me këtë sfidë. Me problemin e përshtatjes së balancave të veta me strukturat e reja. Në këtë aspekt ka pika në të cilat Fisheri ka të drejtë. Kurse është i gabuar shprehja e përsëritur shpesh nëpër mediat perëndimore, kur thuhet se "Bota islame shpreh pezëm ndaj Perëndimit me qëllim të mbulimit të problemeve të veta". Kjo për arsye se nëse i fokusojmë vendet që janë fli e paqartësive të periudhës dymbëdhjetëvjeçare pas Luftës së Ftohtë, do të shohim se në krye janë bashkësitë myslimane dhe ato të Afrikës. Vrasja e 250 mijë bosnjakëve në luftën mes viteve 1992-1995, përdhunimi i grave bosnjake, vujatjet

në Palestinë, në Irak, në Çeçeni, në Kosovë nuk janë probleme që burojnë nga brendësia e botës islame, por nga mjegullia në rendin ndërkombëtar. Hapësira gjeografike që emërtohet si botë islame i ngërthen në vete brezat më strategjikë të botës, faktet qytetërimore më komplekse dhe diversitetet më të shquara kulturore.

Zengin: A thua këta faktorë e pengojnë zbatimin e demokracisë në botën islame?

Davutogllu: Në një aspekt po. Mund të themi se përpjekjet për demokratizim në Europën Lindore pas Luftës së Ftohtë patën mbështetje të madhe, kurse përpjekjet për zbatimin e demokracisë në botën islame nuk kanë mbështetje të mjaftueshme në opinionin perëndimor. Në të gjitha vendet arabe mbizotërojnë regjime antidemokratike, gjë kjo që është rezultat edhe i vullnetit të sistemit ndërkombëtar. Natyrisht, bota islame ka probleme të brendshme. Por është e pamundur që regjimet e Lindjes së Mesme të qëndrojnë në këmbë pa përkrahjen ndërkombëtare. Pra, kur flasim për regjimet diktatoriale ose ato tradicionale mbretërore, në asnjë mënyrë s'duhet shpërfillur sistemi ndërkombëtar. Bota islame duhet të bëjë në vetvete një përllogaritje të mirëfilltë. Por, nga ana tjetër ka nevojë për qetësi. Është vështirë që ta bëjë këtë përllogaritje duke i përjetuar të gjitha këto tendosje, duke qenë vazhdimisht zonë krizash. Kjo për arsye se përnjëherë mund të paraqiten reagime. S'duhet harruar se edhe Perëndimi duhet ta përllogaritë vetveten.

Zengin: Fisherit nuk i erdhi ndonjë përgjigje prej botës islame, por sikur të vinte, thoni se duhej të theksoheshin këto aspekte të Perëndimit.

Davutogllu: Jo vetëm në botën islame, por edhe në shumë fusha të tensionit në boshtin Perëndim-Lindje, Veri-Jug, problemet janë pasojë e funksionimit të sistemit ndërkombëtar. Për të përjetuarat në Ruan-dë, për urinë e përgjithshme në Afrikë, kanë përgjegjësi sa shoqëritë afrikane aq edhe institucionet ndërkombëtare. Në këtë kontekst mund të thuhet se i gjithë njerëzimi duhet të ndalet dhe të bëjë llogari.

Zengin: Zotëri Davutogllu, vendet e rajonit si Irani, Siria, Turqia, Egjipti ejt., që janë shtete myslimane, janë kundër operacionit ushtarak. Kundër ndërhyrjes është edhe Europa, Franca, Gjermania, Rusia, madje edhe Anglia si aleati më i rëndësishëm i ShBA. Prej Uashingtonit vijnë mesazhe, edhe pse nuk është politikë zyrtare, për ndërhyrje në Irak. Vallë Amerika a mund të bëjë ndërhyrje ushtarake, kur e kemi parasysh këtë front të qartë të pozicionuar?

Davutogllu: Është shumë interesante se pas 11 shtatorit në një emision kemi folur rreth luftës globale, për skenaret e luftës antiterroriste dhe në veçanti kemi theksuar një gjë. Kemi pohuar se faza e parë është ajo psikologjike, se faza e dytë është ajo strategjike dhe e treta, sistemuese. Në fazën psikologjike, ShBA mund të bënin një koalicion të gjerë. Kjo për arsye se opinioni botëror për shkak të lëkundjes së ShBA dhe për shkak të të qenët të tyre në pozitë të viktimës, e mbështeti ndërhyrjen në Afganistan. Edhe atëherë patëm theksuar se “është vështirë që në fazën strategjike ky koalicion të ruhet”. Zhvillimet në Afganistan, meqenëse bëhet fjalë për një operacion të fazës psikologjike, mundësonin formimin e një koalicioni të

përgjithshëm. Por me lëvizjet e fundit, kur Bushi Iranin, Irakun dhe Korenë e Veriut i shpalli për “bosht djallëzor”, lindi një diferencim dykahësh. Një diferencim që u duk mes ShBA dhe Europës jo vetëm në boshtin e Irakut, por edhe në atë të Palestinës. Kjo do të thotë se në periudhën strategjike, ShBA e kanë vështirë që me aleatët e vet të formojnë koalicion absolut dhe kjo mund të cilësohet si politikë e baraspeshës së fuqive. Por, ky shtet kapacitetin e vet operacional do të vazhdojë ta ruajë përmes koalicioneve të reja. Tani mund të bëjë ndonjë operacion, mund të godasë pikat në shënjestër, por s’mund t’i ketë pranë të gjithë aleatët si në rastin e Afganistanit ose të Luftës së Gjirit. Kjo për shkak se vendet e BE-së janë kundër këtij operacioni. Arsyet janë të shumta: Frika prej prishjes së baraspeshimeve në Lindjen e Mesme, rritja e peshës së Amerikës dhe të Izraelit në Lindjen e Mesme dhe bashkë me këtë investimet e shumta të jashtme në Iran e në Irak. Është shumë interesant fakti se Europa investon në ato vende, me të cilat ShBA s’kanë marrëdhënie të mira. Franca ka marrëdhënie të ngushta me Sirinë, Irakun dhe Iranin. Për shkak të këtyre investimeve, Europa nuk dëshiron që të ballafaqohet me çrregullimet eventuale, të cilat mund t’i shkaktojë operacioni i ShBA në Irak.

Zengin: Forumi i Stambollit u organizua nga BE-ja dhe Organizata e Konferencës Islamike e në fillim u tha se “Ky tubim është shumë kuptimplotë meqenëse bëhet pas 11 shtatorit”. Por është e pakuptimtë që në këtë forum s’morën pjesë ShBA, vend ky që sillet si padron i botës. Sidoqoftë, tubimi i Stambollit

ndërlidhet me Amerikën, të gjitha mesazhet i ishin adresuar asaj.

Davutogllu: Dimensioni i dytë i fazës strategjike është ky: Shtetet islame për herë të parë bashkë me Europën treguan reagim të përbashkët kundër qëndrimit të ShBA ndaj Palestinës dhe Irakut. Kjo tregon se fleksibiliteti diplomatik i ShBA, të cilat kundër Irakut menjëherë formuan koalicion me Sirinë, Arabinë Saudite, me Egjyptin, kurse kundër Iranit me Irakun dhe Arabinë Saudite, është dobësuar. Amerikanët duhet të mendojnë rreth kësaj tabloje.

Zengin: ShBA po shtyjnë një ligjëratë, sipas së cilës “mund të bëjmë ndërhyrje edhe vetë, pa aleatët”.

Davutogllu: Por siç cekta edhe në përgjigjen e pyetjes suaj të mëparshme, politika e bazuar në kontroll dhe balancë tanimë s’mund t’u mjaftojë ShBA për të ndërtuar një sistem ndërkombëtar. Tani e tutje Amerika duhet të zhvillojë politika të mbështetura në pjesëmarrje dhe në parimet themelore të rendit ndërkombëtar. Tashmë është vështirë që në Lindjen e Mesme, si në vitet 1980 dhe në fillim të atyre 1990, të gjallërojnë një politikë e quajtur *double containment*, që e përjashton edhe Iranin, edhe Irakun. Sepse Irani nuk është siç mendon Amerika, si në vitet 1980 vend i përjashtuar jashtë sistemit, përkundrazi, në saje të marrëdhënieve të zhvilluara me Rusinë, Kinën, madje edhe me Indinë, është vend që përpiqet të pozicionohet brenda sistemit ndërkombëtar. Edhe Iraku, si në kuadër të botës arabe ashtu edhe në opinionin e përgjithshëm botëror po lirohet prej kthetrave të të qenët i përjashtuar. Dhe, operacioni i ndërmarrë nga Shtetet

e Bashkuara kokë më vete, madje dhe nëse është i suksesshëm në aspektin ushtarak, këtij shteti në aspektin diplomatik mund t'i sjellë rezultate negative të papritura. Në veçanti opozita që vepron brenda sistemit në Francë dhe ajo prej jashtë sistemit në Kinë janë shumë të zëshme. Këto dhe shumë vende të tjera janë kundër ndërhyrjes në Irak. ShBA në këtë koniunkturë të kundërt ndaj vendeve të rajonit që janë fqinjë me Irakun, mund të ndërmarrin aksione të pjesshme si aty nga mesi i viteve 1990. Por, nëse ndërmarrin aksion të përgjithshëm si ai i Afganistanit, e kanë vështirë të gjejnë mbështetje në opinionin ndërkombëtar. E kjo ia hap rrugët përforcimit të koalicioneve të ndryshme jashtë ShBA.

Zengin: Domethënë, nëse ShBA ndërmarrin aksion, nuk mund të pritet që të mbështetet prej vendeve që sot e kundërshtojnë.

Davutogllu: Zor se mund të gjejnë mbështetje te to. Nëse Amerika ndërhyr në Irak, për shkaqe të cilat ne e kemi vështirë t'i kuptojmë, nuk duhej që në këtë fazë të binte ndesh me Iranin. Duke e kundërshtuar Iranin, thuajse formoi një koalicion irano-irakian. Edhe Turqia është e shqetësuar prej zhvillimeve në Irak. Pra këto shtete e kanë vështirë ta ndërrojnë pozitën e vet. Por *de facto* është e mundshme që Iraku të copëtohet, ose në saje të ndërhyrjes ushtarake të ndryshohet regjimi sadamian në pushtet. Por një politikë e tillë mund të sjellë me vete rreziqe të tjera. Ndërhyrjet e tilla mund të shkaktojnë dallgëzime në botën arabe, që është e ndjeshme dhe që po kalon nëpër procesin e krizës. Këtu kemi të bëjmë me një gjendje që s'mund

të krahasohet me atë të Afganistanit. Unë mendoj se, nëse diplomacia amerikane e humb fleksibilitetin e vet, ShBA në një periudhë të gjatë mund të përballen me pasoja negative.

Zengin: Si mund të vlerësohet qëndrimi i Ankarasë si në forumin e Stambollit, ashtu edhe në lidhje me çështjen e Irakut?

Davutogllu: Në fakt, Turqia pas Luftës së Ftohtë kapi koniunkturën më të rëndësishme të dy shekujve të fundit. Por mangësitë, dobësitë e ndryshme dhe papërgatitja bënë që kjo koniunkturë të mos shfrytëzohej mirë. Tash Turqia me zbatimin e një politike gjakftohtë, racionale dhe vizionare, mund t'ia hapë vetes një fushë të gjerë të manovrimit. Sot në botë na del para kjo tablo: Në tensionimet midis Lindjes-Perëndimit, Veriut-Jugut, Turqia zë një vend mjaft interesant. Shikuar prej Lindjes, është dorë e zgjatur e Perëndimit, kurse prej Perëndimit, duket si dorë e zgjatur e Lindjes. Shikuar prej Veriut, për shkak të të ardhurave për frymë banori duket si pjesë e Jugut, kurse kur këtë vend e shikojmë prej Jugut, para na del një vend i Veriut, anëtar i OECD-së, një kandidat për antarësim në BE, anëtar i NATO-s. Nëse sot Turqia arrin ta bashkojë virtytin e Lindjes, racionalitetin e Perëndimit, procesin e Jugut për kërkim të drejtësisë dhe produktivitetin ekonomik të Veriut, mund të ecë shumë përpara.

Zengin: A ka kuadro dhe burime njerëzore për të realizuar një gjë të tillë?

Davutogllu: Në aspekt të kuadrit s'mund të rrah gjoksin, por lirisht mund të them se Turqia ka trashëgimi të bujshme historike dhe kulturore për të bërë

hapa të mëdhenj përpara. Kemi mungesë të një elite që do t'i korrë të mirat. Dhe një dimension tjetër, siç përmendëm edhe në fillim të emisionit, vetëdija për historinë, strehimi në vete i të gjitha trashëgimive antike (kultura mesopotamase, anadollake, egjease, iraniane, egjiptiane, e Lindjes së Mesme dhe europiane) Turqisë i japin një pozitë të veçantë. Të gjitha këto kultura antike janë formuar rreth nesh. E kemi përjetuar modernitetin. Një sintezë që do të bëhet mes këtyre përvojave Turqisë ia hap horizontet në të katër anët. Por kjo sintezë e ka kuptimin e vet vetëm nëse Turqia e shpreh vullnetin, se edhe ajo vetë është subjekt, se ajo vetë është aktor. Nëse ne ecim me ligjëratën "Sistemi ndërkombëtar le të formohet diqysh, le të nxjerrë në mejdan diçka, më vonë do t'i gjejmë vend vetvetes", ligjëratë kjo të cilën që 150 vjet e kemi parapëlqyer dhe për këtë arsye s'kemi arritur që ta gjejmë veten, e humbasim këtë shans. Por, nëse sot do ta shfrytëzojmë iniciativën, nëse thellësinë tonë gjeografike në Afro-Eurazi e bartim në fushën ndërkombëtare dhe nëse bëjmë një sintezë mes veçorive tona lindore me racionalitetin perëndimor, atëherë kjo përpjekje që sot duket si diplomatike, e plotëson edhe sfondin kulturor e filozofik dhe na hap shtigje të reja. Një shpërthim i këtillë kulturor me siguri se do ta gjejë kundërvlerën e vet strategjike. Turqia duhet të jetë e pranishme në skenën ndërkombëtare jo vetëm me fuqinë ushtarake, por edhe me atë kulturore. Atëherë në sytë e Perëndimit dhe të ShBA duhet të kërkojmë kredibilitet dykahësh, madje shumëkahësh, e jo vetëm njëkahësh. Ne në asnjë mënyrë s'duhet të lejoj-

më që të shndërrohem në vend, i cili respektohet vetëm nga Perëndimi, që s'përfillet nga Lindja, ose që llogaritet vetëm nga Lindja për shkak të trashëgimisë historike, e as që të respektohem vetëm nga Veriu, e në Jug të mos kemi fare peshë. Nëse arrijmë të fitojmë kredibilitet katërdimensional përnjëherë, gjë të cilën mund ta bëjmë, atëherë të gjitha këto forume Turqisë ia hapin edhe më tepër hapësirën e veprimit dhe formohet një tablo, në të cilën ndikimi ynë ndërkombëtar shndërrohet në ndikim strategjik rajonal.

*Globalizimi: ndryshim i përbërjes dhe i formës**

Alltënolluk: Konstatimet tuaja lidhur me globalizimin. Ç'kuptim ka globalizimi? Si ka lindur?

Davutogllu: Globalizimi në rrafshet e ndryshme përkufizohet në mënyra të ndryshme. Ata që çështjes i qasen në mënyrë më sipërfaqësore dhe më pragmatike, me këtë term nënkuptojnë rrjetin e marrëdhënieve të komunikimit që viteve të fundit vazhdimisht shkojnë duke u lehtësuar dhe duke u sofistikuar. Për shembull, për një tregtar që mallin e vet për një çast mund ta shtrojë në pazarin më të largët të botës, për një gazetar që lajmin ose shkrimin e vet mund t'ia çojë gazetës së vet përnjëherë, për një qytetar akademik që në çdo çast mund t'i ndjekë botimet shkencore përmes internetit, për një njeri që në çdo çast mund t'i ndjekë përmes televizionit ngjarjet nga të katër anët e botës, globalizimi është shpërthim i mundësive dhe kapaciteteve të ndryshme. Ata që duan t'i vizatojnë globalizimit një kornizë teorike dhe ardhmëri të përgjithshme, këtë dukuri e shohin si shkallë përfundimtare dhe fatin e njerëzimit e të historisë së tij e ndërliqhin me këtë dukuri. Teza e Fukujamës për *fundin e historisë*, ajo e Naisbitt-it dhe e Abuderne-it për *megarirjet*, dimensionin ekonomik i globalizimit të cilin e

* Revista *Alltënolluk*, prill 1993.

trajton Drucker-i, qasja e Tofflerit për *powershift*-in janë shembuj të këtij kërkimi teorik. Thua jse në të gjitha këto pikëpamje teorike bëhet fjalë për analizë të strukturës politike, ekonomike ose sociale. Veprat e këtyre shkencëtarëve, që disa herë parapëlqejnë metodën përkufizuese e ndonjëherë atë futuriste, më tepër janë shkruar me qëllim kapjen e një ritmi social dhe të interpretimit të rezultateve praktike të këtij ritmi, sesa të kapjes së thellësisë filozofike dhe teorike. Karakteri progresiv i këtyre pikëpamjeve synon që globalizimin ta paraqesë si një vijë optimiste dhe të pashmangshme.

Është e mundur që të flitet për tre dimensione kryesore të globalizimit, që i përfshijnë këto përvijime pragmatike dhe teorike:

1. Përhapja e kapacitetit dhe përfshirjes së shfrytëzimit të mjeteve teknologjike.

2. Standardizimi i mënyrës së jetesës paralel me ndryshimet radikale në matricat e prodhimit dhe të konsumit.

3. Hyrja në një proces universalizues monopolist të mekanizmave ekonomikë, socialë dhe politikë.

Nëse këto dimensione i trajtojmë veç e veç, mund të thuhet se brenda pesëmbëdhjetë viteve të fundit faktori më i rëndësishëm përsheptues i procesit të globalizimit është transformimi teknologjik. Në veçanti ndryshimi i jashtëzakonshëm në teknologjinë e komunikimit dallgë-dallgë ka ndikuar edhe në mjetet tjera teknologjike. Ky ndryshim, si në aspektin e përbërjes ashtu edhe në atë të përhapjes, është shumë më përfshirës sesa revolucionet dhe shndërrimet e mëparshme teknologjike. Ekziston dallim i madh mes vi-

jës së përhapjes në korniza globale të mjeteve të gjeneruara nga Revolucioni Industrial dhe atyre të revolucionit komunikativ të viteve të fundit. Ndërsa përhapja e makinave të avullit dhe e rrymës elektrike në shoqëritë e ndryshme ka qenë një proces përafërsisht njëshekullor, përhapja në korniza globale e risive nga teknologjia e kompjuterëve llogaritet me pak muaj.

Ndryshimi i formave të prodhimit dhe të konsumit ka sjellë me vete edhe ndryshimin e mënyrës së jetesës dhe standardizimin. Revolucioni Industrial i ka dhënë përparësi ngritjes së infrastrukturës teknologjike në kufijtë nacionalë dhe kështu zhvillimi i teknologjisë është bërë kusht për formimin e shteteve kombëtare. Raportet me rajonet tjera janë paramenduar në formën lënda e parë-forca punëtore e lirë-tregu, gjë kjo që përbën bazën e paralelizmit mes strukturimeve kolonialiste dhe Revolucionit Industrial. Pra, Revolucioni Industrial në plan të parë kishte monopolizimin e prodhimit dhe përhapjen e konsumit, kurse revolucioni informatik për shkak të strukturës së vet, parasheh një standardizim në skemat e prodhimit, një standardizim të plotë që do t'i tejkalojë kufijtë kombëtarë. Ndryshimi që është paraqitur si në strukturën ashtu edhe në funksionimin e kompanive ndërkombëtare, është refleks i kësaj dukurie. Tanimë prodhimi i një malli nuk bëhet vetëm brenda kufijve të një shteti. Dizenjoja e një produkti mund të bëhet në Itali, përshtatja kushteve të fabrikës në Gjermani, prodhimi i prototipit në Francë, prodhimi përfundimtar në Tajlandë, kurse tregtimi prej Singapori. Njohuritë në lidhje me teknikën e prodhimit përmes kompjuterëve

në çast qarkullojnë prej një kontinenti në tjetrin. Ky ndryshim që e ka shkatërruar teknologjinë vendore të prodhimit, e bën të domosdoshëm standardizimin e matricave të prodhimit. Ai e lëkund mënyrën e jetesës së kulturave lokale dhe nën pamjen e globalizimit, me vete sjell monopolizim kulturor.

Kjo mënyrë e jetesës është një zhvillim në përputhje me përhapjen monopolizuese të mekanizmave socialë, kulturorë, politikë dhe ekonomikë. Mekanizmi i tregut që përputhet me këto zhvillime, diktatura e mediave që e garanton përhapjen e kulturës masive dhe mekanizmi i kontrollit politik janë pjesë natyrore të globalizimit.

Alltënolluk: Cilat janë pasqyrimet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të globalizimit?

Davutogllu: Nëse fillojmë nga analiza filozofike e dukurisë në fjalë, duhet theksuar se globalizimi është ndryshim i strukturës dhe i formës. Unë mendoj se në këtë drejtim Perëndimi është duke përjetuar një çekuilibër serioz. Nëse i studiojmë ndryshimet përmbajtësore dhe trajtësore teknologjike që kanë shkaktuar transformimin e qytetërimeve, mund të përfundojmë se këto transformime kanë lindur paralel me ripërtëritjet e thella filozofike-teorike. Për shembull, nëse i qasemi Revolucionit Industrial të periudhës së mëparshme, do të vërejmë se revolucioni është gatuar me një lëvizje filozofike-teorike. Përmbledhjet moderniste të cilat arrijnë deri në shekullin XV, e kanë përgatitur infrastrukturën e këtij revolucioni, kanë ngërthyer interpretime rreth ndryshimeve të brendshme të aksh periudhave dhe i kanë kahëzuar këto ndryshi-

me. Filozofia iluministe e shekullit XVIII përbën përpjekjen për formimin e thelbit dhe shpirtit të Revolucionit Industrial. "Grandteoritë" e Kantit, të Hegelit dhe të Marksit janë fryte të përpjekjeve të tilla.

Globalizimi, të cilin jemi duke e përjetuar sot dhe revolucioni kibernetik që përbën burimin e tij, nuk janë rezultate të një ripërtritjeje të tillë filozofike-teorike e as që kanë aftësi orientuese. Përkundrazi, kanë lindur në kuadër të një procesi të krizës, në të cilin ka hyrë modernizmi në veçanti dhe qytetërimi perëndimor në përgjithësi. Sot tradita e mendimit perëndimor nuk ka në vete bërthamë që do ta kuptimësonte ndryshimin e përmasave të këtilla. Kornizat filozofike të modernizmit në masë të madhe e kanë humbur vlerën. Rrymat pasmoderniste që pretendojnë të jenë alternativa të modernizmit, në vend të kërkimit të së vërtetës universale, po zhvillohen në vijë më relative dhe më subjektive. Një gjë që e rëndon edhe më tepër gjendjen është edhe fakti, se qytetërimet dhe qarqet kulturore vendore, të cilat mund të ofrojnë sintezën e cila do mund të ishte injeksion për dalje nga rrëmuja, po ballafaqohen me shpartallimin e vet. Qytetërimi perëndimor, i cili këtë krizë ua ka "eksportuar" edhe shoqërive të tjera nëpërmjet globalizimit, prej këtyre lëkundjeve s'mund të shpëtojë në saje të dinamizmit të vet dhe ndërkohë s'mund të krijojë marrëdhënie të shëndosha me qarqet e tjera kulturore. Përveç kësaj, shpejtësia marramendëse e zgjerimit të revolucionit kibernetik nuk jep hapësirë kohore për një ripërtëritje të tillë. Pra, fenomeni i globalizimit, i cili në përgjithë-

si trajtohet me aspektet e veta pozitive, mund të shkaktojë krizë afatgjatë të mendimit dhe të vlerave.

Shikuar nga këndi i strukturës ekonomike, si tregu, ashtu edhe strukturimi i prodhimit e i kompanive shënojnë shpërthim të dukshëm. Proporcionet ekonomike, të bazuara në prodhimtarinë funksionale, në përgjithësi, në vend të zhvillimit në kufijtë nacionalë dhe vendorë, zgjerohen në formën e kompanive ndërkombëtare me avantazhe të shumta. Kjo situatë e bën të nevojshëm formimin e sistemit të tregtisë së lirë, të bazuar në parimin e qarkullimit të papengueshëm të mallrave, të kapitalit dhe të fuqisë punëtore. Teoritë ekonomike rreth globalizimit parashohin një përvijim të këtillë. Këto zhvillime edhe më tepër do ta përforcojnë karakterin oligarkik të sistemit ekonomik ndërkombëtar. G-8 është refleksion i forcimit të kësaj strukture oligarkike në rrjedhat ndërkombëtare ekonomiko-politike. Vendet prijëse në kuadër të G-8 në të shumtën e rasteve mundohen që duke i përjashtuar tërësisht shoqëritë e tjera, t'i ndajnë mes vete të mirat e procesit të globalizimit. Globalizimi duke e lënë fatin e shoqërive të ndryshme në duar të vullnetit të padukshëm të mekanizmave të ndryshëm, edhe më tepër e ka prishur ritmin e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik të shumicës së shteteve, gjithë kjo në favor të shteteve prijëse në skenën ndërkombëtare. Por kontradiktat e brendshme ekonomike të strukturës e pengojnë në masë të madhe zhvillimin e konceptit dhe të praktikës së tregtisë së lirë globale. Blloqet tregtare dhe orientimet mbrojtëse, që burojnë prej këtyre kontradiktave të brendshme, dukshëm ndikojnë në vijën

e procesit të globalizimit. Lufta tregtare mes ShBA dhe BE-së që kohëve të fundit tregon rritje, ndërhyrjet e udhëheqësisë së ShBA ndaj tregtisë së lirë me qëllim mënjanimin e çekuilibrit tregtar mes ShBA dhe Japonisë, janë tregues të rëndësishëm të kësaj kontradikte. Kjo gjendje shfaq një kontrast midis globalizimit ekonomik që është kërkesë e ripërtëritjes teknologjike, dhe lokalizimit e rajonalizimit që janë reflekse të strukturimit ekonomik dhe politik aktual ndërkombëtar. Fuqitë e mëdha ekonomike, të cilat shteteve të tjera u sugjerojnë mekanizëm absolut të tregtisë së lirë, për hir të interesave të vet kombëtarë vazhdojnë t'i shfrytëzojnë metodat mbrojtëse të fshehta dhe të hapura.

Një kontradiktë e tillë është e pranishme edhe në strukturimin politik ndërkombëtar. Vetë teoria e globalizimit kërkon një ndërtim të ri, ku do të marrin pjesë të gjitha shtetet. S'duhet harruar se strukturimi në fjalë bazohet në disa vlera të përbashkëta universale. Sistemi i Kombeve të Bashkuara, i cili kolonializmit të padrejtë, të lindur paralel me Revolucionin Industrial, i mundëson të vazhdojë të jetojë në mënyrë të fshehtë në suaza të së drejtës ndërkombëtare, s'ka arritur të ndërtojë infrastrukturë të vlerave të përbashkëta të njeriut, as ka arritur të fitojë legjitimitet të plotë te shtetet anëtare, e as që ka arritur të zhvillojë mekanizma që do ta merrnin nën kontroll paqen dhe drejtësinë politike ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara, që kanë lindur në kushtet koniunkturale të periudhës së Luftës së Ftohtë, më tepër kanë kontribuar në drejtim të ndarjes së fuqisë politike reale në një bazë të diskutueshme. OKB-ja bashkë me G-7 kanë synuar kahëzimin e ekonomisë dhe politikës

ndërkombëtare në një rrafsh oligarkik. Dallimi i vetëm ndërmjet këtyre dy institucioneve qëndron në atë, se OKB-ja në saje të Këshillit të vet të Përgjithshëm krijon një atmosferë simbolike dhe mashtruese të pjesëmarrjes së vendeve të botës.

Prej globalizimit të vërtetë pritej që këtë strukturim ta ndryshonte në drejtim të pjesëmarrjes më aktive të të gjitha shteteve anëtare të OKB-së. Por ç'e do që ndodhi e kundërta: Në vend të strukturës dypolëshe lindi një strukturë monopoliste. Mekanizmi vendimmarrës i OKB-së në saje të globalizimit po monopolizohet në drejtimin e kundërt. Ose thënë me fjalë të tjera, ky karakter i mekanizmit monopolizues të globalizimit po reflektohet në sistemin ndërkombëtar. Në këtë kontekst mund të thuhet se globalizimi nuk përbën një pjesëmarrje në zgjerim e sipër, por udhëheqjen e gjithë globit prej një qendre të vetme. Pjesëmarrja demokratike, e cila paraqitet si vlerë kryesore e Rendit të Ri Botëror, kur bëhet fjalë për mekanizmat ndërkombëtarë të vendosjes, po nëpërkëmbet. Madje dhe nëse të gjitha shtetet e botës jashtë pakicës vendosëse në OKB marrin vesh për një çështje, njëri prej shteteve që ka të drejtë vetoje mund ta bllokojë atë vendim konsensual. Zbatimi i qartë i standardeve të ndryshme-dyshe nga ana e OKB-së në Bosnjë dhe në Irak flet shumë qartë për këtë nonsens. Globalizimi po shfrytëzohet për ta legjitimuar mosndryshimin e statukuosë. Revolucioni teknologjik dhe shpërthimi mediatik, që përbëjnë bordin e kësaj dukurie, po shfrytëzohen për formimin e opinionit se sistemi ndërkombëtar imponon vendimet e mekanizmit vendosës monopolist.

Kriza në të cilën është zhytur qytetërimi perëndimor mbizotërues e pamundëson lindjen e ndonjë sistemi të vlerave, që do ta thurte infrastrukturën e globalizimit. Për këtë arsye mund të thuhet se lokalizimi si antipod i globalizimit, duke filluar nga Perëndimi, është shndërruar në një fenomen serioz. Racizmi i shënuar në Europën perëndimore, ngjarjet që ndodhën në Bosnjë, të cilat nuk vërehen as në botën e kafshëve, dhe nxitja e këtyre ngjarjeve nga qendrat e fuqisë vetëm për shkak se viktimat ishin myslimanë, flasin se qytetërimi perëndimor, që ka krijuar krizë vlerash, po nxit një proces të tjetërsimit shkatërrimtar.

Alltënolluk: E gjitha kjo si do të ndikojë në botën islame?

Davutogllu: Këto rrjedha kanë sjellë me vete një sfidë për shoqëritë islame, të cilat do të preken në mënyrë të drejtpërdrejtë prej këtyre ndryshimeve radikale. Cilësia, kahu dhe zhvillimi i këtij ndikimi varen prej dinamizmit që do të tregojnë shoqëritë islame në aspektin kulturor, politik dhe ekonomik. Në këtë drejtim është shumë me rëndësi qëndrimi i qarqeve vendimmarrëse. Por, para së gjithash s'duhet harruar edhe dy gjëra të rëndësishme:

1. Revolucioni informativ dhe ndikimi i tij nuk është dallgëzim i thjeshtë e kalimtar. Ai ka aftësi për të determinuar shoqërinë dhe marrëdhëniet e sjelljet në të gjitha sektorët e jetës, pra ka potencial për ta përcaktuar *modus vivendin*. Me fjalë të tjera, është shndërrim qytetërimor. Ky proces global ka nevojë të interpretohet nga shumë kënde. Siç kemi cekur edhe më parë, struktura e brendshme e qytetërimit perën-

dimor, për shkak të krizës që është duke e përjetuar, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik e bën të pamundshëm interpretimin e këtillë. Për këtë arsye ky qytetërim, në vend të ndryshimit parapëlqen *staus quo*-në.

2. Duhet qenë realist dhe duhet theksuar se shoqëritë islame po përjetojnë një periudhë të krizës. Kjo krizë nuk është pasojë e një qorrrokaku teorik, që ka të bëjë me dimensionin e qenies dhe të vlerës që sundon në Perëndim. Kriza e shoqërisë islame është pasojë e mosjetësimin të një paradigme, që ka qëndrueshmëri të fuqishme të brendshme. Në këtë kontekst mund të thuhet se shoqëritë islame po kalojnë një periudhë edhe të krizës, edhe të dinamizmit. Nga bota islame periudha të tilla janë përjetuar edhe në të kaluarën. Ndërveprimi gjatë përhapjes së Islamit nëpër qendrat tradicionale qytetërimore si Irani, Bizanti dhe India përbën shembullin pozitiv të reagimit ndaj kësaj sfide. Në saje të këtij ndërveprimi, paradigma e qytetërimit islam në një ambient dhe formacion të ri është përforcuar edhe më tepër. Shfrytëzimin e fryteve të këtij ndërveprimi e kanë mundësuar dijetarët islamë, të cilët ndërkohë në saje të mendjemprehtësisë dhe të ndikimit social ishin edhe orientuesit e këtij procesi. Kështu janë mënjanuar elementet negative që janë paraqitur gjatë ndërveprimit dhe qytetërimit islam, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë institucional, ka dalë i ripërtërirë dhe i forcuar. E njëjta gjë s'mund të thuhet edhe për ndryshimin që ka lindur në Perëndim gjatë ballafaqimit të procesit të modernizimit, i cili është zhvilluar paralel me Revolucionin Indus-

trial. Ky proces i ndryshimit që ka filluar në shekullin XIX dhe që është zhvilluar gjatë shekullit XX, si në qytetërimet tjera ashtu edhe në atë islam, ka pasur pasojë dërmuese dhe kështu mospërputhja mes teorisë e praktikës ka arritur pikën kulmore. Në këtë sërë, në shoqëritë islame është rritur tensioni i reagimeve ndaj këtij ndryshimi, janë shfaqur polarizime dhe palët e ndryshme, të cilat është dashur ta orientojnë shoqërinë, e kanë hequr herë në këtë e herë në atë anë. Me kalimin e kohës qarqet, të cilat dëshironin që ndryshimin e trajtës perëndimore t'ua impononin prej lartë poshtë shoqërive islame, e morën në duar pushtetin politik e kjo pati për pasojë zbrapsjen kulturore dhe institucionale. Mund të themi se ky ndërveprim nuk ka prurë gjallërim por krizë qytetërimore, me të cilën ballafaqohemi edhe sot e kësaj dite. Në shoqëritë islame, në vend të qëndrueshmërisë së brendshme është shfaqur çrregullim kulturor dhe institucional.

Shoqëritë islame, të përshkuara nga një proces i këtillë i krizës dhe i dinamizmit, po hyjnë me të shpejtë nën flatrat e revolucionit informativ dhe të hapësirës së ndikimit të globalizimit, që është fryt i revolucionit të përmendur. Është vështirë të thuhet se shoqëritë islame, të cilat ende nuk e kanë vënë në themele të shëndosha përballjen me revolucionin industrial dhe me modernizmin, të kenë korrje-shirje të frytshme nga ky transformim. Por, Perëndimi, përkundër periudhës së përhapjes së modernizmit, është duke përjetuar një periudhë të krizës e të dekadencës. Në këto rrethana që njeriun e fusin në ballafaqim me krizë të ekzistencës dhe të vlerave, ka mundësi që në

skënë të dalë trashëgimia teorike dhe historike e qytetërimit islam. Domethënë, ky transformim mund të shkaktojë dërrmimin ose gjallërimin e shoqërive dhe të qytetërimit islam. Faktor që do ta përcaktojë rrjedhën e këtij transformimi është ringjallja e traditës diturore, e cila do ta mundësojë gjenerimin e dijes dhe tejkalimin e qorrsokeve teorike-praktike. Kushti minimal i marrjes së këtij transformimi në vijën pozitive është ristrukturimi dhe ripërtëritja teorike, që merr si shembull traditën shkencore të shekujve të parë të historisë islame.

Alltënolluk: Kundërshtimi i globalizimit, mbrojtja e vetvetes, përfitimi prej kësaj dukurie... Cila prej këtyre mundësive është më e dobishme për botën islame?

Davutogllu: Mendoj se përgjigjen e kësaj pyetjeje e dhamë në përgjigjen e pyetjes pararendëse. Sidoqoftë, mund të thuhet se revolucioni informativ dhe globalizimi, si dukuri që duke i zhdukur reagimet individuale dhe lokale po e përhapin hapësirën e vet të ndikimit, përbëjnë sfida të reja, me të cilat shoqëritë islame po përballen. Dihet se s'ka ndonjë dallim të madh mes një individi që bën rezistencë, duke mos e ditur forcën e një dallge të madhe të ujit, dhe atij që i nënshtrohet asaj me vetëdëshirë. Këta dy persona përfundimin e kanë të njëjtë. Me dallgët arrijnë të mbisundojnë ata që e dinë forcën dhe kapacitetin e vet, që i dinë veçoritë e rrymave ujore, që dinë t'i tërheqin në drejtim pozitiv dhe t'i shfrytëzojnë duke vënë penda ose diçka tjetër. Duke u nisur nga ky krahasim, kuptojmë se njeriu s'duhet ta lërë mënjanë egon e vet, s'duhet t'i nënshtrohet teknologjisë e as të bëhet rob i

saj. Në rastin e valëve nuk është zgjidhje as reagimi individual dhe vendor. Elementi më i rëndësishëm i globalizimit është zgjerimi i jashtëzakonshëm i dimensionit ideor dhe veprues të njeriut. Për këtë arsye, myslimanët nuk duhet që të marrin udhën e lokalizimit e të izolimit, duke e nxjerrur veten jashtë procesit dhe duke u marginalizuar. Një qëndrim i tillë bindesh me cilësinë universale të Islamit dhe me përkuftizimin e fushës së përgjegjësisë së myslimanit. Përkundrazi, duhet që ta pranojmë këtë sfidë me gjithë përmasat e saj dhe duke i shfrytëzuar mjetet e saj, duhet që veten t'ia çelim botës. Me këtë fenomen të ri, ai që s'arrin ta shpjegojë Islamin në Nju-Jork ose në Tokio, s'ka gjasa ta shpjegojë atë as në një fshat të Hakkarit. Është e nevojshme që të zhvillohet një thesar dhe një ligjëratë që veçantësohet në çdo rrafsh dhe në çdo mjedis, por që në ndërkohë mund të zgjerohet në çdo fushë.

Për t'ia dhënë kësaj sfide hakun, ndihet nevojë për një tip të ri të njeriut në çdo lëmë të jetës. Për tipin e ri të afaristit, të burokratit, të ekonomistit dhe para së gjithash, të prototipit të mendimtarit e të dijetarit. Nëse arrijmë t'i bëjmë ballë kësaj sfide, s'ka dyshim se trashëgimia jonë teorike dhe historike do të na mundësojë rigjallërimin dhe ristrukturimin tonë qytetërimor.

*Lindja-Perëndimi: ballafaqimi i qytetërimeve**

Firdevs Çakmak: Çka nënkuptojmë me shprehjen përplasje e qytetërimeve?

Davutogllu: Kjo shprehje lindi dhe u përhap në përmasa botërore pas botimit të artikullit të famshëm të Hantingtonit. Në fakt, ka dallim mes vetë konceptit dhe teorisë nga njëra anë, e domethënies politike të cilën e përmban në vete kjo sintagmë, nga ana tjetër. Para tezës për përplasjen e qytetërimeve, në vitet '80 u hodh në qarkullim një tezë tjetër, ajo e Fukujamës për *fundin e historisë*. Sipas saj njerëzimi, në saje të mekanizmave të gjeneruar nga qytetërimi perëndimor, ka arritur strukturën më të përkryer, pra e ka arritur fundin e kërkimit politik dhe filozofik. Kjo kishte këtë domethënie: Meqenëse njeriu e ka arritur fundin e kërkimit të vet, përfundojmë se ka marrë fund edhe rrjedha e historisë. Kjo tezë e bartte në vete cilësinë ultraoptimiste të vitit 1989, kur u shemb Muri i Berlinit dhe kur vendet socialiste përpiqeshin të kalonin nga socializmi në kapitalizëm. Në atë kohë mbizotëronte atmosfera e përhapjes së idealeve të Perëndimit. Por, pas një kohe të shkurtër pas thellimit në baltën e Luftës së Gjirit dhe atë të Bosnjës, pas shfaqjes së standardeve dyshe dhe pas viktimizimit të 250 mijë nje-

* Revista *Revizyon*, verë 1999.

rëzve vetëm pse janë myslimanë, u kuptua se në të vërtetë historia nuk ka përfunduar, se vlerat e qytetërimit perëndimor nuk janë vlera që e ngërthejnë tërësisht njeriun. Përkundër kësaj tabloje, u nxor në pah teza e Hantingtonit për *përplasjen e qytetërimeve*, me të cilën pretendohet se për largimin e qytetërimit perëndimor prej atyre vlerave, nuk është përgjegjës ky qytetërim dhe se tani e tutje fillon një periudhë e re kaotike, që është pasojë e luftës mes të gjitha qytetërimeve të tjera. Fukujama theksonte "rendin", kurse Hantingtoni "kaosin". Fukujama si ndërtues të rendit e shihte qytetërimin perëndimor, kurse Hantingtoni si shkaktar të çrregullimit i quante të gjitha qytetërimet e tjera. Unë mendoj se këto dy teza që duken si alternativa të njëra-tjetrës, në fakt për nga cilësitë politike dhe strategjike e përplotësojnë njëra-tjetrën, gjë të cilën e kam theksuar në një artikull timin të botuar në atë kohë. Kur teza e Fukujamës u shemb për shkak të asaj që u përjetua në Bosnjë, filloi të dalë në plan të parë teza e Hantingtonit. Për këtë arsye, them se në tezën për përplasjen e qytetërimeve nuk shoh kërkim filozofik ose historik. Bëhej fjalë për një tezë me përmbajtje politike, e cila përmes një strategjie të keqe e sakrifikoi gjallërimin e qytetërimeve.

Pjesa e shfrytëzuar e tezës është kjo: Me të vërtetë që nga fillimi i shekullit XX, prej kohës së ngritjes së Perëndimit, në veçanti në periudhën mes viteve 1925-1950, qëndrimi i përhapur lidhur me historinë e qytetërimeve ishte ai i Tojnbit dhe i shumë historianëve të tjerë të qytetërimit, sipas të cilëve qytetërimi perëndimor është duke përparuar, kurse qytetërimet e tjera

dalngadalë do të fshihen prej historisë. Përkundër këtij parashikimi, që nga gjysma e dytë e shekullit XX, në veçanti aty kah çereku i fundit i shekullit të zënë ngoje, në të gjitha pellgjet qytetërimore jashtëperëndimore po shënohet një gjallërim i madh. Japonia u shndërrua në fuqi ekonomike dhe politike, në qytetërimin indian u shfaqën ritme të reja. Në qytetërimin islam, i cili është qytetërimi i fundit që po ballafaqohet dhe ndeshet me Perëndimin, ky gjallërim ka gjurmë më të thella, rezultate që bien më lehtë në sy. Huntingtoni, me tezën për përplasjen e qytetërimeve, duke e shfrytëzuar gjallërimin në pellgjet qytetërimore joperëndimore, mundohet të arrijë qëllime strategjike. Nga ky këndvështrim mund të thuhet se përplasia e qytetërimeve është tezë që e keqpërdor gjendjen reale në kuptimin strategjik.

Çakmak: Cilat janë veçoritë dhe dallimet mes qytetërimeve të Lindjes dhe atyre të Perëndimit? Ç'është ajo gjë që Lindjen e bën Lindje e Perëndimin Perëndim?

Davutogllu: Ekzistojnë dallime si midis qytetërimit islam dhe atij perëndimor, ashtu edhe mes qytetërimit islam dhe atij lindor, në kuadër të të cilit bëjnë pjesë qytetërimi indian dhe ai kinez. Domethënë, s'mund të thuhet se qytetërimet joperëndimore kanë marrëveshje në çdo pikë, e as që formojnë pellg të përbashkët qytetërimor. Dallimi kryesor mes këtyre qytetërimeve është mënyra e perceptimit të ekzistencës së njeriut. Qytetërimi islam, për shkak të fleksibilitetit është më lehtë i perceptueshëm dhe meqë ka një vetëperceptim të fortë, meqë është zhvilluar në një periudhë kur komunikimi ka qenë më i dobët, është për-

brendësuar në përmasa të mëdha nga shoqëritë me të cilat ka hyrë në ndërveprim. Përveç kësaj, është për t'u theksuar se është shumë lehtë të ndikosh në këtë vetëperceptim. Për shembull, turqit, iranianët, nigerianët, pas pranimit të Islamit, e kanë shumë lehtë të depërtojnë në këtë vetëperceptim. Këmba e ushtarit mysliman asnjëherë s'ka shkelur në Indonezi, vend ky që e ka përvetësuar identitetin islam. Holanda një kohë të gjatë në këtë vend krijoi kolonitë e veta, por s'arriti të bëhej e pranuar për vendasit indonezianë. Të njëjtën gjë e shohim edhe te imperializmi anglez në Indi. Qytetërimi perëndimor është zgjeruar për dy arsye: ose për t'i bartur burimet e ndryshme dhe për t'i shfrytëzuar ato, ose për t'i zhdukur vendasit dhe për t'u vendosur në dherat e huaja. Metoda e parë është shfrytëzuar në Indi dhe në Indonezi. Pra, populli vendas le të jetë aty ku është e ne do t'i shfrytëzojmë burimet e tyre. Metoda e dytë është zbatuar në Amerikë. Pra, le ta shfarosim popullatën vendase dhe pastaj t'i zëmë tokat e tyre për të jetuar. Në këtë rast nuk kemi përpjekje për të jetuar me njerëzit vendas, duke e ndarë nënqiellin dhe të mirat e njëjta. Nga ana tjetër, qytetërimi islam në çdo vend ku ka shkuar, ka formuar një vetëperceptim dhe hapësirë jetike në të cilën ka pasur mundësi që shumë shpejt të depërtohet. Qytetërimet joperëndimore si ai islam, kinez dhe indian kanë ndarë të njëjtin fat kundruall Perëndimit. Këto pëllgje të qytetërimit nën ndikimin e kolonializmit perëndimor si rrezik i jashtëm, e kanë humbur qëndrueshmërinë e vet të brendshme. Kjo është ana më reale e ndarjes Perëndimi-Lindja dhe Perëndi-

mi-joperëndimi. Nga njëra anë qytetërimi perëndimor, i cili pretendon se e ka formuar historinë dhe se përbën pikën kulmore të historisë vijëzore, nga ana tjetër shumë pellgje qytetërimore, që përpiqen ta tregojnë dhe të ruajnë qenien e vet në kuadër të rrjedhës historike. Fati i njëjtë i ka afruar këto pellgje dhe kjo pamje e nxjerr në pah ndarjen Perëndimi-Lindja.

Çakmak: Si e shpjegoni përpjekjen e Perëndimit që veten gjithherë ta pozicionojë në polin pozitiv, kurse pjesëtarët e qytetërimeve të tjera që mundohen ta ruajnë kulturën e vet, në polin negativ? Prej nga e merr këtë forcë?

Davutogllu: Kjo dukuri e ka legjitimitetin e vet filozofik dhe teorik. Për shembull, emri më i famshëm i letërsisë kolonialiste, Kiplingu, flet për *Përgjegjësinë e njeriut të bardhë*. Nëse zbritni në rrënjët e qytetërimit perëndimor, do t'ju dalë para elementi arian, i cili botës bashkëkohore ia ka bartur teorinë për epërsinë e njeriut të bardhë. Pra kemi të bëjmë me një pretendim për epërsi, i cili vazhdon nga thellësitë e historisë. Ekziston një unitet i dukshëm mes mendësisë që e ka ndërtuar sistemin e kastave në Indi, i cili bazohet në epërsinë e njeriut të bardhë, dhe mendësisë së periudhës moderne të Perëndimit, që trumbeton po ashtu për epërsinë e njeriut të bardhë (perëndimorit) dhe për të drejtën për t'i shfrytëzuar të gjithë njerëzit e tjerë. Elemente të tjera të rëndësishme të qytetërimit perëndimor janë institucionet e krishterimit dhe teologjia e etika hebreje. Siç dihet, edhe te çifutët ekziston një doktrinë për popullin e zgjedhur, gjegjësisht për epërsinë e hebrenjve ndaj gjithë popujve të botës.

Nëse ndalemi te elementet hegjemonike të qytetërimit perëndimor, pra te pozita e kapitalit hebre në kuadër të Perëndimit, dhe te pretendimi i gjermanëve për epërsi e për të mbisunduar botën, vërehet qartë se një grup njerëzish kanë ide të mbështetura me argumente teologjike. Ky është njëri prej dallimeve të rëndësishme mes nesh dhe Perëndimit.

Çakmak: Lindjen e kemi ndarë në pjesët e quajtura qytetërimi kinez, qytetërimi indian dhe ai islam. Por në Perëndim një ndarje e tillë s'është bërë. Nëse Perëndimit i themi qytetërimi perëndimor, atëherë shtrohet pyetja nëse Lindjen mund ta cilësojmë me një emërues të përbashkët: qytetërimi islam?

Davutogllu: Është vështirë të zhvillohet një koncept i quajtur Lindje, që do të përfshinte gjithçka jashtë Perëndimit. Edhe elementi arianit nuk është monolit. Në formimin e qytetërimit perëndimor kanë luajtur rolin e vet elementi arian, filozofia greke, etika dhe teologjia hebraike, e drejta romake etj. Të gjitha këto elemente janë shkrirë në një kavanoz. Por edhe në kuadër të vetë Perëndimit gjallërojnë kultura dhe pikëpamje të ndryshme. Është vështirë që Perëndimi të futet në një kallëp të vetëm, por nëse përpiqemi të japim një tipologji të njeriut perëndimor, gjë të cilën më mirë e ka bërë Galtungu, ka mundësi që t'i përcaktojmë parametrat kryesorë të botëkuptimit të tij. Kur flasim për Lindjen, prej të gjitha kulturave që janë në lindje të Perëndimit, reaksionin më serioz filozofik, teorik dhe historik ndaj Oksidentit mund ta japë qytetërimi Islam dhe në këtë kontekst, paraqitet ambient përplasës me Perëndimin. Në të vërtetë, edhe përkun-

dër kësaj gjendjeje, ne e kemi thesarin në të cilin gjendet edhe harta, që mund të na e tregojë rrugëdaljen nga kjo krizë, në të cilën është thelluar qytetërimi perëndimor. Sa i përket Indisë dhe Kinës, unë, përkundër parashikimit të Hantingtonit për tendosje mes pellgjeve qytetërimore jashtë Perëndimit, mendoj se do të pasojë zbutja e raporteve ndërmjet tyre. Hantingtoni, me qëllim të mbrojtjes së interesave të Perëndimit, thotë se pellgjet qytetërimore duhet të luftojnë mes vete. Përkundër këtij pohimi, ne theksojmë rëndësinë e afrimit të pellgjeve të ndryshme qytetërimore, që janë nën tehun e rrezikut shkatërrues të Perëndimit. Qytetërimi perëndimor i jep rëndësi vetëm një aspekti të kapaciteteve të njeriut, pra ia ngushton atij horizontet. Sot në Perëndim po përjetohet një krizë e filozofisë ekzistenciale. Është arritur fundi i shtigjeve, të cilat Perëndimi mund t'ia hapë njeriut. Sot po përjetohet krizë epistemologjike, krizë e filozofisë së dijes. Po përjetohet një krizë e vlerave. Parametrat e Perëndimit rreth qenies, dijes dhe vlerave shënojnë krizë. Fuqia e qytetërimit islam, përveç burimeve politike-ekonomike, qëndron në ofrimin me vetëdije alternative të qenies, të dijes dhe të vlerave. Qytetërimi kinez dhe ai indian edhe pse po shënojnë gjallërim serioz, s'ia dalin të bëjnë rezistencë ndaj Perëndimit në formën që e bën Islami. Këto qytetërime s'kanë ndonjë mjet si Kur'ani, burim ky i dijes dhe i vlerave, që frymëzon vetëdije të ekzistencës, që vazhdimisht lexohet në shoqëritë e ndryshme të botës, që e thur mendësinë dhe kulturën e elitës, që e përcakton mënyrën e sjelljes së masave të gjera popullore. Kur'anin

e lexon bosnjaku, shqiptari, turku, malajziani, tanzaniani... Kështu formohet një pikëpamje e përbashkët e ekzistencës dhe e dijes. Qytetërimi indian ka burim që mund të bëhet më fleksibil dhe të tërhiqet në fusha të ndryshme, burim që përbën një tërësi jashtëzakonisht komplekse, e cila e ka vështirë të përqendrohet në një pikë. Pra, mund të themi se qytetërimi islam është një botë që më parë dhe në mënyrë më të gjerë mund ta tregojë qëndresën ndaj destruksionit perëndimor. Qytetërimi islam në vete i ngërthen alternativat e daljes prej krizave në të cilat gjendet. Ky qytetërim, përkundër tezës së Hantingtonit, duhet të zhvillojë dialog me qytetërimet e tjera, por ndërkohë duhet të jetë i vetëdijshëm edhe për të vërtetat që i ngërthen në vete.

Çakmak: A mund të thuhet se globalizmi i ka ndryshuar përkufizimet dhe konceptet për Lindjen dhe Perëndimin, madje i ka eliminuar ato?

Davutogllu: Globalizimi ka ligjëratën dhe tablonë e vet, që shfaqet në këtë ligjëratë. Por, është e diskutueshme madje nëse gjendja reale e pasqyron në mënyrë të plotë këtë tablo. Globalizimi njeriut i ka ofruar një standardizim në sferën e komunikimit dhe në veçanti në atë të konsumit, i ka ofruar shpërthim të potencialit. Në këtë vijë janë përjetuar dy procese të cilat duken si kontradiktore. Globalizimi edhe pse ngërthen në vete elemente të shtypjes ekonomiko-politike në drejtim të standardizimit të mënyrave të sjelljeve të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme, nga ana tjetër ka nxjerrë në pah mjete për zgjerimin e kulturave lokale. Çdo kulturë gjen mjete për ta treguar veten. Këtu, konkurenca ka të bëjë me atë sesa kultu-

rat lokale mund t'i shfrytëzojnë në mënyrë efektive ato mjete. Perëndimi i cili e ka në duart e veta forcën ekonomike dhe politike, në saje të globalizimit imponon një mënyrë jetese monolite. Nga ana tjetër, ndonëse nuk arrin t'i tejkalojë problemet që i bie me vete ajo mënyrë e jetesës, fillon që t'u përgjigjet kulturave vendore në përmasa sa ato e kapërcejnë atë. Para 30 viteve ShBA ishin shtet i pastër perëndimor, domethënë, një shtet ku joperëndimorët ishin përjashtuar. Por, tash ky vend është shumë më kozmopolit. Bashkësinë e dytë fetare në ShBA e përbëjnë myslimanët. Në këtë vend jetojnë shumë kinezë, japonezë dhe latinoamerikanë. ShBA pak nga pak po e humbin identitetin e pastër perëndimor. Edhe pse është fuqi hegjemonike e botës, po përjetojnë ndryshim në vetvete. Në Gjermani ka më tepër se tre milionë myslimanë. I ngjashëm është edhe shembulli i Francës e i Gjermanisë. Këto janë elemente refleksive të imperiaлизmit. Anglezët sunduan në Indi por tani, pas dy brezash, indianët dhe pakistanezët po gjallërojnë një kulturë të re në Angli. Francezët e sunduan Algjerinë, por sot veriafrikanët po formojnë një nënkulturë në Francë. Në këtë mënyrë marrëdhëniet po bëhen shumë më dinamike. Kjo është një dukuri e shënuar edhe në qytetërimet e mëparshme. Roma duke u rritur, ka shkuar duke u bërë më kozmopolite, e me kozmopolitizmin kanë filluar të dalin në plan të parë cilësi të ndryshme. Në Romë depërtuan madje edhe fetë e Persisë. Kjo mund të thuhet edhe për shtetin osman, i cili duke u rritur filloi që në strukturën e vet të mbërthente elemente të ndryshme, gjë kjo që këtij subjekti

botëror ia ka shtuar fuqinë. Por më vonë, në etapën e dobësimit, Perandoria Osmane filloi të përjetonte probleme në drejtim të ndërtimit të një strukture të përbashkët. Edhe Perëndimi sot është duke përjetuar një proces të njëjtë.

Çakmak: Çfarë kuptimi kanë në vijën e përplasjes së qytetërimeve fjalët e Xhemil Meriçit, i cili thotë: “Madje dhe nëse i rrënojmë të gjitha xhamitë dhe nëse i djegim të gjithë Kur’anët, prapë jemi osmanllinj”?

Davutogllu: Fjalë që me të vërtetë e reflektojnë shumë mirë këtë tablo. Identitetet s’mund t’i ndryshoni përmes vullnetit politik. S’mund t’i ndryshoni ato përmes diktateve politike nga qendra, s’mund të “prodhoni” identitete të reja. Politikën e ndryshimit mund ta zbatoni mbi një brez ose një grupim shoqëror, por s’ka gjasa që identitetin e një shoqërie të tërë ta ndryshoni me një vendim qendror. Ngjarje të kësaj natyre janë përjetuar në Kinë. Kur erdhi në pushtet Maoja, u mundua që përmes Revolucionit Kulturor ta ndalonte konfucianizmin në tërë Kinën. Por sot konfucianizmi po shënon gjallërim në Kinë. Gjëra të ngjashme janë përjetuar edhe me dhënien përparësi identitetit sovjetik para atij rus. Por, sot në plan të parë po del identiteti historik rus. Ekzistojnë identitete të bazuara në themele reale historike. Kur këto identitete përputhen me identitetet politike-strategjike, kur e plotësojnë njëri-tjetrin, para na del një tablo politike më e fortë dhe më kohezive. Por, nëse mes tyre fillon përplasia, atëherë përjetohej krizë e identitetit. Dhe nëse në një periudhë të caktuar një identitet strategjik politik e mban nën presion identitetin real

historik, në periudhën tjetër me siguri se identiteti real historik fillon të ringjallet. Nisur prej këtui, mund të themi se historia osmane gjendet në fushën qendrore të hartës sonë socio-kulturore. Turqia, në aspektin politik është e detyruar që diku të takohet me osmanllin. Madje edhe nëse nuk dëshiron të takohet, ngjarjet e bëjnë të detyrueshme një gjë të tillë. Shikoni vetëm ngjarjet e dekadës së fundit: Pse në vitet '80 myslimanët e Bullgarisë erdhën në kufirin turk dhe kërkonin strehim? Pse Nahxhivani azeras deshi t'i bashkohet Turqisë? Pse në kohën kur në Irakun verior kishte krizë, kurdët e atjeshëm deshën të strehoheshin në Anadolli? Pse për problemet në Bosnjë dhe në Kosovë kërkohet ndihmë nga Turqia? Bëhet fjalë për tërheqshmëri të qendrës, për përfshishmërinë që osmanlliu e ka jetuar një kohë të gjatë. Dhe çdo shoqëri e gjen identitetin e vet me qytetërimin e fundit që e ka ndërtuar. Qytetërimi ynë i fundit të cilin e kemi formuar, është ai osman. Për këtë arsye është vështirë të jetosh me një identitet që e përjashton identitetin osman-historik. Ju, si Turqi madje dhe nëse e përjashtoni të kaluarën, grupet që ju shohin si "tjetri" vazhdojnë t'ju përkufizojnë me identitetin osman. Madje edhe turku më ateist për europianin është osmanlli dhe si i tillë do të vazhdojë të mbetet. Turku sado që të mundohet ta tregojë veten me identitet të ateistit, prapëseprapë nuk do të ketë gjasa që ta ndryshojë mendimin e tjetrit. Zaten çështja e Bashkësisë Europiane këtë e ka treguar në mënyrë mjaft të qartë dhe të dhimbshme. E tillë është edhe vetëdija jonë shoqërore. Firmosja e marrëveshjes së Bashkimit Doganor rastisi në kohën

kur një klub yni i futbollit e kishte mundur një ekip europian dhe me atë rast në faqen e parë të një gazete u shfaq ky titull: "Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkimit Doganor ëndrra historike u bë realitet. Turqia tanimë është pjesë e Europës". Në faqen e fundit të gazetës në fjalë me shkronja të mëdha shihej titulli: "Europë! Dëgjojë zërin e shputave tona!" Nëse i sillni në një vend gazetarët që i kanë vënë këta dy tituj, ndoshta fare nuk do t'i referohen identitetit osman. Kjo është një tablo që reflekton një aspekt kontradiktor të Turqisë. Është një gjë që gjendet në gjenet shoqërore dhe kulturore. S'është mirë që ky fakt të futet në ligjëratën përplasëse e as të injorohet.

Çakmak: Nëse kundërtinë mes Lindjes dhe Perëndimit e shikojmë nga një kënd fetar, a mund të flitet për oponencën ndërmjet Islamit dhe krishterimit?

Davutogllu: Në thelbin e qytetërimeve ka një vetëdije të ekzistencës. Thënë më drejt, qytetërimet janë formë shoqërore e vetëdijes së ekzistencës. Në këtë rast, qytetërimin nuk e shoh si diçka të kufizuar. Pas vetëdijes për ekzistencën, pa marrë parasysh është në formën e botëkuptimit fetar ose jofetar, qëndron feja. Është shumë vështirë që vetëdijen për ekzistencën ta shkëputësh prej fesë. Ateizmi si përpjekje për t'i gjetur përgjigje një pyetjeje së cilës i kërkon përgjigje edhe feja, mbetet në atë fushë. Qytetërimet lindin nga vetëdijet e ndryshme për ekzistencën dhe ashtu si mund të jetojnë në vende të ndryshme, mund të bashkëjetojnë edhe në hapësirë të njëjtë. Në fakt, te pjesa dërrmuese e qytetërimeve klasike vetëdijet e ndryshme për ekzistencën kanë bashkëjetuar. Për

shembull, në shtetin osman, siç përmendet shpesh, jomyslimanët e kanë përcjellë mënyrën e tyre të jetesës prej brezi në brez. I njëjtë është rasti edhe me Indinë e Andaluzinë. Por sot ndodh diçka tjetër: Qytetërimi perëndimor vetëdijen e vet për ekzistencën dëshiron që ta ngulitë në mendësinë e pjesëtarëve të qytetërimeve të tjera dhe përmes saj të imponojë një sistem të njohjes dhe të vlerave. E kjo krijon përplasje edhe në pellgjet e tjera qytetërimore. Për ta tejkaluar këtë përplasje të personalitetit, shkohet në ndarje shekullore. Shoqëritë që do të arrijnë ta riprodhojnë pozitën e vet në qytetërimin e të ardhmes, do të mbijetojnë. Në këto raporte feja do të ketë pozitë qendrore dhe rëndësia e saj vazhdimisht do të shtohet. Në fillim të shekullit XX flitej për fundin e fesë, në mesin e shekullit të përmendur flitej për fundin e ideologjisë, kurse aty kah mbarimi i tij, për fundin e historisë. Kurse feja, historia dhe ideologjia janë tri fusha që e kuptimësojnë ekzistencën e njeriut. Moderniteti e përfoli fundin e të triave, por s'e pruri fundin e asnjërës. Dhe, gjithçka fillon nga e para. Edhe feja, edhe ideologjia, edhe historia me përcaktimet e reja do të aktualizohen përsëri.

Çakmak: Cilat janë shkaqet e mospranimin të Perëndimit për kulturën shumë të fortë lindore-islame, e cila në Europë ka (ri)ardhur me shpërnguljen e punëtorëve myslimanë, edhe pse disa herë shprehet i mahnitur me të?

Davutogllu: Të ndalemi pak te psikologjia kryqtare. Kur kryqtarët hynë në tokat islame, ata synonin pastrimin e tokave të shenjta nga pabesimtarët; shoqëria të cilën ata e quanin pabesimtare dhe barbare

ishte shumë më e lartë se ata, shumë më e sofistikuar, e bazuar në themele shumë më të forta. Këto ishin arsyet pse kryqtarët mbetën të shokuar dhe këtë shok e bartën edhe në kulturën europiane. Qytetërimi perëndimor për shkak të tronditjeve si kjo dhe të ngjashme me të, u fut në një krizë të re dhe për ta zgjidhur këtë krizë filloi të kërkojë rrugëdalje të reja. Edhe ne kemi përjetuar trauma të ngjashme. Edhe intelektualët tanë, kur vajtën për të parën herë në Perëndim, kanë përjetuar një shok të këtillë. Mbi pluhurin e atij shoku kulturor, ne tash po mundohemi të formojmë një vetëdije të re, një personalitet që s'turpërohet prej vetvetes. Nga ana tjetër, Perëndimi ka hyrë në një etapë kur po e ndien lëkundjen e vetëdijes së vet, në saje të së cilës ka arritur të mbisundojë. Nëse i shqyrtojmë mendimet dhe konceptet e teoricienëve të mëdhenj të Perëndimit të para 150 vjetëve, do të konkludojmë se intelektualit perëndimor nuk e ka shtuar sigurinë në vetvete, ai ka filluar ta humbë vetëbesimin. Në atë kohë, në veçanti në periudhën pas filozofisë iluministe, arsyeja (*ratio*) do ta gjenerojë shkencën, kurse shkenca përparimin. Por, ç'e do që shkenca, e cila është produkt i arsyes nuk sjell çdoherë përparim, e sjell bombën atomike... Dhe Perëndimi s'ia doli të formonte një tërësi vlerash që do t'i kontrollonte të gjitha këto. Dobësia në këtë pikë i shtyu shoqëritë e tjera të formonin paragjykime ndaj shoqërive me gjykime vlerash më të forta. Disa u shprehën se "Mund të marrim disa gjëra prej kulturave të tjera". Me të vërtetë qytetërimet që përshkohen nga kriza të tilla duhet të marrin injeksion të qytetërimit. Perëndimorëve u du-

ket e vështirë ta pranojnë këtë injeksion në kohën kur mbisundojnë si në aspektin ushtarak, ashtu edhe në atë politik. Dhe vazhdimisht e zgjedhin rrugën e përjashtimit. Shembulli i fundit është ndarja që bën Huntingtoni në trajtën West-Rest (Perëndimi-Të tjerët). Kjo është një ndarje kategorike e njerëzimit, që buron nga një reagim i tillë, por me kalimin e kohës intelektualët dhe shoqëria perëndimore do t'i bien në të. Perëndimi momentalisht po jeton në kthetrat e konservatorizmit të ashpër, nuk është i hapur ndaj ideve të reja, nuk lejon që të debatohet rreth tyre. Natyrisht se ky pohim nuk vlen për gjithë Perëndimin. Në gjirin e tij ka edhe intelektualë e njerëz të tjerë me horizonte të gjera. Por, në përgjithësi, Perëndimi mundohet ta ruajë fuqinë ushtarake dhe politike. Në këtë vijë pa e kuptuar Islamin siç duhet, duke e treguar këtë fe si rrezik, po formon një imazh të pavërtetë për një qytetërim të tërë. Nëse një bashkësi ka filluar të vuajë prej kompleksit të rreziqeve, kjo do të thotë se ka filluar ta humbë fuqinë. Qytetërimi që është i sigurt në vetvete, nuk mendon rreth rreziqeve.

Çakmak: Në saje të integritit kulturor aktual, a mund të vijë deri te thyerja e ndarjes që ekziston prej kohësh "Ne dhe Perëndimi"?

Davutogllu: Nëse integrimi kulturor është përhapja e mënyrës perëndimore të jetesës, kjo mund të kuptohet në dy mënyra. Sikur myslimanët të mos hyjnë në marrëdhënie të këtillë me modernitetin, sikur të vazhdonin të jetonin nëpër zonat malore si ishuj të vegjël kulturorë, ndoshta s'do të shfaqej përplasja. Do të trajtoheshin si elementet antropologjike dhe turisti-

ke të Afrikës, të Australisë e të Amerikës Jugore dhe perëndimorët do të ishin të kënaqur me ta, s'do të kishte kurrfarë ballafaqimi. Përplasja lindi për arsye se myslimanët nuk deshën të jenë objekt hulumtimi dhe turizmi. E ndien nevojën për ta jetuar prej brenda modernitetin dhe për t'i qëruar hesapet me të, ishin të detyruar për një gjë të tillë. Sepse përplasja ishte në natyrën e kapitalizmit, në natyrën ekonomike-politike të kapitalizmit. Që të mund ta shisnin mallin e vet, myslimanët duhej të modernizoheshin, duhej t'i pranonin mënyrat e konsumit të ofruara nga Perëndimi. Myslimani, që filloi ta modernizojë mënyrën e vet të jetesës shumë më tepër e ndjeu kontradiktën dhe iu desh të reagonte. Procesi i quajtur integrim kulturor e shtoi kundërtinë dhe e thelloi krizën e identitetit. Pyetjet si "Pse ne s'jemi në histori?", "Pse s'jemi të pranishëm sot?" mund të jenë të pakuptimta për një fshatar që ka një mënyrë të caktuar të konsumit dhe që jetën e rregullon sipas saj. Por, për një shoqëri në modernizim e sipër janë kuptimplota dhe janë pyetje që kërkojnë përgjigje. Kur ta shtroni pyetjen "Kush jemi ne?" duhet të jeni të gatshëm për ballafaqim. Duhet të jeni trim dhe të keni pretendime në këtë çështje. Nëse ndaleni në librat që shfrytëzohen në rrjetin arsimor zyrtar, do të shihni se në to nuk flitet fare për shoqëritë joperëndimore. Dhe ne këtë e mësojmë si histori universale, si histori të tërë njerëzimit. Qytetërimi perëndimor, në saje të paradigmës së vet arsimore dhe të literaturës, ka bërë identifikimin e historisë njerëzore me historinë e vet. Kjo vetvetiu e ka këtë domethënie: "Ju si kinezë, myslimanë dhe indianë

nuk keni vend në histori". Dhe natyrisht, njeriu që ka vetëbesim, që është i vetëdijshëm për qenien dhe që ka ndjenja të krenarisë, do të reagojë në këtë mënyrë: "E ku e kam vendin unë në histori? Nëse unë nuk jam fare në histori, ç'kuptim ka qenësia im? Nëse unë në të kaluarën kam pasur pellgun tim të qytetërimit dhe të kulturës që ka qenë determinues, atëherë ku jam tash?" Prej atij çasti, pa marrë parasysh se modernizoheni, në mendjen tuaj shfaqet çështja e "ne"së, fillon të formohet pyetja e vetëperceptimit. Unë mendoj se kjo gjendje sadoqë duket se e zbut dhe e bën më fleksibël gjendjen, e rrit përçarjen njohëse të individit.

Çakmak: Ballafaqimi i shtetit osman me Perëndimin a ndodhi përnjëherë, ose me vetëdije dhe dëshirë?

Davutogllu: Mund të thuhet se ky ballafaqim nuk ka ndodhur as me vetëdije e as përnjëherë e papritmas. Këto dy botë janë ballafaquar në një proces natyror. Shteti osman ka ecur dhe është zgjeruar në drejtim të Perëndimit dhe ballafaqimi ka qenë i pashmangshëm. Dhe kjo domosdoshmëri vazhdon edhe sot e kësaj dite. S'ka mundësi të ktheheni te vetja dhe t'i ikni kësaj përballjeje, s'mund ta harroni atë dhe të silleni sikur i takoni asaj bote. Duhet ta dimë mirë se një ballafaqim i tillë ekziston dhe se ka lindur si domosdoshmëri historike. Është e nevojshme që të silleni sipas kërkesave të domosdosë historike. Vullnetin për shndërrim të vetëdijes së ekzistencës në një formë të re të qytetërimit duhet ta ushqejmë si një amanet të shenjtë dhe duhet të jemi të gatshëm që me Perëndimin të ballafaqohemi në çdo fushë, në çdo nivel, të gatshëm për dialog por edhe për ballafaqim të ndershëm.

Çakmak: Teza e Hantingtonit për përplasjen e qytetërimeve a e ka tërhequr interesimin e qytetarëve akademikë myslimanë?

Davutogllu: Tepër madje. Ndoshta edhe më tepër sesa kjo tezë e ka merituar. Dashur e pa dashur kemi qenë të detyruar të jemi në rrjedha. Mendoj se ndaj Hantingtonit si në rrafshin akademik ashtu edhe në atë historik, është treguar më tepër interesim sesa e ka merituar. S'ka pasur nevojë që të hiperbolizohet kaq.

Krizat si mundësi për hapërim drejt shtigjeve të reja

Alltënolluk: Jemi duke përjetuar një ndryshim shekullor. Turqia në mënyrë interesante ka hyrë në procesin e kandidimit për të qenë anëtare në NATO. Kemi ardhur në një pikë të rëndësishme në aventurën e perëndimorizimit që vazhdon prej periudhës osmane. Presidenti i ShBA, duke pohuar se “Turqia si një vend islam, me preferimet e veta do t’i japë formë shekullit XXI”, Turqisë i jep një rol mjaft me peshë. Si i vlerësoni këto zhvillime? Vallë, çfarë roli synohet të na jepet? A mund të bëni një krahasim ndërmjet Perëndimit dhe Islamit duke u nisur prej debateve rreth mijëvjeçarit të ri? Çfarë mendoni në lidhje me krizën e vetëbesimit, të llojit “Qytetërimin tonë s’i ka mbetur çka të thotë kundrejt qytetërimin perëndimor”?

Davutogllu: Mendoj se duhet ikur prej konstatimeve afatshkurtra që bazohen në një fotografi dhe koniunkturë të vetme dhe se duke i shfrytëzuar periudhat kalimtare, si kjo e kalimit prej një shekulli në tjetrin, duhen bërë vlerësime më të thella. Para së gjithash duhet theksuar, se çdo qytetërim e ka perceptimin e vet të veçantë të kohës e të hapësirës. Pra, duhen bërë vlerësime jashtë psikologjisë së mijëvjeçarit ose të shekullit. Për shembull, ndryshimi kohor mes viteve 1999 dhe 2000 nuk duhet konsideruar si vijë e prerë e ndarjes. Duhet kuptuar se ky perceptim i kohës

është i varur prej qytetërimit dhe kulturës. Viti 2000 është i rëndësishëm në rrjedhën e qytetërimit perëndimor. Në aspektin fetar, ky vit përbën edhe fillimin e një mijëvjeçari të ri dhe asocion me Romën, të cilën Perëndimi e sheh si formë të veten juridike dhe politike. Por, për pellgjet qytetërimore jashtë Perëndimit, për qytetërimin kinez, për qytetërimin indian dhe për atë islam vitin 2002 është datë shumë e re. Qytetërimi kinez thuhet se ka histori pesëmijëvjeçare. I njëjtë është rasti edhe me qytetërimin indian. Qytetërimi islam ka një perceptim të kohës që shkon deri te njeriu i parë, deri te Ademi (a.s.), pra shënon një vazhdimësi që shkon shumë më larg 1400 vitet që na ndajnë nga koha kur ka jetuar Muhammedi (a.s.). Krahasimet mes Islamit dhe Perëndimit duhen bërë në varësi të këtij perceptimi të faktorit kohë.

Nëse do të bënim një vlerësim të një mijë viteve të shkuara, do të përfundonim se në raportet mes Islamit dhe Perëndimit janë përjetuar transformime të rëndësishme. Në këtë kornizë mund të thuhet se Turqia ka një pozitë të veçantë. Në fillim të mijëvjeçarit të dytë, turqit u njohën me Islamin, e pranuan atë dhe e islamizuan Anadollin. Nëse vitin 1071 e marrim si fillim të mijëvjeçarit të ri, mund të themi se ndërkohë përbën edhe fillimin e shpërnguljes së madhe të tyre në Anadoll bashkë me qytetërimin islam dhe shndërrimin e kësaj hapësire gjeografike në vatan të tyre. Fiset turke që kanë qenë element mjaft dinamik, u vendosën në Anadoll, formuan perceptimin e vet për hapësirën dhe i përveshën krahët që qytetërimin islam ta rindërtonin. Është shumë interesante se në të

njëjtën kohë e, si reagim ndaj disfatës në Malazgirit, në vitin 1096 perëndimorët filluan luftërat e kryqëzatore. Elementet teutone, franke dhe anglosaksone që sot konsiderohen bosht i qytetërimit perëndimor, pas takimit me krishterimin, duke dashur t'i shpëtojnë tokat e shenjta depërtuan në Anadoll. Pra është kjo periudha kur në tokat e Anadollit u ballafaquan turqit, të cilët në fillim të mijëvjeçarit të dytë e pranuan Islamit e hynë nën flatrat e këtij qytetërimi, dhe popujve europianë të cilët e patën pranuar që më parë krishterimin. Tre shekujt e parë të këtij ballafaqimi kaluan në larje të hesapeve me Bizantin. Nëse e trajtojmë periudhën e kaluar deri në vitin 1355, mund të thuhet se Anadoli ishte shndërruar në mejdan lufte. Në vitin 1355 turqit kaluan në Rumeli si element parësor i qytetërimit të cilin e kishin zgjedhur, kaluan në Europë dhe ia filluan luftës për mbisundim. Një periudhë afër treshekullore, mes viteve 1355-1699, turqit arritën të mbisundojnë Europën Lindore dhe atë të Mesme. Në këtë periudhë si shtet që merrej për model ishte shteti osman. Ky subjekt bartte bindjen se e kishte bashkuar historinë në vete dhe se e kishte rindërtuar historinë rreth konceptit të "antikës". Nga ana tjetër perëndimorët, të cilët kishin mbetur shumë prapa osmanllinjve, mundoheshin që ta përvetësonin modelin osman. Këtë mund ta vërejmë te mendimet e Bodinit, të Makiavelit, si dhe të shumë mendimtarëve perëndimorë, të cilët shtetin osman e shihnin si model shumë të fortë që s'e njihte disfatën. Tre shekujt e fundit, pra periudha ndërmjet viteve 1700-2000, është kohë kur myslimanët kanë mbetur prapa Perëndimit. Këtë pe-

riudhë mund ta ndajmë në dy etapa. Myslimanët, të cilët deri në kohën e Tanzimatit nuk dyshonin fare në vetveten dhe në të vërtetat e qytetërimit të tyre, në "luftën" me Perëndimin kishin mbetur prapa. Në njëqind e pesëdhjetë vitet e fundit, myslimanët kanë filluar që t'i diskutojnë të vërtetat e tyre të qytetërimit, kanë pësuar disfata ushtarake dhe kanë filluar ta përjetojnë procesin e quajtur perëndimorizimi. Pra, nëse e vlerësojmë periudhën e mijëvjeçarit të fundit, do të shohim se 150 vitet e fundit i takojnë vetëm Perëndimit ose se mijëvjeçari i shkuar ka kaluar nën sundimin e botës perëndimore.

Vërehet qartë se anadollaku në ballafaqimin mes qytetërimit islam dhe atij perëndimor është në qendër të mejdanit të qërimit të hesapeve, në qendër të frontit: Së pari, si bartës i qytetërimit islam, pastaj si element dominant i qytetërimit islam në Perëndim dhe në 150 vitet e fundit si një entitet në ndarje shekullore, që në mënyrë më serioze është duke e përjetuar përvojën e perëndimorizimit... Kur bëjmë një vlerësim të një perspektive kaq të gjerë të mijëvjeçarit të kaluar, natyrisht që pritet që tek ne të gjendej një thesar dhe përvojë e çmuar. Si qendër e fundit e qytetërimit, e kemi zotëruar trashëgiminë e qytetërimit islam, e kemi pasur këtë përparësi dhe si entitet që e kemi mundësinë e përvetësimit të vlerave të qytetërimit perëndimor, që sot ka pretendime të forta për njëfarë globalizimi.

Kjo është një tablo që na flet për dallueshmërinë e shoqërisë turke. Prej kësaj tabloje mund të lindë edhe kriza, por, nga një ballafaqim dinamik dhe produktiv

mund të dalë edhe një aliazh, i cili mund t'i ndihmojë si botës islame ashtu edhe tërë njerëzimit. Elementet pasive dhe ato penguese të një qytetërimi s'mund të lënë gjurmë serioze në histori. Kurse subjektet prijëse dhe ato që janë të detyruara në mënyrë të drejtpërdrejtë të ballafaqohen me një qytetërim tjetër, gjithëherë lënë gjurmë të thella në historinë e njerëzimit. Fjalët e Klintonit rreth rolit të Turqisë në marrëdhëniet dhe balancat ndërkombëtare na bëjnë të jemi optimistë. Kjo pikturë që flet për sfidat me të cilat ballafaqohemi, mund të gjenerojë ide dhe vlera kulturore të rëndësishme.

Alltënolluk: A mund të bëni një vlerësim të shekullit të fundit nga prizmi i marrëdhënieve të qytetërimin perëndimor me qytetërimet e tjera?

Shekulli i fundit i Perëndimit

Davutogllu: Shekulli XVIII përbën periudhën kur qytetërimi perëndimor, përpiquej që përreth filozofisë së iluminizmit t'i rindëronte të vërtetat e veta absolute. Nëse shkojmë edhe pak prapa, do të vërejmë se shekulli XVII në përgjithësi është shekulli i qytetërimin islam dhe i dinastisë turke në veçanti. Është shekull kur në Eurazi ka sunduar qytetërimi islam përmes dinastive turke në kuadër të shtetit osman, safevit dhe babur. Këtë e thonë dhe e pranojnë edhe mendimtarë si Hodgsoni. Kjo është periudha kur në Perëndim, në saje të politikave merkantiliste ekonomike

dhe atyre absolutiste politike, filluan t'i hapeshin shtigjet imperializmit klasik. Shekulli XVIII është një fazë kohore kur në Europë bashkë me revolucionet, në plan të pari doli filozofia iluministe, kur u hapën horizonte të reja në filozofi brenda kornizës së re shkencore të qytetërimit perëndimor.

Në shekullin XIX, filozofia iluministe solli me vete një koncept të ri për historinë dhe hapësirën, që synonte ta përfshinte tërë njerëzimin. Në veçanti në pjesën e dytë të shekullit në fjalë janë parashtruar teori të përmasave të mëdha, që historinë e tërë njerëzimit e kanë interpretuar përreth vetes. Filozofia e historisë e Hegelit, koncepti ekonomik i Marksit, pikëpamja filozofike e Kantit nga periudha e mëparshme janë refleksione të reja me përfshirje të madhe. Lëvizja në pjesën e dytë të shekullit XIX ia filloi që tërë botën ta shihte si fushë mbisundimi të kësaj kornize të re kulturore dhe filozofike. Me të vërtetë perandoritë koloniale angleze dhe franceze e ndanë botën dysh. Fillimi i shekullit XX përbën periudhën kur dominimi i qytetërimit perëndimor dhe vetëbesimi i tij arriti kulmin. Tanimë e tërë rrjedha e njerëzimit është reduktuar vetëm në rrjedhën e qytetërimit dhe historisë perëndimore. Në këtë kohë filluan të shfaqeshin tezat se qytetërimet e tjera dalngadalë do të eliminohen. Nga fillimi i shekullit XX deri në vitet '30 në përgjithësi pritej që infrastruktura kulturore/filozofike dhe dominimi i qytetërimit perëndimor të përforcoheshin, kurse pellgjet e tjera qytetërimore të bëheshin avull. Atëbotë mbizotëronte një perspektivë e tillë. Në atë kohë kishte edhe mendimtarë si

Spengleri, që mendonin se qytetërimi perëndimor është në krizë.

Tani, nëse bëjmë krahasimin e shekullit XIX dhe atij XX do të përfundojmë se, që nga gjysma e dytë e shekullit XX, Perëndimi dalngadalë filloi ta humbë prestigjin që e kishte pasur më parë. Në këtë kohë filluan të shtrohen në tryezën e debatit postulatet themelore të filozofisë së iluminizmit. Në fillet e filozofisë iluministe mendohej se njeriu në saje të treshes arsyeja-shkenca-përparimi do ta arrinte përparimin absolut dhe përmes këtij përparimi, lirinë dhe sigurinë absolute. Sipas kësaj teorie, njeriu gjatë tërë historisë e pat kërkuar lirinë dhe sigurinë, pra kërkoi të jetë i lirë dhe të jetojë në një hapësirë të sigurt. Dhe deri te këto gjëra duhej të arrinte si rezultat natyror i përparimit. Por shekulli XX tregoi se punët nuk po shkojnë në atë drejtim, njeriu nuk arriti të bëhet më i lirë në saje të shkencës. S'ia doli që me kalimin e kohës t'i zgjerojë fushat e lirisë së vet. Përkundrazi, zhvillimet shkencore si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë ushtarak e teknologjik ia ngushtuan atij fushën e sigurisë dhe të lirisë. Trumbetohej se njeriu do të ishte më i sigurt, kurse ai në Luftën e Parë Botërore u ballafaqua me shkatërrimin më të madh të historisë. Themi kështu, sepse për herë të parë, përkundër teknikave klasike të luftimit, në saje të forcave ajrore e pësuan edhe njerëzit jashtë frontit luftarak. Lindi një problem i sigurisë madje edhe te njerëzit që s'ishin përfshirë në luftë. Lufta e Dytë Botërore këtë gjendje e përkeqësoi edhe më tepër. Sepse këtë herë, me një ndërmarrje më të madhe teknologjike, në saje të bombës atomike, lin-

di problemi i sigurisë së brezave të ardhshëm. Kjo shkaktoi një shok të madh në tërë botën në përgjithësi dhe në Perëndim në veçanti.

Mendimi për mbisundimin absolut të qytetërimit perëndimor dhe zhdukjen e të tjerëve, që arriti kulmin mes viteve 1930-1940, pas Luftës së Dytë Botërore u zëvendësua me qëndrimet skeptike rreth vlerave të qytetërimit perëndimor. Në këtë kontekst krahas problematikës së ekzistencës, lindi edhe ajo e dijes. Filluan të lëkundeshin edhe pretendimet e fizikës të shekullit XIX për ta perceptuar hë për hë absolute, si dhe bindjet se racionalizmi dhe pozitivizmi kanë kapacitet për t'i ripërcaktuar vlerat e të gjithë njerëzimit. Relativizmi, fizika e kuantumit dhe rrymat pasmoderniste filluan ta tronditin idenë për të vërtetën absolute dhe të vetme të modernitetit, idenë absolutiste që vërtitej rreth treshit arsyeja-shkenca-progresi. Kjo ua hapi dyert pikëpamjeve fetare, për të cilat në fillin të shekullit të shkuar u pretendua se ishin duke dhënë shpirt, si dhe të vërtetave të qytetërimeve të tjera, për të cilat Tojnbi po ashtu kishte pohuar se do të vdesin. Këtë çështje e prek edhe Koncili II i Vatikanit. Me këtë koncil, që nga vitet 1960 në Perëndim elementi fetar filloi të rigjallërohej, vlerat krishtere përsëri u kthyen në skenë. U gjallëruan dhe u shfaqën shumë lëvizje fetare. Përveç kësaj, ngjallje u shënua në të gjitha pellgjet qytetërimore. Në Kinë, vlerat konfuciane ndihmuan që në Paqësor, bashkë me vlerat kapitaliste, të formohet një fuqi dhe balancë e re ekonomike. Në Japoni u përjetua ballafaqimi i vlerave shintoiste me kapitalizmin. Në Indi hinduizmi shënoi ngritje. Në bo-

tën islame u përjetua ripërtëritja e koncepteve bazë të qytetërimit dhe të besimit islam.

Alltënolluk: Me sa duket, ballafaqimi që po përjetohet nëpër këto pellgje qytetërimore me kapitalizmin ende nuk jep sinjale të suksesit të këtyre qytetërimeve (lindore).

Davutogllu: Është e vërtetë. Në fillim të shekullit të kaluar, për perëndimorin bota joperëndimore s'ishte hiç e rëndësishme. Kurse joperëndimorët po përjetonin një mosbesim të skajshëm në vetveten. Mendonin se s'kishin ç'të thoshin përballë Perëndimit. Një gjendje e tillë më së shumti mbretëroi mes dy luftërave botërore. Kjo ishte koha e ngritjes së ideologjive dhe kur mendohej se ato i kishin zënë vendin fesë. Ideologjitë si socializmi, fashizmi dhe nazizmi erdhën me pretendime se do ta plotësonin vendin e feve. Por, pas Luftës së Dytë Botërore thuajse të gjitha ideologjitë në mënyrë suksesive i kaploi kriza. Natyrisht, u rrënuan së pari fashizmi dhe nazizmi për shkak të disfatës së pësuar në luftë, e më pas edhe socializmi. Lindi nevoja për plotësimin e vendit të zbrazur pas shkapërderdhjes së botës totalitare. Kapitalizmi s'pati fuqi për një gjë të tillë. Ai zhvillon një mënyrë të konsumit, por s'ka kapacitet për ta vlerësuar botëkuptimin dhe ekzistencën e njeriut. Periudha kur ngriheshin ideologjitë është koha kur në Perëndim u shpall fitorja përfundimtare e neoimperializmit. Sepse midis dy luftërave botërore nuk pati mbetur asnjë copë toke, ku nuk sundonin fuqitë perëndimore, thuajse e gjithë gjeografia joperëndimore sundohej nga shtetet perëndimore. Por, që nga Lufta e

Dytë Botërore, pra në pesëdhjetëvjeçarin e dytë të shekullit të kaluar u shënuar një rënie drastike e ideologjive dhe ngjallje e pikëpamjeve fetare. Meqë në qytetërimet joperëndimore të gjithë parametrat jetësorë sillen rreth fesë, gjallërim u shënuar në të gjitha sferat e jetës.

Në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, pas Luftës së Dytë Botërore kur u formuan shtete të reja, në vend të idesë së sundimit absolut të Perëndimit u aktualizua çështja e entiteteve të reja politike nga pellgjet kulturore dhe qytetërimore jashtë Perëndimit. Madje edhe shumica e vendeve që sot e përbëjnë OKB-në kanë lindur nga lufta antikolonialiste e zhvilluar kundër perëndimorëve. Gandi dhe Lëvizja e Botës së Tretë u bënë simbol i kësaj lufte. Ndërmjet dy luftërave botërore, ekzistonin vetëm tre shtete islame. Pas Luftës, lindën 45 shtete që janë anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike. Me shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik ideologjitë shekulare e arritën kufirin e tyre përfundimtar. Shtrohet pyetja se me çka do të plotësohet boshllëku që e lanë pas ideologjitë shekulare? A thua atë do ta plotësojnë fetë dhe vlerat klasike ose pozitivizmi shkencor? Në këtë drejtim po shënohet një krizë e madhe. Nëse besimet dhe kulturat që në fushën klasike i kanë dhënë kuptim jetës së njeriut, arrijnë t'ia përshtasin veten ambientit të ri të krijuar, shekulli i ardhshëm do të jetë periudhë kur këto pellgje do të luajnë një rol shumë më të rëndësishëm. Flisni për dobësimin e ndjenjës së besimit në vetvete të pellgjeve qytetërimore joperëndimore. Unë s'mendoj kështu. Te ato qytetërimet unë shoh besim më të fortë në vete sesa në fillim të shekullit të kaluar.

Alltënolluk: Nëse i kemi parasysh pamjet që ditëve të fundit shfaqen në media dhe i ndërlidhim ato me ngritjen e pikëpamjeve qytetërimore e fetare nga pellgjet joperëndimore, a mund të themi se Perëndimi është duke i fiksuar këto tendenca dhe është duke u munduar të ndikojë e të vërë gisht në to? Kohëve të fundit po flitet për interesimin që princi Çarlz po tregon për Islamin, madje nëpër kulluare flitej se në Dhomën e Lordëve do të emërohej edhe një prijës fetar mysliman (imam). Ministri i Punëve të Brendshme të ShBA ka dhënë një deklaratë, në të cilën pohon se "Identiteti amerikan nuk është produkt i fesë së krishterë". Tashmë kemi dëgjuar për porosinë e Klintonit me rastin e muajit të shenjtë të Ramazanit. Fatih Sultan Mehmedi kur e çliroi Stambollin, u shpreh në këtë mënyrë: "Jam mëkëmbës edhe i Romës Lindore". Siç duket, fuqia mbisunduese po përshkohet nga brenga e zotërimit, e legjitimitetit dhe e të bërit të vetes të pranueshëm për çdokënd. A thua këto gjëra flasin për një brengë të tillë?

Davutogllu: Këtu kemi të bëjmë me raporte dykahëshe. Nëse dëshironi që tërë botës t'i jepni rend, këtë mund ta bëni ose duke treguar forcë, siç është rasti i Luftës së Gjirit, ose duke vënë një sistem, në të cilin do të gjejnë jetë të gjitha kulturat e tjera. Shteti osman që munduar ta gjente rendin duke zgjedhur rrugën e dytë. Për këtë arsye, shteti osman në vend që t'i eliminojë kulturat antike, u mundua t'i mbante nën flatrat e veta. Nga ana tjetër, imperializmi pati zgjedhur rrugën e parë: Të ndërtojë rend hegjemonik duke i zhdukur të gjitha kulturat antike. Për këtë arsye thu-

het se qytetërimi islam dhe qendra e fundit e këtij qytetërimi bazohet në pluralizmin kulturor. Kurse imperializmi perëndimor u mundua që ta zhdukte kulturën e inkave e të actekëve, t'i eliminonte të gjitha kulturat vendore, të cilat i pati përshkuar. Por, kohëve të fundit, pas Luftës së Dytë Botërore, një qëndrim i tillë filloi të gjykohej. Si rezultat i këtij hapi është kritika e gjerë që i bëhet orientalizmit. Në këtë fazë u aktualizua çështja nëse mund të bashkëjetohej me shoqëritë e tjera. S'ka mundësi që çdo kënd i vogël i botës, të udhëhiqet vetëm prej europianëve perëndimore ose prej atlantikasve. Perëndimi para së gjithash duhet ta kuptojë këtë të vërtetë.

Një problem tjetër me rëndësi është ai i legjitimitetit. Përfytyroni Londrën e viteve 1910 dhe atë të viteve 1990. Në Londrën e viteve 1990 mund të rastisni indianë, pakistanezë, bangladesha, afrikanë etj. Imperializmi anglez i viteve 1910 ishte i orientuar drejt botës së jashtme, kurse në vitet 1990 prej vendeve të kolonizuara u shënua një rrymë e shpërnguljes në Angli. Sot Londra nuk është qytet vetëm i anglezëve. Këtë të vërtetë duhet ta shohin edhe prijësit shoqërorë si princi Çarlz. Nëse e vizitoni Londrën, do të vëreni një tablo ku anglezët e pastër do t'ju dalin pakicë. Gjendja nuk është e ndryshme as në Francë. Numri i algjerianëve, i tunizianëve dhe i veriafrikanëve të tjerë shkon vazhdimisht duke u rritur. E njëjta gjë ndodh me turqit në Gjermani. Para 50 viteve, vënia në përdorim e xhamisë së parë në ShBA ka qenë ngjarje e madhe, kurse sot thuhet në çdo qytet të vogël ose të madh të këtij vendi ka nga një xhami. Ashtu si ka xhami, ka

edhe lagje kineze, tempull të hinduizmit... Kolonializmi i shekullit XX solli me vete edhe lëvizje të popullatës drejt shteteve kolonizuese. Ja pra, tash për t'i udhëhequr këta njerëz duhet gjetur një kornizë që do t'i referohet botës së tyre kulturore. Kjo është ajo që kërkohet në Amerikë. Një kornizë që në kuadër të kulturës amerikane do t'u gjejë vend urimeve të Ramazanit, që Islamin do ta mbajë brenda sistemit si feja e dytë për nga numri i ithtarëve. Në Dhomën e Lordëve të Anglisë përveç imamet mysliman, do të ketë edhe një prijës fetar sikh dhe një hindu. Qëllimi thelbësor përmes gjithë kësaj është ruajtja e kohezionit shoqëror. Vitin e kaluar, në një kongres ndërkombëtar, këtë çështje e diskutuam edhe me disa akademikë perëndimorë: Demokracia perëndimore ka dy probleme, dy pika nevralgjike. Së pari, në rendin ndërkombëtar nuk ka demokraci. Mbisundon një rend hierarkik, ku pesë shtete që janë pjesë e Këshillit të Sigurimit në OKB prijnë dhe vendosin, kurse shtetet e tjera janë në plan të dytë. E dyta, sa janë demokratike vetë vendet perëndimore? Këtu problem bazë është pjesëmarrja politike e joperëndimorëve. Nëse struktura e banorëve të Londrës ndryshon, kurse struktura udhëheqëse e këtij qyteti ende bart karakterin e pastër anglez, kjo do të thotë se mes këtyre dy dukurive ka një kontradiktë. Nëse numri i myslimanëve të ShBA vazhdimisht rritet dhe nga ana tjetër asnjë myslimani nuk i jepet ndonjë funksion në politikë, kjo do të thotë se diçka nuk është në rregull. Perëndimi është i detyruar që të ballafaqohet me këto çështje. Edhe në shekullin XXI përqindja e ardhësve nga vendet joperën-

dimore do të vazhdojë të rritet, sepse shtetet perëndimore kanë popullatë që plaket. Numri i vendasve do të zvogëlohet dhe ky është problem serioz që kërkon zgjidhje. Nëse këtë problem ende do të mundohen ta zgjidhin duke i konsideruar ardhësit si pjesëtarë të kulturës së dorës së dytë, të qytetërimit të dorës së dytë, si njerëz të një klase më të ulët, natyrisht se do të pasojnë reagime, formimi i një vetëdijeje oponente dhe si rezultat i të gjithë kësaj do të shtohen turbullirat. Metoda më e mirë e zgjidhjes është pranimi i "të huajve" si pjesë e sistemit ndërkombëtar dhe kombëtar. Nëse zgjidhet metoda e parë lind racizmi, realitet ky që është i pranishëm në shumicën e vendeve perëndimore; e nëse zgjidhet metoda e dytë, Perëndimi e pranon gjallërinë e këtyre qytetërimeve. Unë nuk e pranoj mendimin se globalizimi është njëkahësh, se është lëvizje njëkahëshe prej Perëndimit drejt shoqëri-ve të tjera. Bëhet fjalë për një lëvizje shumëkahëshe. Në saje të globalizimit, lindorët mund të influencohen nga vlerat e Perëndimit, jugorët prej vlerave të veriorëve, por mund të ndodhë edhe e kundërta, edhe Perëndimi për ta mbushur fushën e zbratur prej ideologjive mund të detyrohet të njihet me qytetërimet e tjera. Pra kemi të bëjmë me një periudhë shumë dinamike, shumë produktive. Është shumë produktive si për ata që duan ta interpretojnë ballafaqimin e qytetërimeve, ashtu edhe për ata që duan t'i kontribuojnë këtij ballfaqimi. Për këtë arsye, në vend që të formojmë bindje pesimiste, duhet të zhvillojmë një pikëpamje optimiste, me pretendime serioze dhe reale.

Alltënolluk: Fukujama, autor i idesë për fundin e historisë, na del para me një identitet të një shkencëtari që prodhon teori sipas porosisë. Teza e tij e fundit është ajo se disa institucione (si familja) të kulturave dhe qytetërimeve lokale, e pengojnë përshtatjen ndaj kulturës universale perëndimore dhe për këtë arsye duhet të zhduken. Ku mund ta pozicionojmë këtë tezë? Sepse tezat e tilla të japin përshtypjen se Perëndimi i përngjan një njeriu që gjendet në errësirë, që s'e sheh dritën, që mundohet t'i bëjë hapat me ndihmën e dikujt që e mban për dore.

Davutogllu: Qëndrimet e Fukujamës për fundin e historisë mundohem t'i ndjek që nga viti 1989. Ne si kundërtezë kemi qëndrimin se nuk kemi të bëjmë më fundin e historisë, por me një transformim qytetërimor. Argumenti themelor në tezën e Fukujamës është ai se njeriu i ka arritur të gjitha vlerat e mundshme dhe se i ka të gjithë mekanizmat për jetësimin e tyre. Ky qëndrim i shfaqur në kohën kur po shembej Muri i Berlinit dhe kur po zhbëhej Bashkimi Sovjetik ishte shumë optimist. Në kritikën që ia kam bërë kësaj teze, kam pohuar se kërkimi i njeriut nuk ka përfunduar, se si perëndimorët ashtu edhe lindorët po ballafaqohen me probleme serioze të lirisë e të sigurisë dhe në këtë kontekst kam përmendur pesë parametra. 1. Çështja e lirisë dhe e sigurisë ontologjike (ekzistenciale). 2. Polemikën në sferën e epistemologjisë, rreth burimeve të dijes dhe fushave të së vërtetës. 3. Problemi i baraspeshës midis zhvillimit teknologjik dhe vlerave morale. 4. Problemi i mjedisit jetësor. 5. Problemi i pluralizmit, problemi rreth qenies së kulturave të tje-

ra. Çdonjëra prej këtyre pikave është çështje më vete dhe s'mund të thuhet se ato janë zgjidhur. Madje mund të thuhet se problemet në fjalë tregojnë ritëm rritjeje.

Fukujama, duke u nisur nga koniunktura e asaj kohe, shtroi një tezë e cila u shfrytëzua në Luftën e Gjirit. Teza në fjalë vdiq me luftën në Bosnjë. Sepse në këtë luftë të gjitha ato vlera për të cilat pretendohet se e kishin prurë fundin e historisë, u nëpërkëmbën. Lufta e Bosnjës tregoi se Fukujama kishte bërë një vlerësim shumë sipërfaqësor. Edhe teza e Hantingtonit synonte shpjegimin e luftës së Bosnjës, por edhe ajo gjallërimet e qytetërimeve i keqpërdori për qëllime strategjike. Të dy këta mendimtarë kanë hequr dorë prej tezave të veta, së paku e ndjenë nevojën për t'i rishqyrtuar të thënat, por ende s'kanë formuar bazament objektiv. Shumë sipërfaqësor është edhe mendimi i Fukujamës, sipas të cilit institucionet tradicionale i bëjnë rezistencë rrjedhës natyrore të globalizimit dhe se e pengojnë përshtatjen e atyre shoqërive ndaj kushteve të reja. Sepse pikërisht këto vlera janë damar ekzistencial i shoqërive joperëndimore, ato ua japin atyre veçanësinë. Nëse një qytetërim është përshkuar nga kriza, nëse është futur në krizë të rendit politik dhe të prapaskenës së vet filozofike, këtë krizë s'mund ta kapërcejë përmes balancave të veta të brendshme. Ka nevojë për injeksion nga një qytetërim tjetër. Nëse i shkatërroni institucionet bazë të kulturave dhe të shoqërive tradicionale, i keni zhdukur edhe injeksionet dhe strukturimet që mund t'ua bien shëndetin. Kjo do të thotë burgosje të vetvetes në krizën në të cilën gjendeni. Unë mendoj se gjërat nuk do të rrjedhin në këtë

drejtim. Ndoshta në sferën politike për një kohë shumë të shkurtër nuk do të lindë konkurrencë e fortë. Dominimi ekonomik dhe politik i Perëndimit do të vazhdojë, por dalëngadalë do të shënohet një rrudhje, një fishkje dhe problemet që do të lindin në trupin e Perëndimit do ta shtyjnë atë që t'i marrë parasysh vlerat dhe vlerësimet, të cilat vijnë nga qendrat kulturore antike joperëndimore.

Dinamizmi i botës islame

Alltënolluk: Ju pohoni se qytetërimi perëndimor ka lindur pas dominimit tre-katërshekullor të qytetërimit islam, se sot një proces i njëjtë është duke rrjedhur edhe për qytetërimin islam. A mundet që këtë ta sqaroni duke na dhënë shembuj konkretë?

Davutogllu: Mund të bëjmë një analogji të këtillë. Në shekullin XVII fuqi dominante ishte shteti osman. Por edhe në Perëndim kishte gjallërim serioz të mendimit. Ndërkohë Perëndimi po përjetonte krizë. Ndërsa osmanllinjte mendonin se me idenë e shtetit të përhershëm (*Devlet-i Ebed Müddet*) kishin vënë rend në planin ndërkombëtar, në Perëndim mbretëronte një krizë e rëndë politike, ekonomike dhe për ta tejkaluar këtë krizë po bëheshin përpjekje të mëdha për gjallërim mendimor. Mendoj se sot është e kundërta. Ndërsa perëndimorët mendojnë se në saje të *Pax Americana-s* kanë formuar një rend global atlantikocentrist, në fakt nuk po i vërejnë pikat e ngecjes filozofike

dhe ideore. Shoqëritë lindore dhe në veçanti pellgu në të cilin gjendet qytetërimi islam, po përjetojnë krizë politike, ekonomike-politike dhe gjeopolitike. Prej gjithë kësaj krize pritet që të lindë një gjallërim ideor.

Kohë më parë, pyetjes së një akademiku amerikan iu pata përgjigjur në këtë formë: "Sot është lehtë të jesh shkencëtar, akademik dhe intelektual amerikan. Sepse kjo do të thotë të jesh një vidë në mekanizmin e madh. Pozita dhe vendi juaj thuajse plotësisht është i (për)kufizuar. Dhe ngaqë është përcaktuar shumë mirë roli që duhet ta luani duke u nisur prej të dhënave të caktuara, që nga shkolla fillore hyni në një korridor dhe pak a shumë e dini se ku do të mbërrini... Kriza nuk duket në një ambient të tillë... Por kjo nuk është gjë mbresëlënëse, nuk është gjë që e nxit njeriun të gjenerojë ide të reja. S'të nxit të jesh në kërkim e sipër. Por, në Lindje, në veçanti në botën islame, të jesh intelektual, të jesh akademik është punë e rëndë, sepse mundohesh që t'u gjesh përgjigje problemeve globale duke u nisur prej realitetit vendor. Nuk mjafton të jesh vidë e thjeshtë e një mekanizmi. Nuk keni shembuj se nëpër cilët korridore duhet ecur dhe ku mund të arrihet. Ndërsa për një intelektual perëndimor është shumë e qartë që po të lexohen veprat e klasikëve të caktuar mund të arrihet një formacion i caktuar, në Lindje s'keni një mundësi të tillë. Sepse në Lindje në veçanti te intelektualët është pamundësuar lindja e një perceptimi të shëndoshë rreth kohës dhe hapësirës. Një gjë të tillë mund ta arrini vetë duke u përpjekur, duke e parë tërësinë. S'mund të formoni përkapje të shëndoshë të kohës dhe të hapësirës si një

akademik i mirë në një disiplinë, e as duke e marrë për bazë një disiplinë të caktuar. Nëse e kuptoni tërësinë, përpjekja juaj bëhet e kuptimtë. Kjo është punë e rëndë. Por, në të njëjtën kohë është një aventurë që t'i hap dyert e botës së filozofisë, që t'i hap sytë e zemrës, horizontet shpirtërore, mbresëlënëse. Unë them se kontributet serioze ideore nuk do të vijnë nga profesionalizimi në stilin perëndimor, të bazuar në formim dhe specializim të skajshëm në sferat sociale dhe politike, por nga njerëzit që përjetojnë kontradikta të forta, që i ndiejnë vuajtjet e tyre, që duke u nisur nga e vërteta e vet merren me problemet globale të njerëzimit dhe tregojnë shtigje për shpëtim prej problemeve të ndryshme. Kjo në fakt nuk flet për privilegjet e njerëzve, por për përgjegjësitë e tyre. Kjo e vërtetë njeriun e ngarkon me një peshë të rëndë. Në këtë aspekt duhet të sigurohet një atmosferë e lirisë së mendimit. Nëse realizohet një gjë e tillë, kontributi i një myslimani, i një kinezi, indiani, afrikani, japonezi, madje edhe i një pjesëtari të trashëgimisë autentike amerikane mund të jetë relativisht më i veshëm sesa kontributi i njeriut të arsimuar në formatin perëndimor. Kjo duhet që neve të na nxitë, të na bëjë më optimistë kundrejt pretendimeve ultrapesimiste të njeriut tipik të kohës së globalizimit.

Alltënolluk: Çka mund të na thoni për ardhmërinë e mbisundimit ekonomik dhe politik të Perëndimit?

Davutogllu: Nëse dominimin ekonomik dhe politik e shikojmë me një sy relativist, për shembull nëse e krahasojmë fundin e shekullit XX dhe fillimin e tij, do të përfundojmë se roli i aktorëve joperëndimorë

është forcuar. Sot përafërsisht 1/3 e prodhimit botëror realizohet në Azinë Lindore, në hapësirën që shtrihet prej Japonie, në Kinë dhe në Indonezinë Jugore. Kjo vlen edhe përkundër krizës së fundit ekonomike... 1/3 e eksportit realizohet në këtë pjesë të botës. Ky pellg është i integruar me ekonominë perëndimore, pra s'është i shkëputur prej saj. Më parë, roli i shteteve që shtrihen në atë pellg ka qenë shumë i vogël. Një gjë tjetër me rëndësi është edhe e vërteta, se në kuadër të brezit më të rëndësishëm strategjik dhe gjeopolitik të botës gjenden edhe vendet islame. Roli i Japonisë në aspektin ekonomik, i Kinës në atë demografik dhe i botës islame në aspektin gjeopolitik dhe strategjik shkon vazhdimisht duke u rritur. Është për shkak të këtij roli që vendet e përmendura dhe bota islame kanë një peshë globale, e cila shkon duke u rritur. Ky realitet ka ndikuar që të ketë reagime të ashpra ndaj teorisë së Hantingtonit. Kjo teori nuk u pranua për shkak të drojës së qendrave perëndimore të forcës ekonomike dhe politike prej reagimeve nga pellgjet joperëndimore. Shikuar nga ky prizëm, mund themi se forca monopoliste ekonomike dhe politike do të jetë e detyruar që dalngadalë të zgjerohet. Por kjo do të marrë shumë kohë. Formimi i një qytetërimi me bosht atlantik ka zgjatur tre shekuj. Tre shekuj kanë kaluar edhe prej lindjes e ngritjes së shtetit osman. Qytetërimi perëndimor e ka përshpejtuar ritmin. Por zgjerimi i shpejtë i këtij qytetërimi, me të njëjtën shpejtësi i fut në po atë kazan edhe qytetërimet joperëndimore. Për këtë arsye mendoj se bota monocentriste s'do të mund të mbijetojë gjatë.

Shtojca

*Përplasja e interesave: një shpjegim për (pa)rendin e botës**

Teoritë pas Luftës së Ftohtë

Ndërsa po veniten parametrat e epokës së Luftës së Ftohtë, është vendosur një lidhje e re ndërmjet procesit të vendimmarrjes politike në qendrat e pushtetit të sistemit ndërkombëtar dhe teorive politike. Kjo pasqyrohet në tezat e kohëve të fundit të librit të Fukujamës *Fundi i historisë*⁴ dhe në shkrimin e Hantingtonit "Përplasja e qytetërimeve".⁵ Me gjithë disa dallime thelbësore dhe terminologjike, këto dy teza kanë të përbashkët po atë formulim ideologjik të orientuar nga status quo-ja, kur përlligjin masat dhe manovrat e politikës së jashtme.

Fukujama i ka shkruar variantet e para të tezës së tij në një atmosferë tejet optimiste, gjatë shembjes së regjimeve socialiste, që pati si simbol rrëzimin e Murit të Berlinit. Ai shpallte fitoren përfundimtare të demokracisë liberale dhe argumentonte se "kjo mund të

* Botuar në: *Perceptions*, Journal of International Affairs, vol. II, no 4, dhjetor 1997-shkurt 1998, f. 92-121. (e përktheu nga anglishtja: Xhevat Lloshi)

⁴ Fukuyama, Francis (1992): *The End of History and the Last Man*, New York, The Free Press.

⁵ Huntington, Samuel (1993): "The Clash of Civilizations", *Foreign Affairs* 72, Summer, f. 22-49.

përbëjë pikën fundore të evoluimit ideologjik të njerëzimit dhe formën përfundimtare të qeverisjes njerëzore, e si e tillë përbën fundin e historisë”.⁶ Sipas kësaj teorie, fosilizimi i përfunduar i kulturave e qytetërimeve të tjera është i pashmangshëm si kundërpërgjigje ndaj fundit të historisë, sepse “kultura - në formën e qëndresës kundër shndërrimit të disa vlerave tradicionale për t’i kaluar te ato të demokracisë - mund të përbëjë një pengesë ndaj demokratizimit”.⁷ Kjo qasje u kthye në kredon e pagëzimit dhe në avangardën intelektuale për kryqëzatën demokratike universale në emër të Rendit të Ri Botëror. Ajo u gjet e përshtatshme për hartuesit e politikës së jashtme të ShBA, sepse gjatë Luftës së Gjirit u dha atyre retorikën e nevojshme politike për të mobilizuar gjithë botën që të arrinin planifikimin e vet strategjik në Luftën e Gjirit. Slogani i “Botës së lirë” për epokën e Luftës së Ftohtë u zëvendësua me “Bashkësinë ndërkombëtare” në epokën pas Luftës së Ftohtë. Për këtë planifikim strategjik janë përdorur - ose shpërdorur - nocionet e globalizimit dhe të përparimit teknologjik.

Teza e Fukujamës, e cila lavdëron universalizimin e vlerave dhe strukturave të qytetërimit perëndimor, ka dhënë këndvështrimin kryesor për të vlerësuar punët politike në epokën pas-sovjetike dhe para-bosnjake. Kriza e Bosnjës u bë fundi i ‘fundit të historisë’; ajo zbuloi zhbalancimet e qytetërimit perëndimor e gjithashtu deformimet e rendit botëror ekzistues. Kjo situatë e re e bëri të nevojshëm një kuadër të ri analitik.

⁶ Fukuyama, *End of History*, f. xi.

⁷ Po aty, f. 215.

Shkrimi i Hantingtonit 'Përplasja e qytetërimeve' mori përsipër të jepte këtë kuadër.

Hantingtoni nisat nga një postulat i ndryshëm prej atij të Fukujamës. Nuk i drejtohet një bashkësie universale vlerash ose ndonjë rendi ndërkombëtar. Në vend të kësaj, ai orvatet të analizojë çrregullimin politik ekzistues me qëllim që të gjejë zonat e konfliktit. Aty ku Fukujama theksonte universalizimin e pashmangshëm dhe të papërballueshëm të vlerave Perëndimore, Hantingtoni përpiqet të shpjegojë proceset qytetërimore alternative, të cilat i mobilizojnë masat në veprimin dhe në kundërvënien politike. Retorika ambicioze dhe idealiste e Fukujamës i lëshon vendin retorikës realiste dhe të kujdesshme të Hantingtonit.. Retorika e ndryshuar pasqyron ndryshimet që kanë ndodhur në fushën politike ndërkombëtare gjatë pesë vjetëve të fundit, të cilat kanë treguar se shpallja e 'fundit të historisë' ishte e parakohshme.

Aty ku Fukujama i drejtohet filozofisë së Hegelit për të përforcuar argumentimin e vet, Hantingtoni i drejtohet historisë së qytetërimit, ndonëse që të dy përdorin të njëjtën metodologji përzgjedhëse, kur citojnë filozofinë dhe historinë. Me sa duket, kjo qasje përzgjedhëse nuk përbën ndonjë gabim metodologjik. Më tepër vjen për shkak të parapëlqimit teorik, që lidhet drejtpërdrejt me misionin prapa tezës. Hantingtoni nuk e merr parasysh karakterin hegjemonist të qytetërimit Perëndimor në formimin e prirjeve globale intelektuale/filozofike, të kodeve shoqërore-kulturore të sjelljes dhe të rendit ndërkombëtar. Kjo është arsyeja përse ai i fajëson qytetërimet joperëndimore

për krizat dhe konfliktet ekzistuese. Ai e shpërfill faktin, që *Lebensraum* [hapësira jetike] i këtyre qytetërimeve është përskajuar efektivisht nga paradigma hegjemoniste e qytetërimit Perëndimor.

Hantingtoni gjithashtu shpërfill faktin, që luftërat globale më shkatërrimtare në historinë e njerëzimit kanë qenë luftëra brendaqytetërimore ndërmjet forcave sistemore të qytetërimit Perëndimor eurocentrik, të cilat kanë qenë "Luftëra të zhvilluara për të vendosur se kush do t'i jepte udhëheqësitë sistemore, rregullat e kujt do të qeverisnin, cilat politika do të përcaktonin trajtën e proceseve sistemore të destinimeve dhe cili kuptim ose vizion i rendit do të mbizotëronte."⁸ Duke përdorur të dhënat e paraqitura nga J. Levy,⁹ Tomsoni pohon se luftërat globale - ato në të cilat ka për secilën më shumë sesa 280.000 të vdekur në betejë- ndërmjet forcave sistemore, përfshijnë afërsisht katër të pestat e humbjeve njerëzore në betejë në luftërat ndërmjet Fuqive të Mëdha perëndimore. Mbitheksimi i përplasjeve rajonale ndërqytetërimore mund t'i mënjanojë nga fushëshikimi disa faktorë shumë të rëndësishëm prapa këtyre përplasjeve, që e kanë burimin te konkurrenca ndërmjet qendrave brendasistemore të pushtetit.

Këto dy qasje në kundërthënie lidhur me rolin e qytetërimeve në punët politike - njëra e Fukujamës, e cila duke e njëjtësuar qytetërimin Perëndimor me fatin e racës njerëzore ose historinë njerëzore, mbi-

⁸ Thompson, William (1988), *On Global War: Historical-Structural Approaches to World politics*, Columbia: University of South Carolina Press, f. 7.

⁹ Levy, Jack S. (1983), *War in the Modern Great Power System, 1495-1975*, Lexington: University Press of Kentucky, f. 96.

thekson rolin e këtij qytetërimi, tjetra e Hantingtonit, që e nxjerr të larë qytetërimin Perëndimor nga përftimi i konflikteve dhe i krizave - janë në të vërtetë pjesë të së njëjtës tablo. Hantingtoni e plotëson tablonë e vizatuar nga Fukujama, duke u dhënë fuqive hegjemoniste një përlligjje teorike për të gjitha strategjitë politike e ushtarake, të cilat kërkohen për të kontrolluar dhe riformësuar sistemin ndërkombëtar: vlerat dhe strukturat Perëndimore na paskan një universalizëm të brendshëm e të papërballueshëm (Fukujama), dhe qenkan qytetërimet e tjera që dalkan përgjegjëse për krizat dhe përplasjet politike (Hantingtoni). Polarizimi sipas Hantingtonit "Perëndimi kundër pjesës tjetër" është pasqyrim politik i kësaj tabloje. "Pjesa tjetër", nënkuptohet, gjithmonë do të ketë nevojë për udhëheqjen e Perëndimit për të arritur te fundi i historisë dhe për të kapërcyer çrregullimin, që vjen prej përplasjeve gjeokulturore. Po të shihet mirë, ky është një ashpërsim i frymës së kolonializmit fundamentalist të Kiplingut (Rudyard Kipling), i shprehur me togfjalëshin "barra e njeriut të bardhë" dhe i rrjedhës së tij të natyrshme, që Arnold Toynbee (Tojnbi) e ka emërtuar një "iluzion egocentrik".

Prania e një iluzioni të tillë vërehet te lidhja që vendos Hantingtoni ndërmjet analizës së vet të përplashes së qytetërimeve dhe rekomandimeve të tij strategjike për hartuesit e politikës Perëndimore. Referimi, që gjatë analizës së ballafaqimeve politike e ushtarake bën te ndërgjegjësimi qytetërimor,¹⁰ është

¹⁰ Huntington, *Clash of Civilizations*, f. 26 (kjo vepër është botuar edhe në gjuhën shqipe në vitin 2004 nga SHB "Logos-A").

një shpjegim i drejtë, por i pjesshëm. Nuk ka dyshim se shembja e sistemit sovjetik i shpërbëri pseudoidentitetet, si dhe frontet pseudopolitike të sistemit dypolësh ndërkombëtar. Mirëpo kjo zbrazëti u mbush me identitetet historike/kulturore, që janë bërë faktori thelbësor i mobilizimit politik dhe i përplasjes ndërqytetërimore. Ky fakt nuk duhet të na çojë që të mos vështrojmë faktorët e tjerë, si konkurrencën strategjike brendaqytetërimore ndërmjet Fuqive perëndimore, përparësimin gjeopolitik, luftën tregtare për të sunduar në ekonominë politike ndërkombëtare etj.

Përbërësit themelorë të një analize alternative për paqëndrueshmëritë politike në epokën pas Luftës së Ftohtë janë këta që vijojnë: (i) fundi i stabilitetit strategjik; (ii) zbrazëtia gjeopolitike dhe gjeoekonomike e pushtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në ekonominë politike ndërkombëtare; (iii) dalja e identiteteve autentike pas shpërbërjes së pseudofronteve të dypolarësisë; dhe (iv) konkurrenca brendaqytetërimore dhe brendasistemore.

Gjeopolitika dhe ekologjia e sistemit politik global

Ka pasur një ndryshim të vijueshëm në strukturën e pushtetit të sistemit ndërkombëtar, duke përjashtuar parametrat e tij globalë. Si e ka thënë me të drejtë Bismarku, e vetmja konstante në politikën e jashtme është gjeografia. Bashkëlidhja ndërmjet ekologjisë së sistemit politik global dhe marrëdhënieve

ndërshtetërore është një fakt. Gjeopolitika ka pasur rol të dyfishtë në marrëdhëniet ndërkombëtare si shkak themelor i krizave dhe i luftërave ndërkombëtare dhe si faktor vendimtar në rirregullimin e sistemit ndërkombëtar. Faktorët gjeopolitikë të paraluftës, që çuan te lufta, janë përdorur prej fituesve në epokën pas luftës për të rirregulluar rendin e ri botëror. Kështu ka ndodhur në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore e gjithashtu në periudhat para dhe pas Luftës së Ftohtë. Siç vëren me të drejtë Koeni, "kjo botë është e organizuar politikisht sipas një mënyre të arsyeshme dhe jo të rastit."¹¹ Një analizë e shkurtër e këtyre teorive gjeopolitike do ta mbështeste këtë argumentim.

Meqë ka një bashkëlidhje ndërmjet ekologjisë së sistemit politik global dhe marrëdhënieve ndërshtetërore, ka ekzistuar gjithashtu një marrëdhënie e qëndrueshme dhe e përshtatshme ndërmjet teorive e strategjive gjeopolitike të fuqive hegjemoniste. Rrjedhimisht, gjeopolitika është një faktor bazë dhe një tregues i zhvendosjes së pushtetit në politikën globale, sidomos gjatë pikave kthesë kritike në historinë e re.

Vëzhgimet gjeopolitike dhe sugjerimet gjeostrategjike të admiralit Mahan¹² në kapërcyellin e këtij shekulli u bënë parimet themelore, që u përdorën nga fuqitë detare anglo-amerikane (atlantike) për të kontrolluar pikat strategjike për hegjemoninë globale. Nga hartuesit e politikës së jashtme të ShBA u zbatuan si

¹¹ Cohen, Saul B. (1973), *Geography and politics in a World Divided*. New York: Oxford University Press, f. iv.

¹² Shih Glassner, Martin Ira (1993), *Political Geography*, New York: John Wiley, f. 225.

gurë të qoshes për politikën sugjerimet e mëposhtme të Mahanit: (i) pushtimi i Havait, (ii) vënia nën kontroll e Karaibeve, (iii) ndërtimi i një kanali për të lidhur Oqeanin Atlantik dhe Paqësor, (iv) mbajtja e luftërave larg brigjeve të ShBA, (v) ndërtimi i aleancave të frenimit. Tre sugjerimet e para u vunë në zbatim, ndërsa dy të tjerat mbeten si parime gjeostrategjike të përhershme për politikën e jashtme të ShBA. Disa nga parashikimet e tjera të Mahanit, si ato lidhur me luftën ndërmjet fuqisë tokësore ruse (Eurazia) dhe fuqisë detare britanike (Atlantiku), pesha e Singaporit si baza më e madhe detare dhe interesat e përbashkët të ShBA, MB, Gjermanisë e Japonisë në frenimin e Ruisë dhe mbajtjen nën kontroll të Kinës gjithashtu u bënë realitet.

Teoria e Makinderit për Kardilandin ("Tokën Zemër") ishte një orvatje për ta riformuluar traditën e politikës së jashtme britanike me qëllim që të bëhej e aftë për të kapërcyer sfidat strategjike të Gjermanisë, e cila synonte ta vinte nën sundim zonën strumbullar të Eurazisë. Sipas teorisë së tij për gjeopolitikën tokësore, kjo zonë strumbullar e Eurazisë, si zemra e kontinentit dhe duke qenë e paarritshme nga fuqia detare, mund të bëhej streha e një fuqie tokësore, e cila mund të arrinte të vinte nën sundim botën prej kështjellave të saj kontinentale. Kjo zonë strumbullar rrethohet prej një drapëri hënor të brendshëm në ishujt dhe në kontinentet përtej Eurazisë. Makinderi e zgjeroi Kardilandin deri në Azinë Qendrore më 1919 dhe e shtyu drejt Lindjes deri te lumi Jenisej më 1943, duke e quajtur Lenalandi.¹³

¹³ Mackinder, Halford J. (1943), "The Round World and the Winning of the Peace", *Foreign Affairs* 21, f. 593-605.

Formula e tij e famshme gjeopolitike për sundimin në politikën globale: “Kush sundon Europën Lindore komandon Kardilandin, kush sundon Kardilandin komandon Ishullin Botëror, kush sundon Ishullin Botëror komandon Botën”, ka pasur mjaft ndikim në përcaktimin e hartës së Europës pas Luftës së Parë Botërore. Aleatët fitimtarë krijuan shtete tampon për ta ndarë Gjermaninë nga Rusia, për ta mbajtur Gjermaninë larg prej Kardilandit dhe Europës Lindore e për të penguar bashkimin e Europës Lindore e të Kardilandit në duart e njërës prej këtyre fuqive kontinentale. Parashikimi i tij, i bërë më 1924, se potenciali i Kardilandit mund të baraspeshohej në të ardhmen prej Europës Perëndimore dhe Amerikës së Veriut (Oqeani i Atlantikut Verior/Mestokësor) mund të vështrohet si frymëzimi i parë për gjeopolitikën e Luftës së Ftohtë.

Lufta e Dytë Botërore ishte një luftë e gjeopolitikës. Teoria e K. Haushoffer-it për një Bllok Transkontinental si një aleancë e formuar prej Gjermanisë, Rusisë dhe Japonisë, ka qenë aleanca më gjithëpërfshirëse kontinentale e fuqive tokësore kundër koalicionit të fuqive detare, e mbështetur në epërsinë detare anglo-amerikane. Kjo strategji euraziatike ka qenë mbështetja teorike e aleancës gjermano-sovjetike më 1939. Më në fund Haushoferi propozoi një koalicion gjithërajonal ndërmjet Eurazisë gjermane dhe rajonit japonez Indo-Paqësor. Me gjithë dështimin e idesë së Haushoferit për Bllokun Transkontinental, sidomos pas sulmit të Hitlerit kundër Bashkimit Sovjetik, në gjeopolitikën aktuale dhe në ekonominë politike ndër-

kombëtare mbetet parashikimi i tij i një ndarjeje gjithë-rajonale në tri zona të veçanta fuqish, nga pikëpamja e gjeopolitikës dhe e ekonomisë politike, secila prej tyre me bërthamën e vet (Europa, Japonia dhe Anglo-Amerika), dhe me një periferi (Afrika e India, Azia Lindore e Juglindore dhe Amerika Latine përkatësisht).¹⁴

Arsyeja gjeopolitike për sulmin e Hitlerit kundër Bashkimit Sovjetik në qershor 1941 ka qenë ambicia e tij për të shtënë në dorë sundimin mbi Kardilandin dhe Eurazinë. Plani i tij gjeostrategjik ishte të arrinte deri në Gjirin Persik nëpërmjet Kaukazit e në Indi përmes Azisë Qendrore dhe Afganistanit. Kjo do të materializonte lidhjen historike e 7 B-ve të gjeo-strategjisë gjermane (Berlin, Budapest, Bukuresht, Beograd, Bosfor, Bagdad e Bombei) kundër fuqive detare koloniale. Një plan i tillë ambicioz mund të pengohej nëpërmjet një koalicioni mes fuqisë kryesore globale detare (ShBA) dhe fuqisë tokësore të Kardilandit (BRSS) me realitetet gjeopolitike që i kapërcenin dallimet ideologjike.

Mirëpo të njëjtat realitete gjeopolitike krijuan një sistem dypolësh ndërkombëtar, të përligjur nga dallimet ideologjike. Varianti i ndryshuar i Spikmanit prej teorisë së Makinderit lidhur me Kardilandin u bë themeli gjeopolitik i politikës së përmbajtjes të Amerikës, e cila ka qenë shqetësimi i përhershëm e hartuesve të politikës në Uashington. Spikmani argumentonte, se potenciali real i fuqisë së Eurazisë mbështetet në atë që Makinderi e kishte quajtur Gjysmëhëna e Brendsh-

¹⁴ Mackinder, Halford J. (1924), *The Nations of the Modern World*, London: George Philip & Sons, f. 251.

me ose Anësore, dhe jo te Kardilandi. Këtë zonë të potencialit të fuqisë ai e quante Rimlandi dhe nxori një formulë tjetër: ai që kontrollon Rimlandin sundon Eurazinë; ai që sundon Eurazinë kontrollon fatet e botës.¹⁵

Politika e përmbajtjes e ShBA synonte të kontrollonte këtë Rimland, në mënyrë që të neutralizonte fuqinë e Kardilandit, i cili në atë kohë ishte nën sundimin e BRSS. Kjo politikë mbështetej në një varg aleancash: NATO-ja (nga Norvegjia deri në Turqi), CENTO-ja (nga Turqia në Pakistan), SEATO-ja (nga Pakistani deri në Filipine në Lindje dhe në Zelandën e Re në Jug). Orvatjet e BRSS për ta thyer këtë frenim përmbajtës të Rimlandit dhe përpjekjet e ShBA për ta ndalur BRSS në Kardilandin e vet sollën shumë luftëra brendashtetërore dhe ndërshtetërore gjatë gjithë epokës së Luftës së Ftohtë. Megjithatë të dy vendet u përpoqën t'i shmangeshin ballafaqimit të drejtpërdrejtë ushtarak. BRSS dështoi në orvatjen e fundit, në Afganistan, për të vënë nën sundim rrugëkalimet më të rëndësishme (Kibrin, Gomalin e Kojakun) nga Kardilandi te Rimlandi dhe kjo u shndërrua në shpalljen gjeopolitike të shembjes së sistemit sovjetik.

Frikësimi bërthamor ka qenë një alternativë tjetër për të kundërpeshuar pozitën strategjike eprorë të BRSS në Eurazi. Hartuesit e politikës së ShBA e përdorën këtë teori për të përlligjur zhvillimin e projekteve bërthamore. Parametrat konvencionalë të garës strategjike vijuan të ishin faktorë me rëndësi, për shkak se kërcënimi bërthamor njësoj i baraspeshuar

¹⁵ Spykman, Nicholas (1944), *The Geography of Peace*. Harcourt, Brace, New York, f. 43.

krijoi një baraspeshim terrori, i cili nga njëra anë, e parandaloi luftën bërthamore ndërmjet Superfuqive dhe, nga ana tjetër, solli shkallëzimin e luftërave konvencionale rajonale, pa sjellë shumë afër rrezikun e ballafaqimit ndërmjet Superfuqive. Shtimi i Konfliktëve me intensitet të ulët (KIU) nga ana e ShBA gjatë kësaj periudhe është një tregues i rëndësishëm për ndikimin e vijuar të garës strategjike konvencionale, me gjithë ekzistencën e frikësimit bërthamor global. Shpërndarja e pesëdhjetë KIU në epokën pas Luftës II Botërore pasqyron përparësitë gjeopolitike të ShBA: 60 për qind të këtyre KIU ndodhën për grindjet lidhur me Rimlandin e Eurazisë (24 për qind në Lindjen e Mesme, 30 për qind në Azinë Lindore dhe gjashtë për qind në Europën Lindore); 32 për qind e tyre ishin në brendatokën amerikane (12 për qind në Amerikën Qendrore; tetë për qind në Amerikën e Jugut dhe 12 për qind në Karaibet); kurse tetë për qind e tyre ndodhën në Afrikë, sidomos në Afrikën Veriore, që është zona më e afërt me Rimlandin e Eurazisë.¹⁶

¹⁶ (i) Tridhjetë prej këtyre KIU ndodhën në Rimlandin Euraziatik: dymbëdhjetë në Lindjen e Mesme (BRSS 1946, Palestinë 1948, Iran 1951-53, Liban 1958, Jordani 1970, Irak 1972-75, OPEC 1974-75, Iran 1979, Siri 1979, Afganistan 1980, Liban 1982-84, Gjiri Persik 1978-88); katërbëdhjetë në Azinë Lindore (Filipine, 1942-45, 1946-55, 1984, 1985-86, Birmani 1945, Kinë 1945-49, 1953-79, Indokinë 1946-54, Koreja e Veriut 1953, Vietnam 1955-65, Laos 1955-65, Tailandë 1965-1985, Kamboxhia 1975); gjashtë ndodhën në Europën Lindore dhe në Mesdhe (Greqi 1946-49, BRSS 1948, 1956, 1961, 1968 dhe në Qipro 1974).

(ii) Gjashtëmbëdhjetë prej këtyre pesëmbëdhjetë KIU ndodhën në brendatokën amerikane: gjashtë në Amerikën Qendrore (Guatemala 1953-54, Guatemala 1965-74, Nikaragua 1978-79, El Salvador 1979, Nikaragua 1981-90 dhe Panama 1987-90), gjashtë në Karaibet (Kubë 1960, Republika Dominikane 1960-62, BRSS 1962, Republika Dominikane 1965-66, Grenada

Fundi i stabilitetit strategjik

Prapa dypolësisë së Luftës së Ftohtë ka pasur një arsyetim gjeopolitik, i cili krijoi një baraspeshë gjeostrategjike ndërmjet “Botës detare të varur prej tregtisë” dhe “Fuqisë kontinentale euraziatike”.¹⁷ Me gjithë ekzistencën e tensionit brenda superfuqive, ky baraspeshim solli një stabilitet strategjik, i cili mundësoi që të mos çmohej asnjë nisje e një sulmi. Ky stabilitet siguronte një mekanizëm kontrolli të arsyeshëm mbi zonat më të ndjeshme strategjike. Marrëdhëniet ndërmjet superfuqive përfundonin në ballafaqim të drejtpërdrejtë vetëm nëse ky stabilitet strategjik kërcënohej prej njëres superfuqi, kur orvatej të vinte nën kontroll pikat nevralgjike strategjike. Kriza e raketave të Kubës (kujtohuni për sugjerimin e Mahanit që të mbahej nën kontroll Deti i Karaibeve), lufta e Koresë dhe lufta e Vietnamit, si dhe pushtimi i Afganistanit nga sovjetikët (kujtohuni për teorinë e Spikmanit lidhur me Rimlandin) janë vetëm disa shembuj të këtyre marrëdhënieve në ballafaqim gjatë epokës së Luftës së Ftohtë.

1983, Haiti 1985-86) dhe katër në Amerikën e Jugut (Brazil 1961-64, Kili 1970-73, Bolivi 1980-86, Ishujt Falkland 1962).

(iii) Katër prej këtyre KIU ndodhën në Afrikë (Afrika e Jugut 1960, Zaire 1960-64, Libi 1970 dhe Angolë 1986).

Hollësitë për këto KIU mund të shihen te Collins, John M. (1991), *America's Small Wars*, Washington: Brassey's.

¹⁷ Këto dy koncepte i kam huazuar prej librit Cohen, *Geography and Politics*. Sipas përkufizimit të tij, Bota detare e varur prej tregtisë përfshinte të dyja Amerikat, gjithë Europën Perëndimore, gjithë Afrikën me përjashtim të këndit verilindor dhe gjithë pjesën përtej brigjeve të Azisë e të Oqeanisë. Fuqia kontinentale euraziatike përfshinte gjithë Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore, si dhe Azinë e Brendshme e Lindore.

Pasoja e menjëhershme e fundit të këtij baraspeshimi strategjik që monopoli strategjik nën udhëheqjen e ShBA, që u përpoqën të rirregullonin mekanizmin e kontrollit, duke iu drejtuar parimeve të detyrueshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Lufta e Gjirit ka qenë e para ngjarje e madhe në këtë proces të rirregullimit të statukuosë gjeopolitike. Mirëpo po ato parime dështuan në Bosnjë. Kombet e Bashkuara nuk e mbrojtën tërësinë tokësore të një shteti anëtar, as nuk e njohën të drejtën e atij shteti për vetëmbrojtje. Konflikti brendasistemor ndërmjet ShBA dhe Europës, si dhe mungesa e bashkëpajtimin ndërmjet fuqive europiane lidhur me Bosnjën u bë fundi i parullës së parakohshme të "Rendit të Ri Botëror". Parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare pësuan dështim në Bosnjë nga një pragmatizëm i shthurur dhe nga paragjykimet mesjetare të Europës.

Kjo pasojë e krizës së Bosnjës përkoj me dy zhvillime të rëndësishme në pikëndërprerjen e gjeopolitikës me ekonominë politike ndërkombëtare. Së pari, administrata e ShBA vuri në dukje se monopoli strategjik nuk do të thotë detyrimisht kontroll i plotë mbi ekonominë politike ndërkombëtare, që përcakton përfitimin ekonomik dhe pjesën e forcave sistemore në konkurrencë. Çmimi që duhej paguar për të qenë në ballë ishte se monopoli strategjik nuk e parandalonte rënien relative të pjesës së Amerikës në ekonominë politike globale, në krahasim me Europën e Japoninë. Kjo krijoi ngurrime në administratën e ShBA për të luajtur rolin e xhandarit në Rendin e Ri Botëror. Tërheqja e forcave të ShBA nga Somalia është një pasojë

tjetër e këtij ngurrimi. Periudha aktuale është e një tranzicioni ndërmjet stabilitetit strategjik dypolësh dhe një strukture shumëpolëshe të baraspeshës së fuqisë.

Së dyti, mjaft fuqi rajonale u orvatën të shfrytëzonin dysinë e kësaj periudhe kalimtare për të vepruar për qëllimet e veta politike e strategjike. Shtimi i përplasjeve rajonale në epokën pas Bosnjës është pasojë e natyrshme e kësaj zbrazëtie gjeopolitike dhe gjeoekonomike.

Zbrazëtia gjeopolitike dhe gjeoekonomike e pushtetit

Një nga faktorët më të rëndësishëm të pastabilitetit në epokën pas Luftës së Ftohtë është pikërisht ky vakuum gjeopolitik dhe gjeostrategjik. Fundi i dypolësisë në sistemin e aleancave e pakësoi tensionin ndërmjet superfuqive, por solli një zbrazëti të madhe në zonën me rëndësi gjeostrategjike, ku ndërpritën Kardilandi me Rimlandin.¹⁸ Një përqindje e madhe e krizave politike dhe ushtarake në epokën pas Luftës së Ftohtë kanë ndodhur në këtë zonë, ku gjenden rrugëkalimet nga Kardilandi te Rimlandi (p.sh. në Ballkan, Kaukaz e në Azinë Qendrore) dhe pikat nevralgjike të brigjeve të Rimlandit (p.sh. Gjiri Persik dhe Bab el-Mandebi/Deti i Kuq).

¹⁸ BSHP është më tepër një sferë gjeopolitike ndikimi sesa një tërësi politike reale. Rrjedhimisht, autoritetet ushtarake ruse kanë deklaruar se kufijtë rusë nisin te kufiri Afgan-Taxhikistan.

Rirregullimet strategjike dhe mekanizmat e kontrollit të dypolarësisë së Luftës së Ftohtë u bënë të pavlefshme, pa pasur ndonjë gjë më të mirë që t'i zëvendësonte. Pikat strategjike të shkëndijimit para Luftës së Ftohtë, të cilat përftoheshin nga baraspesha e fuqive luftuese, dolën në tablo në mungesë të një vullneti politik ndërkombëtar. Rrugëkalimet strategjike nga stepat aziatike deri në Europë dhe rrugët/pikat nevralgjike të afrimit drejt Detit Mesdhe dhe Baltikut u bënë zona vatre të konfliktit. Boshti Drava-Sava ndërmjet Serbisë, Kosovës e Maqedonisë, Karpateve dhe Transilvanisë ndërmjet Rumanisë e Hungarisë, Besarabia ndërmjet Moldavisë, Rusisë e Rumanisë, si dhe rruga e daljes në Detin Baltik mbi Vendet Baltike janë zonat themelore strategjike problematike në Europën Lindore e në Ballkan. Po këto zona kishin përparësi strategjike në garën brendasistimore të Fuqive të Mëdha gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Një zbrazëti e ngjashme gjeopolitike u përftua në Kaukazi, një rrugëkalim tjetër me rëndësi prej Kardiandit të Rimlandi dhe detet e ngrohta. Ky rajon lidhet strategjikisht me Turqinë Lindore, Iranin Verior, Irakun dhe Gjirin Persik. Kjo lidhje strategjike u këput nga baraspesha strategjike gjatë kushteve të dypolësisë së epokës së Luftës së Ftohtë. Transkaukazinë e kishte nën kontroll Bashkimi Sovjetik, ndërsa Turqia Lindore dhe Irani verior (deri në kohën e Revolucionit Iranian) ishin në sferën e ndikimit të bllokut perëndimor, duke e ndaluar fuqinë kontinentale euraziatike që të arrinte burimet gjeoekonomike të Lindjes

së Mesme dhe potencialin gjeopolitik të Rimlandit. Plani i NATO-s lidhur me ledhin turk përbënte mbrojtjen e krahut të tij jugor. Iraku, që në atë kohë ishte aleat i sovjetikëve, luante një rol me rëndësi në kundërpeshën me këtë bllok perëndimor.

Dy ngjarje politike të rëndësishme kanë pasur ndikim rrënjësor në baraspeshën e Luftës së Ftohtë për këtë lidhje strategjike. Goditja e parë për parametrat strategjikë dypolësh në këtë rajon qe Revolucioni Iranian në vitin 1979, me Luftën e parë të Gjirit ndërmjet Iranit e Irakut si reagim strategjik kundrejt këtij zhvillimi të ri. Fuqitë rivale të epokës së Luftës së Ftohtë e mbështetën Irakun për të penguar çfarëdo ndryshimi në statukuonë strategjike të këtij rajoni dhe ia arritën ta kufizonin aftësinë ushtarake e diplomatike të Iranit.

Goditja e dytë ishte shembja e sistemit sovjetik si poli baraspeshues i dypolësisë strategjike. Kjo pozitë e re strategjike u dha fuqive rajonale një rast për të mbushur vakuumin. Iraku, i cili ushtarakisht mbështetej prej fuqive sistemore në Luftën e parë të Gjirit, u orvat të krijonte një bërthamë të re strategjike me aftësitë e veta ushtarake. Fuqitë sistemore e përdorën këtë ambicie të Sadam Hysenit për të rivendosur statukuonë nën udhëheqjen perëndimore, duke i konsoliduar realisht gjithë fuqitë rajonale kundër Irakut. Kjo krijoi një Luftë të dytë të Gjirit, e cila dha si përfundim kontrollin njëpolësh strategjik të ShBA mbi Gjirin. Mirëpo Lufta e dytë e Gjirit solli më shumë situata të paqarta sesa një rend të kthjellët, me gjithë parullën e Rendit të Ri Botëror.

Rajoni prej Kaukazit Verior në veri deri te Kuvajti në jug është plot me anë të papërputhura ndërmjet territoreve të njohura ndërkombëtarisht dhe realiteteve *de facto*. Iraku i ndarë është në gjendje kaosi. Nuk është garantuar tërësia tokësore e Irakut, as nuk është njohur republika autonome e kurdëve. Çështja kurde po bëhet një krizë kronike pa ndonjë zgjidhje. Një e pesta e territoreve të azerëve janë nën pushtimin e Armenisë dhe republikat autonome të Abhazisë e të Çeçenisë po kërkojnë njohje ndërkombëtare. Nuk ka ndonjë organizëm ndërkombëtar ose gatishmëri për të gjetur një zgjidhje tërësore për shkak të faktit se secila Fuqi e Madhe ka tjetër vizion lidhur me të ardhmen e këtij rajoni tepër të ndjeshëm dhe të pasur. Ky rajon jo vetëm është shtylla kurrizore strategjike e Eurazisë, por po ashtu edhe një zonë me burime gjeoekonomike. Potenciali i naftës i Azerbajxhanit, burimet ujore të Turqisë Lindore, si dhe fushat naftëmbajtëse të Kirkikut në Irakun Verior, në Iran e në Kuvajt janë të gjitha të ndërlidhura strategjikisht njëra me tjetrën dhe kanë rëndësi thelbësore për orvatjet rajonale e globale për të vendosur mbisundimin aty.

Kjo është arsyeja përse atmosfera kaotike në këtë rajon u përforcua pas përfundimit të zbrastësive gjeopolitike dhe gjeoekonomike. Përplasjet e nënkuptuara qytetërimore dhe kulturore janë arsye fare të vogla të kësaj atmosfere kaotike, sepse ky rajon është pjesë përbërëse e po atij qytetërimi, e konkretisht e qytetërimin islamik, me përjashtim të Armenisë dhe të pjesëve të krishtera të Gjeorgjisë. Çështja e Karabakut dhe e trojeve azere të pushtuara nga forcat ar-

mene janë e vetmja përplasje reale kulturore/qytetërimore në këtë rajon.

Zbrazëtia e tretë gjeopolitike u përftua në krahun jugor të Azisë Qendrore, e cila ka qenë njëra ndër zonat më të rëndësishme të ballafaqimit ndërmjet Fuqisë Kontinentale Euraziatike dhe Fuqisë Detare të varur nga tregtia, si dhe ndërmjet fuqive rajonale si Kina, India e Pakistani. Rrugëkalimet e korridoret nga Kardilandi Qendror Aziatik te Rimlandi rrethues kanë qenë vija demarkacioni të luftës globale për sundim, duke nisur me luftën anglo-ruse të shekullit të nëntëmbëdhjetë për hegjemoninë mbi këtë brez me rëndësi gjeopolitike. Zona tampon në këtë luftë kanë qenë Afganistani me rrugëkalimet e tij (Kojakun, Gomalin, Kiberin) dhe korridori (Uakani) nga Azia Qendrore te rrafshulltat e Indit. Kjo rrugë, e cila është përdorur edhe nga Aleksandri i Madh, ka vijuar të luajë një rol me peshë në Lojën e Madhe të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në Luftën e Ftohtë në shekullin e fundit. Sulmi i sovjetikëve i vitit 1979 në këtë zonë tampon u bë një pikë kthese e baraspeshës strategjike të Luftës së Ftohtë, ndërsa dështimi i tij çoi te rrëzimi i shtyllës strategjike sovjetike në Azi.

Që nga koha e shembjes së Bashkimit Sovjetik, Rusia është orvatur ta përforcojë vijën e mëparshme të demarkacionit në Taxhikistan. Prandaj Rusia ndërhyri në luftën civile në Taxhikistan dhe njëkohësisht shpalli se kufiri Afgan-Taxhik është kufi i Rusisë. Ky nuk mund të jetë një argument i vlefshëm sipas territoreve të njohura ndërkombëtarisht; megjithatë ai tregon se janë të vlefshëm dhe kanë ndikim mbizotërues

faktorët gjeopolitikë, pavarësisht nga ndryshimet në territoret ndërkombëtare. Rusia nuk dëshiron ta lërë sferën gjeopolitike të ndikimit, që e kishte fituar në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Grindjet territoriale kino-indiane dhe indo-pakistane gjithashtu pasqyrojnë peshën e këtij rajoni. Kina, e cila sot e ka nën kontroll rrugëkalimin Mintaka, kërkon ta përdorë rrugën e Karakoramit si rrugën strategjike kryesore në këtë rajon, ndërsa India synon ta përforcojë kontrollin mbi rajonin e diskutueshëm të Kashmirit. Luftërat e vazhdueshme civile në Afganistan dhe në Taxhikistan, si dhe tensioni në rritje e shtypja në Kashmir e në Ksingiang janë pasojë e kësaj zbrazëtie gjeopolitike në këtë zonë tejet të rëndësishme për të ardhmen e luftës së fuqisë euraziatike. Gara që po përhapet ndërmjet fuqive të mëdha dhe rajonale me qëllim që të kenë një pjesë në burimet gjeoekonomike të Azisë Qendrore, e ndërlikon gjendjen në këtë rajon dhe gjen pasqyrim në marrëdhëniet ndërkombëtare në trajtën e luftërave civile, tensioneve rajonale dhe manovrave taktike për të riformësuar pozicionet strategjike në këtë rajon.

Të gjitha këto pika shkëndijimi provojnë se fundi i baraspeshës strategjike të Luftës së Ftohtë, të mbështetur në dypolësinë, ka krijuar një vakuum të thellë gjeopolitik dhe gjeoekonomik në zonën, ku ndërpriten rrugëkalimet Veri-Jug me brezin Lindje-Perëndim të Rimlandit. Ky është faktori real i krizave politike dhe i pastabilitetit në epokën pas Luftës së Ftohtë. Dallimet kulturore dhe paragjykimet historike, që u rigjallëruan pas shembjes së identiteteve ideologjike të epokës dypolëshe të Luftës së Ftohtë, shfrytëzohen

për të përlijtur këtë garë strategjike. Bota myslimane, e cila u bë arena e ndërprerjes së këtyre dy dukurive, ringjalljes qytetërimore dhe garës strategjike, është bërë pika e vatrës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Bota myslimane: kërcënim antisistemor apo viktimë e përplasjes gjeopolitike?

Një karakteristikë tjetër e përbashkët e teorive në epokën pas Luftës së Ftohtë është paraqitja nga ana e tyre e Islamit si sfida kryesore e epokës së re. Fukujama e sheh Islamin si një kërcënim të rëndë për vlerat universale të liberalizmit:

Është e vërtetë se Islami përbën një ideologji sistematike e koherente, po ashtu si liberalizmi dhe komunizmi, me kodin e vet të moralit dhe doktrinën e drejtësisë politike e shoqërore. Thirrja e Islamit është në potencë universale, që shkon te gjithë njerëzit si njerëz dhe jo thjesht si anëtarë të një grupi të veçantë etnik ose kombëtar. Dhe Islami në të vërtetë e ka mundur demokracinë liberale në shumë pjesë të botës islamike, duke paraqitur një kërcënim të rëndë për praktikën liberale madje edhe në vendet, ku nuk ka arritur drejtpërdrejt pushtetin politik. Fundi i Luftës së Ftohtë në Europë u pasua menjëherë nga sfida kundër Perëndimit prej Irakut, në të cilin Islami mund të vështrohej si një faktor.¹⁹

¹⁹ Fukuyama, *End of History*, f. 45-6.

Në mënyrë të ngjashme, Hantingtoni e paraqet Islam si qytetërimin, i cili është përgjegjësi kryesor për përleshjet përgjatë vijave të mëdha të shkëputjes historike, nga njëra anë, dhe si partner të koalicionit sfidues kundër Perëndimit, nga ana tjetër:

Në Eurazi vijat e mëdha të shkëputjes historike ndërmjet qytetërimeve janë përsëri të ndezura flakë. Kjo është sidomos e vërtetë përgjatë kufijve të bllokut islamik në trajtë gjysmë hëne të kombeve nga dalja e Afrikës deri në Azinë Qendrore. Dhunë po shfaqet gjithashtu ndërmjet myslimanëve, nga njëra anë, dhe serbëve ortodoksë në Ballkan, çifutëve në Izrael, hinduve në Indi, budistëve në Birmani dhe katolikëve në Filipine. Islami i ka kufijtë të përgjakur.²⁰ Një lidhje ushtarake konfuciane-islamike ka marrë jetë, me synimin për të përkrahur sigurimin nga ana e pjesëtarëve të saj të armëve e të teknologjisi së armëve, që u nevojiten për përballuar fuqinë ushtarake të Perëndimit... Kështu po bëhet një formë e re e garës së armatimeve ndërmjet shteteve islamike-konfuciane dhe Perëndimit.²¹

Këto vëzhgime dhe realitetet politike ekzistuese e bëjnë të domosdoshëm një rivlerësim të pozitës strategjike të botës myslimane në epokën pas Luftës së Ftohtë. Para së gjithash, na duhet të kërkojmë faktorët e mbuluar dhe arsyet, që i shtojnë hartuesit e politikave të Fuqive të Mëdha sistemore për të forcuar veprimet ushtarake dhe strategjike në botën myslimane, e të cilat i çojnë teoricienët politikë të paraqitja e Islamit si kërcënim për sistemin e botës. A e zotëron vërtet bota myslimi-

²⁰ Huntington, "Clash of Civilizations", f. 35.

²¹ *Po aty*, f. 47.

mane kapacitetin politik, ekonomik e ushtarak për të përpunuar një strategji të pavarur, apo mos disa qendra fuqie duan të krijojnë një armik-pol për të përligjur operacionet e tyre taktike dhe strategjike?²²

Brenda kufijve të parametrave të dhënë të sistemit ndërkombëtar është shumë e vështirë të argumentohet, se bota myslimane mund të përpunojë një strategji globale të pavarur, si një forcë antisistemore, e cila të gëzonte një farë pushteti për të bërë zgjedhjen e vet sesi do të përfshihej në sistemin botëror. Përgjithësisht shtetet myslimane renditen afër fundit të rendit në hierarkinë e sistemit botëror. Po të përdorim kategorizime të ndryshme, mund të themi se vetëm fuqitë hegjemonike/globale/të bërthamës mund të gëzojnë një farë luksu, që të kenë të drejtën e zgjedhjes në procesin e përparësimit të planifikimit strategjik. Vendet myslimane janë ose pjesë e kategorive periferike, ose johegjemonike, të cilat detyrimisht i përcaktojnë hapat strategjikë dhe taktikë brenda kufizimeve që u lihen prej strategjive nga ana e fuqive hegjemonike. Vendet myslimane që kanë pozicion më të mirë në

²² Formimi i polit armik në epokën e Luftës së Ftohtë na shtyn të mendojmë seriozisht për mundësinë e dytë. Vërejtja e mëposhtme e Wallerstein-it është mjaft interesante nga ky këndvështrim: "Të gjithë krejt të shkujdesur hamendësojmë se ka pasur një zhvendosje në politikën e ShBA kundrejt BRSS prej përshtatjes së Rusveltit te qëndrimi armiqësor i Luftës së Ftohtë i Trumanit dhe pasuesve të tij. Nuk jam i kërij mendimi. Mua më duket se politika e ShBA ka qenë në vazhdimësi, përtej ndryshimeve në retorikë. ShBA dëshironin një BRSS stalinist me një miniperandori, me kusht që ajo të mbetej brenda kufijve të viteve 1945-48. Stalinistët u shërbenin ShBA si përligjje politike dhe si elementi çimentues i hegjemonisë së tyre në sistemin botëror." Shih Wallerstein, Immanuel, 'Marksi, marksizëm-leninizmi dhe përvojat shoqërore në sistemin e botës moderne', *Thesis Eleven*, vëll. 27, f. 46.

këtë renditje janë ato, të cilat janë kandidate për t'u bërë fuqi rajonale. Ndonëse këto fuqi rajonale kanë më shumë elasticitet, sidomos në planifikimin taktik, përsëri ato duhet të mbajnë parasysh parametrat strategjikë, që jepen nga Fuqitë e mëdha dhe Superfuqitë.

Atëherë përse disa strategjistë orvaten të formulojnë një strategji të bazuar në hamendjen se ka një kërcënim mysliman kundër rendit ndërkombëtar? Arsyeja themelore që e shpallin botën myslimane si kërcënim janë mundësitë gjeopolitike, gjeoekonomike dhe gjeostrategjike të botës myslimane, si dhe nevoja për të pasur një përlligje ideologjike për veprimet strategjike e taktike në mënyrë që të kenë kontrollin mbi këto mundësi. Na duhet t'i krahasojmë kushtet globale pas Luftës së Ftohtë me këto mundësi për të zbuluar përse ka zona konflikti në trevat myslimane.

Karakteristika e parë dhe më e rëndësishmja e gjeopolitikës së botës myslimane është fakti, që ajo përbëhet prej pjesëve më strategjike të Rimlandit dhe Kardilandit. Kjo karakteristikë ka sjellë me vete shumë mundësi dhe epërsi strategjike, si dhe rreziqe strategjike për botën myslimane. Para së gjithash, ajo i siguron botës myslimane një vendosje gjeografike, që është mjaft e përshtatshme për zhvillimin e njëkohshëm të strategjisë kontinentale e detare. Dobësia themelore e fuqive hegjemoniste në dy shekujt e fundit ka qenë se zotëronin vetëm njërën prej këtyre aftësive gjeografike, atë që ua lejonte zhvillimi i strategjisë ose kontinentale, ose detare. Për shembull, Britania dhe ShBA në themel kanë zbatuar një strategji detare, ndërsa Gjermanisë e Ruisë u duhej të përqendrohe-

shin në një strategji kontinentale të mbështetur në fuqinë tokësore. Ky fakt ka krijuar një baraspeshë gjeostrategjike dhe një konflikt të brendshëm mes fuqive hegjemoniste për trevat myslimane.

Spikmani ngulte këmbë për epërsinë gjeostrategjike të Rimlandit, sepse kjo zonë ishte e prekshme si për fuqinë detare, edhe për atë tokësore, prandaj i duhej të vepronte në të dyja mënyrat. Prandaj ai mbështeste mendimin, që forcat aleate duhej të përpunonin një strategji për pas lufte, që të parandalonte çfarëdo konsolidimi të Rimlandit.²³ Për më tepër, ai rekomandonte që fuqitë bazë detare e tokësore (ShBA dhe BRSS) duhej të bashkëpunonin për të mbajtur nën kontroll vendet e panënshtuara të Rimlandit, për shkak se këto vende kishin mundësi të zhvillonin strategji shumëpërmasore. Prandaj bashkëpunimi i pashpallur kundër Iranit gjatë luftës Iran-Irak dhe koalicioni i shpallur kundër Irakut në Luftën e Gjirit nuk janë gjëra që na habisin. Të dyja superfuqitë e kishin ndihmuar Irakun ushtarakisht për të parandaluar që Iraku të konsolidohej në Rimland nëpërmjet një vale revolucionesh. Pastaj bashkëpunuan për ta shkatërruar aftësinë ushtarake të Irakut, që i kishte siguruar Irakut një pozitë strategjike superiore nga pikëvështrimi gjeopolitik dhe gjeoekonomik në zemër të Rimlandit.

Çfarë do të thotë konsolidimi në Rimland, që qenka kaq i rrezikshëm për fuqitë klasike hegjemoniste tokësore dhe detare? Praktikisht do të thotë kontroll stra-

²³ Spykman, *Geography of Peace*, f. 43; Glassner, Martin Ira & de Blij, Harm J. (1989), *Systematic Political Geography*, New York: John Wiley & Sons, f. 228.

tegjik mbi vendet myslimane ose bashkëpunim strategjik me to, sepse vendet myslimane kanë plotësisht nën sundim zemrën e Rimlandit nga lindja në perëndim, si dhe rrugëkalimet nga veriu në jug, nga Kardi-landi te detet e ngrohta nëpërmes Kaukazit drejt brezit jugor të Azisë Qendrore dhe Afganistani. Përveç kësaj, vendet myslimane kanë ose plotësisht (Anatolia dhe Gadishulli Arabik), ose pjesërisht (Nënkontineti Indian dhe Indokina) nën kontroll ishujt dhe gjysmishujt me rëndësi (Qipron, Sumatrën, Javën, Borneon, Mindanaon), të cilët i rrethojnë pikat në zemrën e trevave euraziatike për të dalë në oqeanet.

Kjo vendosje gjeografike i ka sjellë përparësi të mëdha botës myslimane, duke ia bërë të mundur që të ketë nën kontroll pikat nevralgjike, të cilat i ndajnë detet e ngrohta të botës, ndërsa njëkohësisht sjellin një rrezik të ndjeshëm për të tërhequr konkurrencën brendasistimore. Tetë nga gjashtëmbëdhjetë pikat nevralgjike strategjiksht më të rëndësishme: Kanali i Suezit, Bab el-Mandebi (dalja prej Detit të Kuq), Ngushtica e Hormuzit (dalja nga Gjiri Persik), Ngushtica e Malakës, Ngushtica e Sundës (ndërmjet Sumatrës dhe Javës), Ngushtica e Lombokut (ndërmjet Balisë dhe Mataramit) dhe Bosfori e Dardanelet (daljet nga Deti i Zi) janë nën kontrollin e plotë të vendeve myslimane, ndërsa një prej tyre (Ngushtica e Gjibraltarit) ndan një shtet mysliman (Marokun) prej një shteti europian (Spanjës). Ky fakt do të thotë se pothuaj të gjitha pikat nevralgjike në Eurazi (më përjashtim të La Manshit dhe Ngushticave të Danimarkës), si çelësat e Rimlandit, janë nën kontrollin e vendeve myslimane. Pjesa që

mbetet: Kepi i Shpresës së Mirë, Ngushticat e Tasmanisë dhe Torres (ngushticat në veri e në jug të Australisë), Ngushtica e Magelanit, Kanali i Panamasë dhe daljet prej Gjirit të Meksikës e Karaibeve gjenden tepër larg nga Kardilandi e Rimlandi, prandaj nuk mund të luajnë ndonjë rol vendimtar në epërsinë gjeopolitike përfundimtare në kontinentin kryesor euraziatik.

Këto përparësi gjeopolitike mbështeten edhe prej burimesh gjeoekonomike. Për shembull, rezervat e vlerësuara të naftës në botë (në miliarda fuçi) janë si më poshtë:²⁴ Lindja e Mesme 397,5; Amerika Latine 84,3; ish Bashkimi Sovjetik 81,4; Afrika 56,2; ShBA 35,6; Europa Perëndimore 26,4; Australazia 18,8; Kanadaja 7,4. Nëse këtyre rezervave të naftës u shtojmë republikat me shumicë myslimane të ish Bashkimit Sovjetik, bota myslimane ka nën kontroll të paktën mbi dy të tretat e rezervave të naftës gjithsej në botë. Kontrolli mysliman mbi disa minerale të tjera strategjike dhe burime energjetike, si kromi, ari, gazi natyror e uraniumi, krijon një ndërprerje të përqendruar të gjeopolitikës me gjeoekonominë, që e tërheq vëmendjen e Fuqive të Mëdha në luftën e tyre për një epokë, në të cilën riformësohen parametrat e mbisundimit global.

Shembja e sistemit sovjetik e ka forcuar pozitën strategjike të botës myslimane nga këto këndvështrime:

1) pjesa qendrore dhe jugore e Kardilandit (Azia Qendrore), që përbëhet prej shtetesh në shumicë myslimane është bërë e pavarur;

²⁴ Farrington, Hugh (1989), *Strategjic Geography*, London: Routledge, f. 8.

2) kontrolli dhe ndikimi i botës myslimane mbi rrugëkalimet nga Kardilandi te brigjet e Rimlandit janë shtuar (sidomos nëpër Kaukaz e në Afganistan);

3) lidhja gjeografike e bashkësive myslimane në Ballkan (Bosnja-Shqipëria-Kosova-Maqedonia-Thraka Perëndimore) është bërë një mundësi e rëndësishme rajonale për arritjen e myslimanëve drejt Europës;

4) gjeoekonomia e botës myslimane është forcuar nga burimet e shteteve të reja myslimane të pavarura. Ndër këto bëjnë pjesë: nafta, kobalti dhe piriti i hekurit në Azerbajxhan; nafta, qymyri i gurit, metalet johekurore, kadmiumi, bismuti, taliumi, zinku, bakri dhe gazi natyror në Kazakistan;²⁵ qymyri i gurit, nafta, mineralet e metaleve johekurore dhe të rralla në Taxhikistan; nafta, gazi, qymyri i gurit, squfuri, kaliumi, bariti, magnezi, bromi dhe jodi në Turkmenistan; metalet johekurore, ari, qymyri i gurit dhe gazi në Uzbekistan; zhiva, antimoni, kallaji dhe zinku në Kirgizstan. Në teorinë e vet gjeopolitike Makinderi ka shpallur, se Kardilandi përmbante toka dhe minerale të barabarta me ato të Amerikës së Veriut dhe sugjeron-te që këto rajone të ndërlidheshin kundër Gjermanisë; dhe

5) një vend i pavarur mysliman (Kazakistani) ka fuqi dhe aftësi bërthamore.

Këta elementë gjeopolitikë dhe gjeoekonomikë të epokës passovjetike e kanë konsoliduar aftësinë shumëpërmasore të botës myslimane dhe kanë ndjellë garën ndërsistemore për këto rajone gjeopolitikisht në

²⁵ Bismuti, kadmiumi dhe taliumi përdoren në elektronikë, në inxhinierinë bërthamore dhe në prodhimin e raketave.

zemër. Analiza e krizës politike aktuale na tregon për rolin e këtyre faktorëve strategjikë në ballafaqimet politike e ushtarake, që shkaktojnë dallimet qytetërimore për të krijuar pastabilitetin dhe përplasjet. Pozita e paqëndrueshme ndërkombëtare e botës myslimane si viktimë e kësaj gare strategjike, është një shembull bindës për këtë argumentim. Kufijtë e përgjakur të Islamit nuk vijnë thjesht për shkak të armiqësive historike ose prej përplasjeve qytetërimore; përndryshe do të kishte qenë e pamundur të shpjegohej Lufta e Gjirit ose kriza e Somalisë, ku ka ndodhur dislokimi më i fuqishëm ushtarak në epokën pas Luftës së Ftohtë. Teoria e Hantingtonit për përplasjen e qytetërimeve në rastin më të mirë është një shpjegim i pjesshëm, i cili shpërfill konfliktet brendasistimore ndërmjet fuqive hegjemoniste, që janë faktori më vendimtar në marrëdhëniet aktuale ndërkombëtare.

Një paraqitje e tillë e botës myslimane, si një armik potencial, ka sjellë te tri dukuri të lidhura me botën myslimane. Në fakt, këto janë orvatje dhe arsytetime *ex post facto*. Së pari, ajo u jep mbështetje prirjeve politike shtypëse në vendet myslimane. Vendet Perëndimore, të cilat mbështesin vlerat demokratike dhe mekanizmat demokratikë në pjesët e tjera të botës, kanë mbështetur regjimet jodemokratike në botën myslimane. Arsyetimi ka qenë i thjeshtë: një sistem demokratik në botën myslimane mund të krijonte regjime islamike, me ndjenja antiperëndimore. Një arsyetim i tillë tregon qartë se motivi bazë prapa kësaj paraqitjeje janë më tepër interesat e tyre politikë sesa vlerat demokratike. Elita ushtarake-politike e korrup-

tuar në disa prej vendeve myslimane e ka shfrytëzuar këtë frikë dhe ka bashkëpunuar me forcat sistemore globale të Perëndimit demokratik me qëllim që të prishte proceset demokratike në botën myslimane.

Disa zhvillime politike të kohëve të fudnit i kanë vërtetuar dyshimet se Perëndimi ka kritere të ndryshme vlerësimi për pjesë të ndryshme të “pjesës tjetër”. Për këtë fakt mund të sillet si shembull paradoksi Algjeria-Haiti. Një ndërhyrje ushtarake kundër procesit politik demokratik në Algjeri pati mbështetjen e qendrave të fuqive perëndimore, ndërsa një ndërhyrje e ngjashme në Haiti shkaktoi një reagim të fortë në formën e sanksioneve ndërkombëtare dhe ndërhyrjes së OKB-së. Ideali i rivendosjes së procesit demokratik, që shërbeu si përlligje për ndërhyrjen ndërkombëtare në Haiti, nuk pati ndonjë vlerë në Algjeri. Vija e turbullt e demarkacionit ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe ndërhyrjes ndërkombëtare është një prej zonave më kritike, në të cilën ndërpriten vlerat dhe interesat. Interesat strategjikë të Perëndimit për të ruajtur sistemet politike jodemokratike kanë shkaktuar keqësimin e pastabilitetit politik dhe u kanë siguruar fuqive hegjemoniste një mundësi të artë për t’i manipuluar këto konflikte të brendshme për qëllimet e tyre strategjike.

Së dyti, shtypja e pakicave myslimane është toleruar në këto vende si çështje thjesht e brendshme. Pakicat myslimane në Kashmir, Sanxhak dhe në Kosovë në Serbi etj., janë përjashtuar nga e drejta për të gëzuar vlerat universale demokratike pas kësaj atmosfere paragjykimesh kundër Islamit. Ky qëndrim madje shtrihet deri në atë nivel, sa banditët serbë përlligjen

që vrasin gratë dhe fëmijët myslimanë, mbi arsytimin se përndryshe dy milionë myslimanë bosnjakë do të pushtokan gjithë Europën. Ata qenë në gjendje të argumentonin edhe se po plotësonin një mision historik, duke e mbrojtur Europën nga fundamentalizmi islamik.

Së treti, disa koalicione ndërkombëtare janë ndër-tuar kundër një kërcënimi të mundshëm islamik. Një senator i ShBA dhe anëtar i Partisë Republikane të presidentit Bush, Larry Pressler, ka këmbëngulur gjatë vizitës së tij në Indi në fillim të vitit 1992, se një konfederatë islamike e armatosur me armë bërthamore prej nëntë vendesh mund të krijohej në Azinë Qendrore e Jugore dhe do të kërcënonte Indinë e stabilitetin botëror. Analistët strategjikë ende po orvaten të provojnë se brezi i vendeve myslimane që shtrihet nga Turqia, Irani, Afganistani dhe Pakistani përmes pesë ish republikave sovjetike, mund të kalojë në pozitë të fundamentalizmit. Është interesante se po i njëjti brez islamik kishte pasur mbështetjen e ShBA gjatë epokës së Luftës së Ftohtë si garanci për interesat strategjikë të ShBA kundër zgjerimit të BRSS.

Paralelisht me këtë dukuri, Serbia po kërkon bashkëpunim të gjerë nga Greqia në Ballkan, ndërsa Armenia po orvatet të ngjallë ndjenjat fetare të Fuqive të Mëdha të Krishtera me qëllim që të fitojë mbështetje për zgjerimin e vet ushtarak kundër Azerbajxhanit. Në të njëjtën kohë Izraeli po mbështet Indinë kundër lëvizjeve masive në Kashmir dhe në Penxhab. Kohët e fundit Vladimir Zhirinovski ka shpallur një "Kryqëzatë të Shenjtë" pansllaviste kundër vendeve myslimi-

mane në brezin jugor të Ruisë, përmes Ballkanit, Kaukasisë dhe Azisë Qendrore. Kështu paragjykimi i përgjithësuar kundër botës myslimane, i cili mbështetet nga një koncept i tejthjeshtësuar për fundamentalizmin, fsheh një fundamentalizëm të qartë antiislamik, që u bën provokacione vendeve fqinje të botës myslimane nga Maroku e deri në Indonezi, nga Bosnja e deri në Azinë Qendrore. Ky fundamentalizëm antiislamik është arsyeja themelore përse bashkësia europiane ka dështuar dhe nuk u bë pluraliste e tolerante, aq sa duhet për të plotësuar premtimin e vet tashmë prej 35 vjetësh, që ta pranonte Turqinë (një vend i çarë sipas analizave të Hantingtonit) si shtet anëtar.

Aventurizmi strategjik ose thjesht rendi global

Zonat më kritike të çrregullimit politik në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohëse janë gjeopolitika dhe ekonomia politike ndërkombëtare. Kur i shqyrtojmë pikat e shkëndijimit të politikës botërore dhe zonat e ballafaqimit ushtarak, atëherë shohim se kemi një intensifikim në ato rajone, që kanë rëndësi nga dy pikëpamje. Zonat ku ndërpriten këta dy faktorë janë zonat më të ndjeshme për përftimin dhe provokimin e konflikteve. Fundi i dypolarësisë ka krijuar rajone të ndjeshme, ku ka zbrazëti të pushtetit. Por pushteti është i nevojshëm për të mbajtur nën kontroll aftësitë strategjike të zonave në zemrën gjeopolitike, si dhe aftësitë e gjera të burimeve, prodhimit dhe tregtisë

të ekonomisë politike ndërkombëtare. Gara ndërmjet fuqive hegjemoniste brendasisteme për të vënë kontrollin mbi këto zona është shkaku kryesor i konflikteve dhe i përplasjeve ushtarake/politike, që ndodhin në këtë zonë strategjike të ndjeshme, e cila është e prekshme nga mbisundimi global.

Rrjedhimisht, Hantingtoni, i cili e nis artikullin e tij me një analizë historike dhe qytetërore, e përfundon me një grup sugjerimesh strategjike për udhëheqësit politikë Perëndimorë. Ai nuk synon të gjejë rrugë paqësore për të zgjidhur përplasjet ndërqytetërore. Përkundrazi, ai u sugjeron hartuesve të politikave perëndimore që t'i manipulojnë, madje disa herë edhe t'i provokojnë, këto përplasje, me qëllim që të sigurohen interesat strategjikë të qytetërimit Perëndimor: "Në afat të shkurtër është e qartë se është në interes të Perëndimit, që të përkrahë një bashkëpunim më të madh dhe unitetin brenda qytetërimit të vet ... për ta zbutur rënien e aftësive ushtarake perëndimore dhe të mbahet epërsia ushtarake në Lindje dhe në Azinë Jugperëndimore; të shfrytëzohen dallimet dhe konfliktet përgjatë shteteve konfuciane dhe islamike ..."

Në fakt, ky pragmatizëm strategjik është faktori kryesor për përftimin e përplasjeve politike dhe ushtarake. Historia e qytetërimeve nuk përbëhet vetëm prej përplasjeve. Kemi shumë shembuj të bashkëpunimit dinamik e paqësor dhe të ndërveprimit midis qytetërimeve. Ka qenë arritur bashkëzistenca qytetërore pluraliste në Spanjë, në Europën Lindore dhe në Indi gjatë shumë shekujve, derisa interesat strategjikë të Perëndimit nisën të viheshin në veprim. Një për-

plasje nuk është e vetmja mënyrë e marrëdhënieve ndërqytetërimore. Një përplasje nis kur ky dallim qytetërimor shfrytëzohet për një objektiv strategjik.

Ky shfrytëzim strategjik i përplasjeve qytetërimore krijon një sfidë reale për sistemin ndërkombëtar. ShBA kanë një rol kyç për kapërcimin e këtij problemi. Karakteri ambig i strategjisë globale të ShBA gjatë epokës pas Luftës së Ftohtë, megjithatë, ka krijuar zbrazëti të reja të pushtetit, që kanë sjellë shkallëzimin e krizave rajonale.

ShBA kanë tri alternativa për përpunimin e një strategjie globale në epokën pas Luftës së Ftohtë: alternativa e parë është të ristrukturohet sistemi i sigurisë kolektive, që të fitojë një qëndrim të patundur, i cili të synojë ripërcaktimin e parimeve aksiomatike për një rend ndërkombëtar të drejtë. Një orvatje e tillë e bën të domosdoshëm një konsensus global në kornizën aksiologjike të këtij rendi ndërkombëtar, të cilën e kanë të përbashkët kultura dhe qytetërime të ndryshme. Një konsensus perëndimor, i cili synon ta përjashtojë qytetërimin islamik (me një të katërtën e popullsisë së botës në brezin më të rëndësishëm strategjikisht të globit); qytetërimi kinez (me një të katërtën e popullsisë së botës, të përqendruar në rajonin ekonomikisht më dinamik), qytetërimi japonez (me një pjesë jashtëzakonisht të madhe, që ka nën kontroll sistemin arterial të financave të ekonomisë politike ndërkombëtare) dhe qytetërimet tradicionale (që janë të përhapura në të gjitha kontinentet) nuk mund të arrijnë një rend global real dhe paqen. Për të arritur një rend politik ndërkombëtar të ligjshëm është i nevojshëm më

tepër një dialog gjithëpërfshirës qytetërimor, sesa një pragmatizëm strategjik, që shfrytëzon përplasjen qytetërimore. Mbarimi i epokës pas Luftës së Ftohtë ka krijuar një mundësi të artë për një përpjekje të tillë globale. Mirëpo ky rast është lënë të shpëtojë nga duart për shkak të krizës brendasistemore.

Alternativa e dytë është të ruhet roli udhëheqës ekzistues së bashku me pragmatizmin strategjik, të mbështetur në nxjerrjen me përparësi të interesave kombëtarë, me qëllim që të pakësohen rreziqet strategjike dhe të zmadhohen interesat ekonomikë. Ky opsjon mund të zbatohet nëpërmjet rregullimeve brendasistemore, me qëllim që të baraspeshohen sfiduesit themelorë sistemorë të strukturës ndërkombëtare politike dhe ekonomike të pushtetit. Kjo do të thotë të ringjallërohet baraspesha konvencionale e politikës së fuqisë, një proces politik dhe ekonomik i lidhur strategjikisht për bisedime dhe garë, si dhe një politikë e jashtme dinamike e elastike për t'iu përgjigjur luhatjeve afatshkurtra dhe pastabilitetit të rajoneve. Ky opsjon do t'i çonte hartuesit e politikës së jashtme të ShBA që të zbatonin një politikë të frytshme aleancash, me qëllim që të rirregullohet struktura e pushtetit në përputhje me atmosferën ndërkombëtare në ndryshim e sipër, në vend që të ketë një sistem aleance të ngulitur si të epokës së Luftës së Ftohtë.

Alternativa e tretë është ringjallja e politikës neoizolacioniste, e cila i drejtohet një strategjie ushtarake mbrojtëse në kontinentin Amerikan konvencionalisht të mbrojtur, e politikës ekonomike proteksioniste, të mbështetur në një treg të madh, dhe e politikës së ja-

shtme me profil të ulët në Eurazi, me qëllim që të parandalohen ballafaqimet strategjike të padëshiruara, por ndoshta të pashmangshme. Praktikisht kjo do të thoshte t'i jepej fund rendit ndërkombëtar politik dhe ekonomik të pasluftës, i cili bazohej në presupozimin e udhëheqjes nga Aleanca Atlantike dhe nga ShBA.

ShBA si fuqia politike udhëheqëse e qytetërimit mbisundues në epokën moderne, nuk kanë pasur sukses që të përpunonin një strategji të qëndrueshme gjatë kësaj periudhe kaotike. Po ta shqyrtojmë politikën amerikane të epokës pas Luftës së Ftohtë, mund të përmendim tri etapa të ndryshme. Etapa e parë, nga rënia e Murit të Berlinit (nëntor 1989) deri në Luftën e Gjirit (janar 1991) mbështetej në retorikën e "Rendit të Ri Botëror" si simboli i opsionit të parë. Mirëpo kjo retorikë nuk u mbështet me hapat e domosdoshëm, që nevojiteshin për ta shpejtuar procesin e risistematizimit të rendit global. Etapa e dytë ka qenë periudha kalimtare nga Lufta e Gjirit (janar 1991) deri në krizën e Bosnjës (prill 1992). Gjatë kësaj periudhe kalimtare ndodhi një zhvendosje në përdorimin e konceptit të "Rendit të Ri Botëror". Ai u përdor më tepër si mjet për të përlligjur manovrat strategjike, sesa si një themel për risistematizimin humanistik të rendit global. Kështu alternativa e parë u zëvendësua nga alternativa e dytë gjatë kësaj periudhe kalimtare. Kjo zhvendosje u bë e dukshme gjatë etapës së tretë, e cila mund të quhet epoka pas Bosnjës. Vetë parimet themelore të sistemit të sigurimit kolektiv dështuan, kur qe puna për të mbrojtur integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës si shtet anëtar i Orga-

nizatës së Kombeve të Bashkuara dhe kjo ishte pasojë e kësaj zhvendosjeje drejt pragmatizmit strategjik të politikës së fuqisë. Ngurrimi i ShBA për të ndërhyrë në punët e Europës, në kundërshtim me agresionin e vazhduar dhe gjenocidin, krijoi gjendjen më të dykuptimshme që nga koha e Luftës së Dytë Botërore dhe solli tronditjen e parimeve të rendit ndërkombëtar. Ky ngurrim është quajtur si një tregues për një shkarje tjetër nga politika e fuqisë drejt izolacionizmit, sidomos për punët e Europës. Statusi i veçantë i Europës në zbatimin e parimeve të OKB-së mund të vështrohet si fundi i rolit udhëheqës të ShBA në sistemin e sigurimit kolektiv pas lufte. E ardhmja e Bosnjë-Hercegovinës nuk do të jetë vetëm fati i një shteti-komb. Ka më shumë gjasa të jetë një provë lakmushi për qendrat e reja të fuqisë në sistemin ndërkombëtar në epokën pas Luftës së Ftohtë.

Çështja me rëndësinë më të madhe për strategjinë e ShBA në një të ardhme të pacaktuar do të vijojë të jetë ruajtja e statusit ekzistues të tyre si lojtari kryesor i një sistemi kolektiv sigurimi. Ky objektivi e bën të domosdoshme plotësimin e dy kushteve: (i) përpunimin e një grupi vlerash në sistemin ndërkombëtar, që do ta kenë të përbashkët të gjitha kombet e globit, pavarësisht prej dallimeve të tyre kulturore e qytetërimore; (ii) lehtësimin dhe trajtimin e tensioneve të shkaktuara prej garës brendasistemore lidhur me zonat kritike të gjeopolitikës dhe të ekonomisë ndërkombëtare.

Parakushti i parë dhe më i rëndësishëm për kushtin e parë është njohja e së drejtës për mbijetesën e disa identiteteve të ndryshme qytetërimore në një

atmosferë bashkezkistence. Kriza qytetërimore ekzistuese do të mund të kapërcehej vetëm nga një dialog qytetërimor dhe nga shkëmbimi i lirë i vlerave. Monopolizimi njëkulturore ka qenë mëdyshja kryesore e qytetërimit perëndimor modern dhe ka çuar te shkatërrimi i qytetërimeve tradicionale. Ringjallja aktuale e qytetërimeve tradicionale është një reagim kundër këtij monopolizimi njëkulturore. ShBA me dy krahët: njëri në Atlantik me trashëgiminë euro-amerikane, dhe tjetri në Paqësor me një sintezë aziatike-amerikane, do të parapëlqenin të mbështesnin një dialog qytetërimor real, në vend që thjesht të ishin mbështetëse të një kryqëzate perëndimore eurocentrike të kolonializmit kundër qytetërimeve tradicionale. Alternativa e fundit madje mund të krijojë paqëndrueshmëri të brendshme për shkak të një krize të identitetit amerikan, meqë Amerika po e sheh veten që me shpejtësi po bëhet një shoqëri gjithnjë e më tepër shumëkulturore, p.sh. myslimanët sot po bëhen grupi fetar i dytë nga madhësia në ShBA, ndërsa aziatikët me të kaluar konfucianiste po e shtojnë më tej rolin e tyre në shoqërinë amerikane.

Kategorizimet ballafaqese, të mbështetura në provokimet e dallimeve qytetërimore, të tilla si Perëndimi kundër Islamit ose Perëndimi kundër pjesës tjetër, nuk mund të japin ndihmesë as për paqen globale e sigurinë, as për procesin e rirregullimit të sistemit ndërkombëtar. Hesapet e gabuara strategjike, të mbështetura në këto kategorizime ballafaqese do të vijojnë të jenë pengesa kryesore për paqen globale. Ambicjet kolonialiste dhe ndjenjat antikolonialiste të

shekullit të fundit përsëri mund të shpërthejnë nga ky shpërdorim strategjik i dallimeve qytetërimore dhe në fund të fundit kjo do të jetë kundër interesit të Perëndimit përgjithësisht dhe ShBA në veçanti.

Hegjemonia amerikane në epokën pas Luftës së Ftohtë e ka përligjur veten nëpërmjet administrimit ndërkombëtar të periudhës paskolonialiste, diçka që ishte formuluar nga parimet e Uillsonit dhe u aktualizua nga Karta e OKB-së. Ringjallja e këtyre kategorizimeve kolonialiste do të ishte një goditje e rëndë për hegjemoninë amerikane, e cila ishte e mbështetur në administrimin e sundimit global nëpërmjet organizatave ndërkombëtare, si OKB-ja. Nga ana e vet, kjo nënkuptonte pjesëmarrjen, ndonëse të pabarabartë dhe jodemokratike, të kolonizuesve dhe të vendeve të kolonizuara të epokës koloniale. Treguesi i parë i kësaj goditjeje mund të jetë shpërbërja e një shteti sovran, të njohur nga OKB-ja në Bosnjë, që praktikisht do të thoshte shembje e vetë parimit të këtij administrimi ndërkombëtar.

Objektivi i dytë mund të arrihet vetëm nëse sistemi ekzistues i sigurimit kolektiv do të rishikohet, me qëllim që të formulohet një mekanizëm i drejtë dhe i mirëpërcaktuar për të pakësuar në minimum aventurizmin strategjik global dhe konfliktin ndërmjet forcave brendasistimore. Përfundimi i baraspeshës strategjike të Luftës së Ftohtë u pasua prej aventurizmit të kufizuar strategjik, si në rastin e pushtimit të Kuvajtit nga Iraku për një Irak të madh dhe spastrimi etnik nga agresorët serbë në Bosnjë për Serbinë e Madhe. Ky aventurizëm strategjik i shkallës së ulët

mund të shkallëzohet me lehtësi deri në nivelin global, nëse kjo prirje do të pasohej prej njërës nga Fuqitë e mëdha, që ka aftësi ushtarake të mëdha. Paaftësia e sistemit të sigurimit kolektiv që të parandalonte spastrimin etnik në Bosnjë, ka nxjerrë në dritë paaftësinë e ShBA dhe të OKB-së për të ndërmarrë veprime, që të mbroheshin parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare kundër aventurizmit strategjik me qendër në Europë.

Konflikti brendasistemor ndërmjet Fuqive të Mëdha e pengoi çfarëdo veprimi kolektiv ose individual në Bosnjë për të mbrojtur dinjitetin njerëzor, që është një tipar i respektuar nga të gjitha qytetërimet njerëzore. Ringjallja e luftës globale gjeopolitike nuk mund të parandalohet, nëse një fuqi me aftësi ushtarake nxitet prej kësaj dobësie. ShBA mund t'u duhet të bashkëpunojnë me vendet joperëndimore, sidomos me shtetet myslimane e konfuciane, që aktualisht kanë nën kontroll zonën gjeopolitike të ndjeshme të Rimlandit, kundër prirjeve nacionaliste në Europë dhe në Rusi, që kanë ambicien strategjike të bllokut kontinental euraziatik. Duhet vënë në dukje se kjo ka qenë shkaku i dy luftërave botërore vetëm brenda një shekulli. ShBA të izoluar nën mbrojtjen bërthamore në kontinentin amerikan nuk mund të jenë të sigurta, nëse një aventurizëm i tillë i ri strategjik nis në Eurazi, siç e kanë treguar personaliteti dhe deklaratat e Vladimir Zhirinovskit.

Treguesi i emrave dhe nocioneve

- 11 shtatori, 18, 20, 22-3, 25-6, 28-30, 34, 37-8, 43-4, 54, 59, 63, 65 68, 70, 77, 79-80, 87, 91-4, 97, 99, 103-4, 111, 113, 128, 155, 176, 183, 185, 216, 218-9, 224, 227, 229, 240-1, 246, 256, 261
- A**
- Abdulhamidi, 169
- Afganistani, 18, 20, 22, 25-6, 30, 47-9, 52, 55-8, 83, 99, 104, 110, 114-6, 118, 122, 158, 169, 171, 184, 188-9, 211-2, 220, 222-3, 225, 242-3, 260, 263-4, 330-1, 333, 339-40, 348, 351
- Aleksandri i Madh, 83, 224, 253, 339
- Ali Bullaç, 24
- All-llahu, 93
- alternativa, 83, 128, 136, 143, 147, 245, 271, 281, 286-7, 323, 326, 354-6, 358, 373
- Anadulli, 163, 188, 192, 235, 250, 290, 299-300
- analiza teorike, 21
- Andaluzia, 222
- Arabia Saudite, 135
- argumente teologjike, 285
- Atlantiku, 33, 50, 52, 254, 256, 328, 329
- B**
- Bagdad, 62, 222, 330
- Ballkani, 92, 94, 116, 162-3, 172, 182, 187, 194-5, 204, 218, 223, 225, 232-3, 239, 247, 352
- Barriera turke, 235
- Bashkësia Europiane, 23, 40, 51, 114, 180, 352
- Bashkimi Sovjetik, 29, 49, 168, 192, 312, 336, 347
- Ben Majmonides, 156
- Bilall Habeshiu, 149
- Bin Ladeni, 58, 94, 96, 104-5, 110, 113
- blloqet tregtare, 272
- boshti anglo-sakson, 41
- Bosnja, 20, 37, 46-7, 78, 110, 112, 116, 162, 172, 183, 188, 194, 198-9, 217, 220, 225, 233, 237, 241, 250, 258, 274-5, 280-1, 287, 290, 313, 322, 334-5, 348, 352, 356, 359-60
- bosnjakët, 234
- bota islame, 62, 74, 100, 124, 126, 128-9, 137, 147, 161, 163, 166-75, 177, 179, 212, 221-2, 224-5, 256-8, 276, 317
- burimet gjeoekonomike, 336, 340
- C**
- Cezari, 42, 119-20
- CNN-Türk, 23-4

- D
dallga e tretë, 26-7
Demireli, 243
demokracia, 27, 63, 68, 117, 310
demokracia liberale, 27, 218,
321, 341
Disfata psikologjike, 163
Drucker, 268
- E
e drejta romake, 285
elementi arian, 28-5
el-Hazini, 75-6, 143
Eurazia, 29, 52, 116, 172, 328
- F
familja, 312
feja sociologjike, 167
feja, 66, 291, 310
fetë perëndimore, 167
filozofia, 76, 133, 141, 205, 271,
285, 303, 372
Fukujama, 27, 31, 33, 37, 46, 61,
65, 75, 106, 117, 137, 139, 172,
281, 312-3, 321, 323, 325, 341
fundi i historisë, 27, 66-7, 105-6,
142, 219, 325
fundi i historisë, 65, 321
fuqia hegjemonike, 136, 288,
343
- G
G-8, 40, 88, 106, 114-5, 272
Gandi, 307
globalizmi, 43, 58, 70, 80, 85-6,
125, 128, 130, 155, 166, 175,
196, 206, 210, 252-3, 287
Grandteoritë, 271
gurët kilometrikë, 244
- Gj
Gjykata Europiane, 176
- H
Hantingtoni, 27, 38, 43, 46, 58,
59, 60-1, 78-9, 105, 120-1, 123,
127, 133, 153, 159, 170, 178,
222-3, 249, 255, 280-2, 286,
287, 297, 313, 317, 321, 323-5,
342, 352-3
Hegeli, 27, 61, 65, 72, 147, 178,
213, 271, 303
hegjemonia amerikane, 359
Hobsi, 72, 74, 80, 178
horizonti mendimor, 14, 246
- I
Ibën Halduni, 59, 76
identiteti, 50, 79, 82-3, 124, 129,
136, 144, 157, 169-70, 173,
179, 181, 213, 229, 283,
288-91, 295, 308, 358
ideologjia, 66, 292
idetë fluide, 14
iluminizmi, 34, 44, 133, 142, 205,
302, 304
iluzioni egocentrik, 147
imperializmi, 33, 131, 283, 288,
303, 306, 308-9
India, 20, 36, 40, 47, 52-3, 55, 58,
115, 167, 170, 223-4, 254, 276,
330, 339, 340
industrializimi, 235, 236
Infinite Justice, 77
Islami, 27, 40-2, 59, 60, 71, 75-6,
94, 102, 120, 123, 128-9,
135-6, 138, 144, 147, 149,
151-2, 154-5, 158, 160-2,
167-8, 170, 172-3, 177, 211,
214, 223, 276, 279, 283, 286,
291, 294, 298-9, 307, 341-2,
349-51, 354, 358

- Izetbegoviqi, 172
 izolacionizmi, 357
 Izraeli, 47, 57, 99, 172, 223, 229,
 256-7, 261, 351
- J
- Jahja Kemal, 237
 Japonia, 47, 58, 81, 114, 135, 195,
 205, 233, 251, 255, 282, 330
 Joperëndimi, 136
- K
- Kanti, 142, 178, 271, 302-3
 kaosi, 84, 113, 216-7, 241, 256,
 338
 kapitalizmi, 81, 95, 144, 295,
 305-6
 Kaukazi, 57, 87, 182, 187, 223,
 225, 232-3, 247, 250, 330, 336,
 338, 346, 352
 Kënallëzade, 71-2, 153-4
 Këshilli i Sigurimit, 40, 114
 Kina, 20, 27, 40, 42, 47-8, 52-3,
 55, 57-8, 99, 114-5, 132, 135,
 154, 166, 170, 195, 221, 223-4,
 254-5, 339-40
 Kipling, 138, 284, 325
 Klintoni, 104, 117, 121, 302, 308
 koka-kola, 85, 175
 kolonializmi, 33, 39, 45, 87, 122,
 160, 163, 170, 220, 248, 258,
 273, 283, 310, 325, 358
 Konfuci, 32, 147, 305, 342, 353,
 360
 Kosova, 20, 110, 172, 199, 241,
 259, 290, 336, 348, 350
 krishterimi, 59, 66, 69, 71, 88, 90,
 102, 131, 142, 150-2, 158,
 161-2, 167, 170, 213, 284, 291,
 300
 Kriteret e Kopenhagës, 29, 134
 kriza, 19, 20, 22, 33-7, 62, 68, 74,
 81, 91, 107, 112, 113, 128, 136,
 142, 160, 168, 178, 180, 217,
 225, 259, 275-6, 287, 293, 298,
 301, 306, 313, 315, 322, 324-5,
 327, 333, 335, 340, 349, 354,
 358
 Kullat Binjake, 20, 44, 70, 75
 kultura mesopotamase, 265
 Kur'ani, 195, 286
- L
- Lebensraum*, 324
 Lidhja e Kombeve, 240
 Lindja, 28, 109, 132, 160, 162,
 180, 248, 250, 256, 266, 280,
 283-4, 315, 346
 Lindja e Mesme, 109, 125, 162,
 233, 347
 lufta civile gjermane, 250
 Lufta e Dytë Botërore, 61, 113,
 141, 304, 307, 329
 luftërat e kryqëzatave, 79, 159,
 161, 300
 luftërat bërthamore, 68
 Lufta e Ftohtë, 7-9, 19, 22, 25-7,
 39-40, 58, 60, 65, 80-1, 83, 94,
 102, 105-6, 111, 165, 172, 181,
 185-7, 190, 196, 201, 216-7,
 225, 235, 238-41, 258-9, 264,
 273, 321-2, 326-7, 329, 331,
 333, 335-7, 339-42, 344, 349,
 351, 354-7, 359
 Lufta e Gjirit, 20
- M
- Mahmudi i Dytë, 133
 Mak Donaldi, 85, 175
 Makiaveli, 71-2, 153, 154, 300

- makrostrategji, 207, 234, 244
 Manheim, 73
 Mao, 289
 Marksi, 81, 271
 Marrëveshja e Dejtonit, 241
 Medineja, 32, 71, 159, 175
 megaprirjet, 267
 mekanizmi monopolizues, 274
 Mevdudi, 212
 Mevlana, 163
 Mimar Sinani, 156
 moderniteti, 34, 65, 68-9, 72,
 82-4, 108, 124-5, 131, 133,
 136, 139, 140-1, 144, 149, 151,
 154, 166, 203, 252-3, 265, 292,
 294-5, 305
 modernizmi, 135, 271, 277
modus vivendi, 275
 monopoli strategjik, 334
 Muhammed Ikbali, 56
 Muhammedi (a.s.), 175, 299
 Muri i Berlinit, 20, 45, 280, 312
 myslimanët, 46, 71, 79, 86-7, 89,
 90, 93, 106, 125, 127, 132, 157,
 159-60, 162-3, 165-6, 169, 171,
 173, 175, 177, 204, 211, 222,
 225, 279, 288, 290, 294
 myslimani amerikan, 173
N
 nafta, 40, 165, 187, 348
 Naisbitt, 267
 Nathan Gardels, 58
 NATO, 60, 96, 114, 184, 188,
 189, 190, 191, 192, 224, 235,
 236, 242, 264, 298, 331, 337
 nazizmi, 306
nomos, 70
 NPQ, 22, 24, 28, 59
Nj
 Nju-Jork, 34, 62, 83, 279
O
 OKB, 88, 106, 114, 218, 256,
 273-4, 307, 310, 350, 357, 359,
 360
 Oksidenti, 285
 Organizata e Konferencës
 Islamike, 23, 258, 261
 orientalizmi, 213, 309
 osmanllinjë, 71, 73-4, 127,
 136-7, 139, 153, 172, 214, 226,
 249, 289, 314
P
 Palestina, 57
 paradigma, 40, 87, 128, 136, 276,
 324
 paragjykimet, 334, 340
 parametrat konvencionalë, 331
 pasmodernizmi, 84, 177
Pax Americana, 18, 33, 39, 314
 pellgjet qytetërimore, 282, 286,
 299, 305
 Pentagoni, 26, 38, 55, 70, 95, 100
 Perëndimi, 23, 28, 31, 33, 38-9,
 43, 46-7, 52, 55, 58-60, 62-3,
 73, 81, 87, 90-1, 108, 115, 118,
 120-1, 128, 130, 132, 134-9,
 145-6, 148, 150, 152, 154-5,
 159, 162, 164-5, 167-9, 171-6,
 180, 186, 191-2, 194, 202, 209,
 214, 221-3, 226, 236, 247-9,
 252, 256, 258-9, 265, 270,
 275-7, 280, 282-6, 288-9,
 291-6, 298-302, 304-8, 310-1,
 314, 316, 323-5, 329, 340-2,
 347, 349-50, 353, 358
 përgjegjësia intelektuale, 210

- përgjegjësia shoqërore, 13
 përplasja e qytetërimeve, 91,
 282, 321, 323
pivot state, 181
 poli negativ, 284
 politika ndërkombëtare, 238,
 274
powershift, 268
 procesi i universalizimit, 129
 protestantizmi, 103, 148
Q
 Qendra Tregtare Botërore, 55,
 95
 qorrsoakaku teorik, 276
 qytetërimet, 21-2, 32, 36, 40, 43,
 52, 59, 60-2, 71, 80-3, 107,
 115, 121-2, 129-30, 138-9, 144,
 146, 153-4, 178, 221, 224, 256,
 271, 277, 281-3, 287-8, 291,
 293, 302-3, 307, 311, 317, 323,
 325, 354, 360
 qytetërimi indian, 282, 285, 287
 qytetërimi islam, 121, 130, 148,
 153-4, 159, 164, 166, 169, 173,
 178, 258, 276, 282-3, 285, 287,
 299, 302, 309, 315
R
 rajonalizimi, 273
 relativizmi, 305
 rendi botëror, 74, 217
 rendi i ri botëror, 174, 216, 241
 rendi ndërkombëtar, 39, 69, 122,
 143, 323, 354
 Revolucioni Industrial, 39, 269
 revolucioni informativ, 275, 278
 Revolucioni Iranian, 171, 337
 revolucioni modern, 17
 Richard Falk, 80, 105, 123
 Rimlandi, 331-3, 335,-7, 339-40,
 344-8, 360
 Roma, 31, 41-2, 90, 107, 129, 288
 romantizmi gjerman, 213, 250
 Rumi, 86, 214
Rr
 rrymat pasmoderniste, 271, 305
S
 Salahuddin Ejjubi, 160
 Sarajeva, 46, 237
 Sejid Kutub, 212
 siguria ontologjike, 67
 sinteza, 60, 194
 Stambolli, 62, 122, 154, 156-8,
 183, 195, 214, 222, 255-7, 261,
 264, 308, 372
 standardizimi, 131, 268-9, 270,
 287
 STV, 22, 24, 65
 subjekti, 13-7, 23-4, 39, 72,
 123-4, 132, 206, 208, 234, 265,
 288, 300, 302
Sh
 ShBA, 18,-20, 23, 35, 45, 47-50,
 52-4, 65, 73, 75, 81-2, 87-92,
 96, 98-9, 103-4, 110-4, 117-20,
 127-8, 133, 140, 168, 170, 183,
 188, 190-1, 195, 205, 208, 211,
 218-21, 224, 233, 241, 243,
 246, 251, 260-2, 264-5, 273,
 288, 298, 308-310, 322, 327,
 330-4, 337, 344-5, 347, 351,
 355, 357-60
 Shkupi, 182, 214, 237
 shoqëria konsumatore, 28
 shoqëria islame, 275-8
 shpërthimi mediatik, 274
 shqiptarët, 188, 237, 250

- shteti kombëtar, 123, 231, 235, 240
- shteti osman, 31, 38, 41, 49, 61, 72, 136, 160, 168, 173, 185-6, 192, 204, 228, 237, 253, 296, 300, 308, 314
- shteti-komb, 357
- T**
- talebanët, 113, 211-2
- tëhuajësimi, 17, 18, 34, 211
- teknologjia, 36, 140-1, 145, 269
- teologjia hebraike, 285
- thesari intelektual, 13
- tjetërsimi shkatërrimtar, 275
- Toffler, 26, 268
- Tojnbi, 39, 59-62, 145-6, 170, 281, 305, 325
- Toni Bler, 211
- torn country*, 178, 200, 249
- trashëgimia antike, 265
- Turqia, 23, 25, 28-30, 43, 48, 86, 99, 104, 114, 119, 121, 130, 135, 149, 169, 178-85, 188-93, 195-200, 202, 204-5, 207-9, 211-2, 214-5, 225, 227-8, 230-7, 239, 243-4, 252, 290, 331, 373
- U**
- Uashingtoni, 34, 260, 330
- Uillsoni, 359
- universiteteti, 73, 202, 239, 244, 246
- Ushtria e Kuqe, 49
- V**
- verstehen*, 250
- vetëbesimi, 37, 132, 139, 141, 147, 159, 164, 179, 183, 186, 196, 199, 212, 248, 296, 298, 303
- Xh**
- Xhemil Meriç, 289
- xihadi, 171, 213
- Xhorxh Bush, 133
- Z**
- Zoti, 63, 76, 102-3, 143, 149, 151, 158, 176
- W**
- WASP, 72, 78, 79, 107

Ahmet Davutogllu

Prof. Dr. Ahmet Davutogllu është lindur në vitin 1959 në Tashkent të Konjës (Republika e Turqisë). Është diplomuar në Universitetin e Bosforit (Boğaziçi Üniversitesi) më 1984, në degët ekonomi dhe shkenca politike. Në po këtë universitet ka magjistruar në drejtimin e administratës publike (1985), kurse titullin e doktorit të shkencave e ka fituar në atë të marrëdhënieve ndërkombëtare (1990). Ndërmjet viteve 1990-1995 ka punuar në Malajzi si anëtar i trupit mësimor universitar dhe si drejtues (në IIUM), e më pas si profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Marmara (Stamboll). Një kohë e ka ushtruar detyrën e shefit të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Beykent (Stamboll). Aktualisht është këshilltar kryesor në Kryeministrinë e Turqisë.

Është njohës i mirë i anglishtes dhe arabishtes.

Davutogllu është pjesëmarrës i tribunave, konferencave dhe simpoziumeve të shumta anekënd botës dhe autor i artikujve të ndryshëm shkencorë.

Lëmenjtë e tij të hulumtimit dhe ligjërimit janë: marrëdhëniet ndërkombëtare, ekonomia politike ndërkombëtare, historia e mendimit politik, historia krahasimtare e qytetërimeve, historia e diplomacisë, analiza strategjike rajonale, politika e Lindjes së Mesme dhe filozofia politike krahasimtare.

Punimet e tij shkencore janë shkruar me një metodë interdisiplinore dhe një pjesë e mirë e tyre janë përkthyer në gjuhë të ndryshme botërore.

Deri tash i ka të botuara këto vepra: *Alternative Paradigms* (University Press of America, Lanham, 1994), *Civilizational Transformation and the Muslim World* (Quill, K. L., 1994), *Stratejik Derinlik-Türkiye'nin Uluslararası Konumu* (Küre Yayınları, İstanbul, 2001), *Küresel Bunalım - 11 Eylül Konuşmaları*, (Küre Yayınları, İstanbul, 2002). Vepra e tij *Stratejik Derinlik* (Thellësia strategjike) menjëherë pas botimit zuri vend në mesin e librave më të shitur në Turqi, ndërsa autorit ia solli çmimin "Mendimtari i vitit" të cilin e ndan Shoqata e Shkrimtarëve të Turqisë.



Copyright©Logos-A, 2009

www.logos-a.com.mk



Kakofonia e shkaktuar në debatet mbi shkaqet dhe pasojat e sulmit të 11 shtatorit në SHBA, ka përparuar klinikisht aq shumë sa që është shndërruar në zhurmë shurdhuese, që i rrezikon gjasat e komunikimit, i cili ofron alternativë serioze për të nxjerrë mësim, që do t'i shërbejnë të ardhmes më të mirë të njerëzimit. Dokrinat e tipit të asaj për fundin e historisë, të ballafaquara me fundin e vet, nuk kanë më asnjë gjasë që të vetëkorrigjohen dhe të ofrojnë një shteg të ri, për ta kuptuar kompleksitetin e kundërthënies të botës së sotme dhe për ta ravijëzuar të ardhmen mbi bazat e joviolencës dhe të bashkëjetesës paqësore të qytetërimeve.

Libri 'Krizë globale', me gjerësinë e trajtimit të krizës së konceptit dominues të Perëndimit, për përplasjen e qytetërimeve dhe përparësinë e imagjinuar të qytetërimit perëndimor, të bazuar në forcë, u ofron lexuesve një rast unik që t'i afrohen të vërtetës mbi krizën e sotme globale të botës dhe mbi udhët që mund ta nxjerrin nga kjo krizë.

Në ambientin, ku ka shumë zhurmë shurdhuese, një ligjëratë e tillë është dhuratë me vlerë të madhe për të gjithë njerëzit e arsyeshëm dhe vullnetmirë.

Dy shembjet që ndodhën në një largësi prej dymbëdhjetë vitesh shkaktuan pasoja me të cilat forcat qendrore të rendit ndërkombëtar ishin të detyruara të ballafaqoheshin. Pas shembjes së Murit të Berlinit nuk u arrit të krijohet infrastruktura institucionale e një rendi botëror të qëndrueshëm dhe të drejtë. Përkundrazi, nxitja e konkurrencës në rajonet e tendosura, pas shembjes së Kullave Binjake nxori në pah fusha të reja problematike. Shkurt e qartë, sakrifikimi i atmosferës optimiste të formuar nga shembja i parë për hir të konkurrencës së bazuar në forcë, ia përgatiti shtratin shembjes së dytë. Në këtë libër që përbëhet prej bisedave rreth këtyre shembjeve, trajtohen përmasat filozofike dhe strategjike të krizës globale, ndikimet e kësaj krize mbi shoqëritë perëndimore dhe ato lindore.

